





Eruditi, juristi dhe komentuesi
NASER MEKARIM SHIRAZI



KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i tretë)

TIRANË, 2011

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i tretë)

Autori: **Eruditi, juristi dhe komentuesi**

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Mohammad Reza Haxh Khezr**

E përktheu nga arabishtja: **Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrektura letrare: **Liseda RAMAJ**

Korrektura teknike: **Vjollca FEZA**

Përkujdesja grafike: **Vullnet MERJA**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Ajeti 253

تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ مِّنْهُمْ مَّنْ كَلَّمَ اللَّهُ ^ط وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ
دَرَجَاتٍ ^ج وَءَاتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ الْبَيِّنَاتِ وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ^ق وَلَوْ
شَاءَ اللَّهُ مَا أَقْتَلَ الَّذِينَ مِنْ بَعْدِهِمْ ^ن مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَاتُ وَلَكِنْ
أَخْتَلَفُوا ^ف فَمِنْهُمْ مَّنْ ءَامَنَ وَمِنْهُمْ مَّنْ كَفَرَ ^ج وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَقْتَلُوا وَلَكِنْ

اللَّهُ يَفْعَلُ مَا يُرِيدُ

“Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët. Disave All’llahu u foli drejtpërdrejt, kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta. Ne i dhamë Isait, birit të Merjemes, prova të qarta dhe e ndihmuam me Shpirtin e Shenjtërisë. Sikur të donte All’llahu, njerëzit që erdhën pas të dërguarve nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin pas ardhjes së provave të qarta, por ata u përçanë: disa besuan, kurse të tjerët mohuan. Sikur të donte All’llahu, ata nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin, por All’llahu bën si të dojë Vetë.”

Komentimi

Roli i profetëve në jetën e njerëzve

Ky ajet tregon për shkallët e të dërguarve, për pozitën dhe për rolin e tyre në jetën e shoqërive njerëzore. Ajeti thotë: **“Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët...”**

Fjala *tilke*, në gjuhën arabe, është përemër tregues për larg. Në gjuhën dhe sintaksën arabe, përemri tregues për larg *ismul isharatu* përdoret për shfaqjen e respektit dhe të nderimit të pozitës së lartë të një personi apo të diçkaje që tregohet për të. Përdorimi i kësaj fjale këtu ka si qëllim të sqarojë pozitën e lartë të profetëve.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme për qëllimin e fjalës *er rusul - të dërguar*, që përmendet në këtë ajet. Vallë, kjo fjalë ka për qëllim të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët apo vetëm ata të dërguar, emrat dhe historitë e tyre janë përmendur në ajetet e mëparshme të kësaj sureje, si: Ibrahim, Musai, Isai, Daudi dhe Ishmuili? Apo janë të gjithë të dërguarit që i përmend Kur'ani deri me zbritjen e këtij ajeti?

Mirëpo, me sa duket, qëllimi i fjalës është për të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët, sepse fjala *er rusul* është e paraprirë nga *elifi* dhe *lami* që tregojnë përgjithësi, gjithëpërfshirje, kështu që kjo fjalë i përfshin të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët.

“...disa syresh i ngritëm mbi të tjerët...”

Në këtë fjali të ajetit duket qartë se profetët, edhe pse janë të njëjtë në profetësi dhe në përcjelljen e mesazhit, nuk janë të njëjtë në pozitë, për shkak të ndryshimit të misioneve dhe të përmasës së sakrificave të tyre.

“...Disave All'llahu u foli drejtpërdrejt...”

Kjo fjali e ajetit tregon për disa nga vetitë e të dërguarve. Këtu bëhet fjalë për hazretin Musa (Paqja e All'llahut qofitë mbi të!), i cili njihet me emrin Kelijmull'lah- biseduesi me All'llahun, siç thuhet edhe në ajetin

164 të sures “En-Nisa”: **“...Sa i takon Musait, All’llahu i ka folur atij drejtpërdrejt.”**

Përsa i përket thënies se qëllimi në këtë ajet është për profetin islam dhe se bisedimi këtu është ai që ka ndodhur në natën e Miraxhit, kjo është e largët.

Gjithashtu, edhe thënia se qëllimi është *uahji, zbulesa, frymëzimi*, që përmendet në ajetin 51 të sures “Shura”: **“Asnjë njeriu nuk i është dhënë t’i flasë All’llahu, përveçse me anë të Frymëzimit...”**, edhe kjo është e largët, sepse frymëzimi përfshin të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët dhe se fjala *minhum, prej tyre*, që tregon për pjesë, nuk është në përshtatje me frymëzimin.

Më pas ajeti shton: **“...kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta.”**

Kjo fjali e ajetit tregon për dallimin midis të dërguarve në shkallë dhe në pozitë. Ka mundësi që qëllimi në këtë përsëritje të tregojë për të dërguarit e caktuar dhe në krye të tyre profeti i nderuar i Islamit, hazreti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse, feja e tij është feja e fundit dhe më e përsosura e tyre. Ai i dërguar, feja e të cilit është më e përkryer dhe më e plotë, duhet që të jetë më i larti i të dërguarve. Veçanërisht, në suren “En-Nisa”, ajeti 41 thuhet: **“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhammed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”**

Dëshmitar tjetër për këtë çështje është se ajeti i mëparshëm tregon për virtytet e hazretit Musa (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) dhe ajeti i mëpasshëm tregon për virtytet e hazretit Isa (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*). Kështu që çështja këtu ka nevojë për tregues të virtyteve të Profetit islam (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kjo për faktin se të tre janë profetë të një prej tri feve të mëdha në botë. Nëse emri i profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do ishte përmendur në mes profetit Musa dhe profetit Isa (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të dy!*), atëherë nuk

do të ishte e habitshme që qëllimi i ajetit është për profetin e Islamit, hazretin Muhammed Mustafanë. A nuk është feja e tij kufiri i mesëm mes dy feve të tjera dhe se çdo gjë në fenë e tij ka ardhur e ekuilibruar dhe e mesme? A nuk thotë Kur'ani: **“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të mesme ...”**?

Pra, shprehjet në këtë ajet tregojnë se qëllimi (kuptimi) i frazës **“disa syresh i ngritëm mbi të tjerët”** është për profetët e mëparshëm, si Ibrahim, sepse në ajetin pasardhës All'llahu i Madhëruar thotë: **“Sikur të donte All'llahu, njerëzit që erdhën pas të dërguarve nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin...”**

“...Ne i dhamë Isait, birit të Merjemes, argumente të qarta dhe e ndihmuam me Shpirtin e Shenjtërisë ...”, pra, Ne i dhamë atij argumente të qarta, si: shërimi i sëmundjeve të vështira, ringjallja e të vdekurve, me lejen e All'llahut, si dhe njohuri të shumta fetare.

Ndërsa, përsa i përket qëllimit të fjalës *rubul kuds*, a është Xhebraili, mbartësi i Shpalljes apo është fuqi tjetër e panjohur dhe e ndryshme, që gjendet te evlijatë e All'llahut? Sqarimet rreth kësaj teme u përmendën në komentimin e ajetit 87 të sures “El-Bekare”.

Gjithashtu, ajeti tregon për situatën dhe gjendjen e popujve të mëparshëm pas profetëve dhe mosmarrëveshjet që ndodhën mes tyre. Ajeti thotë: **“Sikur të donte All'llahu, njerëzit, që erdhën pas të dërguarve, nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin pas ardhjes së provave të qarta...”**.

Pozita dhe madhështia e të dërguarve nuk e ndalojnë gjetjen e mosmarrëveshjeve në mesin e ndjekësve të tyre, sepse All'llahu e ka lënë të lirë njeriun. Mirëpo njeriu e keqpërdor përfitimin nga kjo liri:

“...por ata u përçanë, disa besuan, kurse të tjerët mohuan.”

Është e qartë se mosmarrëveshjet mes njerëzve lindin si pasojë e ndjekjes së egos dhe unit të tyre. Mirëpo, mes të dërguarve

të All'llahut nuk ka asnjë lloj mosmarrëveshje, pasi kanë të gjithë një qëllim të përbashkët.

Më pas ajeti dëshmon se All'llahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm për ndalimin e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve mes njerëzve, qoftë edhe me detyrim. Mirëpo, Ai bën çfarë të dojë, mbështetur në urtësinë e përputhur me plotësimin dhe përsosmërinë e njeriut. Për këtë, Ai e ka lënë njeriun të lirë që të zgjedhë: **“Sikur të donte All'llahu, ata nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin, por All'llahu bën si të dojë Vetë.”**

Nuk ka dyshim se disa njerëz e keqpërdorin këtë liri. Prania e lirisë në shoqëri konsiderohet e domosdoshme për plotësimin dhe përsosmërinë e njeriut, sepse përsosmëria e detyruar nuk quhet përsosmëri.

Nga përmbajtja e ajetit, që flet për çështjen e detyrimit, shohim se besimi me detyrim është i pasaktë. Ajeti konstaton se All'llahu i Madhëruar e ka lënë të lirë njeriun, ku disa besojnë dhe disa të tjerë nuk besojnë.

Hulumtim

Vallë, a janë fetë shkak i mosmarrëveshjeve?

Disa shkrimtarë perëndimorë i akuzojnë fetë, duke thënë se ato janë shkak i ndarjes dhe i mosmarrëveshjeve mes njerëzve. Po ashtu, thonë se fetë janë shkak i shumë gjakderdhjeve dhe se historia dëshmon për shumë luftëra fetare.

Në këtë mënyrë, ata u përpoqën të dënojnë fetë dhe t'i konsiderojnë si shkaktare në ndodhitë e luftërave dhe të mosmarrëveshjeve.

Si përgjigje të thënieve të tyre po japim disa sqarime:

Së pari: Mosmarrëveshjet, që përmenden në ajetin e lartpërmendur, në të vërtetë nuk ndodhën mes ndjekësve të vërtetë të një feje, por ato lindin nga ndjekësit jo të sinqertë dhe nga kundërshtarët e fesë. Nëse shohim ndonjë mosmarrëveshje mes ndjekësve të ndryshëm të feve, ato nuk janë si shkak i mësimave fetare, por për shkak të devijimeve, të fanatizmit të verbër dhe të përzierjes së feve qiellore me paganizmin.

Së dyti: Vërtet feja dhe ndikimi i saj sot është kufizuar vetëm te një pjesë e shoqërisë njerëzore. Edhe pse është e tillë, shohim se luftërat janë ashpërsuar dhe janë zgjeruar në anët e ndryshme të botës. Vallë, është feja shkaktare e këtyre luftërave apo shpirti uzurpues në disa njerëz është shkak i vërtetë i tyre? Mirëpo, sot këto luftëra shfaqen me veshje fetare. Një ditë tjetër me veshjen e fraksioneve ekonomike dhe politike. Një ditë tjetër me veshje tjetër. Sido që të jetë, feja nuk ka asnjë faj në këtë çështje, por janë pushtuesit ata që i ndezin zjarret e luftërave, duke përdorur argumente të shumëllojshme.

Së treti: Vërtet, fetë qiellore, në veçanti Islami, të cilat e luftojnë fanatizmin dhe racizmin kombëtar, janë shkak për heqjen

e kufijve të racizmit dhe kufijve gjeografikë. Në këtë mënyrë fetë zhdukin luftërat që ndizen si pasojë e këtyre faktorëve. Të shumta janë luftërat në histori, që janë shuar dhe kjo i dedikohet feve qiellore. Po ashtu, shpirti i paqes, i vëllazërisë, moralet e përkryera dhe ndjenjat njerëzore, flamurin e të cilave e ngrenë sa më lart fetë qiellore, kanë ndikuar shumë në zhdukjen e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve midis njerëzve.

Së katërti: Vërtet, prej mesazheve të feve qiellore është çlirimi dhe përkrahja e shtresave të varfra e të shtypura. Ky mesazh ka qenë shkak i luftërave që kryen të dërguarit dhe ndjekësit e tyre kundër të padrejtëve dhe shfrytëzuesve, siç ishin Faraoni dhe Nemrudi. Këto luftëra, që konsiderohen përpjekje në rrugën e çlirimit të njeriut, nuk përbëjnë problem tek fetë. Përkundrazi, ato janë shenja të krenarisë dhe të fuqisë së tyre. Vërtet, luftërat e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si me politeistët mekas, ashtu edhe me kisrat, të gjitha kanë qenë të tilla.

Ajeti 254

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعَ فِيهِ

وَلَا خَلَّةَ وَلَا شَفْعَةً وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobsimtarët janë keqbërësit e vërtetë.”

Komentimi

Dhënia është ndër shkaqet e rëndësishme të shpëtimit në Ditën e Gjykimit

Ajetet e mëparshme folën për kombet e shkuara, për xhihadin e qeverive hyjnore dhe për mosmarrëveshjet që ndodhën në mesin e njerëzve pas largimit nga kjo jetë të profetëve (*Paqja e All'llabut qofitë mbital*). Ky ajet u bën thirrje myslimanëve dhe u tregon për një nga detyrat e rëndësishme të tyre, e cila është faktor i forcimit të bazës së tyre mbrojtëse dhe e unifikimit të fjalës dhe e qëndrimit të tyre. Ajeti thotë: “O ju që keni besuar! Jepni nga të mirat që ju kemi dhënë Ne...”

Fjalja: “...nga të mirat që ju kemi dhënë Ne...” ka kuptim të gjerë. Ajo përfshin dhënien e detyrueshme dhe atë të pëlqyeshme, vullnetare.

Po ashtu, edhe dhënien shpirtërore: si, mësimi e të ngjashëm me të. Mirëpo, po të shihet “kërcënimi” në fundin e ajetit,

do të kuptohet se qëllimi në dhënie të jetë për atë të detyrueshmen, pra, zekatin e të ngjashme më të. Në shtesë të saj duhet thënë se dhënia e detyrueshme e forcon edhe më shumë Bejtul Malin- Thesarbajtësen - dhe strukturën e shtetit. Fjala *mimma* tregon se kjo dhënie është për një pjesë të pasurisë së një personi dhe jo për të gjithën.

I ndjeri Tabarsij, në komentimin “Mexhmaul Bejan”, anon më shumë nga mendimi i përgjithësisë së ajetit, në lidhje me dhënien e detyrueshme dhe atë të pëlqyeshme. Ai thotë se fundi i ajetit nuk konsiderohet kërcënim, por është njoftim për ndodhitë e frikshme që do të ndodhin në Ditën e Kiametit.¹

Mirëpo, duke parë fundin e ajetit, që thotë se jobesimtarët janë të padrejtët, sqarohet se mosdhënia e detyrueshme është një prej llojeve të mosbesimit dhe të padrejtësisë.

Më pas ajeti shton: **“...para se të vijë Dita në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi!”** Duhet të jepni, nëse sot keni mundësi ta bëni, sepse Ahireti, që është vendi i korrijës së atyre që mbollët në këtë jetë, nuk ju jep mundësinë të bëni asgjë.

Në atë botë nuk ka as bashkëpunime reciproke, as marrëveshje ekonomike, me të cilat mund të blini lumturinë dhe shpëtimin prej ndëshkimit. As lidhjet shoqërore, që nëpërmjet tyre fitoni në këtë jetë poste e pasuri, nuk ju bëjnë dobi, sepse vetë shokët tuaj, që kishit në këtë jetë, do të ankohen nga rezultati i punëve të tyre dhe nuk u bëjnë asgjë të tjerëve.

Në atë Ditë as ndërmjetësimi (shefaati) nuk do t’ju bëjë dobi, sepse ju nuk e zbatuat dhënien e detyrueshme; nuk keni vepruar ashtu siç duhet, që ta meritoni shefaatin. Kështu që të gjitha dyert e shpëtimit janë të mbyllura përpara jush.

¹ “Mexhmaul Bejan”; vëll. 1 dhe 2, f. 360.

“Jobsimtarët, ata janë të padrejtët.” Për faktin se ata nuk e zbatuan dhënien dhe zekatin. Në këtë mënyrë ata i bënë padrejtësi vetes së tyre dhe njerëzve të tjerë.

Me këtë ajet Kur'anit sqaron:

Së pari: Vërtet, jobsimtarët i bëjnë padrejtësi vetes së tyre. Duke mos zbatuar dhënien e detyrueshme dhe duke mos praktikuar detyrat e tjera fetare dhe humane, ata ia ndaluan vetes së tyre lumturinë më të madhe. Padyshim, këto moszbatime do t'ia rëndojnë kurrizin në Ditën e Gjykimit. Sigurisht që All'llahu nuk i ka bërë padrejtësi atyre, por ata i bënë padrejtësi vetes së tyre.

Së dyti: Gjithashtu, jo besimtarët i bëjnë padrejtësi individëve të shoqërisë së tyre. Kjo për arsye se mosbesimi është burimi i zemërngurtësisë, i të dhënit pas anës materiale dhe i adhurimit të dynjasë. Të gjitha këto janë burime të padrejtësisë. Duhet theksuar se fjala *kufr- mosbesim*, që përmendet në këtë ajet ka kuptimin e *rebelimit, të kokëfortësisë, të mëkatit dhe të mosbindjes ndaj urdhrave të All'llabut*. Fjala *kufr*, me këtë kuptim, përdoret shumë jo vetëm në Kur'anin Fisnik, por edhe në tekstet e tjera islame.

Ajeti 255

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَهُ مَا فِي
السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۗ يَعْلَمُ مَا
بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۗ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ ۗ
وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ ۗ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۗ وَهُوَ الْعَلِيُّ

الْعَظِيمُ

“All’llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursiu¹ i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!”

¹ Termi *Kursij*, fjalë për fjalë, përkthehet: stol, karrige, ndenjësë. Kursiu është një krijesë madhështore e All’llahut me formën e treguar nga kuptimi i saj gjuhësor dhe që ndodhet në këmbët e Fronit të All’llahut. Ai shtrihet mbi qiejt dhe tokën dhe, sipas transmetimeve autentike nga profeti Muhammed (a.s.), përmasat e tij janë aq të mëdha, saqë qiejt dhe toka, në krahasim me të, ngajnë si unaza në shkretëtirë.

Ajeti Kursij, një prej ajeteve më të rëndësishëm të Kur'anit

Për sqarimin e rëndësisë dhe të mirësisë së këtij ajeti mjafton thënia e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur e pyeti Ubej ibn Ka'b: "Cili është ajeti më i mirë prej ajeteve të Kur'anit?"

Profeti iu përgjigj: **"All'llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!"**

Ubeji ka thënë: "Pastaj Profeti vendosi dorën e tij në gjoksin e vet dhe tha: **"... Beto hem në Atë, shpirti i Muhammedit është në dorën e Tij, se ky ajet ka gjuhë dhe dy buzë që e madhërojnë All'llahun nën Arsh."**

Në një hadith tjetër, transmetuar nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), profeti Muhammed ka thënë: **"Padroni i Kur'anit është surja "El Bekare" dhe padroni i sures "El Bekare" është "Ajeti Kursij". O Ali! Ky ajet ka pesëdhjetë fjalë dhe çdo fjalë ka pesëdhjetë të mira."**

Në një hadith tjetër, transmetuar nga imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: **"Cilido që lexon "Ajetin Kursij" një herë, All'llahu do t'i largojë atij njëmijë të këqija prej të këqijave të kësaj jete dhe një mijë të këqija prej të këqijave të Ahiretit. E keqja më e lehtë është varfëria dhe më e keqja në Ahiret është dënimi i varrit."**

Transmetohet se Ebi Abdilahi, imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: **"Çdo gjë ka majë dhe maja e Kur'anit është Ajeti Kursij."**¹

Të shumta janë transmetimet islame rreth mirësisë së Ajetit Kursij. Po e mbyllim me një thënie të profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **"Ajeti Kursij ka ardhur prej thesareve nën Arsh dhe ai nuk i është dhënë asnjë profeti para meje."**²

¹ "Mexhmaul Bejan"; vëll. 1, f. 360.

² Tefsijrul "Burhan"; vëll. 2, f. 245. "Biharul Anuar"; vëll. 89, f. 264. Për sqarime të mëtejshme shiko "Biharul Anuar"; vëll. 89, f. 262 -272.

Komentimi

Një grup atributesh të hijeshisë dhe madhësisë së All'llahut

Ky ajet fillon me përmendjen e Vetës së Shenjtë me çështjen e Njeshmërisë (teuhidit) me emrat e bukur të All'llahut dhe me cilësitë e larta të Tij, ku thotë: **“All'llahu! Nuk ka Zot tjetër përveç Tij...”**

All'llah do të thotë Vetë e vetme grumbulluese e cilësive të përsosura, që është Krijuesi i gjithçkaje. Në këtë ekzistencë nuk gjendet adhures tjetër përveç All'llahut.

Me fjalinë: **“All'llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij...”**, Kur'ani sqaron Njeshmërinë e Krijuesit të ekzistencës dhe kjo Njeshmëri është baza e Islamit. Mirëpo, siç e thamë, kjo e vërtetë gjendet te fjala All'llah. Për këtë edhe fjalja: **“All'llahu! Nuk ka Zot tjetër përveç Tij...”** është dëshmuese dhe vërtetuese e po asaj të vërtetë që përmban fjala *All'llah*.

Fjala *el haj-j-i i gjallë*, përdoret për atë që jeton dhe kjo është sifetun mushebbahah¹, që tregon për përleshmëri dhe vazhdimësi. Nga njëra anë, jeta e All'llahut është e vërtetë, sepse jeta e Tij është po Veta e Tij dhe nuk është rastësi ose diçka e rastit për Atë dhe as e ardhur nga diçka tjetër. Në ajetin 58 të sures “Furkan” thuhet: **“Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes...”**

Nga ana tjetër, jetë e vërtetë dhe e plotë është ajo që nuk pasohet me vdekjen. Për këtë, jeta e vërtetë është jeta e All'llahut, është e vazhdueshme dhe e përherëshme (*minel ez el ilel ebed*).

Ndërsa jeta e njeriut, e cila pasohet me vdekjen, nuk mund të jetë e vërtetë. Në ajetin 64 të sures “Ankebut”, lexojmë: **“Jeta e kësaj**

¹ Sifetun mushabeha kakuptimin e cilësive të ngjashme. Duhet ditur se cilësitë e All'llahut të Madhëruar edhe pse janë të ngjashme në emërtim me cilësitë e njeriut, por ato ndryshojnë në essence sepse cilësitë e All'llahut janë Veta e Tij e Shenjtë, ndërsa tek njeriu janë të fituara. (shënim i përkthyesit)

bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” Prandaj, jeta e vërtetë i përket vetëm All'llahut të Madhëruar.

Ç'do të thotë që All'llahu është i Gjallë?

Në shprehitë e përdorura, një qenieje i thuhet se është e gjallë, nëse cilësohet me rritjen, ushqimin, shumimin, me ndjeshmërinë dhe lëvizjen. Mirëpo duhet pasur kujdes se disa mendjeshkurtër e llogarisin jetën e All'llahut njësoj siç u përmend, ndërkohë që ne e dimë shumë mirë që Ai nuk mund të cilësohet me asnjë cilësi nga të përmendurat. Ky lloj krahasimi e çon njeriun të gabojë në fushën e njohjes së All'llahut, duke i krahasuar cilësitë e Tij me cilësitë e njeriut.

Fjala *el hajatu-jeta, me kuptimin e saj të gjerë*, është *dija dhe fuqia*. Prandaj, ai që zotëron dijen dhe fuqinë e pakufizuar, zotëron jetën e plotë e të vërtetë.

Jeta e All'llahut është grumbullim i dijes dhe i fuqisë së Tij. Në realitet, me dijen dhe fuqinë arrihet të bëhet edhe dallimi mes të gjallit dhe të vdekurit. Rritja, lëvizja, ushqyerja dhe shumimi janë cilësi të krijesave. Ato janë jo të plota dhe të kufizuara dhe krijesat e plotësojnë mangësinë e tyre me ushqim e me lëvizje. Kurse ai, që nuk është i mangët, nuk mund të cilësohet me këto cilësi.

Fjala *el kajjum - i përjetshmi*, është *sifatun mubalegh* (cilësi e hiperbolizuar)- *për përjetësinë*. Kjo fjalë tregon për ekzistencën e vetvetishme të All'llahut, kurse ekzistenca e krijesave është e lidhur me praninë e Tij. Me fjalë të tjera: Të gjitha krijesat e kësaj ekzistence janë të mbështetura te Ai (janë prej Tij).

Është e natyrshme së fjala *kijam*, siç përdoret në të shumtën e rastevenë ditët e sotme, *ka kuptimin e qëndrimit në një formë të caktuar*. Mirëpo, përderisa ky lloj kuptimi nuk përputhet me All'llahun e pastër nga cilësitë trupore (materiale), atëherë kuptimi i kësaj fjale në ajet

është prania e Tij -për krijimin, sistemin dhe zotimin, sepse Ai është Krijuesi i krijesave dhe është zotuar për sistemimin, edukimin dhe vazhdimësinë e tyre. Ai kurrë nuk është i pavëmendshëm, qoftë edhe për një çast të vetëm ndaj krijesave. Ai gjithmonë është *i vazhdueshëm* dhe *i përbërshëm*.

Nga kjo kuptohet se *el kajjum* është baza e të gjitha cilësive vepruese si: Krijues, Dhënës, Udhëzues, Ngjallës i të vdekurve, etj.

Pa dyshim që prania ndaj krijimit dhe sistemimit të çështjeve të botës i përfshin të gjitha këto, sepse Ai është Ai që jep e dhuron, Ai është Ai që ngjall, Ai është Ai që i vdes, Ai është Ai që udhëzon. Për këtë, edhe emrat Krijues, Dhurues, Ngjallës, e të ngjashme me to, të gjithë grumbullohen te *el kajjum*.

Në të vërtetë, fjala *el hajj* - *i Gjallë*, përfshin të gjitha cilësitë e All'llahut, si: dija, fuqia, dëgjimi, shikimi, etj. Dhe fjala *el kajjum*, tregon se të gjitha krijesat kanë nevojë për Të. Prandaj thuhet se emri më i madh i All'llahut i përfshin këto dy cilësi (*el hajju* dhe *el kajjum*).

Më poshtë ajeti thotë: **“...Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!...”**

Fjala *sunetun-dremitje*, vjen nga rrënja “*uesene*”, *kotet, dremit dhe fle gjumë të lehtë*. Sipas mendimit të shumë komentuesve, kjo ka kuptimin e dremitjes dhe e të çliruarit në fillim të gjumit. Me fjalë të tjera, ai është gjumi i lehtë.

Fjala *neumun-gjumi* është gjendja në të cilën bien disa shqisa të rëndësishme të njeriut. Në realitet, dremitja, konsiderohet si gjumë i rastit për syrin dhe, kur depërton thellë te njeriu dhe kap mendjen, atij i thuhet gjumë. Fjalja **“...Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!...”** është dëshmuar dhe vërtetuese e cilësisë së ekzistencës absolute, me të cilën cilësohet All'llahu. Kjo për faktin se prania e plotë dhe e pakufizuar në mbajtjen dhe drejtimin e ekzistencës nuk duhet të jetë për asnjë çast larg vëmendjes. Kjo do të thotë që

All'lahu nuk është i pavëmendshëm për asnjë çast në sundimin e Tij të plotë.

Për këtë, çdo cilësi, që nuk është në përputhje me përjetësinë e All'lahut, automatikisht nuk ekziston te Ai. Jo vetëm kaq, Vetja e Tij është e pastër, qoftë edhe nga ndikimi i çdo faktori që çon në pakujdesi e pavëmendshmëri në veprat e Tij, siç është dremitja.

Përsa i përket paraprirjes së fjalës *sinetun* ndaj fjalës *neum*, që përmenden në ajet, duke ditur që i forti përmendet më parë së i dobëti, kjo i kthehet normalitetit të procesit të gjumit, sepse në fillim njeriu dremit, më pas dremitja shtohet më shumë, derisa hyn në gjumin e thellë.

Ky ajet flet për vërtetësinë e vazhdimësisë së mirësive të All'lahut, për përheshmërinë e Tij dhe se Ai nuk është i pavëmendshëm asnjë çast ndaj ekzistencës. Ai nuk është si njerëzit, të cilët, për shkak të gjumit apo të faktorëve të tjerë, bëhen të pavëmendshëm ndaj të tjerëve.

Duhet pasur parasysh që shprehja: “Atë nuk e kaplon” është e mrekullueshme dhe e plotëson mjaft saktë qëllimin. Kjo shprehje e paraqet gjumin sikur është një qenie e fortë me kthetra, që e kap njeriun dhe e robëron. Nëse njeriu më i fortë dobësohet para mbretërisë së gjumit, kjo është një çështje për të cilën nuk gjendet debat.

Mbretëria e All'lahut është pakufi

“...Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë.”

Nuk mund të ketë kijam (sundim, udhëheqje) për çështjet e ekzistencës pa të qenit pronar absolut i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që ndodhet në to. Ky ajet, pas përmendjes së pushtetit absolut të All'lahut, tregon për një të vërtetë, se e tërë Gjithësia është pronë

vetëm e All'llahut të Madhëruar dhe çdo gjë, që ndodh në këtë Gjithësi, është me urdhrin e Tij.

Prandaj, njeriu nuk është pronar i vërtetë i asaj pasurie që ka në zotërim. Këtë pasuri ai e zotëron për një kohë të kufizuar dhe sipas kushteve të caktuara nga Pronari i vërtetë. Për këtë, duhet që pronarët e përkohshëm të zbatojnë plotësisht kushtet e vendosura nga pronari i vërtetë dhe absolut. Përndryshe, pronësia e tyre e përkohshme bëhet e pavlefshme dhe nuk u lejohet përdorimi i saj.

Kushtet e vendosura për përdorimin e pasurive janë të ardhura nga sheriati dhe u janë prezantuar njerëzve. Është e qartë se ky kushtëzim, në realitet, konsiderohet një faktor i rëndësishëm prej faktorëve edukativë. Kjo për faktin se, kur njeriu beson se nuk është pronar real i asaj që zotëron dhe se atë që zotëron e ka në përdorim për një kohë të shkurtër, padyshim që ai nuk do t'i shkelë të drejtat e të tjerëve dhe nuk do të vrapojë pas lakmisë, koprracisë dhe monopolizmit, të cilat bëhen të pranishme tek njeriu si rezultat i dhënies pas dynjasë. Ai kushtëzim është nxitës për edukimin e njeriut, me qëllim që të njohë të drejtat e tij legjitime.

“Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?”

Në realitet, kjo është një përgjigje për pretendimin e politeistëve, që thoshin se ne i adhurojmë idhujt që ata të jenë ndërmjetësuesit tanë tek All'llahu, siç thuhet edhe në ajetin 3 të sures “Zumer”: **“Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek All'llahu.”**¹

Ky ajet është si një lloj pyetësori mohues, që ka kuptimin se askush nuk e kryen ndërmjetësinë pa lejen e All'llahut të Madhëruar.

¹ Frazja *ma - fjarë, ç'ka*, që gjenden në fjalinë “Çfarë ka në qiej dhe në tokë.” është përdorur për krijesat jofrymore. Meqenëse edhe frymorët janë pronësi e All'llahut të Madhëruar, kjo frazë është përdorur për shkak të shumicës, sepse krijesat jofrymore (jomendore) janë më të shumta se ato frymore (mendore).

Ky ajet plotëson kuptimin e Përjetësisë dhe të sundimit absolut të All'llahut për çdo gjë që gjendet në këtë gjithësi.

Me fjalë të tjera themi: Nëse dëgjojmë se dikush bën ndërmjetësim tek All'llahu, kjo nuk do të thotë se ai njeri zotëron diçka dhe se ndikimi i tij është i pavarur. Por, nëse ai ndërmjetëson, kjo është një dhunti nga ana e All'llahut të Madhëruar. Kur ai njeri e kryen ndërmjetësimin me lejen e All'llahut, ky është një argument tjetër, që tregon në vetvete për përjetësinë dhe fuqinë absolute të All'llahut.



Hulumtim

Ndërmjetësimi nuk është hatërllek

Shefaati¹ është ndihma që i fortë i jep të dobët për të kaluar fazat e plotësimit të tij me lehtësi dhe me sukses.

Mirëpo, kjo fjalë përdoret edhe si ndërmjetësim për faljen e gjynaheve. Por, kjo fjalë ka kuptim më të gjerë dhe përfshin të gjithë faktorët dhe shkaqet në këtë ekzistencë. P.sh: toka, uji, ajri dhe rrezet e diellit janë faktorë dhe shkaqe që e ndihmojnë farën e bimës apo të pemës që ajo të mbijë dhe të bëhet bimë apo pemë e plotë.

Nëse shefaatin, që përmendet në këtë ajet, do ta shohim se ka këtë kuptim të gjerë, do të mësojmë se ndikimi i faktorëve dhe i shkaqeve të ndryshme nuk e kufizojnë sundimin absolut të All'llahut e as nuk e pakësojnë fuqinë e Tij, sepse ndikimi i të gjithë këtyre faktorëve nuk arrihet veçse me lejen e All'llahut të Madhëruar. Edhe ky është një tjetër argument i Përjetësisë dhe i sundimit absolut të Tij.

¹ Për shefaatin folëm hollësisht në xhuzin e parë të këtij komentimi, pikërisht në komentimin e ajetit 48 të sures së bekuar “El-Bekare”.

Disa njerëz hamendësojnë se shefaati, në dijen e fesë, është i ngjashëm me hatërllekun dhe se kuptimi i tij i përgjithshëm është lejimi i njeriut të bëjë çfarëdo lloj gjynahu, pastaj të kërkojë ndërmjetësim për faljen me lehtësi të atyre gjynaheve.

Por, çështja nuk është e tillë. As kundërshtuesit nuk e kanë kuptuar ashtu siç duhet shefaatin nga prizmi fetar, po ashtu, as mëkatarët, që i thyejnë dhe i tejkalojnë kufijtë e All'lahut.

Shefaati që e bëjnë besimtarë të devotshëm, mund të konsiderohet si “shefaat tekvinij”, i cili realizohet nëpërmjet faktorëve natyrorë njësoj si realizohet te fara e bimës. Ashtu si fara nuk mund të mbijë e të rritet kur nuk janë të pranishëm rrezet e diellit, uji dhe ajri, po ashtu edhe shefaati i të dashurve të All'lahut nuk mund të realizohet kurrë për ata që nuk e meritojnë.

Jo vetëm kaq, ata as bëjnë shefaat për njerëzit që nuk e meritojnë.

Shefaati ka nevojë për marrëdhënie shpirtërore mes ndërmjetësit dhe ndërmjetësuesit. Prandaj, cilido, që shpreson në ndërmjetësim, duhet që në këtë jetë të krijojë lidhje shpirtërore me atë që beson se do t'i bëjë ndërmjetësim. Në realitet, këto marrëdhënie do të jenë mjet prej mjeteve edukative të atij që kërkon ndërmjetësim, e cila e afron atë në medresenë e ideve të ndërmjetësuesit. Kjo është ajo që e bën atë të meritueshëm për të fituar shefaatin.

Nga kjo kuptohet se shefaati nuk e ndryshon dëshirën dhe vullnetin e All'lahut të Madhëruar ndaj gjynahqarëve dhe mëkatarëve.

“Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara tyre dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre.”

Pas fjalëve rreth shefaatit dhe se ai arrihet vetëm me lejen e All'lahut të Madhëruar, vjen fjalia tjetër sqaruese e kësaj thënieje. Kjo fjali e ajetit në fjalë thotë se All'lahu është i Gjithëditur për të shkuarën dhe të ardhmen e atyre që kërkojnë shefaat.

Ai është i Gjithëditur edhe për të fshehtat e tyre. Prandaj, ata janë të paaftë që të sqarojnë çështje të reja për ndërmjetësuesit, me anë të të cilave ta bëjnë All'llahun të ndryshojë vendimin e Tij rreth tyre.

Komentuesit përmendin alternativa të shumta rreth kuptimit të fjalisë: **“Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara tyre dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre.”** Disa kanë thënë se kuptimi i togfjalëshit: **“përpara tyre”** ka për qëllim çështjet e dynjasë, e cila ndodhet para njeriut. Ndërsa kuptimi i togfjalëshit: **“pas tyre”** ka për qëllim çështjet e Ahiretit, të cilat do të vijnë pas kësaj jete të njeriut. Disa komentues të tjerë kanë përmendur të kundërtën e këtij komentimi.

Një grup i tretë komentuesish kanë thënë se kjo tregon për punët e njeriut, të mira apo të këqija, ose për çështje që njeriu i di dhe nuk i di.

Mirëpo, po të studiohen ajetet e Kur'anit, do të shihet se ky togfjalësh ka si qëllim vendin, siç thotë ajeti 17 i sures “A’raf” që përmend thënien e shejtanit: **“...e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta...”**

Nganjëherë këto dy fjalë, *përpara* dhe *mbrapa*, kanë kuptimin e aspektit kohor, siç thotë ajeti 170 i sures “Al Imran”: **“Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë All'llahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre...”**

Ndërsa në ajetin që po flasim, këto dy fjalë tregojnë për vendin dhe kohën, që do të thotë se All'llahu është i Gjithëditur për të shkuarën dhe për të ardhmen e njerëzve. Është i Gjithëditur për ato që i kanë para tyre dhe i njohin dhe për ato që ndodhen pas tyre dhe nuk i njohin. Nga kjo del se All'llahu është i Gjithëditur për kohën dhe vendin, prandaj çdo vepër është me lejen e Tij deri edhe shefaati.

Cilësia e tetë dhe e shenjtë e All'llahut është: **“kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron.”**¹

Edhe kjo frazë është dëshmuese dhe vërtetuese e dijes së gjerë dhe të pakufizuar të All'llahut dhe se dija e krijesave nuk është gjë tjetër veçse dhunti nga dija e Tij. Për këtë edhe dija e ndërmjetësuesve është e kufizuar përballë dijes së All'llahut. Dijsa e tyre është aq sa i ka dhënë All'llahu i Gjithëdijshëm.

Nga kjo frazë e ajetit përfitohen dy gjëra:

E para: Askush nuk është i ditur në vetvete, por të gjitha dijet dhe njohuritë e njerëzve janë prej All'llahut të Gjithëditur. Është Ai që i heq perdet për të zbuluar të vërtetën e krijimit dhe të fshehtat e natyrës dhe, si rezultat i njohjeve të vazhdueshme, njeriut i zgjerohen më shumë horizontet e njohjes.

E dyta: All'llahu i Madhëruar mund t'i japë atij që do dije nga të gajbit (të padukshmes) dhe informon atë që do për sekretet e të fshehtave.² Frazë: *la jubitune* është treguese e mahnitshme për të vërtetën e dijes, e cila është një lloj *ibatatu-rrethim*.

Për cilësinë e nëntë dhe të dhjetë të All'llahut të Madhëruar ky ajet thotë: **“Kursiu e Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato.”**

Dhe për cilësinë e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë ajeti thotë: **“Ai është i Larti, Madhështori!”**

¹ Shumica e komentuesve thonë se fjala *ilm-dituri*, që përmendet në këtë ajet, ka kuptimin *el ma'lum-i njobur*. Kjo është në përshtatje edhe me kuptimin e ajetit, si dhe me *teb'udhijeb*. Shih tefsijret “Mexhmaul Bejan”, “Tefsijrul Kebijr”, “Ruhul Meanij”, “El Kurtubij”, komentimi i ajetit në fjalë.

² Këtë do ta sqarojmë më mirë në komentimin e ajeteve që flasin për dijen e gajbit (të padukshmes), siç është ajeti 26 i sures “Xhin”.

Hulumtime

1- Kuptimi i Arshit dhe i Kursijut

Fjala *kursij*, rrjedh prej fjalës *kurs*, sipas *vaznit irth*, që do të thotë *origjina e diçkaje dhe themeli i saj*. Po ashtu përdoret për çdo gjë të grumbulluar dhe të lidhur. Përdoret edhe për stolin e ulët dhe ndenjësën. E kundërta e kësaj fjale është fjala el *arsh*, që ka kuptimin e tavanit, ose të diçkaje me tavan, ose të karriges me këmbë të larta. Përderisa mësuesi apo profesori ulen në karrige gjatë mësimdhënies, emri *kursij* u transformua që të tregojë për dijen. Nganjëherë përdoret si simbol edhe për pushtetin dhe sundimin dhe nënkupton udhëheqjen dhe qeverisjen.

Ky ajet flet për “kursijun e All’llahut” dhe se ajo përfshin qiejt dhe Tokën. Për këtë, kjo fjalë mund të ketë disa kuptime:

A-Zona e zbatimit të sundimit

Kjo do të thotë se sundimi i All’llahut është për qiejt dhe për Tokën dhe se ky sundim përfshin çdo vend. Pra, përfshin tërë botën materiale që gjendet në Tokë dhe në qiej, si: yjet, planetët, etj.

Sipas kësaj, *arshi* është më lart se bota jonë materiale, sepse *arshi*, siç e thamë, ka kuptimin e tavanit (sakf), ose diçka me tavan, ose send ulës më i lartë se karrigia. Në këtë mënyrë, *arshi* përfshin edhe botën e shpirttrave, të melekëve dhe të metafizikës. Pra, nëse vendoset fjala *kursij* përballë fjalës *arsh*, do të nxjerrim si përfundim se e para ka kuptimin e *botës materiale dhe të natyrës*, ndërsa e dyta ka kuptimin e *metafizikës*.

Për arshin gjenden kuptime të tjera, që do t’i përmendim në komentimin e ajetit 53 të sures së bekuar “El A’raf”. Kur nuk gjendet përballë fjalës *kursij*, atëherë kjo fjalë merr kuptimin e të gjithë Ekzistencës.

B- Zona e zbatimit të dijes

Kjo do të thotë se çdo gjë, që gjendet në qiej dhe në Tokë është e përfshirë në dijen e All'llaut të Madhëruar dhe asgjë nuk ndodhet jashtë kësaj dijeje absolute. Siç e thamë, fjala *kursij* është edhe metonimi për dijen.

Ka transmetime të shumta që e mbështesin këtë kuptim. Ndër to është edhe hadithi i përcjellë nga Hafs ibn Gijath e cila ka transmetuar nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), kur e pyetën për kuptimin e frazës: **“Kursiu e Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën”** dhe ai ka thënë: “Kuptimi i saj është dija.”¹

C- Diçka më të gjerë se qiejt dhe Toka

All'llahu është i Gjithëdijshtëm për çdo anë të tyre. Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është se Kursiu i All'llahut përfshin të gjithë qiejt dhe Tokën. Ky lloj komenti është përcjellë edhe nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), **i cili ka thënë:** “Kursiu është përfshirës i qiejve dhe i Tokës, e atyre që gjendet mes tyre dhe çka gjendet nën to.”²

Në disa transmetime të tjera thuhet se Kursiu është shumë herë më i gjerë se sa qiejt dhe Toka.

Kuptimi i parë dhe i dytë janë të qartë. Ndërsa kuptimi i tretë është diçka që dija njerëzore akoma nuk ka arritur ta njohë dhe të zbulojë sekretet e tij.

Deri tani nuk është konstatuar nga rrugët shkencore një pjesë e botës së qiejve dhe e tokës. Po ashtu, nuk ka argument që të mohojnë ekzistencën e saj.

Dijetarët dhe shkencëtarët, nëpërmjet mjeteve njohëse shkencore, e pohojnë të gjithë se zgjerimi i qiellit dhe i tokës shtohet me kalimin e ditëve dhe askush nuk thotë që zgjerimi i botës

¹ Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, 259, hadithi 1036.

² Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, 260, hadithi 1042.

ekzistuese është vetëm ky që njihet sot nga shkenca. Gjithashtu, nuk mund të largohet mundësia e pranisë së faktorëve të panumërt jashtë rrethinës së mjeteve vrojtuese që gjenden sot, të cilët ndikojnë në zgjerimin e universit.

Këtu shtojmë se të tre këto komente nuk e kundërshtojnë njëri-tjetrin, sepse fraza: **“Kursiu i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën...”** tregon për sundimin absolut të All'llahut dhe për zbatimin (ekzekutimin) e fuqisë së Tij në qiej e në tokë. Në të njëjtën kohë, kjo frazë tregon për praninë e dijes së Tij të pakufizuar, si dhe për ekzistencën e një bote tjetër, që është më e gjerë se bota jonë. Si konkluzion themi se ky ajet është plotësues i ajeteve të mëparshëm që flasin për dijen e gjerë të All'llahut.

Me fjalë të tjera: Arshi i sundimit të All'llahut dhe fuqia e Tij janë sunduese mbi qiejt dhe tokën. Kursiu i dijes së Tij përfshin çdo gjë. Asgjë nuk ndodhet jashtë sundimit dhe dijes së Tij.

Fjala *jeuduhu*, që përmendet te fjalia e ajetit: **“...dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato.”** vjen nga fjala *enede*, që do të thotë *rëndesë* dhe *vështirësi*. Kështu që ajeti ka kuptimin se ruajtja e qiejve dhe e tokës nuk është e rëndë dhe as e vështirë për All'llahun. Ai nuk është si krijesat, të cilat lodhen në mbajtjen e gjërave dhe ndiejnë vështirësi. Kjo për faktin se krijesat janë të dobëta dhe me fuqi të kufizuar, ndërsa fuqia e All'llahut është e pakufizuar. Tek Ai, si rëndesa edhe lehtësia, kanë një kuptim. Kuptimi i ndryshëm i rëndesës dhe i lehtësisë vërtetohet tek ai që ka fuqi të kufizuar.

Nga sa u tha më lart sqarohet se përemri që gjendet tek fjala *jeuduhu* tregon për All'llahun e Madhëruar. Supozimi se përemri tregon për Kursiun, meqenëse mbajtja e qiejve dhe e tokës nuk është e vështirë për Kursiun, është i dobët.

Thënia: **“Ai është i Larti, Madhështori!”** është dëshmuese dhe përforcuese për thëniet e mësipërme. Kjo do të thotë se All’llahu është më i Larti dhe më Madhështori ndaj çdo ngjashmërie. Ai është i Vetëm dhe i pashoq. Asgjë nuk është e rëndë, as e vështirë dhe nuk lodhet në mbajtjen e ekzistencës dhe në sundimin e saj. Ai kurrë nuk është i pavëmendshëm ndaj kësaj ekzistence dhe dija e Tij përfshin çdo gjë.

2- Vallë, Ajeti Kursij është i vetëm?

Mund të lindë pyetja: Vallë, Ajeti Kursij fillon me: **“All’llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij”** dhe mbaron me thënien: **“Ai është i Larti, Madhështori!”**, apo edhe dy ajete në vazhdim janë pjesë e Ajetit Kursij?

Nëse dy ajetet në vazhdim do të jenë pjesë e Ajetit Kursij, atëherë, kur të lexohet Ajeti Kursij në namazin e natës së varrimit të të vdekurit (namazul uahsheh), (namazi i frikës nga vetmia) duhen lexuar edhe dy ajetet në vazhdim.

Të gjitha argumentet tregojnë se Ajeti Kursij është ajeti i lartpërmendur.

a- Të gjitha transmetimet, që flasin për mirësitë e leximit a të këndimit të Ajetit Kursij, tregojnë se ky ajet është një.

b- Fjala *kursij* përmendet vetëm tek ajeti i lartpërmendur. Për këtë është quajtur edhe Ajeti Kursij.

c- Në disa transmetime shprehet qartë ky kuptim. Në një hadith, që ka përmendur shejhu Suduku, në librin e tij “El Amali”, rreth mirësive të këtij ajeti, i cili është i përcjellë nga imam Aliu (*Pagja qoftë mbi të!*) thuhet se imami e filloi leximin e Ajetit Kursij me: **“All’llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij.”** dhe e përfundoi me: **“Ai është i Larti, Madhështori!”**

d- Autori i librit “Mexhmaul Bejan” përmend një transmetim nga libri “Mustedrek Sefinetul Bihar”, se Ajeti Kursij është deri te thënia e All’llahut: **“Ai është i Larti, Madhështori!”**¹

dh- Në një hadith të profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që e ka përmendur imam Ali ibn Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: **“Kushdo që lexon katër ajetet e para të sures “El-Bekare”, Ajetin Kursij, dy ajetet pas Ajetit Kursij dhe tre ajetet e fundit të kësaj sureje (“El-Bekare”), nuk do ta godasë asgjë e keqe në veten e tij, as në pasurinë e tij. Atij nuk i afrohet djalli dhe as nuk e harron Kur’anin.”**²

Nga kjo thënie, gjithashtu kuptohet se Ajeti Kursij është vetëm një.

e- Në disa transmetime thuhet se Ajeti Kursij ka 50 fjalë dhe për çdo fjalë genden 50 të mira.³

Nëse numërohen fjalët e këtij ajeti, duke filluar nga: **“All’llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij..”**, deri te thënia: **“Ai është i Larti, Madhështori!”** do të dalin 50 fjalë.

Ka transmetime që thonë se duhen lexuar edhe dy ajetet e tjera pas Ajetit Kursij, deri te thënia: **“ku do të qëndrojnë përgjithmonë”** (fundi i ajetit 257), por jo me qëllimin se janë pjesë e Ajetit Kursij.⁴ Sido që të jetë, duke parë argumentet e mësipërme, Ajeti Kursij është vetëm një dhe jo më shumë.

3- Argumenti rreth rëndësisë së Ajetit Kursij

Rëndësia e Ajetit Kursij është shumë e madhe. Kjo rëndësi pasqyrohet në përmbajtjen e këtij ajeti, e cila përfshin shumë njohuri

¹ “Mustedrek sefinetul bihar”, vëll. 9, f. 101.

² “Biharul Anuar”, vëll. 89, f. 260. “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 621.

³ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 361.

⁴ “Uesailu Shiah”, vëll. 8, f. 172.

islame, përmend atributet e All'lahut dhe veçanërisht shpjegon Njëshmërinë e Tij.

Siç e përmendëm edhe më lart, këto cilësi ishin dymbëdhjetë dhe çdo cilësi, që përmendet në këtë ajet, është drejtuese për edukimin e njeriut dhe se njeriu duhet të mendojë thellë rreth tyre. Ebu Fetuh Raziu thotë: “Secili prej këtyre cilësive mohon një nga medhhebet e kota.” (Nëpërmjet këtij ajeti bëhet e mundur ndreqja e dymbëdhjetë ideve të gabuara.)¹



¹ Tefsijri “Ruhul Xhinan”, vëll.2, f. 327.

Ajeti 256

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ۗ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ ۚ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ
وَيُؤْمِرْ بِاللَّهِ فَقَدْ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انفِصَامَ لَهَا ۗ وَاللَّهُ سَمِيعٌ

عَلِيمٌ

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt dhe beson në All’llahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. All’llahu dëgjon dhe di gjithçka.”

Shkaku i zbritjes

Autori i tefsijrit “Mexhmaul Bejan”, Tabarsij, rreth shkaktut të zbritjes së ajetit thotë: “Në Medine jetonte një burrë, që quhej Ebul Hasijn dhe kishte dy djem. Disa tregtarë, që shkonin në Medine, i propozuan djemve të tij që të përqafojnë kristianizmin. Djemtë u ndikuan shumë nga fjalët e tregtarëve dhe e përqafulan kristianizmin. Të dy djemtë shkuan në Sham së bashku me tregtarët.

Ky veprim i djemve e shqetësoi shumë Ebu Hasijnin dhe shkoi të lajmëronte profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për atë që i kishte ndodhur. Ai i kërkoi Profetit që të bënte diçka për t’i rikthyer djemtë e tij në Islam.

Ebu Hasijni e pyeti Profetin se a është i lejuar detyrimi për t'i kthyer ata në Islam? Atëherë zbriti ajeti në fjalë dhe sqaroi: **“S’ka detyrim në fe.”**¹

Në tefsirin “El Manar” thuhet se Ebu Hasijni donte t'i detyronte djemtë e tij që të ktheheshin në Islam. Së bashku me babain e tyre shkuan tek profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për sqarimin e çështjes. Ebu Hasijni tha: “Si mund t’ia lejoj vetes sime që djemtë e mi të hyjnë në zjarr dhe unë të mos bëj asgjë ndaj tyre?!” Atëherë zbriti ajeti në fjalë.²



¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 22, f. 16.

² Tefsijrul “Manar”, komentimi i ajetit në fjalë.

Komentimi

Feja nuk është me detyrim

Ajeti Kursij përmban Njëshmërinë e All'llahut dhe cilësitë e Tij absolute, të cilat përbëjnë bazën e fesë. Përderisa këto argumentohen logjikisht, nuk është nevoja e detyrimit. Ky ajet thotë: **“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!”**

Fjala *er rushd* do të thotë *el hidaje-udbëzim për të arritur tek e vërteta dhe e drejta*. E kundërta është kuptimi i fjalës *el gajj-shmangie, shtrembërim nga e vërteta dhe e drejta*.

Përderisa feja interesohet për shpirtin e njeriut dhe se mendimi i tij bazohet tek besimi dhe te bindja e vërtetë, atëherë për njeriun nuk ka rrugë tjetër përveçse ajo e logjikës dhe e arsytimit. Fjala: **“S’ka detyrim në fe.”** tregon për këtë kuptim. Në shtesë të kësaj, edhe shkaku i zbritjes së këtij ajeti e sqaron këtë gjë.

Siç e përmendëm, disa të paditur e pyetën profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se a mund t’ia ndryshojnë besimin njerëzve me detyrim? Si përgjigje për ata zbriti ajeti, duke sqaruar se feja nuk është prej çështjeve ku përdoret forca, veçanërisht, kur gjenden argumente të qarta dhe mrekulli shpjeguese, që sqarojnë rrugën e drejtë e të vërtetë prej rrugës së shtrembër.

Ky ajet është një përgjigje e prerë për ata që e akuzojnë Islamin se, në disa raste, ai strehohet tek forca, tehu i shpatës dhe fuqia ushtarake për përhapje. Mirëpo, kur shohim se Islami nuk e lejon babain që të përdorë dhunë ndaj fëmijës së vet për t’ia ndërruar besimin, kjo duhet të jetë e qartë edhe për të tjerët. Sikur të ishte e lejuar ndërrimi i besimit të tjetrit me dhunë, atëherë do të ishte më

parësore që babai të kryente një vepër të tillë ndaj fëmijës. Por Islami nuk ia ka dhënë këtë të drejtë askujt.

Nga këtu qartësohet fakti se ky ajet nuk është i kufizuar vetëm me ithtarët e Librit (Ehlul Kitab), siç hamendësuan disa komentues. Po ashtu, ky rregull nuk është anuluar, siç thanë disa të tjerë. Ky rregull është i vazhdueshëm dhe është në përshtatje me logjikën dhe mendjen.

Më pas, ajeti i bekuar, si rezultat i asaj që u tha më lart, thotë: **“Ai që mohon djallin dhe beson në All’llahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë.”**

Fjala *taagunt* është shprehje ekzagjeruese e fjalës *tuqijan*, që do të thotë *mësymje* dhe *tejkalim kufiri*. Kjo përdoret për cilindo që e tejkalon kufirin. Për këtë, *tagut* është shejtani, idhulli, mësymësi, udhëheqësi i padrejtë, mendjemadhi, çdo adhurues tjetër përveç All’llahut, si dhe çdo rrugë që nuk mbaron tek All’llahu i Madhëruar. Kjo fjalë ka kuptimin e njëjësit dhe të shumës.

Përsa i përket fjalës *taagunt*, që përmendet në ajet, komentuesit kanë mendime të ndryshme. Disa kanë thënë që ka kuptimin e idhujve, disa të tjerë kanë thënë se është djalli apo rabinët, apo magjistarët. Mirëpo, me sa duket, kuptimi i kësaj fjale i përfshin të gjitha këto. Jo vetëm kaq, por mund të jetë më përgjithësuese duke përfshirë çdo tejkales të kufijve dhe çdo rrugë devijuese dhe humbëse.

Në të vërtetë, ajeti mbështet ajetin e mëparshëm, i cili thotë: **“S’ka detyrim në fe.”**, sepse feja fton në rrugën e All’llahut, që është burimi i mirësisë, i begatisë dhe i lumturisë. Ndërsa të tjerët, përveç fesë, ftojnë në shkatërrim, në rrugë të shtrembër.

Padyshim, lidhja me All’llahun është shpëtuese dhe lidhja më e fortë, e cila nuk këputet kurrë.

“All’llahu dëgjon dhe di gjithçka.”

Fundi i këtij ajeti tregon për një të vërtetë, duke thënë se besimi dhe mohimi nuk janë çështje të jashtme. All’llahu është i Gjithëditur për ata që flasin hapur dhe për ata që flasin fshehur. Po ashtu, Ai është i Gjithëditur për ato që fshehin njerëzit në brenditë e tyre, në zemër dhe në ndërgjegje.

Ky ajet përmban përgëzim për besimtarët e vërtetë dhe qortim për hipokritët dhe mohuesit.



Hulumtim

Fetë nuk detyrojnë

As Islami dhe as fetë e tjera nuk mund t'i detyrojnë njerëzit të besojnë. Kjo për dy arsye:

E para: Pas të gjitha atyre argumenteve dhe shenjave të qarta dhe konkluzioneve logjike dhe mrekullive sqaruese nuk gjendet as më e pakta nevojë për detyrim. Forcën e përdor ai që ka nevojë për logjikë dhe argument. Feja e All'lahut është logjiku e fortë dhe argumentuese e qartë dhe e fuqishme.

E dyta: Vërtet feja është e bazuar mbi besimin me zemër dhe nuk mund të detyrohet me dhunë, ndërsa faktori forcë, shpatë dhe fuqi ushtarake mund të ndikojnë në trup dhe jo në zemër dhe as në mendime e në besim.

Nga ato që u thanë, bie poshtë thënia e kryqëzatave helmuese ndaj Islamit, që thotë se Islami u përhap me shpatë. Nuk gjendet thënie më retorike dhe as elokvente se sa thënia e Kur'anit: **“S'ka detyrim në fe.”**

Ziliqarët bëjnë sikur nuk e dinë këtë thënie të qartë të Kur'anit. Me anë të shtrembërimit të kuptimit të xhihadit dhe të betejave islame ata përpiqen të saktësojnë thëniet e tyre. Ndërkohë që duket qartë para çdo të drejti se, luftërat që kanë bërë myslimanët, kanë qenë mbrojtëse ose çliruese.

Këto luftëra nuk kanë pasur qëllim pushtimin dhe zgjerimin e pushtetit. Qëllimi i tyre ka qenë mbrojtja e vetvetes dhe mbrojtja e një grupi të shtypur prej thundrave të mësymësve dhe çlirimi i tyre prej robërisë, për të nuhatur më pas aromën e lirisë dhe të zgjedhë vetë atë rrugë që e sheh të dobishme.

Dëshmi e gjallë e kësaj çështjeje është edhe historia e Islamit gjatë gjithë kohëve. Kur myslimanët udhëhiqnin ndonjë vend, ata i linin pasuesit e feve të tjera të lirë si myslimanët.

Përsa i përket taksës së vogël, që merrnin myslimanët prej tyre, ishte thjesht çmim për shpenzimet e mbrojtjes dhe të sigurisë së tyre. Në këtë mënyrë, vetja, pasuria, nderi dhe dinjiteti i tyre ishin të mbrojtur nën hijen e Islamit.

Autori i librit “Qytetërimi islam dhe arabët” thotë: “Myslimanët bashkëpunonin me grupimet e feve të tjera me tolerancë dhe udhëheqësit e tyre shpirtërorë lejoreshin të organizonin tubime fetare të posaçme për ta.”

Islami e ka përdorur forcën në tri çështje:

1- Për të fshirë dhe për të zhdukur gjurmët e politeizmit dhe të idhujtarisë. Islami, idhujtarinë, nuk e konsideron fe, por e quan devijim, sëmundje dhe paganizëm. Islami nuk e lejon që disa njerëz të ecin në rrugën e devijimit e të humbjes. Për këtë duhet që ata të ndalen në kufirin e tyre. Kjo është arsyeja që Islami i fton idhujtarët të besojnë në monoteizëm. Nëse kundërshtojnë, atëherë përdoret forca ndaj tyre për të thyer idhujt dhe për të shembur vendadhurimet e tyre, me qëllim që të zhduket njëherë e përgjithmonë kjo sëmundje e rëndë shpirtërore.

2- Për të përballuar kurthet që synojnë zhdukjen e Islamit.

Në këtë rast jepen urdhra për xhihad mbrojtës, duke u mbështetur në fuqinë ushtarake. Të gjitha luftërat në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si ajo e Uhudit, Ahzabit, Hunejnit, etj kanë qenë mbrojtëse.

3- Për të arritur lirinë e thirrjes dhe të predikimit.

Çdo fe ka të drejtë që të jetë e lirë në paraqitjen e vetes së saj në mënyrë logjike. Nëse dikush e pengon fenë që të jetë e lirë, feja ka të drejtë që ta marrë të drejtën e saj me forcë.



Ajeti 257

اللَّهُ وَلِيُّ الَّذِينَ ءَامَنُوا يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ۗ وَالَّذِينَ
كَفَرُوا أَوْلِيَآؤُهُمُ الطَّاغُوتُ يُخْرِجُونَهُم مِّنَ النُّورِ إِلَى الظُّلُمَاتِ ۗ
أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۗ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٢٥٧﴾

“All’llahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësi. Këta janë banorët e Zjarrit (të Xhehennemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

Komentimi

Drita e besimit dhe errësirat e mohimit

Ky ajet na thotë se besimtarët kanë mbrojtës, udhëheqës dhe udhëzues: **“All’llahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë.”** Këta besimtarë ecin nën hijen e kësaj mbrojtjeje, duke dalë nga errësira në dritë: **“Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.”**

Fjala *uelijjun* në original ka kuptimin e *afërsisë* dhe të *mosndarjes*. Për këtë edhe udhëheqësit edukues i thuhet *uelijjun*¹. Me këtë fjalë emërtohet edhe miku i dashur. Mirëpo kuptimi i kësaj fjale në këtë ajet është i pari, prandaj edhe ajeti thotë: **“All’llahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë.”**

Mund të thuhet që udhëzimi i besimtarëve prej errësirave në dritë është e natyrshme dhe e lehtë. Por, duke parë fazat e udhëzimit dhe të besimit sqarohet se besimtarët, gjatë rrugës së tyre drejt përsosmërisë së lartë, kanë nevojë të madhe për udhëzimin e All’llahut. Për çdo fazë, për çdo hap dhe për çdo vepër kanë nevojë për udhëzimin e All’llahut të Madhëruar. Kjo është e ngjashme me thënien tonë në çdo namaz: **“Udhëzoni në rrugën e drejtë.”**²

Më pas ajeti shton se eulijatë e mohuesve janë taaguuti (idhujt, djalli, udhëheqësi i padrejtë, etj.) Këta taaguu i drejtojnë pasuesit e tyre kah errësirat. Ajeti thotë: **“Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësirë.”** Si pasojë e kësaj vepre: **“Këta janë banorët e Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”**

¹ Sqarimi më i detajuar i kësaj fjale do të jetë në komentimin e ajetit 55 të sures “El-Maide” që thotë: **“Miqet dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm All’llahu, i Dërguari i Tij.”**

² Sure “El-Fatiha”, ajeti 6.

Hulumtime

1- Vërtet, shëmbëllimi i besimit me dritën dhe i mohimit me errësirën është një shëmbëllim mjaft retorik dhe i lartë. Drita është burimi i jetës, zanafilla e mirësive, e zhvillimit, e lëvizjes drejt përsosmërisë, pikënisja e bindjes, e njohjes dhe e udhëzimit. I tillë është edhe besimi. Ndërsa errësira është simbol i palëvizshmërisë, i vdekjes, i injorancës, i frikës, i humbjes i gjumësisë. I tillë është edhe mohimi dhe mosbesimi.

2- Në këtë ajet dhe në ajete të tjera të Kur'anit, fjala *dhulumat-errësira*, përmendet në numrin shumë, kurse fjala *nur - dritë*, përmendet në numrin njëjës. Kjo tregon se rruga e drejtë dhe e vërtetë nuk ka degëzime. Përkundrazi, ajo është rrugë e vetme si vija paralele mes dy pikave. Ndërsa e kota, mosbesimi dhe mohimi janë burimi i të gjitha llojeve të mosmarrëveshjeve e të përçarjes. Deri edhe ndjekësit e të kotës nuk janë të bashkuar mes tyre në kotësinë që ndjekin. Ata nuk kanë qëllim të përbashkët. Disa komentues supozojnë se kuptimi është që rreshtat e të kotës, në krahasim me ato të pasuesve të së vërtetës, janë më të shumtë.

3- Mund të thuhet se për mohuesit nuk gjendet dritë që të dalin prej saj. Por, duke ditur se drita e besimit është e pranishme gjithmonë në natyrën krijuese të tyre, atëherë kjo thënie u përshtatet plotësisht atyre.

4- Është e qartë se All'llahu i Madhëruar nuk i detyron besimtarët që të dalin nga errësira në dritë. As mohuesit, jobesimtarët nuk i detyron që të dalin prej dritës së Njehsimit (teuhidit) që gjendet në natyrën krijuese. Por, janë punët dhe veprat e tyre shkaktare të kësaj rruge dhe këto punë e vepra janë produkti i fundit e i dhembshëm për jobesimtarët.

Ajeti 258

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِي حَاجَّ إِبْرَاهِيمَ فِي رَبِّهِ أَنْ آتَاهُ اللَّهُ الْمُلْكَ إِذْ قَالَ
 إِبْرَاهِيمُ رَبِّيَ الَّذِي يُحْيِي وَيُمِيتُ قَالَ أَنَا أُحْيِي وَأُمِيتُ ۗ قَالَ إِبْرَاهِيمُ
 فَإِنَّ اللَّهَ يَأْتِي بِالشَّمْسِ مِنَ الْمَشْرِقِ فَأْتِ بِهَا مِنَ الْمَغْرِبِ فَبُهِتَ الَّذِي
 كَفَرَ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٢٥٨﴾

“A nuk ke dëgjuar ti (Muhammed) për atë që polemizoi me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse All’llahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahim i tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje” - ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje.” Ibrahim i pastaj i tha: “All’llahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!” Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. All’llahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”

Komentimi

Polemizimi i Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) **me tiranin e kohës së tij**

Në ajetin e mëparshëm u përmend udhëzimi i besimtarëve nëpërmjet kujdestarisë dhe udhëzimit hyjnor. Po ashtu u përmend humbja dhe devijimi i mohuesve dhe i pasuesve të tiranëve. Në këtë ajet All'llahu i Madhëruar përmend disa dëshmi përveç atyre që u përmendën. Një ndër këto dëshmi është edhe polemizimi i Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me tiranin e kohës së tij, Nemrud. Ajeti thotë: **“A nuk ke dëgjuar ti (Muhammed) për atë që polemizoi me Ibrahimin për Zotin e tij...?”**

Më pas ajeti tregon për shkakun kryesor të këtij polemizimi, duke thënë se tiranin e kishte sunduar ndjenja e vetëpëlqimit, e mendjemadhësisë dhe ishte i dehur nga posti i mbretërisë: **“...sepse All'llahu i kishte dhënë pushtet.”**

Ka shumë njerëz që, kur ndodhen në gjendje të zakonshme, i shohim të drejtë, etj. Mirëpo kur arrijnë në pozita apo bëhen të pasur, ata harrojnë çdo gjë dhe arrijnë të shpërfillin edhe gjërat e shenjta.

Më poshtë ajeti na thotë se ai, i padrejti, e pyeti Ibrahimin për Zotin e tij, duke i thënë: “Kush është Ai All'llah që më fton ta adhuroj? **“Ibrahimi i tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje.”**

Në realitet, çështja më e madhe është ajo e krijimit. Domethënë, ligji i jetës dhe i vdekjes, që është shenja më e qartë për dijen dhe fuqinë e All'llahut të Madhëruar. Mirëpo, Nemrudi tiran ndiqte rrugën e debatit, marrëzisë dhe të falsifikimit të së vërtetës për t'i mashtruar njerëzit rreth tij, duke u thënë atyre se ligji i jetës dhe i vdekjes ishte në dorën e tij: **“- ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje.”**

Për të konstatuar këtë pretendim të rremë, Nemrudi përdori një hile, siç thuhet në një transmetim të njohur. Ai urdhëroi që të sillen dy të burgosur. Njërin e liroi dhe për tjetrin urdhëroi ta vrasin. Pastaj i tha Ibrahimit dhe të pranishmëve: “E patë se si unë jap jetë dhe shkaktoj vdekje?”¹

Për hedhjen poshtë të kësaj hileje, si dhe për të vërtetuar gënjeshtren dhe mashtrimin e Nemrudit, Ibrahimit sollli argument tjetër. Me këtë argument Nemrudi nuk mund t’i mashtronte njerëzit. **“Ibrahimi pastaj i tha: “All’llahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!”**

Këtu, kokëforti nuk foli. **Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. All’llahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”**

Me këtë thënie, kundërshtari mendjemadh u mposht dhe nuk mundi të thotë asgjë përballë këtij argumenti logjik të Ibrahimit. Kjo është rruga më e mirë për t’ia mbyllur gojën çdo kundërshtari kokëfortë.

Çështja e jetës dhe e vdekjes janë më të rëndësishme se sa lëvizja e diellit, lindja dhe perëndimi i tij, që është argument tjetër, që konstaton fuqinë dhe dijen e All’llahut të Madhëruar, prandaj edhe Ibrahimit e përmendi si argument të parë jetën dhe vdekjen. Nëse në atë tubim do të kishte mendimtarë dhe zotërues të mendjes, do të mjaftoheshin me këtë argument dhe do të bindeshin, sepse çdo njeri e kupton që çështja e lirisht të të burgosurit dhe vrasja e tjetrit, nuk ka lidhje me jetën dhe vdekjen e natyrshme.

Mirëpo ka raste që ky argument nuk mund të jetë i mjaftueshëm, siç ndodhi me ata njerëz naiv, të cilët ndikoheshin nga gënjeshtret dhe mashtrimet e Nemrudit. Për këtë, Ibrahimit paraqiti argumentin tjetër, që ishte çështja e lindjes dhe e perëndimit të diellit, me qëllim që t’u sqarohet e vërteta të gjithë të pranishmëve.²

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 12, f. 34

² Argumenti i dytë fillon me shkronjën *fa*, që tregon se i dyti nuk e mohon të parin, por i shtohet të parit.

Sa e mrekullueshme ishte vepra e Ibrahimit, kur paraqiti argumentin e jetës dhe të vdekjes si argument i duhur, edhe pse Nemrudi pretendoi se mund ta bëjë atë ashtu siç bën All'llahu! Më pas Ibrahimit paraqiti argumentin tjetër, atë të lindjes dhe të perëndimit, që të sqarohet falsifikimi i pretendimit të Nemrudit se mund të bëjë atë që bën All'llahu Fuqiptotë.

Në përmbajtjen e fjalisë: **“All'llahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”**, sqarohet se udhëzimi dhe humbja, edhe pse janë vepra të All'llahut të Madhëruar, zgjedhja është në dorë të njerëzve. Bërja e gjynaheve, si: padrejtësia, mosbindja, shthurja e të ngjashme me to, formojnë në zemër dhe në mendje një perde, e cila pengon kuptimin e së vërtetës.

Hulumtime

1- Kur'anit nuk e thotë emrin e atij që polemizoi me Ibrahimin. Ai thotë: **“... sepse All'llahu i kishte dhënë pushtet.”**, që do të thotë se, nga mendjemadhësia e tij për pushtetin që kishte, polemizoi me Ibrahimin.

Autori i Tefsijrit “Derul Menthur” përmend një transmetim nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), që thotë se polemizuesi ka qenë Nemrud ibn Ken'an.¹

Edhe librat e historisë e përmendin këtë emër.

2- Edhe pse Kur'anit nuk e thotë kohën e zhvillimit të dialogut, argumentet tregojnë se dialogu është zhvilluar pas thyerjes së idhujve nga ana e Ibrahimit dhe pas shpëtimit të tij nga zjarri. Është e qartë se para hedhjes së tij në zjarr nuk janë bërë të tilla debate, sepse idhujtarët e lejonin Ibrahimin të fliste.

¹ Tefsijri “Derul Menthur”, vëll.1.f 331.

Ata e konsideronin atë kriminel, që duhej ndëshkuar sa më shpejt, për shkak të veprës së keqe që bëri, duke thyer zotat e tyre të shenjtë.

Ata, të zemëruar, e pyetën Ibrahimin pse e kreu këtë vepër, pastaj urdhëruan që ta digjinin atë. Por, kur doli nga zjarri i padjegur dhe i padëmtuar, arriti të shkojë te Nemrudi dhe të dialogojë me të.

3 - Në ajet duket qartë se Nemrudi nuk ishte prej atyre që hulumtonin për të vërtetën. Përkundrazi, ai dëshironte të shfaqte mashtrimin e tij si të drejtë dhe të vërtetë. Ka mundësi që përdorimi i foljes *haaxhe-polemizon, debaton, bën fjalë*, ka për qëllim këtë kuptim, sepse kjo folje përdoret për këtë lloj gjendje.

4- Nga ajeti sqarohet se tirani i asaj kohe pretendonte se ishte jo vetëm zot që ta adhuronin, por të besonin se ai ishte krijuesi i gjithësisë. Me fjalë të tjera, ai e shihte veten e tij si krijues dhe të adhuruar.

Nuk është për t'u çuditur, sepse, ndërkohë që njerëzit adhurojnë idhuj prej guri e druri, duke i konsideruar se ndikojnë në jetë dhe në sistemimin e saj, tirani mashtrues shfrytëzon kohën që të ftojë njerëzit mendjehetë në adhurimin e tij, duke e paraqitur veten si idhull.

5- Është e vështirë për ne përcaktimi i saktë i fillimit të historisë së adhuruesve të idhujve. Në realitet, adhurimi i idhujve është një lloj devijimi nga besimi i drejtë, i vendosur në natyrën krijuese të njeriut. Përderisa kjo natyrë krijuese është gjithmonë e pranishme te njeriu, edhe devijimi i saj nga grupe të ndryshme njerëzish gjatë historisë ka qenë i vazhdueshëm.

Për këtë mund të thuhet se historia e adhurimit të idhujve mund të shkojë deri me krijimin e njeriut të parë në tokë. Kjo se njeriu, bazuar në natyrën e tij krijuese, drejtohet gjithmonë kah një fuqi e mbinatyrshme. Këtë natyrë të tij e mbështesnin edhe argumentet e qarta të sistemit të krijimit, nga i cili konstatohej se gjendet një Krijues i Ditur dhe i Fortë. Këtë njeriu arrinte ta kuptonte nëpërmjet dy rrugëve: mendjes dhe natyrës krijuese.

Kur fëmija ndien urinë, nëse nuk do t'i jepet ushqim i duhur, ai do të zgjasë dorën tek gjërat e tjera, si: dheu, balta, etj. Dalëngadalë ky fëmijë do të mësohet me këtë gjë dhe do të veprojë. I tillë është edhe njeriu, i cili, nëpërmjet mendjes dhe natyrës krijuese të tij, kërkon të njohë All'llahun. Nëse nuk drejtohet në drejtim të drejtë, ai do ta hedhë shikimin tek idhujt e prodhuar, duke i veshur ato me cilësi hyjnore dhe do t'i përulet e do t'i adhurojë.

Nuk është nevoja të flitet për mendjeshkurtrit dhe mendjelehtët, të cilët çdo gjë e fusin në kallëpin e së prekshmes. Kjo për shkak se mendimi i tyre është i pandarë nga zona e së prekshmes. Për këtë ata e kanë të vështirë të adhurojnë Zotin e padukshëm e të paprekshëm. Prandaj u drejtuan në prohimin e zotave nga guri dhe druri.

Thuhet se popujt e mëparshëm i shenjtëronin të dërguarit dhe personalitetet fetare. Kur vdisnin, ata ndërtonin statuja për t'i mbajtur të gjalla kujtimet e tyre dhe i konsideronin heronj të shenjtë. Me kalimin e kohës, mendjelehtët edhe i adhuronin. Ky ka qenë një tjetër shkak prej shkaqeve të adhurimit të idhujve.

Shkak tjetër i adhurimit të idhujve ka qenë edhe prania e disa krijesave natyrore, të cilat ishin burim i mirësisë, i bereqetit, si: dielli, hëna, uji, zjarri, etj. Duke parë ndikimin e tyre, njeriu, pa u thelluar në mendim se edhe këto janë krijesa, arriti që t'i përulet dhe t'i konsiderojë si gjetësit e kësaj gjithësie. Me kalimin e kohës ata filluan t'i adhurojnë këta.

Zanafilla e adhurimit të idhujve është e lidhur me injorancën, paditurinë dhe mosmeditimin e drejtë e të thellë. Për t'u mbrojtur prej këtij adhurimi duhet të ndiqen mësimet dhe udhëzimet e të dërguarve, të cilat e ftojnë njeriun në dije, meditim, arsyetim të drejtë.

Ajeti 259

أَوْ كَالَّذِي مَرَّ عَلَىٰ قَرْيَةٍ وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا قَالَ أَنِيَ يُحْيِي ۚ هَذِهِ
 اللَّهُ بَعْدَ مَوْتِهَا ۗ فَأَمَاتَهُ اللَّهُ مِائَةَ عَامٍ ثُمَّ بَعَثَهُ ۗ قَالَ كَمْ لَبِثْتَ ۗ قَالَ
 لَبِثْتُ يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۗ قَالَ بَلْ لَبِثْتَ مِائَةَ عَامٍ فَانظُرْ إِلَىٰ طَعَامِكَ
 وَشَرَابِكَ لَمْ يَتَسَنَّهْ ۗ وَانظُرْ إِلَىٰ حِمَارِكَ وَلِنَجْعَلَكَ آيَةً لِّلنَّاسِ ۗ
 وَانظُرْ إِلَىٰ الْعِظَامِ كَيْفَ نُنشِزُهَا ثُمَّ نَكْسُوهَا لَحْمًا ۗ فَلَمَّا تَبَيَّنَ
 لَهُ قَالَ أَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٥٩﴾

“Po për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha: “Si mund ta kthejë në jetë All’llahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!” Dhe All’llahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti: “Sa kohë ke ndenjur këtu?” - Ai u përgjigj: “Një ditë ose gjysmë dite”. - “Jo” - i tha All’llahu, “por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd (si do ta ringjallim) që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit; vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!” Kur atij iu bë e qartë, ai tha: “Tashmë e di se All’llahu është i Fuqishëm për çdo gjë!”

Komentimi

Tregimi i çuditshëm i Uzejrit

Ky ajet tregon për historinë e një ndër të dërguarve, e cila është një dëshmi e fortë për çështjen e ringjalljes. Ajeti i mëparshëm fliste për dialogun e profetit Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me Nemrudin mendjemadh rreth çështjes së teuhidit dhe njohjes së All'llahut të Madhëruar. Ky ajet dhe ajetet e mëpasshme flasin rreth ringjalljes dhe jetës pas vdekjes. E fillojmë sqarimin e historisë në formë përmbledhëse e më pas do të fillojmë komentimin e ajetit.

Ajeti tregon për një burrë, i cili po udhëtonte me gomar dhe me vete kishte ushqime dhe ujë. Gjatë rrugës ai kaloi pranë një fshati të shkatërruar, ku eshtrat e banorëve të tij ishin shndërruar në dhë. Kur pa këtë pamje tmerruese, burri tha: “Si do t'i ringjallë All'llahu këta të vdekur?”

Sigurisht që pyetja e tij nuk ka qenë dyshuese, se nuk besonte se All'llahu ringjall të vdekurit. Pyetja ishte në mënyrë habitore, sepse edhe argumentet e tjera, që gjenden në ajet, tregojnë se ai ka qenë një prej të dërguarve dhe All'llahu i ka folur atij. Po ashtu, edhe transmetimet¹ islame e mbështesin këtë që thamë.

Kur bëri këtë pyetje, All'llahu ia mori shpirtin dhe e la të vdekur për njëqind vjet. Pastaj e ringjalli dhe e pyeti: “Si mendon ti, sa ke qëndruar në këtë shkretëtirë?” Burri, duke llogaritur ditët, i tha një ditë ose më pak. All'llahu i tha se ke qëndruar këtu njëqind vjet. Shikoje ushqimin tënd dhe ujin tënd, edhe pse kanë qëndruar kaq kohë, me lejen e All'llahut ato nuk janë prishur, që ti të bindesh që ke qëndruar njëqind vjet të plota; shikoje gomarin tënd, i cili është

¹ “Usailu Shia”, vëll. 16, f.142.

shpërbërë i tëri dhe nuk është si ushqimi dhe uji yt. Pastaj shiko se si do t'i bashkojmë eshtrat e tij dhe do ta ringjallim përsëri.”

Kur i pa të gjitha këto gjëra, burri tha: **“Unë e di se All'lahu është i Fuqishëm për çdo gjë!”** pra, unë jam plotësisht i bindur, pasi e pashë ringjalljen trupore.

Vallë, për cilin profet flet ky ajet? Ka thënie të ndryshme. Disa kanë thënë se ka qenë Erimja, disa të tjerë kanë thënë se ka qenë Hidri. Mirëpo nga ajo që njihet më mirë ndër thëniet, mendohet se ka qenë Uzejri.¹

Ka mendime të ndryshme edhe për fshatin. Disa kanë thënë se ka qenë Bejtul Makdis, të cilin e shkatërroi Nbukhedh Nassr. Mirëpo kjo është e largët.

Kthehemi te komentimi i ajetit.

“Po për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha: “Si mund ta kthejë në jetë All'lahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!”

Ky ajet, siç e thamë edhe më lart, është plotësues i ajetit të mëparshëm, që fliste rreth teuhidit, kurse ky ajet flet për çështjen e Ringjalljes.

Fjala *urush* është shumësi i fjalës *arsh*, që këtu ka kuptimin e *tavanit*.

Fjala *kbaijetun* në origjinal do të thotë *kbalijetun-e zbrazët*. Por këtu është me kuptim metaforik për shkatërrimin dhe rrënimin. Zakonisht, shtëpitë e ndërtuara janë të banuara. Ndërsa, shtëpitë e zbrazura, ose janë të shkatërruara, ose janë shkatërruar për shkak të mosbanimit. Sido që të jetë, ajeti: **“...pranë një qyteti të rrënuar përtokë”**, ka kuptimin se të gjitha shtëpitë e atij vendi ishin të rrënuara. Dihet se kur thuhet të rrënuara, nuk shihet asnjë shenjë muri mbi tokë.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 370.

“Si mund ta kthejë në jetë All’llahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!”

Nga pamja e jashtme e ajetit duket se Profeti ka qenë i vetëm në këtë ndodhi. Me këtë lloj të foluri ai i flet vetes së vet. Është e natyrshme kur ai tha si mund ta kthejë në jetë. Kuptimi është për banorët e këtij *karjeti*, sepse ai i kishte parë me sy eshtrat e banorëve.

“Dhe All’llahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli.”

Shumica e komentuesve kanë mendimin se vdekja e këtij profeti njëqind vjet ka qenë e vërtetë dhe pas vdekjes e ringjalli atë. Ata bazohen tek fjala *ematehu-e vdiq*. Me përjashtim të autorit të tefsijrit “El Manar”, i cili thotë: “Ka mundësi që kjo fjalë të tregojë për një lloj gjumi të gjatë, i cili tek disa kafshë njihet si *subat*. Në këtë gjendje, gjallesa hyn në një gjumë të thellë e të gjatë pa vdekur, siç ndodhi me banorët e shpellës.”¹

Nëse qëndrimi në gjumë për disa vite është i mundshëm, atëherë mund të thuhet siç tha edhe autori i tefsijrit “El Manar”.

Mirëpo, në këtë ajet nuk gjendet argument për vërtetësinë e thënies së autorit të tefsijrit “El Manar”, por pamja e jashtme e ajetit tregon se Uzejri u nda nga kjo jetë dhe pas njëqind vjetëve u kthye në të. S’ka dyshim se jeta dhe vdekja janë që të dyja fenomene të mbinatyrshme.

Këtu mund të përmend gjumin e thellë dimëror të disa kafshëve, të cilat flenë në dimër dhe zgjohen kur largohet i ftohti. Mund të përmend ngrirjen e disa kafshëve me ngrirje normale ose ngrirjen e disa njerëzve për disa vjet, duke qëndruar të pavdekur. E gjitha kjo ishte për të afruar idenë e vdekjes dhe të jetës për një vit.

Qëllimi i përmendjes së këtyre shembujve ka qenë për të dalë në konkluzionin: Vërtet, All’llahu, ashtu siç është i Plotfuqishëm në mbajtjen e të gjallëve njëqind vjet në gjumë të thellë apo të ngrirë,

¹ Tefsijri “El Manar i Meragiut”, komentimi i ajetit në fjalë.

pastaj i zgjon dhe i rikthen në gjendjen e mëparshme, po ashtu Ai është i Plotfuqishëm për ringjalljen e të vdekurve.

Kur ne e pranojmë parimin e besimit në botën tjetër dhe ringjalljen e të vdekurve, si dhe i pranojmë ndodhitë e jashtëzakonshme si mrekullitë e profetëve, atëherë nuk është nevoja që ajetet e Kur'anit t'i komentojmë me anë të një serie prej çështjeve natyrore, duke kundërshtuar në këtë mënyrë kuptimin e dukshëm të ajeteve. Kjo nuk është e rregullt dhe as e domosdoshme.¹

Siç thonë disa komentues: “Ne sikur e kemi harruar që në fillim kemi qenë të vdekur dhe All'llahu na solli në jetë. Ku është pengesa që të përsëritet dukuria e vdekjes dhe e jetës?!”

“Sa kohë ke ndenjur këtu?” - Ai u përgjigj: “Një ditë ose gjysmë ditë.”

Në këtë ajet All'llahu e pyet të dërguarin e Tij se sa qëndroi në gjumë. Ai lëkundet në përgjigje, duke thënë se ka qëndruar një ditë të plotë ose një pjesë të ditës. Nga kjo lëkundje kuptohet se koha (ora) e vdekjes dhe e ringjalljes së tij ndryshon nga ajo e ditës, p.sh., sikur vdekja të ketë ndodhur para dite dhe rikthimi në jetë të ketë ndodhur pasdite. Për këtë ai dyshoi, a kishte fjetur një ditë dhe një natë të plotë (24 orë) apo kishte fjetur vetëm disa orë të ditës. Prandaj, kur tha se kishte kaluar një ditë në gjumë, dyshoi dhe tha: **“ose gjysmë (një pjesë së ditës) ditë”**. Por, menjëherë ai dëgjoi: **“- “Jo” - i tha All'llahu, “por ke ndenjur njëqind vjet.”**

Pastaj All'llahu e urdhëroi të dërguarin e Tij që të shikojë ushqimin që kishte me vete dhe të shikonte gomarin e tij që të bindej për realitetin e çështjes. I pari nuk ishte prishur, ndërsa i dyti ishte plotësisht i shpërbërë dhe ishte bërë pluhur. Qëllimi ishte që, së pari, ai ta dinte se All'llahu është i Fuqishëm që gjërat, që prishen, t'i lërë

¹ Vërtet, qëndrimi i ushqimit dhe i pijes për njëqind vjet, siç tregon ajeti, si dhe ringjallja e gomarit, të gjitha këto janë argumente të prera të Ringjalljes në Ditën e Kiametit dhe nuk duhet të jemi të pavëmendshëm ndaj kësaj çështjeje.

ashtu siç janë edhe për njëqind vjet dhe, së dyti, ta kuptojë kohën që kishte kaluar në vdekje. **“Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur!”**¹

Fraza *lem jetesenneb*, vjen nga lënda *senetin*, që do të thotë se *nuk ka një vit*, për shkak të mosprishjes. Në këtë mënyrë kuptimi i ajetit është: Vështroje ushqimin dhe pijen tënde, sikur nuk kanë ndenjtur më shumë se një vit dhe nuk kanë ndryshuar. Kjo do të thotë se All'llahu është i Plotfuqishëm që diçka, e cila priset shpejt si ushqimi, ta lërë pa u prishur. Po ashtu, Ai është i Plotfuqishëm në ringjalljen e të vdekurve dhe e bën me lehtësi. Ruajtja e ushqimit, i cili përmban lëndë ruajtëse, pa u prishur për një kohë të gjatë nuk është më e lehtë se ringjallja e të vdekurve.²

Ajeti nuk e tregon llojin e ushqimit të Uzejrit. Disa thonë se ushqimi i tij kanë qenë frutat e fikut dhe pija e tij ka qenë lëngu i disa frutave.³ Siç dihet, këto prishen shumë shpejt. Mbjajtja e tyre për një kohë të gjatë, pa u prishur, është çështje e rëndësishme.

“Shikoje gomarin tënd.” (si do ta ringjallim)

Pasi i tha që të shohë ushqimin, All'llahu i thotë që të shohë gomarin e tij, i cili ishte shpërbërë i tëri me kalimin e kohës. Është për t'u habitur se si kafsha e njohur, që jeton gjatë, të shpërbëhet në këtë formë, ndërsa sendet që prishen më shpejt, si: frutat dhe lëngu, nuk ndryshuan as erën dhe as shijen. Ky është kulmi i dukjes së fuqisë absolute të All'llahut të Madhëruar.

¹ Shumica e komentuesve janë të mendimit se fraza *lem jetesenneb* rrjedh nga rrënja *senetun*. Shiko tefsiret e Tabarsiut, Fahrudin Raziut, Kurtubiut, Ebul Fetuh. Er Ragibu në librin e tij “El Mufredat”, thotë që rrjedh nga rrënja *senetun*, megjithëse e sqaron te lënda *senne* me kuptim tjetër.

² Përemri te fjala *lem jetesenneb* flet për ushqimin dhe pijen. Është përdorur në njëjës për qëllim lloji, sepse që të dyja janë të një lloji.

³ Tefsijru “El Kebijr”, Tefsijri “Ruhul Meanij” dhe Tefsijri “Xhamiul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë.

“...që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit”, që do të thotë se historia jote nuk është dëshmi dhe shenjë mrekullie vetëm për ty, por për mbarë njerëzit.

“...vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!”

Fjala *nushuz*, që përmendet në ajet, ka kuptimin e *ngritjes, të dukjes dhe të shfaqjes*. Këtu ka kuptimin e ngritjes së eshtrave nga vendi i tyre dhe bashkimi me njëri-tjetrin për herë të dytë. Atëherë kuptimi i ajetit është: Shikoj këto eshtra të shpërbëra se si do t'i ngremë dhe do t'i lidhim me njëra-tjetrën. Më pas do t'i mbulojmë me mish dhe do t'i ringjallim. Është e qartë se këtu bëhet fjalë për eshtrat e gomarit dhe jo të banorëve të atij fshati.

Disa komentues supozojnë se këtu bëhet fjalë për eshtrat e Uzejrit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Kjo është e pamundur, sepse biseda e All'llahut me Uzejrin u zhvillua pas ringjalljes së tij. Disa të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për eshtrat e gomarit ose të të vdekurve që Uzejri u habit nga ringjallja e tyre.¹

Edhe ky është mendim i largët, sepse fjalia paraardhëse fliste për gomarin dhe jo për banorët.

Kur atij iu bë e qartë, ai tha: “Unë e di se All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë!”

Kur iu qartësuan të gjitha këto çështje, Uzejri (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) tha se e di që All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ai nuk tha: “Tani e mësova.”, siç tha Zulejha për Jusufin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“Tani do të dalë në shesh e vërteta!”** ²

¹ Tefsijru “Keshaf”, vëll. 1, f. 307.

² Sure “Jusuf”, ajeti 51.

Ajeti 260

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَىٰ قَالَ أُولَٰئِكَ تُؤْمِنُونَ ۖ قَالَ
بَلَىٰ وَلَٰكِن لِّيَطْمَئِنَّ قُلُوبُكَ ۖ قَالَ فَخُذْ أَرْبَعَةً مِّنَ الطَّيْرِ فَصُرْهُنَّ إِلَيْكَ ثُمَّ
أَجْعَلْ عَلَىٰ كُلِّ جَبَلٍ مِّنْهُنَّ جُزْءًا ثُمَّ ادْعُهُنَّ يَأْتِينَكَ سَعْيًا ۚ وَاعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ

عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٦٠﴾

“Kur Ibrahim i tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!” – Zoti i tha: “A nuk beson?” - “Besoj” - iu përgjigj Ibrahim, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.” All’llahu i tha: “Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre, pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se All’llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

Komentimi

Edhe njëherë shfaqet ringjallja në këtë jetë

Pas historisë së Uzejrit, Kur’ani Fisnik përmend një histori tjetër, atë të profetit Ibrahim (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*), me qëllim që të plotësohet çështja. Shumica e komentuesve dhe historianëve për komentimin e këtij ajeti përmendin këtë histori:

Një ditë Ibrahim (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) po ecte bregut të detit dhe pa një ngordhësirë të hedhur në breg, ku gjysma e saj ndodhej në ujë dhe gjysma tjetër në tokë. Atë e kishin sulmuar grabitqarët dhe kafshë të tjera mishngrënëse. Kur e pa Ibrahim (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) këtë skenë, në mendje i erdhi një pyetje dhe dëshironte që njerëzit ta dinin përgjigjen e saj. Pyetja ishte rreth mënyrës së rikthimit të të vdekurve në jetë. Ai u mendua thellë në vetvete, duke thënë: “Sikur të ndodhte me trupin e njeriut siç ndodhi me trupin e kafshës, që trupi i tij të jetë ushqim për kafshët e tjera, ku trupi i njeriut do të bëhet pjesë e trupit të kafshëve, si do të ringjallej ai njeri?”

Ibrahimi (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) i foli Zotit të tij dhe i tha: **“Kur Ibrahim tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!”** All’llahu i Madhëruar iu përgjigj: **“A nuk beson?”** në ringjallje? **-“Besoj”** - iu përgjigj Ibrahim, **“por dëshiroj të më qetësohet zemra.”**

Atëherë All’llahu e urdhëroi që të marrë katër zogj, t’i therrë dhe ta përziejë mishin e tyre. Pastaj t’i ndajë në disa pjesë dhe çdo pjesë ta vendosë në një mal (kodër) dhe t’i thërrasë që të shkojnë tek ai. Ibrahim (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) e zbatoi urdhrin dhe u habit, kur

pa pjesët e zogjve që bashkoheshin dhe i vinin atij duke fluturuar nga anë të ndryshme.¹

Për këtë ndodhi ka dhe një komentim tjetër, që e përcjell Fahru Raziu.² Komentuesi Ebu Muslim i kundërshton mendimet e komentuesve të tjerë. Ne do të përmendim këtu komentin e komentuesit bashkëkohor, El Manar:³ “Në ajet nuk ka argument që tregon se Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) i theri zogjtë dhe pastaj ata u ringjallën me lejen e All'llahut të Madhëruar.

Por, ky ajet është sqarim për shembullin e çështjes së Ringjalljes, që do të thotë: O Ibrahim merri katër zogj dhe silli pranë teje, derisa të kënaqesh me shoqërimin e tyre dhe ata do të të përgjigjen kur t'i thërrasësh, sepse zogjtë janë qeniet më të afta për këtë veprim. Pastaj çdo zog vendose në një mal (kodër) pastaj thirri ata dhe shpejt do të vijnë tek ti.

Tani fillojmë me komentimin e ajetit.

“Kur Ibrahim tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!”

Më lart thamë se ky ajet është plotësues i ajetit të mëparshëm për çështjen e Ringjalljes. Fraza: **“Tregomë si i ngjall të vdekurit!”** tregon se ai kërkoi të shohë me sy mënyrën e kryerjes së ringjalljes dhe nuk kërkoi të shohë Ringjalljen.

– Zoti i tha: “A nuk beson?” -“Besoj” - iu përgjigj Ibrahim, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.”

Disa mund të hamendësojnë se kjo kërkesë e Ibrahimit (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) tregon për besimin e tundur të tij. Për zhdukjen e kësaj hamendësie All'llahu e pyeti: **“A nuk beson?”**, me qëllim që të vijë përgjigja e tij sqaruese për çështjen dhe heqëse e çdo dyshimi. -

¹ Tefsijrul “Ajjashi”, vëll. 1, f. 142. “Biharul Anuar”, vëll. 7, f. 36 dhe 41.

² Tefsijrul “Kebijr”, komentimi i ajetit në fjalë.

³ Tefsijrul “Manar”, komentimi i ajetit në fjalë.

“Besoj” - iu përgjigj Ibrahimimi, “por dëshiroj të më qetësohet zemra.”

Nga ky ajet kuptohet se argumentet shkencore dhe logjike çojnë në bindje, por ato nuk çojnë në qetësinë e zemrës. Ato kënaqin dhe bindin mendjen, por jo zemrën dhe ndjenjat. Ai, që i kënaq dhe i bind të dyja anët, është të parit me sy dhe dëshmia prekëse. Kjo është temë e rëndësishme dhe do ta sqarojmë më shumë në vendin e saj.

Të përmendurit e qetësisë së zemrës tregon se të menduarit para se të arrijë në fazën e dëshmisë është gjithmonë në gjendje lëvizjeje dhe shndërrimi. Por nëse arrin në fazën e të parit, mendimi pushon dhe qetësohet.

“All’llahu i tha: “Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre.”

Fjala *sibune* vjen nga fjala *es seuv*, që do të thotë *prerje, copëtim* ose *anim* (mësim) ose *thirre*. Kuptimi prerje, copëtim është më i përshtatshëm. Pra, merr katër zogj dhe theri, copëtoi dhe përzieji ato.

Qëllimi ishte që Ibrahimimi (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) të shihte një shembull prej ringjalljes së të vdekurve. Kjo nuk është në përshtatje me mësimin e tyre dhe as me thirrjen e tyre. Këtë e sqaron vazhdimi i ajetit: **“Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre.”**

Ky është argument se zogjtë u copëtuan në pjesë. Ata që thanë se fraza *“Sirhunne ilejke”* ka kuptimin *e mësim* apo *të shoqërimit*, ndoshta kanë qenë të pavëmendshëm ndaj frazës *xhu’zen - pjesë*.

Profeti Ibrahim (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) e kreu këtë vepër dhe, kur i thirri ata, pjesët e tyre u bashkuan dhe zogjtë u ringjallën përsëri. Kjo i sqaroi Ibrahimimit (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) se Ringjallja në Ditën e Kiametit do të jetë e tillë dhe në mënyrë më të gjerë.

Disa kanë mendimin se fjala *sa’jen*, që përmendet në ajet, ka kuptimin se *zogjtë, pasi u ringjallën, nuk fluturuan, por ato ecën me shpejtësi për tek Ibrahimimi (Paqja e All’llabut qoftë mbi të!), sepse kjo fjalë ka kuptimin e ecjes së shpejtë. Është përcjellë se Halil ibn Ahmed, poet dhe letrar i*

njohur, ka thënë se Ibrahim (Paqja e All'llabut qoftë mbi të!) po ecte me shpejtësi kur i erdhën zogjtë pranë. Kjo do të thotë se ishte Ibrahim (Paqja e All'llabut qoftë mbi të!) ai që eci shpejt dhe jo zogjtë.¹ Megjithë këtë, provat tregojnë se fjala “sa’jen” është *kinajetu e fluturimit të shpejtë*. **“...pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”**



¹ Tefsijri “Bahrul Muhijj”, vëll. 2, f. 300, komentimi i ajetit në fjalë. Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë.

Hulumtime

1- Ndodhia e jashtëzakonshme

Pa dyshim që kjo ndodhi ishte e jashtëzakonshme, njësoj si ndodhia e Ringjalljes në Ditën e Kiametit. Ne e dimë që All'llahu i Madhëruar është Sunduesi mbi ligjet e natyrës dhe nuk është i sunduar prej tyre. Nuk është e vështirë që të ndodhin të tilla çështje me lejen e Tij.

Këmbëngulja e disa komentuesve, për të kundërshtuar komentimin e njohur, duke thënë se kuptimi është shoqërimi dhe mësimi i zogjve që, kur t'i thërrasë, t'i përgjigjen, është mendim shumë i dobët dhe janë fjalë që nuk bazohen në logjikë. Ato fjalë nuk janë në përputhje as me Ringjalljen dhe as me historinë e Ibrahimit (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) dhe me të parin e ngordhësirës në bregun e detit, për shkak të së cilës kërkoi të shohë skenën e ringjalljes.

Është për t'u përmendur se Fahrudin Raziu ka thënë se të gjithë komentuesit janë të një mendimi me tefsirin që u përmend, me përjashtim të Ebu Muslimit, i cili e refuzoi atë.¹

2- Katër zogjtë e ndryshëm

S'ka dyshim se katër zogjtë kanë qenë prej katër llojesh të ndryshëm. Përndryshe nuk do të realizohej qëllimi i profetit Ibrahim (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*), që çdo pjesë të kthehej në origjinën e saj. Në disa transmetime thuhet se këta zogj kanë qenë: palloi, gjeli, pëllumbi dhe korbi.² Dihet që ndryshimet janë të shumta mes tyre.

¹ Tefsirul "Kebijr", vëll. 7, f. 41.

² "Biharul Anuar", vëll. 7, f. 36 dhe 41.

Disa kanë mendimin se ato janë pasqyrues të cilësive të njeriut, p.sh: palloi simbolizon vetëpëlqimin dhe mendjemadhësinë, gjeli simbolizon dëshirat e forta seksuale, pëllumbi simbolizon lojën dhe zbavitjen dhe korbi simbolizon shpresat e kota dhe lakmitë e paarrtshme, të largëta.

3- Numri i maleve e i kodrave

Në Kur'an nuk përmendet numri i maleve, në të cilat profeti Ibrahim (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) vendosi pjesët e zogjve. Por hadithet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja e All'llabut qoftë mbi ta!*) thonë se ato kanë qenë dhjetë.¹

Për këtë, në transmetime, thuhet se kushdo që porosit që një pjesë e pasurisë së tij të shpenzohet për diçka, pa caktuar përqindjen e saj, edhe sikur të shpenzojë 10%, mjafton.²

4- Kur ndodhi kjo ngjarje?

Ka ndodhur në kohën kur profeti Ibrahim (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) ishte në Babiloni apo kur shkoi në Sham? Me sa duket, ajo ka ndodhur në Sham, sepse zona e Babilonisë nuk ka pasur male.

5- Ringjallja trupore

Shumica e ajeteve të Kur'anit, që flasin për Ringjalljen, sqarojnë anën trupore. Vërtet, i dituri për kuptimet e Kur'anit në përgjithësi dhe për ajetet e Ringjalljes në veçanti, e di se ajo, që përmend Kur'ani, është Ringjallja trupore. Pra, njeriu do të ringjallet me trup dhe me shpirt.

¹ "Biharul Anuar", vëll. 7, f. 36 dhe 41.

² Tefsijri "Nuru Thakalejn", vëll. 1, f. 278 dhe 279.

Kur'ani këtë e përmend duke thënë ringjallja e të vdekurve. Sikur Ringjallja të ishte vetëm me shpirt, kjo ringjallje që përmend Kur'ani nuk do të kishte asnjë kuptim.

Ky ajet sqaron me shumë qartësi mënyrën e bashkimit të pjesëve të shpërbëra të trupit. Kjo ishte ajo që pa edhe profeti Ibrahim (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*).

6- Paqartësia e ngrënies dhe e të ngrënit

Siç e përmendëm, shkakun që e shtyu Ibrahimin (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*), që të kërkojë shikimin e ringjalljes së të vdekurve ishte shikimi i ngordhësirës në bregun e detit, të cilën po e hanin kafshët mishngrënëse. Nga kjo kuptojmë se interesimi i Ibrahimit (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) ishte i lidhur me rikthimin e trupit të vdekur, pasi atë e hanë kafshët dhe bëhet pjesë e trupit të atyre kafshëve. Në dijen e (akides) besimit kjo njihet si Rregulli i Ngrënësit dhe i të ngrënit.

Për sqarimin e kësaj çështjeje themi: Vërtet, në Ditën e Kiametit, All'llahu i Madhëruar do ta ringjallë njeriun me trup. Me fjalë të tjera, njeriu do të ringjallet me trup dhe me shpirt.

Këtu lind pyetja: Kur trupi i njeriut do të kthehet në dhé dhe atë e thithin rrënjët e bimëve apo pemëve, pastaj do të formohen fruta, që i ha njeriu tjetër dhe bëhet pjesë e trupit të tij, ose të supozojnë se në situatë shumë të vështirë, njeriu ha mishin e njeriut, atëherë, tek cili trup do të ringjallen këto pjesë? Nëse do të bashkohet me trupin e parë, trupi i dytë do të mbesë i mangët. Nëse do të qëndrojnë tek trupi i dytë, atëherë i pari do të jetë i mangët ose nuk do të ekzistojë.

Përgjigja: Kjo pyetje është e hershme, ku filozofët dhe dijetarët e besimit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Nuk e shohim të domosdoshme që t'i përmendim të gjitha këtu. Disa të tjerë nuk kanë gjetur përgjigje bindëse. Për këtë ata filluan të bëjnë te'vilin e ajeteve,

që kanë lidhje me Ringjalljen trupore dhe u mbështetën në konsiderimin e personalitetit të njeriut në të kufizuar vetëm me shpirtin dhe me karakteristika shpirtërore. Mirëpo personaliteti i njeriut nuk është i kufizuar vetëm me shpirtin dhe as ajetet e posaçme të Ringjalljes nuk janë të paqarta, saqë të bëhet te'vili i tyre. Padyshim, këto ajete janë shumë të qarta.

Disa të tjerë thanë për një ringjallje trupore, që ndryshon shumë nga ringjallja shpirtërore. Mirëpo, ne gjejmë një rrugë shumë të qartë duke u mbështetur në tekstet kur'anore, të cilat përrputhen me arritjet e shkencës moderne.

Sqarimi i kësaj thënieje ka nevojë për disa mukadimat (hyrje).

1- Ne e dimë se pjesët e trupit të njeriut, nga fëmijëria deri në vdekje, ndryshojnë disa herë, deri edhe qelizat e trurit, të cilat nuk ndryshojnë nga numri, por sipas pjesëve, nga njëra anë ushqehen dhe nga ana tjetër ndahen. Me kalimin e kohës ky proces çon në ndërrimin e plotë të tyre, ku pas dhjetë vitesh nuk mbet në trup asnjë grimcë nga trupi i mëparshëm.

Kur qelizat e mëparshme arrijnë afër zhdukjes, të gjitha karakteristikat dhe ndikimet e veta ia kalon qelizës së re, prandaj, edhe dallueshmëritë e njeriut, si: gjatësia, forma, etj, prej strukturës trupore, me kalimin e kohës qëndrojnë konstante.

Për këtë, pjesët e fundit të çdo njeriu, kur pas vdekjes kthehen në dhé, janë të zbrazëta prej atyre tipareve që i fitoi gjatë jetës. Ato janë historia që flet për ecurinë e trupit të njeriut në jetën e tij.

2- Është e vërtetë që shpirti është baza mbi të cilën ngrihet personaliteti i njeriut. Por duhet të dimë që shpirti plotësohet dhe edukohet me trupin. Që të dyja shkëmbejnë ndikimet. Ashtu siç nuk ngjasojnë dy trupa nga të gjitha anët, po ashtu nuk ngjasojnë dy shpirta. Për këtë shkak, shpirti nuk reagon plotësisht vetëm në trupin që është edukuar dhe është plotësuar me të. Prandaj, në Ringjallje

duhet patjetër prania e të njëjtit trup, me qëllim që shpirti të bashkohet me atë trup dhe të rifillojë aktivitetin e tij në botën më të lartë dhe të vjelë frytin e punëve të tij.

3- Në çdo qelizë prej qelizave të trupit gjenden të gjitha cilësitë e tij, që do të thotë se, nëse do të mundësohemi në edukimin e të gjitha qelizave të trupit të njeriut, që të bëhet i plotë dhe i përkryer, ai njeri do të mbartë të gjitha cilësitë e njeriut nga i cili u mor ajo pjesë. A ka qenë njeriu në ditën e parë më shumë se një qelizë? Tani pas kësaj mukademeje, (hyrjeje) të kthehemi për t'iu përgjigjur kundërshtimit të përmendur.

Në Kur'anin Fisnik ka ajete që flasin qartë se të gjitha pjesët e trupit të njeriut do të ringjallen në Ditën e Gjykimit. Nëse një njeriu i hahet mishi i tij, të gjitha ato pjesë, që u hëngrën, do të kthehen te trupi original. Këtu duhet thënë se trupi tjetër nuk pakësohet, por zvogëlohet, sepse pjesët e trupit të ngrënë do të jenë shpërndarë në të gjithë trupin e ngrënësit. Për këtë, kur kthehen pjesët e ngrëna, trupi i ngrënësit zvogëlohet vetëm aq sa i merret atij, p.sh: ai që peshon gjashtëdhjetë kilogram, kur i merr pjesën e ngrënë, mbetet dyzet kilogramë.

Vallë, a shkakton kjo problem? Sigurisht që jo, sepse ky trup i vogël përmban të gjitha cilësitë e njeriut pa asnjë shtesë apo mangësi. Në Ringjallje do të jetë si një fëmijë që lind i vogël, pastaj rritet, zhvillohet dhe ringjallet në formën e njeriut të plotë.

Vallë, kjo lloj rritje dhe ky lloj zhvillimi janë të menjëhershëm në Ringjallje apo të shkallëzuar? Këtë nuk e dimë. Mirëpo, ajo që dimë është, qoftë i menjëhershëm, qoftë i shkallëzuar, nuk përbën problem. Çështja është e zgjidhur në të dyja gjendjet.

Lind një pyetje tjetër: Si do të jetë puna, nëse i gjithë trupi i një njeriu ngrënës është i përbërë nga pjesët e trupit të njeriut të ngrënë? Përgjigjja është e lehtë, sepse si kjo gjendje është e vështirë të gjendet. Çështja e ngrënësit dhe e të ngrënit arrihet kur ka një trup të caktuar,

pastaj ushqehet prej trupit tjetër dhe zhvillohet. Pra, së pari, duhet të supozojmë praninë e një trupi të mëparshëm, që ai është ushqyer me një trup tjetër. Kështu, trupi i dytë do të jetë pjesë e trupit të parë dhe jo i gjithi. (mendohu)

Nga ky shpjegim sqarohet se çështja e Ringjalljes trupore të njeriut, në vetvete, nuk ka asnjë problem dhe nuk është nevoja e te'vilit të ajeteve të qarta që konstatojnë këtë çështje.



Ajeti 261

مَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ كَمَثَلِ حَبَّةٍ أَنْبَتَتْ سَبْعَ سَنَابِلٍ
فِي كُلِّ سُنْبُلَةٍ مِائَةٌ حَبَّةٌ وَاللَّهُ يُضَعِفُ لِمَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٦١﴾

“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të All’llahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. All’llahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm.”

Komentimi

Shpenzimi, edukim i personalitetit të njeriut

Shpenzimi, dhënia janë prej çështjeve të rëndësishme, të cilën e dëshmon Islami dhe Kur’ani Fisnik. Ajeti i lartpërmendur është i pari prej ajeteve të bekuara në suren “El-Bekare”, që flet për shpenzimin dhe dhënien.

Përmendja e tij pas ajeteve të Ringjalljes, ndoshta ka kuptimin se shpenzimi në rrugën e All’llahut është një ndër faktorët dhe shkaqet e shpëtimit në ahiret. Disa kanë thënë se ka lidhje me ajetet e xhihadit, që ishin para ajeteve të Ringjalljes dhe të Teuhidit.

Ajeti i bekuar thotë: “Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të All’llahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e

cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra.”

Atëherë, totali i arritur nga një kokërr është shtatëqind kokrra. Më pas ajeti shton se shpërblimi i shpenzuesve nuk është i kufizuar vetëm me kaq, por **“All’llahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë.”**

Kjo ka lidhje me qëllimin dhe sasinë e çiltërsisë së çdo njeriu në punë dhe në vepra, në sasi dhe në cilësi. Nuk është për t’u habitur nga ky shpërblim i madh, sepse mëshira e All’llahut të Madhëruar është e gjerë dhe fuqia e Tij është gjithëpërfshirëse. Ai është i Mirinformuar për gjithçka **“All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”**

Disa komentues kanë mendimin se kuptimi i fjalës *infak*, që përmendet në ajet është xihadi në rrugën e All’llahut, sepse ky ajet është përforcues i ajeteve që flisnin për historinë e Uzejrit, Ibrahimit dhe Talutit. Por, e drejta është se kuptimi i ajetit është më i gjerë dhe se lidhja e tij me ajetet e mëparshme nuk është argument i përvetësimit të këtij ajeti dhe i ajeteve të ardhshme, sepse fjala *fi sebijlilab* është me kuptim të gjerë dhe përfshin çdo shpenzim të mirë. Në shtesë të kësaj themi se edhe ajetet në vazhdim flasin në mënyrë të pavarur rreth shpenzimit. Transmetimet islame tregojnë se kuptimi i fjalës *infak* në këtë ajet është i përgjithshëm.¹

Është për t’u përmendur se ky ajet i krahason ata njerëz që shpenzojnë në rrugën e All’llahut me farën (kokrrën) e bereqetshme, e cila mbillet në tokë pjellore. Ndërkohë që krahasimi në shumicën e rasteve duhet të jetë mes shpenzimit dhe farës. Pra, të krahasohen punët e tyre dhe ata vetë.

¹ Tabarsiju në tefsijrin “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 437. Pasi argumenton se kuptimi i ajetit është i gjerë dhe i përgjithshëm, thotë: “Kjo është transmetuar nga Ebi Abdilahi (imam Sadiku) (*Paqja qoftë mbi të!*)”

Disa komentues thonë se në ajet gjendet *hadhf* –mospërmendje, si fjala *sadaka* para fjalës *el ledhijne junfikune* dhe fjala *zariun-mbjellës*, para fjalës *habetin*-kokrra e të ngjashme me këto.

Mirëpo, në këtë ajet nuk gjendet asnjë tregues për praninë e kësaj mospërmendjeje. Krahasimi i shpenzuesve me kokrrat e bereqetshme është një krahasim i mrekullueshëm. Me këtë, Kur’ani sikur thotë: Puna e çdo njeriu është reflektuese e ekzistencës së tij. Sa më shumë të zgjerohen punët, aq më shumë zgjerohet prania e tij reale.

Me fjalë të tjera: Kur’ani nuk e ndan punën e njeriut nga ekzistenca (prania) e tij. Sipas Kur’anit, këto janë dy pamje të ndryshme për një të vërtetë të përbashkët, janë dy anë të një monedhe. Për këtë, ajeti mund të komentohet pa supozuar asnjë lloj mospërmendje.

Ky ajet tregon për një të vërtetë se personaliteti i njeriut të mirë rritet dhe zhvillohet shpirtërisht me punët e tij të mira. Këta shpenzues janë të ngjashëm me farërat frytdhënëse, të cilat i shtrijnë rrënjët dhe degët e tyre në të gjitha anët dhe japin bereqetin e tyre në çdo vend.

Shkurtimisht: Për një gjë krahasuese duhet patjetër të gjenden tri gjëra të tjera: krahasuesi, i krahasuari dhe tipari krahasues. Në këtë ajet krahasuesi është njeriu që shpenzon, i krahasuari është fara e bereqetshme dhe tipari krahasues është rritja dhe zhvillimi. Ne besojmë se njeriu shpenzues në rrugën e All’llahut nëpërmjet kësaj vepre dhe pune rritet dhe udhëzohet, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe sociale.

I njëjti kuptim me këtë gjendet edhe në ajetin 265 të kësaj sureje.

Në mesin e komentuesve gjendet hulumtim rreth frazës: **“Nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra.”**

Ajeti tregon se një kokërr e vetme bëhet shtatëqind kokrra ose më shumë. Ata thonë se ky krahasim nuk ka prani të jashtme, por është supozim, sepse kokrra e grurit në sezonin e korrjes, nuk arrin në shtatëqind kokrra. Sipas tyre, kuptimi duhet të jetë për një lloj të veçantë kokrrë, si duhani, i cili e prodhon këtë sasi.

Ajo që tërheq vëmendjen është se, kohët e fundit, disa gazeta kanë shkruar se në disa fusha të mbjella me grurë, në vitet me reshje, u prodhuan kallinj shumë të gjatë, ku çdo kalli mbarte rreth katërqind mijë kokrra. Kjo tregon se shembulli i Kur'anit është i vërtetë dhe real.

Fjala *judaafu-shton*, vjen nga rrënja *dafe*, që do të thotë *sasi e dybershme apo e disabershme*. Duke parë atë që përmendëm më lart për praninë e kokrrave që prodhojnë me mijëra kokrra të tjera, e kuptojmë se shembulli i Kur'anit është i vërtetë.

Hulumtime

Shpenzimi dhe problemi i dallimit shtresor në shoqëri

Prej problemeve të mëdha, me të cilin vuan gjithmonë njeriu dhe do të vazhdojë të vuajë, me gjithë arritjet e mëdha në përparimin teknologjik dhe material, është dallimi shtresor në shoqëri. Nga njëra anë shohim varfëri shkatërruese dhe nga ana tjetër grumbullim marramendës të pasurisë.

Në shoqëri shohim njerëz që grumbullojnë aq shumë pasuri, saqë nuk mund ta numërojnë. Po ashtu shikon të tjerë që jetojnë në varfëri, ku disa prej tyre nuk mund të sigurojnë të domosdoshmet e jetës së tyre, si: ushqimin, veshmbathjen dhe vendstrehimin.

S'ka dyshim se ajo shoqëri, që ndërtohet mbi pasurinë tmerruese dhe mbi varfërinë vdekjeprurëse, nuk ka jetëgjatësi. Ajo nuk e arrin kurrë lumturinë e vërtetë. Një shoqëri e tillë, pa dyshim që udhëhiqet nga frika, stresi, mërzia, të menduarit për keq e më pas konflikti dhe armiqësia.

Ky dallim shtresor ka qenë i pranishëm edhe më parë. Për fat të keq, sot është bërë akoma më i rrezikshëm se ai që ka qenë më parë. Kjo për arsye se porta e bashkëpunimit të vërtetë njerëzor është mbyllur përpara njerëzve.

Në vend të saj janë hapur portat e kamatës shkatërruese, e cila është faktori kryesor i zgjerimit të greminës shtresore në mesin e njerëzve. Ajo është argument më i qartë i dukjes së komunizmit e të ngjashmeve me të, i përhapjes së gjakderdhjes dhe i luftërave tmerruese, të cilat zhvillohen në shekullin tonë në anë të ndryshme të botës.

Zanafilla e shumicës së këtyre luftërave është ekonomia dhe reagimi i të varfëve që përbëjnë shumicën e njerëzve në botë.

Dijetarët dhe ekspertët e ekonomisë janë përpjekur të shërojnë këtë plagë dhe secili prej tyre zgjodhi një mënyrë dhe rrugë. Komunizmi zgjodhi anulimin e pronës private. Socializmi zgjodhi rrugën e vendosjes së taksave të rënda dhe ngritjen e institucioneve të përgjithshme humane, të cilat sot janë më shumë formale se praktike, duke menduar se me këtë mënyrë dhe rrugë e zgjidhin problemin. Por, në të vërtetë, asnjë prej atyre metodave dhe rrugëve nuk arriti të bëjë një hap ndikues. Kjo për faktin se zgjidhja e këtyre problemeve nuk mund të bëhet me shpirt material, i cili sundon botën.

Me një vështrim meditues në këtë ajet sqarohet se një prej qëllimeve të Islamit, është heqja dhe zhdukja e dallimit të padrejtë shtresor, që e ka pikënisjen tek padrejtësia sociale mes dy shtresave, e pasura dhe e varfra. Ai ka si qëllim ngritjen e nivelit të jetesës së atyre që nuk kanë mundësi të sigurojnë nevojat e jetës.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, Islami ka vendosur një program të gjerë, që përfaqësohet me ndalimin rreptësisht të kamatës, me pagesën e taksave islame, si zekatin dhe khumsin (1/5 e fitimeve në vit). Ai nxit në shpenzim, në kredi pa kamatë (kardul hasan), në ndihmat e ndryshme materiale. Ajo që është më e rëndësishmja, Islami ka si qëllim ringjalljen e shpirtit vëllazëror në mesin e njerëzve.

Ajeti 262

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ثُمَّ لَا يُتَّبِعُونَ مَا أَنْفَقُوا مَنًّا وَلَا
أَذَى لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٢٦٢﴾

“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të All’llahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”

Shoqata

Islami

Komentimi

Ajeti i mëparshëm sqaroi në mënyrë të përgjithshme rëndësinë e shpenzimit. Ky ajet sqaron disa kritere të këtij shpenzimi. (Nga përmbajta e ajetit përfitohet se shpenzimi, që përmendet këtu nuk është i veçantë për shpenzimin në xhihad.)

Ajeti thotë: **“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të All’llahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”**¹

Nga ky ajet kuptohet shumë qartë se shpenzimi në rrugën e All’llahut nuk është i pranueshëm nëse përmban përgojim apo fyerje për nevojtarët. Ai, që e shpenzon pasurinë e tij në rrugën e All’llahut, pastaj ia përmend apo ka si qëllim të ofendojë të tjerët, në të vërtetë nuk merr asnjë lloj shpërblimi nga vepra e tij.

¹ Fjala *menne* ka kuptimin e gurit të peshores. Më pas është përdorur për mirësitë e rëndësishme, në të cilën shihet ana praktike (dhëniet e All’llahut janë të tilla).

Ajo, që është më e rëndësishme në këtë ajet, është se Kur'ani Fisnik nuk e konsideron kapitalin material si kapital bazë të jetës së njeriut. Por ai llogarit edhe kapitalin shpirtëror dhe social.

Kushdo që i jep dikujt dhe ia përmend apo pas dhënies vepron diçka që e lëndon, në të vërtetë ai nuk ka dhënë asgjë. Nëse ai i ka dhënë një kapital, i ka marrë po një kapital. Jo vetëm kaq, ka raste që të përmendurit e asaj që jep apo shikimi ofendues, kushtojnë më shumë se ajo që i dha.

Nëse të tillë njerëz nuk fitojnë asnjë shpërblim nga shpenzimi i tyre, kjo është e drejtë dhe e natyrshme. Këta njerëz janë borxhlinj dhe jo dhënës, sepse dinjiteti i njeriut është shumë herë më i çmueshëm se sa pasuria dhe paraja.

Vështroje mirë ajetin. Dy fjalët *el menn* dhe *edha* vijnë pas fjalës *thumme-pastaj*, e cila ka kuptimin e vonesës. Pra, gjendet një kohë mes dy veprave. Atëherë, kuptimi i ajetit është i tillë: Ata që shpenzojnë dhe pas një kohe nuk e përmendin dhe as i bëjnë keq atij që i japin, shpërblimi i tyre do të jetë i ruajtur tek All'llahu i Madhëruar. Kështu që duhet patjetër të shmanget përgojimi dhe dëmtimi jo vetëm në kohën e shpenzimit, por edhe më pas.

Duhet theksuar se *el men* dhe *el edha*, që janë shkak i mospranimit të shpenzimit, nuk janë të posaçme vetëm për shpenzimin për të varfrit dhe nevojtarët. Por, ato duhen shmangur në të gjitha punët e përgjithshme sociale, si xhihadi në rrugën e All'llahut dhe veprat e përgjithshme të dobishme që kërkojnë sakrificë dhe përpjekje.

“...do të kenë shpërblim te Zoti i tyre...”

Kjo fjali e ajetit i qetëson shpenzuesit se shpërblimi i tyre është i ruajtur tek All'llahu Bujar. Kjo me qëllim që ata ta vazhdojnë këtë rrugë me besim dhe me bindje të plotë. Ajo, që është tek All'llahu,

është e qëndrueshme dhe nuk pakësohet. Fjala *rabihim*, ka mundësi të tregojë se All'llahu i Madhëruar ia shton shpërblimin atyre.

“...dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”

Për këtë shpenzuesit janë të bindur dhe nuk kanë as më të voglën ndjenjë të frikës e të pikëllimit për atë që shpenzojnë, sepse çdo gjë do ta shohin nesër kur të dalin para All'llahut.

Disa komentues kanë mendimin se fraza ka kuptimin që nuk frikësohen nga varfëria, nga smira, nga koprracia e të ngjashme me to. Nuk pikëllohen për atë që shpenzuan në rrugën e All'llahut.

Në një hadith, profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Kushdo që i jep diçka një besimtari, pastaj e fyen me fjalë apo ia përmend atë që dha, dhënia e tij është e pavlerë.”¹**

Ai njeri, që shpenzon në rrugën e All'llahut dhe nuk vepron kështu pas dhënies, nuk i frikësohet mospranimit të asaj që veproi. Mësimet e Islamit dëshmojnë dhe e përforcojnë saktësinë e sheriatit të bekuar në këtë çështje. Disa dijetarë kanë thënë: ‘Kur ti i jep sadaka një njeriu dhe e di se, kur ta takosh, ai e ka të vështirë të të takojë, se do të kujtojë sadakanë tënde, mos e tako atë.’²


¹ Tefsijrul “Burhan”, vëll. 1, f. 235,

² Tefsijri “Ruhul Xhinan”, vëll. 2, f. 364

Ajeti 263

قَوْلٌ مَّعْرُوفٌ وَمَغْفِرَةٌ خَيْرٌ مِّنْ صَدَقَةٍ يَتَّبِعُهَا أَذَىٰ ۗ وَاللَّهُ غَنِيٌّ حَلِيمٌ ﴿٢٦٣﴾

“Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. All’llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë.”



Fjala e mirë është më e përkryer se sadakaja e shoqëruar me fyerje

Ky ajet plotëson temën e ajetit të mëparshëm rreth lënies së të përmendurit dhe të ofendimit në shpenzim dhe dhënie. Ajeti thotë: “Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje.”

Duhet të dihet se ajo, që shpenzohet në rrugën e All’llahut, në të vërtetë është thesar për ju, për shpëtimin tuaj, sepse All’llahu i Madhëruar nuk ka nevojë as për ju dhe as për shpenzimin dhe dhënien tuaj. Ai është i Butë përballë paditurisë suaj, sepse “All’llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë.”

Dy hulumtime

1- Ky ajet sqaron logjikën e Islamit për vlerat shoqërore të njerëzve, të dinjitetit të tyre. Ai ka mendimin se ata njerëz, që përpiqen të ruajnë kapitalin njerëzor dhe bashkëpunojnë me nevojtarët me butësi, u drejtohen me humanizëm dhe nuk i përhapin sekretet e tyre, kjo është më e mirë dhe më e përkryer se sa shpenzimi i atyre vetëpëlqyesve, që mbartin shikim të ngushtë, që, edhe kur japin pak, e pasojnë këtë me fyerjen e njerëzve të nderuar, duke shkatërruar personalitetin e tyre. Në të vërtetë, dëmi i atyre njerëzve është më i madh se dobia. Nëse ata shpenzojnë ndonjë pasuri, i përballin pasuritë e tjera me humbje dhe shkatërrim.

Nga kjo që thamë sqarohet se fraza “*Kaulun ma’ruf*”-*fjalën e mirë*, ka kuptim të gjerë dhe përfshin çdo lloj fjale të mirë, ngushëllimi dhe udhëzimi.

Disa kanë mendimin se kjo ka kuptimin e urdhërimit në të mira.¹ Por, ky kuptim nuk përputhet me kuptimin e jashtëm të ajetit.

Fjala *el magfiretu-falje*, ka kuptimin e mospërdorimit të ashpërsisë nga nevojtarët. Ka raste, për arsye të vështirësive që hasin këta nevojtarë në jetën e tyre, flasin fjalë të ashpra që i thonë me gojë dhe jo me zemër. Me këtë ashpërsi shprehëse ata duan të hakmerren ndaj atyre që u kanë bërë padrejtësi dhe u kanë shkelur të drejtat. Më e pakta që duhet të bëjnë njerëzit e pasur kundrejt varfërisë së nevojtarëve, është t’i durojnë fjalët e tyre, që janë si shkëndija zjarri në zemrat e tyre.

S’ka dyshim se durimi ndaj ashpërsisë së tyre dhe falja e tyre e pakëson presionin shpirtëror dhe psikik. Me këtë sqarohet rëndësia e urdhrave të All’llahut.

¹ Këtë e përmend autori i tefsijrit “El Bahrul Muhij”, vëll. 2, f. 307 me fjalën *kijle*.

Disa kanë mendimin se fjala *el magfiretu*, këtu ka kuptimin origjinal të saj që është, *mbulim, fshehje*, që do të thotë *mbulim i sekreteve të nevojtarëve të ndershëm dhe fisnikë*. Ky komentim nuk bie ndesh me ato që përmendëm më lart, sepse, nëse ne do ta komentojmë fjalën *el magfireh* me kuptim më të gjerë, ajo përfshin si faljen, ashtu edhe mbulimin dhe fshehjen.

Në komentimin “El Mexhmaul Bejan” përmendet një hadith i ardhur nga profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Kur një nevojtar të kërkojë diçka, mos ia ndërprisni fjalën derisa të mbarojë. Pastaj përgjigjuni atij me respekt dhe butësi ose me dhënien e mundshme apo me fjalën e mirë. Kjo se ka mundësi që tek ju të jetë dikush, që nuk është as njeri dhe as xhin, të shohë se si vepron me ato që All'llahu ju ka lejuar.”¹**

Në këtë hadith profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sqaron një nga anët e etikës së shpenzimit dhe të dhënies.

2- Sigurisht, që frazat e shkurtra që gjenden në fundin e ajeteve të Kur'anit, disa prej tyre përmendin cilësitë e All'llahut, kanë lidhje me përmbajtjen e ajetit. Sipas kësaj, fraza **“Innall'lahe ġanijun hamijd”-“All'llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë”** ka kuptimin që njeriu është i padrejtë dhe, kur fiton ndonjë post apo pasuri, ai e konsideron veten e tij të pasur dhe nuk ka nevojë për të tjerët.

Me këtë gjendje ata përdorin ashpërsinë dhe i kundërvihen të varfërve dhe nevojtarëve. Për këtë Kur'ani thotë se i Vetëmjaftueshëm është vetëm All'llahu. Ai nuk ka nevojë për askënd. Ndërsa ndjenja e njeriut se ai është i vetëmjaftueshëm është *serabun-mirazh*, që nuk duhet ta çojë në padrejtësi ndaj të varfërve.

¹ Tefsijri "Mexhmaul Bejan", vol. 1dhe 2, f. 375, Tefsijri I Kurtubiut, vëll. 3, f. 310

Në fund ajeti thotë se All'llahu është i Butë edhe ndaj atyre që nuk e falënderojnë. Edhe besimtari duhet të jetë i tillë, pra, i butë me të tjerët.

Ka mundësi që ajeti të ketë kuptimin se All'llahu nuk ka nevojë për shpenzimet tuaja. Atë që shpenzoni është në të mirën tuaj dhe mos ia përmendni të tjerëve atë që u jepni. All'llahu është i Butë ndaj ashpërsisë suaj dhe nuk nxitohet në ndëshkimin tuaj, sepse ju mund të zgjoheni dhe të ndreqni veten tuaj.



Ajetet 264 - 265

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَبْطُلُوا صَدَقَاتِكُمْ بِالْمَنِّ وَالْأَذَى كَالَّذِي يُنْفِقُ مَالَهُ رِئَاءَ النَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَمَثَلُهُ كَمَثَلِ صَفْوَانٍ عَلَيْهِ تُرَابٌ فَأَصَابَهُ وَابِلٌ فَتَرَكَهُ صَلْدًا ۖ لَا يَقْدِرُونَ عَلَى شَيْءٍ مِّمَّا كَسَبُوا ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ ﴿٢٦٤﴾ وَمَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ ابْتِغَاءَ مَرْضَاتِ اللَّهِ وَتَثْبِيتًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ كَمَثَلِ جَنَّةٍ بِرَبْوَةٍ أَصَابَهَا وَابِلٌ فَفَاتَتْ أَكْلَهَا ضَعْفِيرًا ۚ فَإِن لَّمْ يُصِبْهَا وَابِلٌ فَطَلَّ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٢٦٥﴾

“O ju që keni besuar! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në All’llahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se All’llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.

Ata që shpenzojnë pasurinë e vet, për të kërkuar kënaqësinë e All’llahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllejnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton. All’llahu i sheh mirë punët që bëni ju.”

Komentimi

Arsyet e shpenzimit dhe rezultati i tij

Në këto dy ajete gjendet ndalim për besimtarët, që të mos fyejnë kur shpenzojnë në rrugën e All'lahut, sepse kjo shkakton prishjen e punëve të tyre. Më pas Kur'ani sjell shembull për shpenzimin e shoqëruar me fyerje dhe një shembull tjetër për shpenzimin që buron te çiltërsia dhe ndjenja humane. Ai thotë: **“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në All'lahun dhe Ditën e Fundit.”**

Rreth shembullit të parë, All'lahu i Madhëruar thotë: **“Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë.”**

Përfytyro (mendo) një gur të lëmuar, të cilin e ka mbuluar një shtresë e hollë pluhuri dhe në këtë pluhur janë vendosur fara mbjellëse, që i rreh ajri dhe rrezet e diellit. Sapo të bjerë shiu mbi këtë pluhur, do ta lajë atë gur dhe do t'i shpërndajë vend e pa vend farat që ndodheshin mbi të.

Pas kësaj do të shfaqet e vërteta e gurit të lëmuar nga sipër, por i futur në tokë. Këtu nuk mund të thuhet se ajri dhe dielli kanë ndikuar për keq ndaj farave, por farërat nuk ishin vendosur në vendin e përshtatshëm. E jashtëmja e vendit të tyre ishte e bukur, por e brendshme e tij ishte e ashpër, ku nuk mund të depërtohej. Shtresa e pluhurit në sipërfaqe nuk e ndihmon bimën që të rritet, sepse bima ka nevojë që rrënjët e saj të hyjnë në tokë dhe të ushqehet.

Kur'ani e shëmbëllen dhënien e shoqëruar me dukje dhe fyerje me atë shtresë të hollë pluhuri që mbulon gurin e lëmuar, që me pamjen e jashtme e mashtron bujkun dhe lodhja e tij ikën me erën. Ky është shembulli që Kur'ani e përmend në ajetin e parë.¹

Në fund ajeti thotë: **“...se All'llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.”** Kjo tregon se All'llahu as nuk do t'i mbarësojë dhe as nuk do t'i udhëzojë këta lloj njerëzish. Kjo për arsye se ata dhanë dhe shpenzuan për t'u dukur ose për t'i fyer të tjerët. Në këtë mënyrë ata zgjodhën rrugën e mohimit dhe për ta nuk është i përshtatshëm udhëzimi. Për këtë edhe Kur'ani, si dhënien me dukje, ashtu edhe me fyerje, i ka vendosur në të njëjtin vend.

Një tjetër shembull i përkryer

Në ajetin e mëposhtëm lexojmë një shembull të përkryer, që është e kundërta e shembullit të parë. Këtu përmenden ata besimtarë që i shpenzojnë pasuritë e tyre në rrugën e All'llahut për shkak të besimit dhe çiltërsisë. Ajeti thotë: **“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet, për të kërkuar kënaqësinë e All'llahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllejnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton.”**

Mendo për këtë ajet, sikur po sheh një fushë të gjelbër që ndodhet në një rrafshnaltë, toka e së cilës është pjellore, që rrihet nga ajri, rrezet e diellit dhe shiu dobiprurës. Nëse nuk bie shi i furishëm, mbi të bie shiu i imët që të ruajë lagështinë e fushës së mbjellë. Rezultati do të jetë se kjo fushë do të prodhojë më shumë se fushat e tjera. Kjo tokë, përveç asaj që është pjellore, së cilës i mjafton edhe


¹ Fjala *sinuan* është shumësi i fjalës *sinuanetun*, që do të thotë *shkëmb i pastër*. Fjala *el nabil* ka kuptimin *e shiut të furishëm*. Fjala *es sald* ka kuptimin *e gurit të lëmuar*. Fjala *di'fejmi* është dytësori i fjalës *di'fun* dhe nuk ka kuptimin e katër herëve, por *dy herëve*, njësoj si *zeuxhejn*, që do të thotë *dy anë*.

shiu i imët dhe se shiu i furishëm nuk e dëmton prodhimin e saj, përveç asaj që ajo përfiton nga rrezet e diellit dhe ajri, është në rrafshnaltë dhe është e sigurt nga përmbytjet.

Ajeti kërkon të thotë se ata që i shpenzojnë pasuritë e tyre në rrugën e All'llahut, me qëllim që të forcojnë besimin dhe bindjen në zemrat dhe shpirtërat e tyre, janë të ngjashëm me atë fushë prodhuese, të dobishme dhe të çmueshme.

Në fund ajeti thotë: **“All'llahu i sheh mirë punët që bëni ju.”**

Kjo do të thotë se All'llahu e di më së miri se kjo dhënie është e shoqëruar me dashuri dhe respekt, apo me dukje dhe me fyerje.



Shoqata

Islami

Hulumtime

1- Vërtet, fraza: **“Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato** (atyre që ua keni dhënë) **dhe duke fyer..”** na mëson se disa punë mund ta ndryshojnë rezultatit e disa veprave të mira. Ky është ihbati (pavlefshmëria e veprave), të cilin e sqaruam në komentimin e ajetit 217 të kësaj sureje.

2- Krahasimi i punës së shoqëruar me dukje me shkëmbin e mbuluar nga një shtresë e hollë pluhuri, është një krahasim i saktë, sepse dukja ka të brendshme të ashpër dhe të egër. Ai përpiqet që këtë ashpërsi ta mbulojë me pamje të mirë nga jashtë, që është dashuria dhe dashamirësia për njerëzit. Mirëpo, veprat e tij nuk janë të rrënjësura në shpirtin e tij dhe nuk kanë asnjë bazë të qëndrueshmërisore. Në momentin më të shpejtë që të zbulohet kjo e vërtetë për shkak të shkaqeve të jetës, shfaqet e brendshmeja e tyre.

3- Fjalja: **“...për të kërkuar kënaqësinë e All'llahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira”** sqaron shkaqet e sakta të shpenzimit në rrugën e All'llahut, të cilët janë dy: kërkimi i kënaqësisë së All'llahut dhe forcimi i shpirtit të besimit në zemra.

Ky ajet thotë se dhënësit e vërtetë janë ata që kanë si qëllim fitimin e kënaqësisë së All'llahut dhe zhvillimin e virtyteve të larta humane në shpirtërat e tyre. Me këtë punë ata duan të zhdukin zemërimin dhe hidhërimin nga zemrat e të varfërve dhe nevojtarëve. Për këtë fjala *min*, që përmendet në ajet, ka kuptimin *fi-në veten e tyre*.

4- Fjalja: **“All'llahu i sheh mirë punët që bëni ju.”**, që ndodhet në fundin e ajetit 265 u tërheq vërejtjen të gjithë atyre që duan të bëjnë një punë të mirë të jenë të kujdesshëm, që qëllimet e tyre, punët e tyre dhe mënyra e kryerjes së punëve të mos përzihen me papastërti, sepse All'llahu është Mbikëqyrësi i punëve të njeriut.

Ajeti 266

أَيُّودٌ أَحَدُكُمْ أَنْ تَكُونَ لَهُ جَنَّةٌ مِّن نَّخِيلٍ وَأَعْنَابٍ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ لَهُ فِيهَا مِن كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَأَصَابَهُ الْكِبَرُ وَلَهُ ذُرِّيَةٌ ضُعَفَاءُ فَأَصَابَهَا إِعْصَارٌ فِيهِ نَارٌ فَاحْتَرَقَتْ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ

الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَتَفَكَّرُونَ ﴿٢٦٦﴾

“A dëshiron ndonjëri nga ju që, duke qenë i moshuar e me fëmijë të mitur e të pambrojtur, kopshti i tij plot palma hurmash, vreshta e gjithfarë lloje frutash dhe i ujitur nga lumenj rrjedhës, të digjet nga një stuhi zjarri?! Ja, kështu All’llahu jua shpjegon shpalljet e Tij, me qëllim që të mendoni.”

Komentimi

Një tjetër shembull rreth dhënies së ndotur nga dukja dhe fyerja

Në këtë ajet Kur’ani sjell një shembull tjetër me të cilin sqaron nevojën e madhe të njeriut për punë të mira në Ditën e Kiametit. Gjithashtu, thotë se si dukja dhe fyerja ndikojnë në punët e mira dhe në fshirjen e mirësisë së tyre.

Ky shembull trupëzohet me pronarin e një fushe të gjelbër me pemë të ndryshme, si hurma dhe rrush, në të cilën rrjedh uji dhe nuk

ka nevojë për vaditje. Mirëpo mosha e thyer e mposhti pronarin e saj, si dhe rreth tij kishte fëmijë të dobët. Ata nuk kishin gjë tjetër përveç këtij vreshti. Nëse do të thahej apo do të digjej, ata nuk do të jetonin. Papritur fryn një erë flakëruese dhe e djeg të gjithë këtë vresht. Vallë, si do të jetë gjendja e të moshuarit dhe e fëmijëve të dobët, që nuk kanë mundësi të sigurojnë kafshatën e gojës? Sa i madh është pikëllimi dhe fatkeqësia e tyre!

“A dëshiron ndonjëri nga ju që, duke qenë i moshuar e me fëmijë të mitur e të pambrojtur, kopshti i tij plot palma hurmash, vreshta e gjithfarë lloje frutash dhe i ujitur nga lumenj rrjedhës, të digjet nga një stuhi zjarri?!”

Gjendja e atyre që bëjnë vepra të mira dhe pastaj i fshijnë me dukjen dhe fyerjen është e njëjtë me gjendjen e atij që lodhet shumë dhe, kur vjen koha e vjeljes së prodhimit, i zhduket çdo gjë dhe nuk i mbetet tjetër veçse pikëllimi dhe mërzia. Më poshtë ajeti thotë: **“Ja, kështu All’llahu jua shpjegon shpalljet e Tij, me qëllim që të mendoni.”**

Përderisa burimi i fatkeqësisë dhe mjerimit, veçanërisht tek punët e gabuara, si dukja dhe fyerja ndaj njerëzve, është mospërdorimi i mendjes dhe i logjikës, All’llahu i Madhëruar i nxit njerëzit që të mendojnë thellë në ajetet e Tij: **Ja, kështu All’llahu jua shpjegon shpalljet e Tij, me qëllim që të mendoni.”**

Hulumtime

1- Këta shembuj tregojnë për të mbjellat e kënaqshme. Këto ajete nuk kanë zbritur vetëm për njerëzit e Medines, të cilët ishin fermerë, por kanë zbritur për të gjithë njerëzit. Janë përmendur të mbjellat, sepse ato përbënin një anë të jetës së tyre.

2- Nga thënia: **“...duke qenë i moshuar e me fëmijë të mitur e të pambrojtur...”** përfitohet se dhënia në rrugën e All’llahut dhe shtrirja e dorës së ndihmës për nevojtarët janë të ngjashme me kopshtin frutdhënës, nga i cili përfiton pronari dhe fëmijët e tij. Mirëpo, dukja dhe fyerja, nuk ndalojnë vetëm pronarin të fitojë nga ky kopsht, por ndalojnë edhe fëmijët dhe brezat e ardhshëm nga mirësitë e këtij kopshti.

Kjo tregon se brezi i ardhshëm janë partnerë të brezave të shkuar në përfitimin e frutave. Gjithashtu dhe nga ana sociale, sepse dashuria dhe mirëbesimi, që fitojnë baballarët për shkak të punëve të tyre të mira në mesin e njerëzve, janë kapitali më i mirë për fëmijët e tyre.

3- Faza **“stuhi zjarri”** mund të tregojë për erërat helmuese, të cilat djegin të mbjellat dhe thajnë ujërat, ose tregon për erërat që fitojnë nxehtësinë kur kalojnë mbi zjarrin e ndezur dhe ky zjarr bashkohet me të, duke e dërguar në zona të tjera; ose mund të tregojë për erëra të shoqëruara me rrufe djegëse, të cilat, kur godasin tokën, djegin çdo gjë që ndodhet në të. Sido që të jetë, kjo është treguese për një shkatërrim të shpejtë.¹

¹ El A’sar”, janë erëra që ngrenë pluhurin. Ajo fryn nga dy anë të ndryshme e më pas pluhuri ngrihet vertikalisht drejt qiellit. (Kjo është ajo që ne e quajmë cikloni. (përkthyesi)

Ajeti 267

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اَنْفِقُوْا مِنْ طَيِّبٰتِ مَا كَسَبْتُمْ وَمِمَّا اَخْرَجْنَا لَكُمْ
 مِّنَ الْاَرْضِ ۗ وَلَا تَيَمَّمُوا الْخَبِيْثَ مِنْهُ تُنْفِقُوْنَ وَلَسْتُمْ بِاٰخِذِيْهِ اِلَّا اَنْ
 تُغْمِضُوْا فِيْهِ ۗ وَاَعْلَمُوْا اَنَّ اللّٰهَ غَنِيٌّ حَمِيْدٌ ﴿٢٦٧﴾

“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se All’llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ky ajet ka zbritur për ata njerëz që praktikonin kamatën dhe jepnin lëmoshë prej saj. Atëherë, All’llahu i ndaloi ata nga ky veprim dhe urdhëroi që sadakaja të jetë nga të mirat e fituara me hallall.¹

Transmetohet nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ky ajet ka zbritur për ata njerëz që jepnin për sadaka nga hurmat më të këqija.²

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë. “Usulul Kafij”, vëll. 4, f. 48.

² Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë. “Usulul Kafij”, vëll. 4, f. 48.

Mes dy transmetimeve nuk gjendet kundërshtim, sepse ka mundësi që ajeti të ketë zbritur për të dy grupet. Shkaku i parë ka të bëjë me pastërtinë shpirtërore, ndërsa i dyti me pamjen e kënaqshme materiale.

Duhet theksuar se ata, që e praktikonin kamatën në kohën para Islamit, kur zbriti ajeti 275 i kësaj sureje, e ndaluan praktikimin e saj dhe, se ky ajet nuk ua ka bërë të ndaluar pasurinë e mëparshme. Mirëpo, është e qartë se ajo pasuri edhe, nëse është e lejuar, ndryshon nga pasuritë e tjera. Në të vërtetë ajo ngjason me fitimin e pasurisë në rrugë përbuzëse.



Shoqata

Komentimi

Flladi

Pasuria që mund të shpenzohet

Ajetet e mëparshme sqaruan frytet e shpenzimit, cilësitë e shpenzuesve dhe punët që zhdukin veprën e shpenzimit në rrugën e All'llahut. Ky ajet sqaron llojin e pasurive që mund të shpenzohen në rrugën e All'llahut.

Në fillim të ajetit All'llahu i urdhëron besimtarët që të shpenzojnë prej të mirave të pasurive të tyre. Në gjuhësi fjala *tajjibat* ka kuptimin e *së pastrës, të kulluarës nga ana shpirtërore dhe materiale*. Ndërsa në ajet ka kuptimin e pasurisë së mirë dhe të dobishme, në të cilën nuk gjendet dyshim rreth hallallit të saj. (fitimit me rrugë të lejueshme).

Këtë e përforcon si kuptimi i përgjithshëm i ajetit, ashtu edhe dy ajetet e përmendura te shkaku i zbritjes së ajetit.

“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës.”

Fraza “*ma kesebtum*”-nga ato që keni fituar, tregon për fitimet tregtare, fitimet nëpërmjet bujqësisë dhe nxjerrjes së mineraleve. Pra, ajo përfshin të gjitha llojet e fitimeve. Kjo sepse zanafilla e fitimeve të njeriut vjen nga toka dhe nga burimet e ndryshme të saj.

Ajeti thotë: Ne i kemi vendosur burimet e pasurisë në shërbimin tuaj, prandaj ju nuk duhet të jeni koprracë dhe dorështrënguar në shpenzimin e më të mirës në rrugën e All'llahut të Madhëruar.

“Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur.”¹

Shumica e njerëzve e kishin zakon që të shpenzonin nga ajo që i tepronte prej pasurive të tyre dhe që nuk kishin vlerë. Ky lloj shpenzimi as që e edukon shpirtin e furnizuesit dhe as që ia kryen nevojën nevojtarit. Jo vetëm kaq, ky shpenzim mund të jetë fyes dhe përçmues për nevojtarin. Për këtë erdhi ky ajeti që e ndalon qartësisht këtë veprim, duke u thënë njerëzve: Si shpenzoni nga kjo pasuri që as ju vetë nuk e pranoni për veten tuaj? Vallë, ju i konsideroni vëllezërit tuaj myslimanë me më pak vlerë apo mendoni se jeni më lart se All'llahu, në rrugën e të cilit po shpenzoni? (All'llahu na mbroftë nga ky mendim!)

Në realitet, ajeti tregon për një mendim shumë të thellë, që shpenzimi në rrugën e All'llahut është në dy anë. Në njërin anë është nevojtarit dhe në tjetrën All'llahu. Nëse shpenzuesi zgjedh për të dhënë nga pasuria e tij atë që është e pavlerë, ai ka fyer pozitën e All'llahut Fisnik, duke harruar se të gjithë ato të mira i ka nga Ai. Gjithashtu, ka fyer edhe nevojtarët, të cilët mund të jenë me pozitë të lartë besimi. Atëherë, kjo pasuri e pavlerë, që u jepet atyre, u shkakton më shumë lëndime dhe dhembje shpirtërore.

¹ Fjala *tejemmum* në origjinal ka kuptimin e qëllimit të çdo gjëje. Edhe në këtë ka të njëjtin kuptim. Kjo fjalë përdoret edhe për *tejemumin*, sepse njeriu ka si qëllim përdorimin e dheut të pastër, siç thotë ajeti 43 i sures “En-Nisa” dhe ajeti 6 i sures “El-Maide”.

Përdorimi i fjalës *tajjibat*, të mirat, përfshin të mirat e dukshme që meritojnë të shpenzohen e të jepen, si dhe të mirat shpirtërore larg çdo dyshimi rreth haramit, sepse besimtarët nuk e dëshirojnë përdorimin e kësaj lloji pasurie.

Po ashtu edhe fjalia: **“...të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur...”**, tregon se qëllimi nuk është vetëm pastërtia e jashtme, sepse besimtarët nuk e pranojnë pasurinë e pavlerë, të papastër dhe të dyshuar, qoftë nga jashtë apo nga brenda.

Fraza **“veçse symbyllur”** i përfshin të gjitha. Disa komentues e kanë kufizuar këtë frazë vetëm me dy kuptimet e përmendura. Ky kufizim nuk është i drejtë. E njëjtë me këtë ajet është edhe ajeti 92 i sures “Al Imran”: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.”**

Sigurisht, ky ajet dëshmon më tepër për ndikimet shpirtërore të shpenzimit.

Në fund ajeti thotë: **“Ta dini se All’llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.”** Mos harroni se All’llahu nuk ka nevojë për shpenzimin tuaj. Ai është i Vetëmjaftueshëm për çdo gjë. Jo vetëm kaq, të gjitha të mirat dhe begatitë janë në dorën e Tij. Për këtë Ai është i Denjë për falënderim dhe lavdërim, sepse të gjitha të mirat i ka vënë në dispozicionin tuaj.

Disa dijetarë kanë mendimin se fjala *hamijd* ka kuptim *Lavdërues, Falënderues*. Në këtë ajet ka kuptimin e emrit *fail-Hamid* dhe jo me kuptimin *Mahmud*, që do të thotë: edhe pse është i Vetëmjaftueshëm për shpenzimin tuaj, Ai ju lavdëron për atë që ju shpenzoni.

Ajeti 268

الشَّيْطَانُ يَعِدُكُمُ الْفَقْرَ وَيَأْمُرُكُم بِالْفَحْشَاءِ وَاللَّهُ يَعِدُكُم مَّغْفِرَةً مِّنْهُ
وَفَضْلًا وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٦٨﴾

“Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse All’llahu ju premtion faljen dhe mirësinë e Tij. All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm.”

Komentimi

Luftimi i pengesave për shpenzim

Ky ajet tregon për një ndër pengesat kryesore të shpenzimit, që është vesvesi (cytja) i shejtanit, i cili e frikëson njeriun nga varfëria e nevoja, veçanërisht kur njeriu dëshiron të shpenzojë prej pasurisë së mirë. Sa të shumta janë mosshpenzimet në rrugën e All’llahut, qoftë i pëlqyeshëm apo edhe i detyruar, si: zekati, khumsi, për shkak të vesvesit të djallit.

Ajeti thotë: “Djalli ju frikëson me skamje e varfëri...”, duke ju thënë juve: “Mos e harroni të nesërmen tuaj dhe të ardhmen e fëmijëve tuaj.” Në shtesë të kësaj ai ju fton juve në mëkate e gjynahe: “dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme.”

Fjala *el fahshaa* ka kuptimin e të gjitha punëve të këqija dhe neveritëse. Në ajet ka edhe kuptimin e koprracisë dhe të moskryerjes së shpenzimit, të cilat në vetvete janë prej gjynaheve dhe mëkateve.

Disa komentues kanë thënë se arabët e quanin njeriun *koprrac-fahish*.¹

Ka mundësi që kuptimi i fjalës *fahshaa* në këtë ajet të jetë për zgjedhjen e pasurisë së keqe për sadaka. Thuhet se ka kuptimin e të gjitha mëkateve, sepse djalli, duke e frikësuar njeriun me varfëri e skamje, e nxit që të fitojë pasuri me haram.

Përdorimi i shprehjes rreth vesvesit të djallit në urdhërore: **“dhe ju urdhëron”**, tregon për vetë vesvesin.

Në thelb, çdo mendim i keq apo i ngushtëzuar dhe pengues për mirë e ka burimin te dorëzimi përballë pëshpëritjeve të djallit. Ndërsa, çdo mendim pozitiv dhe ndërtues me dimension logjik e ka burimin te frymëzimet hyjnore dhe tek natyra e shëndoshë krijuese.

Për sqarimin e këtij kuptimi themi: Në shikim të parë, shpenzimi çon në mendimin e pakësimit të pasurisë. Ky është vështrim i ngushtë djallëzor. Mirëpo, nëse e thellojmë shikimin, do të kuptojmë se shpenzimi është garancia e qëndrueshmërisë së shoqërisë, zbatimi i drejtësisë shoqërore, pakësim i shtresave dalluese në shoqëri dhe civilizim i përgjithshëm.

Është e natyrshme se përparim dhe civilizim i shoqërisë do të thotë që individët e saj të jenë në gjendje të mirë ekonomike. Kjo është pikëpamje e vërtetë hyjnore.

Me këtë, Kur’ani do t’u mësojë njerëzve se shpenzimi, edhe pse në pamje të jashtme duket si pakësim, në realitet është shtim i kapitalit të pasurisë së shpenzuesve si materialisht, ashtu edhe shpirtërisht.

¹ Tefsijri “Ruhul Bejan”, vëll. 1, f. 431. Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, tefsijrul “Kebijr”, ajeti në fjalë.

Nëse i hedhim një vështrim botës ku jetojmë, në të cilën gjenden dallime shtresore, fatkeqësi, varfëri, si rezultat i padrejtësisë dhe monopolizimit, atëherë do ta kuptojmë më mirë përmbajtjen e këtij ajeti.

Nga ajeti, gjithashtu, përfitojmë se ka një lidhje mes lënies së shpenzimit dhe *fahshait*. Përderisa fjala *fahshaa* ka kuptimin e koprracisë së tmerrshme, atëherë kjo lidhje është se lënia e shpenzimit e forcon edhe më tepër cilësinë e koprracisë te njeriu. Duhet thënë se shpenzimi ka ndikime të mëdha shpirtërore, të cilat nuk duhen mohuar.

“Kurse All’llahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij.”

Në Tefsijrin “Mexhmaul Bejan”, përmendet një transmetim nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Tek shpenzimi gjenden dy gjëra nga All’llahu dhe dy nga shejtani. Ato dy të All’llahut janë: falja e gjynaheve dhe shtimi i pasurisë. Ato dy të shejtanit janë: varfëria dhe urdhërimi në të shëmtuara.”¹

Sipas këtij transmetimi, fjala *magfiretun*, që përmendet në ajet, ka qëllimin e faljes së gjynaheve dhe fjala *fadlun*, ka qëllimin e shtimit të pasurisë, kur shpenzohet nga kjo pasuri, siç transmetohet edhe nga Ibn Abbasi.

“All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”

Kjo tregon se fuqia dhe dija e All’llahut janë të pakufizuara. Ai është i Plotfuqishëm për atë që premton dhe padyshim që njeriu qetësohet nga ky premtim. Premtimi i All’llahut nuk është si premtimi i djallit mashtrues e i dobët, i cili e shtyn njeriun në mëkate. Djalli është i dobët dhe i paditur për të ardhmen. Për këtë, premtimi i tij nuk është tjetër veçse humbje dhe nxitje për të bërë mëkate dhe gjynahe.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan” komentimi i ajetit në fjalë. Tefsijri “Et Tibjan”, vëll. 1, f. 346.

Ajeti 269

يُؤْتِي الْحِكْمَةَ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا ۗ
وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٦٩﴾

“Ai ia jep urtësinë kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”

Komentimi

Mirësia më e mirë e All'llahut

Duke parë ato që u përmendën në ajetin e mëparshëm, i cili fliste për frikën e djallit nga varfëria dhe për premtimin e të Gjithëmëshirshmit për falje dhe shtim të pasurisë, ky ajet flet për urtësinë, njohjen dhe dijen, sepse urtësia është e vetmja që mund të bëjë dallimin mes premtimit të djallit e të All'llahut. Ajo e fton njeriun në mejdanin e faljes së All'llahut dhe në lënien e pëshpëritjeve të djallit dhe e mëson që të mos ia vërë veshin frikësimit nga varfëria.

Me fjalë të tjera: Te disa njerëz shohim një lloj njohjeje dhe dijeje si shkak i pastërtisë së zemrës dhe i ushtrimeve shpirtërore, të cilat ndikojnë shumë dhe janë shumë dobiprurëse. Prej atyre dobive është se ky njeri i kupton më së miri dobitë e shpenzimit dhe rolin e tij të madh në shoqëri.

Ai njeri arrin ta kuptojë dallimin mes pëshpëritjeve të djallit dhe dobisë së shpenzimit. Ajeti thotë: **“Ai ia jep urtësinë kujt të dojë.”**

Për kuptimin e fjalës *el Hikmetu-urtësia*, janë përmendur shumë kuptime, ndër to: njohja dhe dija për sekretet e ekzistencës, dija për të vërtetat e Kur'anit, mbërritja tek e vërteta me thënie dhe vepra, njohja e All'llahut, ajo është dritë e All'llahut, me të cilën dallohet pëshpëritja e djallit nga frymëzimet e Rrahmanit (All'llahut).

Me sa duket, kjo fjalë ka kuptim të gjerë, ku përfshin të gjitha çështjet, ndër to edhe profetësinë, e cila është një lloj dije, arsytimi dhe perceptimi. Rrënja e fjalës *hikmet* vjen nga *hikmun*, që do të thotë *ndalim, pengim*. Përderisa dija dhe njohja e pengojnë dhe e ndalojnë njeriun që të bëjë punë të ndaluara (haram), për këtë, kësaj i thuhet *hikmetun-urtësi*.

Është e natyrshme se qëllimi në frazën **“kujt të dojë”** nuk është se urtësia nuk i jepet gjithkujt dhe pa llogari. Edhe dëshira e All'llahut buron nga urtësia dhe Ai ia jep urtësinë atij që e meriton dhe e ujit me ujën e këndshëm të këtij burimi të kulluar.

“Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.”

Dihet që dhënësi i urtësisë është All'llahu. Mirëpo këtu nuk është përmendur emri i Tij.

“Cilitdo që i është dhënë urtësia.”

Nga kjo fjali kuptojmë se urtësia, në vetvete, është diçka e mirë, pa marrë parasysh burimin e saj.

Këtu mund të thuhet: Në fushën e atij që zbret urtësia, vërtet i ka zbritur një bereqet dhe mirësi e shumtë, por jo mirësinë absolute, kjo, sepse lumturia dhe e mira absolute nuk gjenden vetëm tek dija dhe, se dija është faktori më i rëndësishëm i lumturisë dhe i mirësisë.

“Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”

Fjala *tedbekur* ka kuptimin e ruajtjes së dijeve dhe njohjeve brenda në shpirt. Fjala *elbab* është shumësi i fjalës *lubbun*, që është *epiqendra e çdo gjëje*. Për këtë i thuhet edhe mendjes *lubbun*.

Kjo frazë e ajetit na thotë se zotëruesit e mendjes janë ata që i ruajnë të vërtetat dhe i kuptojnë ato. Edhe pse të gjithë njerëzit zotërojnë mendje, me përjashtim të të çmendurve, jo të gjithë cilësohen si njerëz të mençur. Të mençurit janë ata që i shfrytëzojnë mendjet e tyre për të hapur rrugët e tyre, duke u bazuar te drita shkëlqyese e urtësisë.

E përfundojmë këtë hulumtim me thënien e një dijetari mysliman (ka mundësi që kjo thënie të jetë nga profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij): ***“Ndoshta All'llahu do ta dënojë një popull në këtë tokë, mirëpo Ai sheh një mësues që u mëson fëmijëve urtësinë dhe për këtë shkak atij populli ia heq dënimin.”***¹

¹ Tefsijri “El Kurtubij”, vëll. 2, f. 1138.

Ajetet 270 - 271

وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِّنْ نَّفَقَةٍ أَوْ نَذَرْتُمْ مِّنْ نَّذْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُهُ^٤ وَمَا
لِلظَّالِمِينَ^٥ مِّنْ أَنْصَارٍ ﴿٢٧٠﴾ إِن تَبَدُّواْ أَلصَّدَقَتِ فَبِعِمَّا هِيَ^٦ وَإِن
تُخَفُّوهَا وَتُؤْتُوهُهَا الْفُقَرَاءَ فَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ^٧ وَيُكَفِّرُ عَنْكُمْ مِّنْ

سَيِّئَاتِكُمْ^٨ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿٢٧١﴾

“Çfarëdo gjëje që të jepni dhe çdo betim që të bëni, me siguri që All’llahu ka dijeni për atë! Keqbërësit nuk do të kenë askënd që t’i ndihmojë. T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. All’llahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”

Komentimi

Mënyra e shpenzimit

Ajetet e mëparshme flisnin për shpenzimin dhe për dhënien në rrugën e All'lahut. Ato thoshin që njeriu duhet të shpenzojë prej pasurisë së mirë dhe jo të shpenzojë pasuri të keqe e të pavlerë. Gjithashtu, kjo dhënie të jetë e shoqëruar me dashuri, çiltërsi dhe moral të mirë. Në këto dy ajete flitet për mënyrën e shpenzimit dhe për dijen e All'lahut rreth kësaj pune.

Në ajetin e parë All'lahu i Madhëruar thotë: **“Çfarëdo gjëje që të jepni dhe çdo betim që të bëni, me siguri që All'lahu ka dijeni për atë!”**

Kuptimi: Çdo gjë që e shpenzoni në rrugën e All'lahut, qoftë shumë apo pak, e mirë apo e keqe, e fituar me hallall apo me haram, i çiltër është qëllimi apo për t'u dukur, jepet e shoqëruar me fyerje apo jo, a është prej atij shpenzimi që All'lahu e ka bërë të detyrueshëm apo e bën njeriu vetë të detyrueshëm me betim, për të gjitha këto All'lahu është i Gjithëdijshëm dhe i Mirinformuar. Duke qenë i tillë, Ai shpërblen ose dënon.

Në fund ajeti i parë thotë: **“Keqbërësit nuk do të kenë askënd që t'i ndihmojë.”**

Fjala *edh dhalimine-të padrejtët*, ka kuptimin e monopolistëve, koprracëve, të atyre që japin për t'u dukur dhe të atyre që dhënien e shoqërojnë me fyerje dhe përmendje. Padyshim që All'lahu nuk i ndihmon ata dhe ajo që shpenzuan nuk do t'i bëjë dobi as në këtë jetë dhe as në Jetën Tjetër.

Ka mundësi që qëllimi i kësaj fjale të jetë për ata njerëz që nuk shpenzojnë për të varfrit dhe nevojtarët. Me këtë veprim ata i bëjnë padrejtësi vetes së tyre dhe shoqërisë ku jetojnë; ose ka për qëllim ata njerëz që nuk japin aty ku duhet dhënë, sepse kuptimi i fjalës *dhulm-*

padrejtësi është i gjerë dhe përfshin çdo punë që bën njeriu aty ku nuk duhet.

Përderisa nuk gjenden kundërshtim mes këtyre tre kuptimeve, atëherë të gjitha këto mund të hyjnë në kuptimin e ajetit.

Vërtet, ata njerëz të padrejtë nuk gjejnë ndihmë as në këtë jetë dhe as ndërmjetësim në Jetën Tjetër. Ky është rezultat prej të veçantave të padrejtësisë të çdo forme qoftë.

Nga përmbajtja e këtij ajeti përfitohet ligjshmëria e betimit dhe obligimi i zbatimit nga betuesi. Betimi ka qenë edhe para Islamit dhe Islami e ka lejuar.

Në ajetin e dytë tregohet për mënyrën e shpenzimit, qoftë fshehur apo hapur. Ajeti thotë: **“T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë.”**

Më këtë veprim, All’llahu do t’ju falë juve: **“...dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. All’llahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”**

Hulumtime

1- S'ka dyshim se çdo shpenzim në rrugën e All'llahut, qoftë hapur apo fshehur, ka ndikime të dobishme. Nëse shpenzimi është i detyrueshëm, atëherë reklamimi i tij nxit të tjerët që ta bëjnë një gjë të tillë. Po ashtu, ky veprim heq akuzat ndaj shpenzuesit se nuk e kryen detyrën e tij.

Ndërsa, kur shpenzimi është i pëlqyeshëm (mustehab), ai është si ftesë dhe njoftim praktik për të nxitur njerëzit që të bëjnë mirë, të ndihmojnë nevojtarët dhe të bëjnë punë të përgjithshme bamirësie dhe humane.

Kurse, shpenzimi i fshehur, pa dyshim që është larg të vepruarit për t'u dukur. Qëllimi i sinqertë në të është më i madh dhe se ndihma e nevojtarëve në fshehtësi mbron dinjitetin dhe fisnikërinë e tyre. Ky është shkaku që ajeti i lavdëron të dy mënyrat e shpenzimit.

Disa komentues kanë thënë se shpenzimi i fshehur është i kufizuar për shpenzimin e pëlqyer (mustehab). Ndërsa shpenzimi i detyrueshëm, si zekati e të ngjashme me të, është mirë të bëhen hapur. Ky nuk është rregull i përgjithshëm, por ndryshon me ndryshimin e situatave të shpenzimit.

Në situatat ku më shumë përmban inkurajim dhe sinqeritet, më parësore është që shpenzimi të bëhet hapur. Dhe në situatat, ku nevojtarët janë dinjitozë dhe fisnikë, është mirë që shpenzimi për ta të bëhet fshehur, sepse mbrojtja e dinjitetit të tyre e bën shpenzimin që të kryhet fshehur. Po ashtu, nëse dikush frikësohet se mos e kaplojë ndjenja e mburrjes apo prishja e sinqeritetit, atëherë është më mirë që shpenzimi të bëhet fshehur.

Në disa hadithe thuhet se shpenzimi i detyruar është mirë të bëhet hapur dhe shpenzimi i pëlqyer është mirë të bëhet fshehur.¹

¹ "Uesailu Shia", vëll. 9, f. 309, Kreu i Istihbabit të dhënies hapur të zekatit të detyrueshëm.

Është transmetuar nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Zekati i detyruar të nxirret hapur dhe të jepet hapur. Të tjerat, përveç zekatit, të jepen fshehur dhe kjo është më e mirë.”¹

Ky hadith e të ngjashëm me të nuk e kundërshtojnë atë që thamë më parë, sepse zbatimi i obligimit mund të jetë shumë pak i përzier me mburrje. Kjo për faktin se ky obligim duhet të zbatohet nga të gjithë myslimanët. Ndërsa shpenzimi mustehab nuk është i detyrueshëm. Për këtë, shfaqja e tij mund të shoqërohet me një mburrje apo me qëllim jo krejt të pastër. Për këtë është më mirë që të bëhet në mënyrë të fshehur.

2- Thënia: “**...dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja.**”, sqaron se shpenzimi në rrugën e All'llahut ndikon në faljen e gjynaheve. Frazja tekfijri (mbulimi) i të këqijave është aludim për faljen.

Është e natyrshme se kjo nuk do të thotë se shpenzimi i një pjese të pasurisë apo parave i heqin njeriut të gjitha gjynahet dhe mëkatet. Prandaj në ajet gjejmë fjalën *min*, që në gjuhën arabe vjen edhe me kuptimin *disa*, që do të thotë se falja përfshin një pjesë prej gjynaheve të njeriut dhe se kjo pjesë është në përputhje me sasinë e shpenzimit dhe me masën e sinqeritetit.

Ka shumë hadithe që flasin për faljen e gjynaheve nëpërmjet shpenzimit. Prej tyre: “**Sadakaja e fshehur shuan zemërimin e Sunduesit, fshin gjynahet njësoj si uji që shuan zjarrin.**”²

Gjithashtu është transmetuar: “**Shtatë njerëz do t'i përfshijë All'llahu nën hijen e Tij, atë kur nuk do të ketë hije tjetër veçse hijes së Tij: imamin e drejtë, të riun që është rritur me bindjen ndaj All'llahut të Madhëruar, atë njeri, zemra e të cilit është e**

¹ Tefsijru “Ali ibn Ibrahim el Kummij”, vëll. 1, f. 92 dhe 93.

² Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 385.

lidhur me xhamitë, dy njerëz që duhen për hir të All'llahut, bashkohen për hir të Tij dhe ndahen për hir të Tij, atë burrë që e fton një grua me post dhe e bukur dhe ai i thotë se unë i frikësohem All'llahut, atë njeri që jep fshehur, saqë e djathta e tij nuk e di se çfarë dha e majta, atë njeri që e kujton All'llahun kur është i vetëm dhe i lotojnë sytë.”¹

3- Nga fjalia: “All'llahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.” përfitohet se All'llahu është i Gjithëdijshtëm për atë që shpenzoni, qoftë hapur apo fshehur. Po ashtu, Ai është i Mirinformuar për qëllimet tuaja, për shpenzimet në fshehtësi dhe në mënyrë të hapur. Ajo që është më e rëndësishme dhe më ndikuese në shpenzim është qëllimi i pastër dhe sinqeriteti në punët që bëhen për hir të All'llahut, sepse Ai i shpërblen punët e njerëzve. Ai është i Gjithëditur për atë që fshihet dhe që duket.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 385.

Ajeti 272

لَيْسَ عَلَيْكَ هُدَاهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ
 خَيْرٍ فَلَا يُنْفِسْكُمْ ۚ وَمَا تُنْفِقُونَ إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ اللَّهِ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ
 خَيْرٍ يُوَفِّ إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تُظْلَمُونَ ﴿٢٧٢﴾

“Ti nuk e ke për detyrë t’i udhëzosh ata në rrugë të drejtë, por është All’llahu Ai që udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë. Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë tuaj, nëse ju këtë e bëni vetëm për hir të All’llahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t’ju rikthehet e plotë dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsijrin “Mexhmaul Bejan” përmendet një hadith i ardhur nga Ibn Abbasi se myslimanët nuk e dëshironin shpenzimin vetëm se për myslimanët. Atëherë zbriti ky ajet, që ia lejon atyre shpenzimin edhe për jomyslimanët kur është e domosdoshme.¹

Përmendet dhe një shkak tjetër për zbritjen e këtij ajeti, i cili është i përafërt me të parin. Transmetohet se një grua myslimane, që quhej Esma, po udhëtonte për të kryer Umren kaza së bashku me të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*). Tek ajo shkuan nëna dhe gjyshja saj dhe i kërkuan ndihmë. Por përderisa ishin idhujtarë, Esmaja nuk u dha atyre. Ajo tha: “Duhet të marr patjetër leje nga i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut*

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, tefsijrull “Kurtubij” dhe tefsijrë të tjerë, fundi ajetit në fjalë.

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për këtë, sepse ju të dyja nuk jeni në fenë time. Shkoi tek Profeti për t'i marrë leje dhe zbriti ajeti i lartpërmendur.¹

Komentimi

Ajetet e mëparshme flisnin në mënyrë të përgjithshme për shpenzimin në rrugën e All'llahut. Mirëpo ky ajet flet për lejueshmërinë e shpenzimit edhe për jomyslimanët, që do të thotë se nuk duhet lënë shpenzimi për nevojtarët dhe fukarenjtë jomyslimanë, sepse ky veprim bëhet shkak që ata të pranojnë Islamin.

Ajeti thotë: **“Ti nuk e ke për detyrë t'i udhëzosh ata në rrugë të drejtë...”**

Nuk është mirë që t'i detyrosh ata në besim dhe se mosshpenzimi për ta është një lloj detyrimi që ata të hyjnë në Islam. Kjo metodë është kundërshtuar. Edhe pse ky ajet i flet profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ai i përfshin të gjithë myslimanët.

Më pas ajeti shton: **“...por është All'llahu Ai që udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.”** E udhëzon atë që e meriton udhëzimin. Pas kësaj, ajeti vazhdon me dobitë e shpenzimit në rrugën e All'llahut: **“Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë tuaj, nëse ju këtë e bëni vetëm për hir të All'llahut!”** Kjo nëse fraza *ma tunfikune-çfarë të shpenzoni*, kuptohet si ndalim. Atëherë kuptimi i gjithë fjalisë është se shpenzimi juaj nuk ka dobi vetëm nëse bëhet në rrugën e All'llahut dhe për hir të Tij.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan dhe tefsijrul “Kebijr”, fundi i ajetit në fjalë.

Gjithashtu, supozohet që kjo fjali është lajmëruese (khaberijeh), që do të thotë: O ju myslimanë, ju nuk shpenzoni vetëm në rrugën e All'lahut për të fituar kënaqësinë e Tij.

Në frazën e fundit të ajetit shohim më shumë përforcim për sasinë e shpenzimit dhe mënyrën e dhënies së tij. Ajeti thotë: **“Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t’ju rikthehet e plotë dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”**

Kjo do të thotë se ju nuk duhet të përfytyroni se shpenzimi juaj do t’ju sjellë fitim të pakët, por e gjitha ajo që shpenzoni do t’ju kthehet e plotë në ditën që do të keni më shumë nevojë për të. Prandaj, mos ngurroni kurrë ndaj shpenzimit.

Nga pamja e jashtme e kësaj fjalie përfitohet se e njëjta pasuri, që jep shpenzuesi, do t’i kthehet atij (jo shpërblimi i tij). Për këtë, ky ajet ka mundësi të tregojë për trupëzimin e punëve, të cilin do ta sqarojmë hollësisht në ajetet e ardhshme.¹

¹ Ky sqarim do të jetë në fundin e ajetit 30 të sures “Al Imran” po në këtë komentim.

Hulumtime

1 – Përgjithësimi në mirësitë e All'llahut dhe në madhësinë e Tij

Ajeti i lartpërmendur thotë se mirësitë e All'llahut dhe begatitë e Tij në këtë botë, ashtu siç i përfshijnë të gjithë, pa marrë parasysh besimin dhe fenë, po ashtu edhe shpenzimi mustehab i besimtarëve duhet të përfshijë edhe plotësimin e nevojave të njerëzve jobesimtarë kur është e domosdoshme.

Është e qartë se shpenzimi ndaj jomyslimanëve duhet të jetë me karakter human. Në këtë rast është i lejueshëm. Nëse është shkak i fuqizimit të kufrit dhe mbështetës i planeve të armikut, shpenzimi nuk lejohet.

2- Udhëzimi është i llojeve të ndryshme

Edhe pse Profeti, nuk është i detyruar të udhëzojë njerëzit, nuk do të thotë se ai nuk është i ngarkuar për udhëzimin e tyre, sepse udhëzimi dhe thirrja janë prej anëve më të rëndësishme të përgjegjësisë së Profetit. Por, qëllimi është se ai nuk është i ngarkuar të ushtrojë presion dhe forcë ndaj njerëzve që të pranojnë Islamin. Vallë, kuptimi i këtij udhëzimi është udhëzim tekvinij apo teshriij? Udhëzimi është disa llojesh:

a) Udhëzimi *tekinij* do të thotë se All'llahu ka krijuar një grup faktorësh prej faktorëve të përparimit dhe të plotësimit në të gjitha krijesat e kësaj bote. Kjo përfshin edhe njeriun, si dhe të gjitha krijesat e gjalla deri edhe sendet. Këta faktorë i shtyjnë krijesat drejt plotësimit.

Vërtet, rritja e foshnjës në mitrën e nënës, rritja dhe zhvillimi i farës brenda në tokë, lëvizja e planetëve dhe e sistemeve diellore në vendodhjet e tyre, etj, janë shembuj të ndryshëm prej udhëzimit

tekvinij (krijues). Ky lloj udhëzimi është i posaçëm vetëm për All'llahun e Madhëruar. Në të ndërhyjnë faktorët dhe shkaqet natyrore e metafizike. Kur'ani Fisnik thotë: (Musai) **tha: “Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”**¹

b) Udhëzimi *teshriij*, udhëzon njerëzit nëpërmjet rrugës së mësimimit, edukimit, ligjeve, udhëheqjes së drejtë, këshillës dhe porosisë. Këtë lloj udhëzimi e kryejnë të dërguarit, imamët e drejtë dhe dijetarët e sinqertë. Për këtë tregon Kur'ani: **“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.”**²

c) Udhëzimi *teukijij* mbështetet në përgatitjen e mjeteve dhe vendosja e tyre në duart e njerëzve që të përfitojnë prej tyre si të duan për të përparuar, siç janë: ndërtimi i medreseve, xhamive, institute edukative, botime literaturash dhe vendosja e planeve mësimore për trajnimin e mësuesve dhe të atyre që kanë aftësi. Ky lloj udhëzimi qëndron mes dy udhëzimeve të mëparshme, atij tekvinij dhe teshriij. Kur'ani thotë: **“Ata që luftojnë (përpiqen, sakrifikojnë) për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, All'llahu është me punëmirët!”**³

d) Udhëzimi drejt mirësive dhe shpërblimit, është udhëzimi i njerëzve të përshtatshëm për të fituar prej rezultatit të punëve të mira të tyre në Jetën Tjetër. Ky udhëzim është i posaçëm për besimtarët punëmirë. Kur'ani thotë: **“Ai do t'i udhëzojë ata, do t'ua përmirësojë gjendjen.”**

Ky ajet vjen pas përmendjes së sakrificës së dëshmorëve në rrugën e All'llahut. Është e qartë se ky lloj udhëzimi ka lidhje me kënaqësinë e tyre në Ahiret, për shkak të fryteve të punëve të mira.

¹ Sure “Ta Ha”, ajeti 50.

² Sure “El-Bekare”, ajeti 2.

³ Sure “Ankebut”, ajeti 69.

Këto katër lloje udhëzimi formojnë faza të ndryshme e të vazhdueshme për një të vërtetë të përbashkët. Në fillim është udhëzimi tekvinij, me të cilin All'llahu udhëzon krijesat e Tij, ndër to edhe njeriun, në të cilin ka vendosur mendjen, arsyetimin dhe fuqi të tjera.

Atë e pason udhëzimi i profetëve, të cilët i udhëzojnë njerëzit në rrugën e vërtetë. Ky lloj udhëzimi ka kuptimin e predikimit dhe të udhërrëfimit.

Pastaj vjen faza e veprimit, në të cilin All'llahu i përfshin të gjitha krijesat me mbarësinë e Tij. Atyre u shtrohen rrugët në të cilat ecin drejt plotësimit. Ky është udhëzim i mbarësuar. Pas këtyre, njerëzit marrin shpërblimin e tyre në Jetën Tjetër.

Udhëzimi i drejtimit dhe i thirrjes, i cili përbën një ndër katër udhëzimet, është prej detyrave të të dërguarve dhe imamëve.

Prandaj, kur gjejmë në Kur'an heqjen e përgjegjësisë e të udhëzimit për profetët, kjo nuk ka lidhje me dy llojet e para të udhëzimit.

“...por është All'llahu Ai që udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.”

Ky udhëzim nuk vjen pa urtësi e llogari, që do të thotë, se All'llahu udhëzon këtë dhe nuk e udhëzon atë, pa shkak. Prandaj, duhet që njeriu të jetë meritues për udhëzim, që ta fitojë atë dhe të përfitojë prej tij.

Nga ky ajet nxjerrim një të vërtetë tjetër: All'llahu i flet të Dërguarit të Tij duke i thënë: Nëse pas këtij qortimi rreth shpenzimit të shoqëruar me mburrje dhe ofendim, shfaqen në mesin e myslimanëve persona që vazhdojnë ta përlyejnë shpenzimin e tyre me këto gjëra, ti mos u zemëro për këtë.

Detyra jote është sqarimi i ligjeve dhe i rregullave, si dhe përgatitja e një klime të shëndoshë shoqërore. Ti nuk e ke për detyrë t'i detyrosh ata që të largohen dhe të heqin dorë nga ky lloj veprimi.

3- Ndikimet e shpenzimit në jetën e shpenzuesit

Në fjalinë: **“Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë tuaj”** vëmë re se dobitë e shpenzimit i kthehen po vetë shpenzuesit. Kjo i shtyn ata që ta bëjnë këtë punë. Është e natyrshme se, kur njeriu e di se dobitë e fitimit të dijes i kthehen po atij, ai nxitet më shumë dhe bëhet akoma më optimist për të mësuar dhe për të praktikuar atë dije.

Në pamje të parë mund të duket se dobitë që i kthehen shpenzuesit për shpenzimin që bën është shpërblimi në Ahiret. Kjo është mëse e vërtetë. Por, nuk duhet të mendojmë se rezultati i shpenzimit është vetëm për në Ahiret. Ai sjell dobi edhe në këtë jetë, si material, ashtu edhe shpirtëror. Dobia shpirtërore është se te shpenzuesi rritet dhe forcohet shpirti i dhënies, i humanizmit dhe i sakrificës. Në të vërtetë, ky është mjet ndikues në plotësimin dhe në edukimin e personalitetit të njeriut.

Prania e njerëzve të varfër dhe nevojtarë në një shoqëri është shkak i krizës sociale. Shpenzimi pakëson dallimin shtresor dhe heq rrezikun që kërcënon të pasurit në shoqëri. Shpenzimi shuan zjarrin përvëlues të shtresës së varfër dhe vret shpirtin hakmarrës në veten e tyre.


Nga këtu themi se shpenzimi është për të mirën e shpenzuesit dhe ka rëndësi shoqërore dhe ruan ekonominë. Pra, në të ka shumë dobi materiale dhe shpirtërore.

4- Çfarë kuptimi ka fraza “*uaxhbulllab*”?

Fjala “*uaxhbulllab*”, në shtesë të kuptimit të njohur të saj, *fytyrë*, përdoret edhe me kuptimin *dhatë-vetë*. Atëherë, fraza *uaxhbulllab* ka kuptimin e *Qenies së Allllabut*, nga e cila duhet të drejtohen

shpenzuesit kur të shpenzojnë. Për këtë, përmendja e fjalës *uaxhbun* në këtë ajet apo në ajete të tjera, ka kuptimin e *përforcimit*. Është e qartë se thëniet tona *li uaxhbilab* apo *li dhatilab* është më e fortë se thënia *lil'lab*, për All'lahun. Atëherë, kuptimi është se shpenzimi është vetëm për All'lahun dhe jo për tjetër kënd.

Është e vërtetë se fytyra është pjesa më fisnike e trupit të njeriut. Në të gjenden organet më të rëndësishme, si të shikuarit, të dëgjuarit, të folurit, etj. Për këtë, sa herë që përdoret fjala *uaxhbun* është arritja e kuptimit të fisnikërisë dhe e rëndësisë. Përdorimi i saj në këtë ajet është metaforik, sepse All'lahu nuk është prej trupi. Ai është i pastër nga të gjitha cilësitë e krijesave.



Ajeti 273

لِلْفُقَرَاءِ الَّذِينَ أُحْصِرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا يَسْتَطِيعُونَ ضَرْبًا فِي
 الْأَرْضِ يَحْسَبُهُمُ الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ
 لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِحْفَافًا ۗ وَمَا تَنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ



Shoqata

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, All’llahu i di ato.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ky ajet ka zbritur për *banorëët e es Sifetu*. Ata ishin rreth katërqind myslimanë nga Meka dhe rrethinat e Medines, të cilët nuk kishin vendbanim dhe të afërm në Medine. Ata u vendosën në Xhaminë e Profetit dhe shfaqën gatishmërinë e tyre për të shkuar në fushën e xhihadit.

Meqenëse qëndrimi në xhami nuk përputhej me rregullat e saj ata u urdhëruan që të shkojnë në Sifetu, që ishte fushë e gjerë jashtë

Medines. Atëherë zbriti ky ajet, që i nxit myslimanët për t'i ndihmuar ata.”¹

Disa komentues kanë thënë: “Ky cilësim frymëzues përputhej me një grup emigrantësh (muhaxhirësh), të cilët, pasi emigruan në Medine, lanë në Mekë pasurinë dhe familjet. Ata u vendosën në Medine për të qenë të pranishëm në xhihad dhe në mbrojtjen e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*), njësoj si banorët e Sifetut, të cilët qëndruan në xhami për të ruajtur shtëpitë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) prej armiqve.”²

Shoqata

Komentimi

Flladi

Vendet më të mira për shpenzim

Në këtë ajet, All'llahu i Madhëruar sqaron vendet më të mira për shpenzimin. Ato janë:

1- “...u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit.” Bëhet fjalë për ata që janë të zënë me punë të rëndësishme, si: xhihadi, stërvitja ushtarake dhe mësimi i dijeve të tjera. Në këtë mënyrë ata nuk gjejnë kohë për të siguruar mjetet e jetesës, siç ishin banorët e Sifetut, të cilët ishin dëshmia më e mirë e kësaj çështjeje.³

Më pas, si përforcim, ajeti thotë: **“...e nuk janë në gjendje të udhëtojnë...”** Janë ata që nuk kanë mundësi të udhëtojnë nëpër vende të tjera ku gjenden mirësitë e All'llahut. Për këtë, ata, që kanë mundësi të sigurojnë mjetet e jetesës, duhet të përpiqen në këtë rrugë

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, tefsijri “Ruhul Xhinan”, tefsijri “El Bahrul Muhij”, Tefsijri i Kurtubiut, tefsijri “Ruhul Meanij”, si dhe tefsijre të tjera në fundin e ajetit në fjalë (me shprehje të ndryshme.)

² Tefsijri “Fi Dhilalul Kur’an”, vëll. 1, f. 462, fundi i ajetit në fjalë.

³ Fjala *basrun* ka kuptimin e *burgimit*, *ndalimit*, *pengimit* dhe *ngushtimit*. Në këtë ajet ka kuptimin e çdo gjëje që e ndalon apo e pengon njeriun që të sigurojë jetesën e tij.

dhe të mos përfitojnë nga munda dhe lodhja e të tjerëve, vetëm nëse janë të zënë me një punë shumë të rëndësishme, siç është xihadi në rrugën e All'llahut të Madhëruar.

2- “Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin.”

Janë ata që të tjerët nuk ia dinë të brendshmen e tyre. Mirëpo, përderisa zotërojnë dinjitet dhe fisnikëri, të tjerët mendojnë se janë të pasur.

Por, kjo nuk do të thotë se janë të panjohur. Për këtë ajeti thotë: **“Do t'i njohësh nga pamja e tyre.”**

Fjala *sijma* do të thotë *shenjë*.¹

Edhe pse ata nuk e shfaqin gjendjen e tyre, pamja e tyre tregon për vuajtjet e tyre dhe këto shenja i dallojnë të diturit. Ngjyra e fytyrës së tyre tregon të fshehtën e tyre.

3- “Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur.” Ata nuk i përngjasin të varfërve dhe lypësve që u lypin njerëzve. Për hir të dinjitetit të tyre, ata nuk kërkojnë dhe as nuk lypin. Këmbëngulja në lypje është shenjë e nevojtarëve të zakonshëm. Ndërsa këta nuk janë të zakonshëm. Thënia e Kur'anit ka kuptimin se ata nuk janë fukarenj të zakonshëm që të lypin. Kjo frazë nuk bie në kundërshtim me frazën: **“Do t'i njohësh nga pamja e tyre.”**, sepse ata nuk njihen nëpërmjet lypjes.

Ka edhe një alternativë tjetër rreth komentimit të ajetit: Nëse i detyron gjendja për të shfaqur nevojën e tyre, ata nuk janë të mërzhitshëm në kërkim. Para vëllezërve të tyre myslimanë ata e shfaqin gjendjen e tyre me edukatë.

¹ Thuhet se vjen nga rrënja *ueseme, damkos, vulos, e turpëroi*, dhe thuhet se vjen nga rrënja *seume, imponon, vendos, damkos*.

“E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, All’llahu i di ato.”

Në këtë ajet përsëri gjendet nxitje për shpenzim, veçanërisht për nevojtarët fisnikë. Sigurisht, shpenzuesit e dinë se All’llahu është i Gjithëditur për shpenzimin e tyre, qoftë edhe fshehurazi dhe, se Ai do t’i shpërblejë ata për shpenzimin që bëjnë, atëherë dëshira e tyre për këtë vepër do të shtohet edhe më shumë.

Hulumtim

Prej mëkateve të mëdha është lypja dhe kërkimi prej njerëzve kur nuk gjendet nevoja.

Ka shumë hadithe që e ndalojnë rreptësisht këtë punë. Në një hadith profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Nuk është e lejuar sadakaja për të pasurin.”**¹

Në një hadith tjetër, profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Kushdo që lyp dhe ka aq sa i mjafton, ai shumon prushet e Xhehenemit.”**²

Po ashtu ka thënë: **“Nuk i pranohet dëshmia atij që i zgjat dorën njerëzve.”**³

¹ “Et Tehdhijb”, vëll. 4, f. 51. “Uesailu Shia”, vëll. 9, f. 233, 234, 239.

² Tefsijrul “Meragij”, vëll. 3, f. 50.

³ “Uesailu Shia”, vëll. 18, f. 281. (Kreu i dëshmisë, kapitulli, 35.)

Ajeti 274

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ سِرًّا وَعَلَانِيَةً فَلَهُمْ أَجْرُهُمْ
عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٢٧٤﴾

“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”

Shkaku i zbritjes

Në shumë hadithe thuhet se ky ajet i bekuar ka zbritur për imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai kishte katër derhem. Njërin e dha ditën, të dytin natën, të tretin e dha haptazi dhe të katërtin¹ në fshehtësi. Atëherë zbriti ky ajet. Është e qartë se zbritja e një ajeti për diçka të veçantë nuk e kufizon kuptimin e tij dhe as e mohon përgjithshmërinë e rregullit.

¹ Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 290 dhe 291. Përmbajta e këtij hadithi gjendet edhe tek librat e Ehli Sunetit. Atë e transmeton autori i librit “Derul Menthur” nga Asakiri, nga Tabarani, nga Ebi Hatim, nga Ibn Xherir, etj. “Shumica e dijetarëve shiit thonë: “Shumica e dijetarëve të Ehli Sunetit janë të një mendimi se ky ajet ka zbritur për imam Ali ibn Ebu Talibin (*Paqja qoftë mbi të!*).” Prej atyre dijetarëve janë: El Uahidij, Eth Tha’lebij, El Khauarizmi, Es Seddij, El Kelbij, Zamakhsharij, Et Taafij, El Kushejri, El Marudij, inul Megazili, ibn Ebil Hadijd e të tjerë.” Shiko tefsijrin “El Burhan”.

Komentimi

Shpenzimi është i lavdëruar me të gjitha format

Ky ajet flet rreth një çështjeje tjetër, që ka lidhje me shpenzimin në rrugën e All'llahut. Ajo është e formave të ndryshme të shpenzimit. Ajeti thotë: **“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre.”**

Është e qartë se zgjedhja e një prej këtyre rrugëve të ndryshme plotësohet duke ruajtur kriteret e më të mirës në shpenzim, që do të thotë se shpenzuesi duhet të ruajë anën morale dhe sociale në shpenzimin e tij, qoftë natën apo ditën, haptazi apo fshehurazi. Nëse nuk gjendet arsye për ta shfaqur shpenzimin ndaj nevojtarëve, duhet që shpenzimi të bëhet fshehurazi, për të ruajtur dinjitetin dhe fisnikërinë e nevojtarit. Ky shpenzim të jetë i mbështetur në qëllimin e sinqertë.

Nëse e kërkon domosdoshmëria që shpenzimi të jepet haptazi, siç është madhështimi i simboleve të All'llahut, nxitja e të tjerëve për të shpenzuar, pa cenuar shenjtërinë e myslimanëve, atëherë të jepet haptazi (siç është shpenzimi për xhihad, për institucionet bamirëse, etj.)

Përmendja e natës para ditës dhe e të fshehtës para dukjes në ajet bëhet, sepse sadakaja e fshehtë është më e mirë, me përjashtim kur gjendet domosdoshmëri për ta shfaqur. Sido që të jetë, shpenzimi nuk duhet harruar e as nuk duhet lënë pa u kryer.

Dihet se çdo gjë që bëhet për hir të All'llahut, (veçanërisht kur mendojmë në cilësinë e Tij Sundimin, që është mbikëqyrëse e zhvillimit dhe e plotësimit), ajo nuk është e pakët dhe e pavlerë. Përkundrazi, është në përputhje me mirësinë dhe kujdesin e All'llahut,

të cilat garantojnë bereqete në këtë jetë, mirësi në Jetën Tjetër dhe afrimet tek All'lahu i Madhëruar.

Në fund ajeti thotë: **“...ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”**

Njeriu e di që të rregullojë çështjet jetësore të tij, ka nevojë për pasuri dhe para. Nëse e humbet pasurinë, ai do të mërzhitet dhe do të pikëllohet. Frika për të ardhmen e tij bëhet më e madhe, sepse ai nuk e di se çfarë e pret në ditët që do të vijnë.

Në të shumtën e rasteve kjo gjendje e pengon njeriun që të shpenzojë e të japë për hir të All'lahut. Përveç atyre që, së pari, besojnë në premtimin e All'lahut dhe e njohin atë premtim. Së dyti, i njohin ndikimet sociale të shpenzimit. Këta besimtarë nuk frikësohen e as nuk mërzhiten ndaj shpenzimit në rrugën e All'lahut. Ata nuk i frikësohen të ardhmes së tyre dhe as nuk mërzhiten kur pasuritë pakësohen kur shpenzojnë.

Ata janë mëse të ditur se, për atë që shpenzojnë, do të fitojnë më shumë nga mirësitë e All'lahut. E njohin shumë mirë bereqetin që sjell shpenzimi si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër, qoftë ky bereqet individual, shoqëror dhe moral.

Ajetet 275 - 277

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ
 الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ الرِّبَا ۗ وَأَحَلَّ اللَّهُ
 الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۚ فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّهِ فَانْتَهَىٰ فَلَهُ مَا سَلَفَ
 وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ ۗ وَمَنْ عَادَ فَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٢٧٦﴾
 ﴿٢٧٥﴾ يَمْحَقُ اللَّهُ الرِّبَا وَيُرْبِي الصَّدَقَاتِ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ ﴿٢٧٦﴾
 إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَءَاتَوْا الزَّكَاةَ لَهُمْ
 أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٢٧٧﴾

“Ata që marrin fajde, do të ringjallen (në Ditën e Gjykimit) si ai që djalli e ka çmendur me prekjen e vet, sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria. Porse All’llahu e ka lejuar tregtinë, kurse kamatarinë e ka ndaluar. Ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe fati i tij është në duart e All’llahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

All’llahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë. All’llahu nuk i do ata që janë mohues - gjynahqarë. Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”

Komentimi

Kamata në Kur'an

Në ajetet e mëparshme flitej për shpenzimin e pasurisë për të ndihmuar nevojtarët dhe për të ngritur nivelin jetësor në shoqëri. Në këto ajete flitet për kamatën, e cila qëndron në anën e kundërt të shpenzimit.

Në realitet, këto ajete janë plotësuese të qëllimit të ajeteve të mëparshme, sepse zbatimi i kamatës thëllon dallimin shtresor dhe pasuria mbetet në duart e një pakice njerëzish. Ajo shkakton varfërimin e shumicës. Ndërsa, shpenzimi është shkak i pastërtisë së zemrave, i shpirtrave dhe i stabilitetit social. Kamata është shkak i koprracisë, i smirës, i përçmimit dhe i papastërtisë.

Këto ajete flasin qartë dhe ashpër për ndalimin e kamatës. Mirëpo, me sa duket, çështja e kamatës ka qenë para ardhjes së këtyre ajeteve. Nëse shohim historinë e zbritjes së këtyre ajeteve, do të na sqarohet kjo e vërtetë. Sipas renditjes së zbritjes së Kur'anit, e para sure, në të cilën përmendet kamata, është surja “Er-Rrum”, e cila është e tridhjeta sure dhe ka zbritur në Mekë. Në suret e tjera të zbritura në Mekë nuk gjejmë tregues për kamatën.

Mirëpo, biseda për kamatën, në suret e zbritura në Mekë, kanë qenë në formë këshillash morale. Kur'ani thotë: **“Ato që i jepni prej kamatës për të shtuar (pasurinë tuaj) përmes pasurisë së njerëzve të tjerë, nuk do të shtohen tek All'illahu”**¹ Kuptimi i këtij ajeti është se mendjeshkurtët thotë se pasuria shtohet me kamatë, por ajo nuk shtohet tek All'illahu.

Pas emigrimit (hixhretit), Kur'ani e përmend (tanavele) kamatën në tre sure të tjera, prej atyre sureve që zbritën në Medine, që, sipas renditjes, janë: sure “El-Bekare”, sure “Al Imran” dhe sure

¹ Sure “El Ankebut”, ajeti 39.

“En-Nisa”. Edhe pse surja “El-Bekare” ka zbritur para sures “Al Imran”, ajeti 130 i sures “Al Imran” e ndalon qartësisht kamatën.

Sido që të jetë, ky ajet dhe ajetet e tjera, që flasin rreth kamatës, kanë zbritur në kohën që kamata ishte e përhapur shumë në Mekë, Medine dhe në mbarë Gadishullin Arabik. Ajo ishte faktori bazë i dallimit shtresor dhe shkaku kryesor i dobësimit të shtresës së varfër dhe i padrejtësisë së aristokratëve. Për këtë, luftimi që shfaqti Kur’ani ndaj kamatës ka qenë ndër më të rëndësishmit e luftërave sociale.

All’llahu i Madhëruar thotë: **“Ata që marrin fajde, do të ringjallen (në Ditën e Gjykimit) si ai që djalli e ka çmendur me prekjen e vet”¹**

Atë që merret me kamatë ajeti e krahason me të çmendurin ose me të sëmurin nga epilepsia, i cili nuk ka mundësi që të ruajë ekuilibrin e tij kur ecën dhe ngatërrohet me këmbët e veta.

Qëllimi është të shembulli i sjelljes sociale të kamatçinjve në dynja, duke i konsideruar si të çmendur në punët që bëjnë. Ata nuk zotërojnë arsytim shoqëror. Ata nuk arrijnë të njohin dobitë e tyre personale. Ndjenja e dhembshurisë dhe e humanizmit nuk ka kuptim për ta, sepse adhurimi i parasë sundon mendjet e tyre deri në atë shkallë sa që nuk arrijnë të kuptojnë se ku do të arrijnë me ato punë të fëlliqura dhe me shfrytëzimin që bëjnë.

Nëpërmjet punëve të tyre ata mbjellin në zemrat dhe në shpirtërat e të varfërve smirën dhe armiqësinë. Ata nuk arrijnë të kuptojnë fundin e tmerrshëm të punëve të tyre, që çojnë në shpërthimin e revolucioneve shoqërore. Një shoqëri e tillë nuk ka siguri e as qëndrueshmëri. Askush nuk do të jetë i qetë deri edhe kamatari. Me punën e tij, kamatari e çmend vetveten me anë të punës së çmendur.

¹ Fjala *jetekhabbatu* vjen nga lënda *khabite*, që do të thotë *humbje e ekuilibrit të trupit gjatë ecjes apo ngritjes*.

Përderisa gjendja e njeriut në Ahiret do të jetë trupëzim i punëve të tij në këtë jetë, atëherë mendohet që ajeti të ketë këtë kuptim: Ata që veprojnë në këtë jetë pa arsye e pa ekuilibër dhe e sundon ndjenja e grumbullit të pasurisë, në Ditën e Kiametit do të dalin si të çmendurit.

Edhe hadithet e cekin këtë kuptim. Në një hadith, të ardhur nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) rreth komentimit të këtij ajeti, thuhet: “Kamatari nuk del nga kjo botë derisa djalli ta çmendë atë.”¹

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Kur u ngrita në qiell pashë disa njerëz që donin të ngriheshin, por nuk mundeshin për shkak të barkut të madh që kishin. E pyeta Xhebrailin: “Kush janë ata?” Xhebraili më tha: “Ata hanë kamatën dhe tani nuk mund të ngrihen veçse si ai që e ka çmendur djalli nga prekja e tij.”**”

Hadithi i parë sqaron zemërimin (idhtirabin) e njeriut në këtë jetë. Hadithi i dytë flet për gjendjen e kamatarit në Ditën e Kiametit. Të dy ajetet kanë lidhje me një të vërtetë. Ashtu siç fryhet barku kur hahet pa ekuilibër e pa llogari, po ashtu fryhet edhe kamatari me paratë haram. Jeta e tij ekonomike në këtë dynja është e sëmure dhe e paqëndrueshme.

Pyetje: A është çmenduria dhe epilepsia, që i përmend ajeti, prej shejtanit, ndërkohë që ne e dimë se këto janë sëmundje psikike, të cilat kanë shkaqet e tyre të njohura?

Përgjigje: Disa kanë mendimin se fraza *messu shejtan-prekja e shejtanit*, është metaforë e sëmundjeve psikike dhe e çmendurisë. Kjo frazë ka qenë e përhapur tek arabët dhe nuk ka kuptimin se djalli ndikon në shpirtin e njeriut.

¹ Tefsijrul “Ajjashi”, vëll. 1, f. 152, hadithi 503.

² Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 291, hadithi 1157.

Por, nuk mund të mohohet se disa punë djallëzore, që i bën njeriu pa u menduar, çojnë në çmenduri djallëzore. Kjo do të thotë se djalli ndikon tek njeriu në këto punë. Ai është shkak i humbjes së ekuilibrit shpirtëror. Kur, punët e gabuara djallëzore përsëriten dhe shtohen, ndikimi i tyre është i natyrshëm dhe njeriu e humbet fuqinë e dallimit të së mirës nga e keqja, të sëmurës nga e shëndosha, mendimin e drejtë nga i shtrembëri.

Logjika e kamatçinjve

“...sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria.”

Kjo fjali e ajetit sqaron logjikën e kamatçinjve, që thotë: Ku është dallimi mes tregtisë dhe kamatës?”

Ata mendojnë se që të dyja, si tregtia ashtu edhe kamata, përbëjnë veprimin e ndërsjellë me kënaqësinë dhe me zgjedhjen e të dy palëve.

Si përgjigje ndaj tyre, Kur’ani thotë: **“Porse All’Ilahu e ka lejuar tregtinë, kurse kamatarinë e ka ndaluar.”** Këtu nuk ka dhënë shumë sqarim, kjo ndoshta për arsye të ndryshimit mes kamatës dhe tregtisë:

Së pari: Në marrëveshjen e shitblerjes, të dy palët janë të njëjtë në fitim a humbje. Ka mundësi që të dy të fitojnë dhe të dy të humbin, ose njëherë fiton njëri e njëherë humbet tjetri. Ndërsa në veprimet me kamatë, kamatarin nuk pëson asnjë humbje. E gjithë humbja i bie në kurriz palës tjetër. Për këtë shohim që institucionet e kamatës zgjerohen dita-ditës. Kapitallet e tyre rriten, po ashtu edhe skamja në shtresën e varfër thellohet.

Së dyti: Në marrëveshjen tregtare të shitblerjes, të dy palët ecin në rrugën e “prodhimit e të konsumimit”, kurse te kamata nuk gjendet asnjë hap i tillë pozitiv.

Së treti: Me përhapjen e kamatës, kapitalet monetare qarkullojnë në mënyrë jo të rregull dhe lëkundin bazat e ekonomisë së shoqërisë. Ndërsa në tregtinë e rregullt, kapitalet monetare qarkullojnë në formë të rregullt.

Së katërti: Kamata shkakton konflikte dhe ndarje shtresore, kurse tregtia e rregullt nuk e çon shoqërinë në konflikte e në ndarje shtresore.

“Ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe fati i tij është në duart e All'llahut.”

Kuptimi i ajetit është: Atij që i vjen këshilla e All'llahut për ndalimin e kamatës dhe e zbaton këtë këshillë, le t'i mbajë fitimet e mëparshme, sepse “ligji nuk është rikthyes”. Ligjet rikthyese sjellin shumë probleme dhe mërzitje në jetën e njerëzve.

Kjo nuk do të thotë që kamatarët të mbledhin më shumë pasuri nga njerëzit, por ka kuptimin e lejimit të asaj që volën nga fitimet para zbritjes së ajetit.

Ajeti thotë: **“...dhe fati i tij është në duart e All'llahut.”**, që do të thotë se punët e tyre në Ditën e Kiametit janë në dorën e All'llahut. Megjithëse e jashtëmja e ajetit tregon se e ardhmja e tyre, dënimi apo falja, janë të paqarta, por, duke parë ajetin e mëparshëm, kuptojmë se qëllimi është falja. Nga kjo duket se mëkati i kamatës është i madh, sepse rregulli i faljes për ata që e praktikojnë kamatën nuk përmendet qartë.

Ka edhe supozime të tjera për kuptimin e kësaj fjalie, por ne nuk i përmendim, për shkak se janë në kundërshtim me të jashtmen e ajetit.¹

¹ Tefsijru “Kurtubij”, vëll. 2, f. 1169. Këtu janë përmendur katër komente. Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë, ku janë përmendur shumë supozime të tjera.

“Ndërta ata që i kthehen kamatës sërisht, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”, që do të thotë se ata që e vazhdojnë praktikimin e kamatës pas ardhjes së paralajmërimeve, le të presin dënimin e rëndë, të dhembshëm dhe të përhershëm në zjarr.

Sigurisht, që dënimi i përhershëm nuk është për atë që beson All'llahun. Por, sipas ajetit, ky dënim është për ata që këmbëngulin në praktikimin e kamatës, sepse me këmbënguljen e tyre ata kundërshtojnë ligjet e All'llahut dhe zhyten në kryerjen e mëkateve. Ky veprim është tregues se besimi i tyre nuk është i drejtë. Me këtë ata e meritojnë dënimin në zjarr.

Po ashtu, mund të thuhet se përhershmeria në dënim, që përmendet këtu, është si ajo që përmendet në ajetin 93 të sures “En-Nisa”, i cili mund të jetë i gjatë, por jo i përhershëm.

“All'llahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë.”

Pastaj shton e thotë: **“All'llahu nuk i do ata që janë mohues - gjynahqarë.”**

Fjala është për ata që nuk mendojnë për të mirat dhe dobitë që ka sadakaja dhe ndoqën rrugën e kamatës, e cila i çoi ata në zjarr.

Fjala *el mehak* ka kuptimin e *pakësimit shkallëzues, gradual* dhe *ribaja* ka kuptimin e *shumimit shkallëzues, gradual*.

Kamatari, me pasurinë që ka, thëllon ndarjen me shtresën e varfër. Puna e tij mund të çojë në shfarosjen e tyre, ose e pakta e të paktave, të mbjellë farën e zemërimit, të smirës e të urrejtjes në zemrat e të varfërve dhe të nevojtarëve, të cilët gradualisht bëhen të etur për t'ia pirë gjakun ose kërcënojnë pasurinë dhe jetën. Kur'ani thotë se All'llahu i drejton kapitalet monetare me kamatë drejt zhdukjes.

Vërtet, që kjo zhdukje godet si individin kamatar, ashtu edhe shoqërinë kamatare.¹

E kundërta ndodh me ata njerëz që kanë zemra të pastra e të mbushura me ndjenja humane. Ata shpenzojnë prej kapitalit të pasurisë dhe parave të tyre, me qëllimin që t'i plotësojnë nevojën të varfërve dhe nevojtarëve të shoqërisë. Ata shpenzojnë me dashuri e dashamirësi. Pasuritë e tyre jo vetëm që nuk përballen me asnjë rrezik, por shumohen normalisht. Ky është edhe kuptimi i Kur'anit kur thotë: **“kurse e rrit përfitimin e bamirësisë.”**

Ky rregull është si për individin, ashtu edhe për shoqërinë. Ajo shoqëri, që interesohet për nevojat e shumicës, në të lëvizin fuqitë mendore e trupore për plotësimin e nevojave të shtresës së varfër, përbën shumicën e shoqërisë. Në këtë mënyrë duket qartë sistemi i drejtë ekonomik, bazuar në përkujdesje dhe në shkëmbimin e dobive të përgjithshme.

“All'llahu nuk i do ata që janë mohues - gjynahqarë.”

Fjala *kuffar*, vjen nga fjala *kefur* në *vaznin fuxbur*, që ka kuptimin e atij që është mbytur në mohimin e mirësisë. Fjala *ethijm* ka kuptimin e atij që është i zhytur në gjynabe.

Kjo pjesë e ajetit tregon se kamatarët, kur, nuk kryejnë shpenzimin dhe dhënien në rrugën e plotësimit të nevojave të shumicës së varfër, mohojnë mirësitë që u dha All'llahu. Jo vetëm kaq, ata i përdorin këto mirësi në rrugën e gjynaheve, të padrejtësisë e të shkatërrimit. Është e natyrshme se All'llahu nuk i do këta lloj njerëzish.

¹ Duhet thënë se, nëse institucionet ekonomike dhe financiare kryejnë studime rreth kamatës dhe kamatarëve, në të shkuarën dhe sot, do të shohin se kamata ka qenë dhe vazhdon të jetë shkaku i shkatërrimit të shumë vlerave dhe popujve, qofshin të shkuar apo të pranishëm.

“Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”

Përballë kamatarëve, mohues të mirësive të All'llahut, qëndrojnë njerëz besimtarë, që nuk janë mendjemëdhenj e as nuk u pëlqen vetja. Ndjenjat e natyrës krijuese të tyre janë gjithmonë të gjalla. Ata janë të lidhur me All'llahun, me faljen e namazit.

Duke qenë se janë të tillë, ata shpejtojnë në plotësimin e nevojave të të tjerëve, duke dhënë zekatin. Ata nuk mendojnë shumë për shtimin e pasurive dhe nuk e pëlqejnë diferencimin shtresor. Pa dyshim, shpërblimi i tyre është i ruajtur tek All'llahu dhe rezultatin e punëve të tyre do ta shohin si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Të tillë njerëz nuk e njohin hidhërimin e as pikëllimin. Nuk i cenon asnjë lloj rreziku që i cenon kamatarët.

Së fundi, këta besimtarë jetojnë të qetë dhe me bindje të plotë.

Ajetet 278 – 281

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ
﴿TV8﴾ فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ ۗ وَإِن تُبْتُمْ فَلَكُمْ
رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ ﴿TV8﴾ وَإِن كَانِ ذُو
عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ ۚ وَأَن تَصَدَّقُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ
﴿TA﴾ وَاتَّقُوا يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ ۗ ثُمَّ تُوَفَّىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا
كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿TA1﴾

“O ju që keni besuar! Ta keni frikë All’llahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë.

Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga All’llahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë.

Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit.

Dhe ruajuni asaj Dite që do të ktheheni tek All’llahu, kur çdokujt do t’i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin e Ali ibn Ibrahim¹ thuhet se pas zbritjes së ajeteve të kamatës tek Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) erdhi Halid ibn Velid dhe tha: “Babai im ka pasur marrëveshje kamatore me beni Thakifin. Ai vdiq dhe nuk e ka marrë borxhin e tij. Më ka porositur që ta marr unë atë pjesë të fajdes që nuk është paguar. A më lejohet ta marr?”

Atëherë zbritën ajetet e lartpërmendura, që ndalojnë njerëzit rreptësisht të merren me kamatën.

Në një transmetim tjetër thuhet se pas zbritjes së këtyre ajeteve profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Vërtet, çdo kamatë prej xhahilijetit (para Islamit) është e refuzuar. Të parën kamatë, që unë e refuzoj, është ajo e xhaxhait tim, Abbas ibn Abdul Mutalibit.”**²

Nga kjo sqarohet se profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), fushatën kundër marrjes së borxheve kamatore të kohës së xhahilijetit, e filloi me të afërmit e tij. Nëse në mesin e të afërmeve të tij kishte të pasur, si Abbasi, Profeti, së pari, ndaloi marrjen e kamatës së tyre.

Në hadithe të tjera thuhet se pas zbritjes së këtyre ajeteve profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e urdhëroi princin e Mekës se, në qoftë se familja Mugijretu, që ishte e njohur për praktikimin e kamatës, do ta vazhdonte këtë punë, atëherë do ta luftonte atë.³

¹ Tefsiri i Ali ibn Ibrahim el Kummij, vëll. 1, f. 93. Uesailu Shia, vëll. 18, f. 131.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 392. Tefsiri “Derul Menthur”, vëll. 2, f. 109, me ndryshim të vogël shprehimor.

³ Tefsiri “Derul Menthur”, vëll. 2, f. 107 dhe 108.

Komentimi

Në ajetin e parë All'llahu u flet besimtarëve dhe i urdhëron ata për devotshmëri dhe përkushtim. Pastaj i urdhëron që të heqin dorë nga fajdet që u kanë mbetur në duart e njerëzve. Ajeti thotë: **“O ju që keni besuar! Ta keni frikë All'llahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”**

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se ajeti fillon me besimin të All'llahu dhe mbaron po me përmendjen e Tij. Kjo tregon shumë qartë se kamata nuk është në përputhje me besimin të All'llahu.

“Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga All'llahu dhe i Dërguari i Tij.”

Në këtë ajet ndryshon rrejedha e bisedës kur'anore. Ajetet e mëparshme porosin dhe këshillojnë, kurse ky ajet i sulmon ashpër kamatarët dhe i paralajmëron ata se, nëse e vazhdojnë kamatën dhe nuk i binden urdhrave të All'llahut për drejtësi dhe vërtetësi, dhe nëse vazhdojnë t'u pinë gjakun të varfërve me kamatën, për Profetin, nuk gjendet mundësi tjetër veçse të përdorë forcën për ndalimin e tyre. Kjo është e njëjtë me lajmërimin për luftë ndaj tyre, e cila e ka pikënisjen tek ligji: **“Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e All'llahut.”**¹

Kur imam Sadiku dëgjoi për një person që merrej me kamatë dhe tallej me ndalimin e saj, e kërcënoi me vrasje.

Nga ky hadith kuptohet se rregulli i vrasjes është për atë që e mohon ndalimin e kamatës. Frazja *fe edhinu* vjen nga lënda *edbine-lejon, shpall*. Sa herë që është *muteadijetu* me urdhër në kuptim, është lejim dhe kur është *mutedijetu* me shkronjën *ja* ka kuptimin e *dijenisë*.

¹ Sure “Huxhurat”, ajeti 9.

Sipas kësaj, kuptimi i thënies së Kur'anit: **"...atëherë iu është shpallur luftë nga All'llahu"**¹ është: Dijeni se All'llahu dhe i Dërguari i Tij do t'ju luftojnë. Kjo në të vërtetë është lajmërim për luftë ndaj këtij grupi. Nuk është e saktë thënia e disa dijetarëve që thanë se kuptimi i këtij ajeti është: "Lejoheni luftën nga ana e All'llahut."

Ebi Bekjiri transmeton: "Kur imam Sadiku u lajmërua për një burrë që hante kamatë tha: "Sikur të më mundësojë All'llahu, do t'ia prisja kokën atij."²

Nga kjo kuptohet se ky rregull është i posaçëm për ata që e mohojnë ndalimin e kamatës në Islam.

Sido që të jetë, ky ajet tregon se shteti islam duhet të përdorë forcën për ndalimin e kamatës.

"Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë."

Nëse ju o kamatarë pendoheni dhe e lini kamatën, atëherë njerëzit t'ju kthejnë juve vetëm kapitalin tuaj, pa fitim. Ky është ligj plotësisht i drejtë, sepse ai nuk i bën padrejtësi as njerëzve e as juve.

Fraza: **"...nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë."**, edhe pse ka ardhur për kamatarët, në të vërtetë është parullë islame e gjerë dhe e thellë, që do të thotë se myslimanët duhet t'i shmangen padrejtësisë, po ashtu ata nuk duhet të dorëzohen para saj. Vërtet, sa më të pakët të jenë duruesit e padrejtësisë, aq më të pakët do të jenë edhe të padrejtët.

Sikur myslimanët të jenë të përgatitur për të mbrojtur të drejtat e tyre, askush nuk do të guxojë t'i shkelë të drejtat e tyre dhe askush

¹ Fjalën *fe'dbinu* shumica e komentuesve e kanë komentuar me kuptimin *fe a'lemu-dijeni*. Ata janë: Tabarsij, në tefsijrin e tij "Mexhmaul Bejan", Ebu Ftuh Er Razi në tefsijrin "Ruhul Xhinan", Fahu Raziu në tefsijrin "El Kebijr", Alusij në tefsijrin "Ruhul Meani", erudite Tabatabai në tefsijrin "El Mijzan", etj.

² "Uesail Shia", vëll. 12, f. 429, (kreu i konstatimit të vrasjes dhe kufrit për shkak të lejimit të kamtës, hadithi 1.)

nuk do të jetë i mundur t'u bëjë atyre padrejtësi. Para se t'i themi të padrejtët: "Mos bëj padrejtësi!", duhet t'u themi të përvuajturve: "Mos u dorëzoni para padrejtësisë!"

"Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen.¹

Në plotësim të sqarimit të së drejtës së borxhdhënësit për të marrë kapitalin e tij, pa fitim, ajeti sqaron një të drejtë të borxhliut, nëse nuk ka mundësi ta shlyejë borxhin. Përveç mosimponimit dhe mosvendosjen e fajdeve të reja, siç ndodhte në kohën para Islamit (xhahilijetit), ai (borxhdhënësi) ka të drejtë t'ia shtyjë kohën për shlyerjen e borxhit (vetëm kapitali që ka marrë) derisa të bëhet i mundur për të paguar.

Ligjet islame, të ardhura për sqarimin e kuptimit të këtij ajeti, e ndalojnë borxhdhënësin që t'i marrë borxhliut shtëpinë apo sendet e domosdoshme. Ky është ligj human, që mbron të drejtat e shtresës së varfër në shoqëri.

"Por është më mirë për ju që t'ia falni borxhin, veç sikur ta dinit."

Në të vërtetë, ky është një hap më i largët i çështjeve të drejtësisë, që do të thotë se kjo është çështje morale dhe humane, që plotëson fjalët rreth të drejtave që u përmendën më lart. Ajeti u thotë borxhdhënësve se më e mira prej atyre, që thanë për borxhliun e paaftë, është që borxhdhënësi të bëjë një hap të madh human dhe t'ia falë borxhin. Vërtet, kjo është vepër humane e përkryer. Kushdo, që i kupton dobitë e kësaj vepre, e beson këtë të vërtetë.

Në Kur'an është e njohur se, pasi sqaron detajet e rregullave dhe të pjesëve të sheriatit islam, ai paraqet idenë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përforcuar thënien e tij të mëparshme, me

¹ Ka mundësi që fjala *kane* është e plotë dhe nuk ka nevojë për *khabër* apo të jetë *nakisetu* dhe *takdijri* të jetë *in kane hunake dbu usretin*.

qëllim që rregullat e mëparshme të depërtojnë sa më mirë dhe sa më lehtë në mendje dhe në shpirt.

Prandaj, në këtë ajet ai u kujton njerëzve Ditën e Kiameti, Ditën e Llogarisë e të Shpërblimit, i paralajmëron për ditën që i pret ata, ku çdo njeriu do t'i vihen para duarve punët e veta, pa asnjë shtesë e mangësi. Çdo gjë, që është e shënuar, do t'u jepen njëherazi. Atëherë, ai do të shohë rezultatit e punëve të veta. E kjo varet se çfarë ka mbjellë ai vetë. Nuk i bëhet padrejtësi. Ai i bën vetë padrejtësi vetes së vet.

“Dhe ruajuni asaj Dite që do të ktheheni tek All’llahu, kur çdokujt do t’i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”

Duhet përmendur se ky ajet është prej treguesve të tjerë të trupëzimit të punëve të njeriut në Botën Tjetër.

Ajo që tërheq vëmendjen është se autori i tefsijrit “Derul Menthur”¹ përcjell me rrugë të ndryshme se ky ajet, që është ajeti i fundit, i ka zbritur profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo nuk mund të mohohet, nëse e marrin në konsideratë përmbajtjen e tij.

Dëmet e kamatës

1- Kamata prish ekuilibrin financiar dhe ekonomik në shoqëri. Ajo çon në grumbullimin e pasurisë në duart e një pakice njerëzish. Ky grup është i vetmi që përfiton nga fitimet, kurse të tjerët vjelin vetëm humbjen, dëmin dhe depresionin.

Sot kamata përbën faktorin kryesor të zgjerimit të hendekut mes shteteve të pasura dhe të varfra. Fundi i këtij hendeku janë luftërat gjakderdhëse e të vazhdueshme.

¹ Tefsijri “Derul Menthur”, vëll. 1, f. 365 dhe 370.

2- Kamata është ngjyrë prej ngjyrave të bashkëpunimit ekonomik jo të rregullt. Pakëson ndjesinë e së mirës dhe mbjell në zemra shpirtin e smirës, kjo për shkak se kamata, në realitet, ngrihet mbi bazën ku kamatari sheh vetëm fitimin e tij dhe nuk i intereson dëmi që e godet borxhliun.

Këtu borxhliu fillon të mendojë e të besojë se kamatari po e përdor pasurinë e tij si mjet për të shkatërruar jetën e të tjerëve.

3- Është e vërtetë se shkak i kamatës është nevoja që e strehon njeriun në të. Mirëpo, ai njeri nuk e harron kurrë padrejtësinë e kamatës. Ka raste që atë e mbulon ndjenja se gishtat e dorës së kamatarit ia shtrëngojnë grykën gati sa nuk e mbysin. Në këtë gjendje, të gjitha pjesët e trupit të borxhliut të gjorë fillojnë e mallkojnë kamatarin dhe bëhet i etur për t'ia pirë gjakun. Ai e shikon me sytë e tij se si lodhja, mundimi dhe paratë e tij hyjnë në xhepin e kamatarit. Si pasojë e kësaj gjendjeje kryhen me dhjetëra krime të tmerrshme, ku borxhliu vetëvritet, ose vret kamatarin, ose bën që populli i vuajtur të çohet në protesta apo revolucion shkatërrues.

Vërtet, shkëputja e marrëdhënieve mes shteteve kamatare dhe atyre që marrin kredi prej tyre me kamatë është e qartë. Ato shtete, të cilat i shohin pasuritë e tyre të përfundojnë në kasafortat e shteteve të tjera, nën emrin e kamatës, i shohin shtetet kamatare me urrejtje e smirë. Në kohën që ajo merr kredi prej atij shteti, për shkak të nevojës së madhe që ka, përfiton nga kjo kohë që të shfaqë urrejtjen dhe zemërimin e tij nëpërmjet formave të ndryshme.

Kjo është ajo që na bashkon në thënien se kamata ka ndikim moral shumë të keq në brendinë e borxhliut dhe shkakton urrejtje në zemrën e tij. Gjithashtu, ajo shkëput bashkëpunimin shoqëror mes individëve dhe shoqërive.

4- Në transmetimet (hadithet) islame tregohet për ndikimin e keq moral të kamatës. Edhe pse janë me fjali të shkurtra, ato kanë kuptim të thellë. Në librin “Uesailu Shia” gjenden transmetime rreth shkakut të ndalimit të kamatës. Në një hadith, të ardhur nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Vërtet, All’llahu e ndaloi kamatën, me qëllim që njerëzit të mos kënaqen me fabrikimin e mirësisë.”¹



¹ “Uesailu Shia”, vëll. 12, f. 422, kapitujt e kamatës, kapitulli i parë.

Ajeti 282

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا تَدَايَنُكُمْ بَدَيْنَ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى فَاكْتُبُوهُ ۚ
وَلْيَكْتُب بَيْنَكُمْ كَاتِبٌ بِالْعَدْلِ ۚ وَلَا يَأْب كَاتِبٌ أَنْ يَكْتُبَ كَمَا عَلَّمَهُ اللَّهُ
فَلْيَكْتُبْ وَلْيَمْلِلِ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ وَلَا يَبْخَسَ مِنْهُ شَيْئًا ۚ
فَإِنْ كَانَ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ سَفِيهًا أَوْ ضَعِيفًا أَوْ لَا يَسْتَطِيعُ أَنْ يُمِلَّ هُوَ
فَلْيَمْلِكْ وَلِيُهُ بِالْعَدْلِ ۚ وَأَسْتَشْهِدُوا شَهِدَيْنِ مِنْ رِجَالِكُمْ ۖ فَإِنْ لَمْ يَكُونَا
رَجُلَيْنِ فَرَجُلٌ وَامْرَأَتَانِ مِمَّن تَرْضَوْنَ مِنَ الشُّهَدَاءِ أَنْ تَضِلَّ إِحْدَاهُمَا
فَتُذَكَّرَ إِحْدَاهُمَا الْأُخْرَىٰ ۚ وَلَا يَأْب الشُّهَدَاءُ إِذَا مَا دُعُوا وَلَا تَسْمَعُوا أَنْ
تَكْتُبُوهُ صَغِيرًا أَوْ كَبِيرًا إِلَىٰ أَجَلِهِ ۚ ذَٰلِكُمْ أَقْسَطُ عِنْدَ اللَّهِ وَأَقْوَمٌ لِلشَّهَادَةِ
وَأَدْنَىٰ أَلَّا تَرْتَابُوا ۖ إِلَّا أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً حَاضِرَةً تُدِيرُونَهَا بَيْنَكُمْ فَلَيْسَ
عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَلَّا تَكْتُبُوهَا ۗ وَأَشْهِدُوا إِذَا تَبَايَعْتُمْ ۚ وَلَا يُضَارَّ كَاتِبٌ وَلَا
شَهِيدٌ ۚ وَإِنْ تَفَعَّلُوا فَإِنَّهُ فُسُوقٌ بِكُمْ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ ۗ وَاللَّهُ

بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٢٨٢﴾

“O ju që keni besuar! Shkruajeni huan që ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar. Le ta shënojë atë me drejtësi një shkruer ndërmjet jush; asnjë shkruer të mos ngurrojë që ta shënojë ashtu siç e ka mësuar All’llahu. Ai le të shënojë, kurse borxhliu le të diktojë dhe le t’i frikësohet All’llahut, Zotit të vet, duke mos lënë mangët asgjë nga borxhi! Në qoftë se borxhliu është mendjelehtë ose i mitur, ose i tillë që nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë saktësisht kujdestari i tij. Thirrni dy dëshmitarë prej burrave tuaj e, nëse nuk gjeni dy dëshmitarë burra, atëherë thirrni për dëshmitarë një burrë dhe dy gra, nga ata që i quani të përshtatshëm; në mënyrë që, nëse njëra grua harron, t’ia kujtojë tjetra. Dëshmitarët nuk duhet të kundërshtojnë kurdo që të thirren. Mos u mërzisni kur e shënoni borxhin, qoftë i vogël apo i madh, duke shënuar edhe afatin e pagimit. Kjo mënyrë është më e drejtë para All’llahut, më e saktë për dëshmi dhe më e përshtatshme për të mos dyshuar. Por, është tregti e pranishme, atëherë nuk do të keni gjynah nëse nuk e shënoni atë. Thirrni dëshmitarë edhe kur të lidhni kontrata për shitblerje dhe të mos dëmtohet as shkruesi, as dëshmitari. Nëse bëni të kundërtën, atëherë keni bërë gjynah, prandaj jini të devotshëm ndaj All’llahut! All’llahu ju mëson ju; All’llahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.”

Komentimi

Shkrimi i marrëveshjeve tregtare

Pasi Kur'ani e sulmoi ashpër kamatën, koprracinë dhe monopolizmin, ka vendosur njohuri të hollësishme për të rregulluar lidhjet tregtare dhe ekonomike, me qëllim që kapitalet monetare të shtohen normalisht dhe pa asnjë mosmarrëveshje e konflikt.

Ky ajet, që është ajeti më i gjatë në Kur'anin Fisnik, përmban nëntëmbëdhjetë nene, që rregullojnë dhe sistemojnë çështjet ekonomike. Ato nene janë si më poshtë:¹

1- Kur një person merr kredi në një tjetër apo kanë bërë marrëveshje, ku njëra palë është borxhliu dhe pala tjetër dhënësi, me qëllim që të mos ndodhë keqkuptim mes palëve në të ardhmen, duhet që të shkruhet kontratë e detajuar mes tyre. “O ju që kenë besuar! Shkruajeni huan që ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar.”

Duhet përmendur se përdorimi i fjalës *dejnun-borxh*, në këtë ajet dhe mospërdorimi i fjalës *kardun-kredi*, është se fjala *kardun* ka kuptimin e këmbimit të dy gjërave të ngjashme, si paratë apo malli, të cilën e merr (kreditori) dhe përfiton prej saj. Pastaj kthen ose paratë ose mallin të i zoti. Kurse fjala *dejnun-borxh*, ka kuptim më të gjerë. Ai përfshin çdo bashkëveprim, bashkëpunim, si: tregtia, qeraja, shitblerja e të tjera, ku njëra palë bëhet borxhli e palës tjetër.

Për këtë, ky ajet përfshin të gjitha bashkëveprimet në të cilat ka borxh, duke përfshirë edhe kredinë (kardin).

2- Me qëllim që të dyja palët të jenë të qeta për rregullsinë e aktmarrëveshjes dhe të bindura për mos ndërhyrjen e asnjërës palë, që

¹ Sigurisht që disa rregulla përfitohen nga përmbajtja dhe nëpërmjet argumentit përkatës. Po t'i shtohen edhe këto lloj rregullash atyre që përmenden, që janë nëntëmbëdhjetë, atëherë ato do të arrijnë më shumë se njëzet e një rregulla.

të ndryshojë aktmarrëveshjen, duhet që shkruesi të jetë një person i tretë: **“Le ta shënojë atë me drejtësi një shkrues ndërmjet jush.”**

Megjithëse pamja e jashtme e ajetit tregon për obligimin e shkrimit të aktmarrëveshjes, në ajetin 283 të kësaj sureje thuhet: **“Dhe, nëse njëri prej jush ka besim tek tjetri, atëherë borxhliu le ta kthejë atë që i është besuar.”**

3- Shkruesi i aktmarrëveshjes duhet që të jetë me drejtësinë dhe të shkruajë të vërtetën dhe realitetin **“me drejtësi”**.

4- Shkruesi i aktmarrëveshjes, të cilit All'llahu i Madhëruar i ka dhënë dijen e shkrimit e të përpilimit të aktmarrëveshjeve, nuk duhet të refuzojë shkrimin e tyre. Përkundrazi, ai duhet t'i ndihmojë palët bashkëpunuese në këtë çështje shoqërore. Ajeti thotë: **“...asnjë shkrues të mos ngurrojë që ta shënojë ashtu siç e ka mësuar All'llahu.”**

Vërtet, fraza: **“...ashtu siç e ka mësuar All'llahu.”** ka kuptimin e përforcimit dhe të shtimit të dëshirës. Por mund të thuhet se ajo tregon edhe për domosdoshmërinë e zbatimit të amanetit dhe ta shkruajë aktmarrëveshjen ashtu siç do All'llahu, me shkrim të saktë. Natyrisht, pranimi i ftesës për të shkruar aktmarrëveshjen nuk është obligim individual (uaxhib ajni).

5- Duhet që një nga palët bashkëpunuese të diktojë detajet e aktmarrëveshjes. Mirëpo, cila palë? Ajeti thotë se të drejtën e diktimit e ka borxhliu: **“Ai le të shënojë, kurse borxhliu le të diktojë...”**

Një konsensus i përbashkët është se firma më e rëndësishme në aktmarrëveshje është ajo e borxhliut. Prandaj edhe aktmarrëveshja, që shkruhet me diktimin e tij, konsiderohet dokument që nuk mund të mohohet.¹

¹ Fraza *uel jum'il* vjen nga lënda *mil-leb*, që do të thotë *dijn - fe* dhe *abkam ilabijeh - dispozita hyjnore*. Disa kanë thënë se ajo vjen nga lënda *melalun*. Përderisa te *el melau* gjendet përsëritje e diktuar, ajo është përdorur herë në formën *imlaun - diktim* dhe herë tjetër në formën *imlal - diktim*.

6- Gjatë diktimit, borxhliu duhet t'i frikësohet All'llahut dhe të mos lërë asgjë pa përmendur, që shkruesi t'i shënojë. **“...dhe le t'i frikësohet All'llahut, Zotit të vet, duke mos lënë mangët asgjë nga borxhi!”**

7- Nëse borxhliu është prej atyre që i vërtetohet cilësia mendjelehtë (sefijhun), i cili është ai që nuk është në gjendje të administrojë pasurinë e tij dhe nuk mund të dallojë dëmin nga dobia, ose është i dobët mendërisht, ose është memec apo i shurdhët, atëherë aktmarrëveshjen ta diktojë kujdestari i tij dhe shkruesi të shënojë fjalët e tij. Ajeti thotë: **“Në qoftë se borxhliu është mendjelehtë ose i mitur, ose i tillë që nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë me drejtësi kujdestari i tij.”**

8- Gjatë diktimit, kujdestari duhet të jetë i drejtë dhe të mbrojë interesin e atij që ka në kujdestari. **“...le të diktojë me drejtësi kujdestari i tij.”**

9- Në shtesë të shkrimit të aktmarrëveshjes, duhet që të dy palët të sjellin dy dëshmitarë: **“Thirrni dy dëshmitarë...”**¹

10, 11- Dy dëshmitarët duhet të jenë të rritur dhe myslimanë. Kjo përfitohet nga fraza e ajetit: **“prej burrave tuaj”**, pra ata që janë në fenë tuaj.

12- Lejohet zgjedhja e dy grave si dëshmitare dhe një burrë. **“...nëse nuk gjeni dy dëshmitarë burra, atëherë thirrni për dëshmitarë një burrë dhe dy gra.”**

13- Duhet që dëshmitarët të jenë të besueshëm dhe të jenë: **“...nga ata që i quani të përshtatshëm.”** Ky ajet sqaron se dëshmitarët duhet të jenë prej të besueshmëve nga të gjitha anët. Në hadithe thuhet se është fjala për drejtësinë, pra, dëshmitarët të jenë të drejtë.

¹ Disa kanë thënë se dallimi mes *shabid* dhe *shehijid* është se *shabid* i thuhet atij që merr pjesë në ngjarje dhe mund të dëshmojë, kurse *shehijid* është ai që dëshmon.

14- Nëse dy dëshmitarët janë burra, secili të dëshmojë veçmas. Ndërsa kur janë një burrë dhe dy gra, dy gratë të dëshmojnë së bashku, ku njëra t'i kujtojë tjetrës, nëse harron diçka për të thënë ose gabon në diktim.

Përsa i përket konsiderimit të dëshmisë së dy grave të barabartë me dëshminë e një burri, bëhet sepse gruaja është më shumë emocionale dhe mund të ndikohet nga faktorë të jashtëm. Për këtë, prania e një gruaje tjetër është se **“nëse njëra grua harron, t’ia kujtojë tjetra.”**

15- Kur dëshmitarët të thirren për dëshmi, ata duhet të jenë të pranishëm në kohën e duhur dhe të mos kundërshtojnë. **“Dëshmitarët nuk duhet të kundërshtojnë kurdo që të thirren.”** Ky është prej rregullave më kryesore islame dhe se drejtësia nuk vërtetohet vetëm se me të.

16- Borxhi, qoftë i madh apo i vogël, duhet të shkruhet, sepse Islami nuk do që të ndodhin konflikte dhe mosmarrëveshje në çështjet tregtare, qofshin edhe marrëveshje të vogla, të cilat mund të çojnë në probleme të mëdha. **“Mos u mërzitni kur e shënoni borxhin, qoftë i vogël apo i madh, duke shënuar edhe afatin e pagimit.”**¹ Fjala *se'mun* do të thotë *mërziqje ndaj diçkaje për shkak të qëndrimit të gjatë*.

Këtu ajeti tregon për filozofinë e këtyre rregullave. Ai thotë se përpikëria në sistemimin e aktmarrëveshjeve e të dokumentacioneve, nga njëra anë garantojnë drejtësinë, dhe nga ana tjetër, i qetëson dëshmitarët kur dëshmojnë. Së treti, largon keqkuptimet mes individëve të shoqërisë. **“Kjo mënyrë është më e drejtë para**

¹ Qëllimi i përmendjes së fjalës *sagjrun-i vogël*, para fjalës *kebijrun-i madh*, është se në shumë raste njerëzit neglizhojnë në bashkëveprimet e vogla ose nuk interesohen t'i shkruajnë ato. Kjo çon në mosmarrëveshje. Ka raste që njerëzit mendojnë se shkrimi i bashkëveprimeve të vogla tregon për korraci. Por Kur'ani e mohon këtë gjë.

All'lahut, më e saktë për dëshmi dhe më e përshtatshme për të mos dyshuar.”

17- Nëse bashkëpunimi është me para në dorë (cash), nuk është e domosdoshme të shkruhet. **“Por, kur është tregti e pranishme, atëherë nuk do të keni gjynah nëse nuk e shënoni atë.”**

Tixharetun hadhireh ka kuptimin e bashkëveprimit (tregtisë) me para në dorë. Frazja *tediruneba*, do të thotë *tregtia aktuale* dhe është përmendur si sqarim e *tixharetu hadhireh*. Kurse fraza: **“atëherë nuk do të keni gjynah”**, do të thotë se nuk është problem edhe për shkrimin e aktmarrëveshjeve me para në dorë nuk është problem. Ajo është punë e mirë, sepse heq gabimet dhe kundërshtimet e mundshme më pas.

18- Edhe pse nuk është nevoja që të shkruhen bashkëveprimet me para në dorë, patjetër dëshmitarët duhet të jenë të pranishëm. **“Thirrni dëshmitarë edhe kur të lidhni kontrata për shitblerje.”**

19- Rregulli i fundit që përmend ajeti është se as shkruesi dhe as dëshmuesi nuk duhet të dëmtohen për shkak se veprojnë me drejtësi. **“...dhe të mos dëmtohet as shkruesi, as dëshmitari.”**

Më pas ajeti thotë se, nëse dikush e dëmton dëshmitarin apo shkruesin për shkak se thotë të vërtetën, ai është gjynah dhe devijim që e nxjerr njeriun nga rruga e adhurimit të All'lahut. **“Nëse e bëni, atëherë keni bërë gjynah.”**

Në fund, pas përmendjes së gjithë këtyre rregullave, ajeti i fton njerëzit në devotshmëri dhe në zbatimin e urdhrave të All'lahut. **“...prandaj jini të devotshëm ndaj All'lahut.”**

Pastaj thotë se All'lahu ua mëson çdo gjë që keni nevojë në jetën tuaj, materiale dhe shpirtërore. **“All'lahu ju mëson ju.”** Ai është i Gjithëditur për të mirën dhe për të keqen e njerëzve dhe Ai vendos se kush është e mirë për ta. **“All'lahu është i Gjithëditshëm për çdo gjë.”**

Dy hulumtime

1- Vërtet, rregullat e hollësishme, që përmenden në këtë ajet për rregullimin e bashkëveprimeve dhe dokumenteve, përmendja e pjesëve në të gjitha fazat në ajetin më të gjatë të Kur'anit, nxjerrin në pah interesimin e madh që ka Kur'ani për çështjet ekonomike në mesin e myslimanëve. Veçanërisht, duhet ditur se Kur'ani ka zbritur në një shoqëri të prapambetur, në të cilën shkrimi dhe këndimi ishin si mall i rrallë.

Deri edhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mbartësi i Mesazhit, nuk pati mësuar më parë dhe nuk kishte shkuar në shkollë. Nga njëra anë kjo është tregues i madhësisë së Kur'anit dhe nga ana tjetër, e rëndësishme së sistemit ekonomik për myslimanët.

Ali ibn Ibrahim, në tefsirin e tij të njohur thotë: “Në transmetime thuhet se surja “El-Bekare” përmban pesëqind rregulla islame. Në këtë ajet gjenden pesëmbëdhjetë rregulla.”¹

Por siç e përmendëm më lart, rregullat e këtij ajeti arrijnë në nëntëmbëdhjetë. Nëse do t'i marrim në konsideratë rregullat përmbajtëse, numri i tyre do të jetë më i madh. Fadil el Mikdadi, në librin e tij “Kenzul Urfan”, përmend njëzet e një rregulla. Pa llogaritur degëzimet e ndryshme të tjera të rregullave. Sipas kësaj, thënia e Ali ibn Ibrahimit se në këtë ajet gjenden pesëmbëdhjetë rregulla, bazohet në bashkimin e disa rregullave me njëri-tjetrin.

Fraza: “**...prandaj jini të devotshëm ndaj All'llahut.**” dhe fraza: “**All'llahu ju mëson ju.**”, edhe pse në ajet përmenden të pavarura dhe janë të lidhura me njëra tjetrën, po të krahasohen të dyja, tregojnë për një lidhje të fortë mes tyre. Kuptimi është se

¹ “Tefsirul Kummij”, vëll. 1, f. 94.

devotshmëria, arsytimi dhe frika ndaj All'llahut ndikojnë shumë në njohjen e njeriut dhe në shtimin e dijes së tij.

Sigurisht, kur zemra e njeriut pastrohet nga papastërtitë, ajo bëhet si pasqyrë e kthjellët që reflekton të vërtetat e All'llahut. Ky kuptim s'ka dyshim e as problem nga ana logjike, sepse cilësitë e këqija dhe punët e këqija janë pengesa të mendjes së njeriut dhe nuk e lënë atë që t'i shohë të vërtetat ashtu si duhen parë. Kur njeriu e largon këtë pengesë nëpërmjet devotshmërisë, atëherë e drejta dhe e vërteta do të duken shumë qartë.

Mirëpo disa sufistë të paditur e kanë keqkuptuar këtë kuptim dhe e kanë bërë argument për mos nxënien e dijeve. Ndërkohë që fjalët e tyre janë në kundërshtim me ajetet dhe hadithet e nderuara islame.

Është e vërtetë se disa dije duhet të mësohen nëpërmjet studimit dhe mësimin në formë të rregullt, siç është e njohur. Një pjesë tjetër e dijeve hyjnore nuk i mbërrijnë njeriut vetëm nëpërmjet pastrimit të zemrës dhe brendisë me ujën e njohjes e të devotshmërisë. Kjo është ajo drita që përmendet në disa transmetime, që All'llahu e hedh në zemrën e atij që e meriton këtë mirësi: “Dija është dritë që All'llahu e hedh (vendos) në zemrën e atij që do.”

Ajeti 283

وَإِنْ كُنْتُمْ عَلَىٰ سَفَرٍ وَلَمْ تَجِدُوا كَاتِبًا فَرِهْنَ مَقْبُوضَةً فَإِنْ أَتَىٰ بَعْضُكُم
بَعْضًا فَلْيُؤَدِّ الَّذِي أُؤْتِمِنَ أَمْنَتَهُ وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ وَلَا تَكْتُمُوا الشَّهَادَةَ
وَمَنْ يَكْتُمْهَا فَإِنَّهُ رَءِيسٌ لِّقَلْبِهِ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٢٨٣﴾

“Nëse jeni në udhëtim e nuk gjeni shkruar, atëherë paguani kapar. Dhe, nëse njëri prej jush ka besim tek tjetri, atëherë borxhliu le ta kthejë atë që i është besuar dhe le t'i frikësohet All'llahut, Zotit të vet. Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare. All'llahu di çdo gjë që punoni ju.”

Komentimi

Ky ajet plotëson ajetin paraardhës dhe përmban disa rregulla

1- Nëse nuk gjendet dikush që të shkruajë aktmarrëveshjen e bashkëveprimit, i cili mund të ndodhë në udhëtim, atëherë borxhliu të lërë kapar diçka që të qetësohet dhe të bindet borxhdhënësi. **“Nëse jeni në udhëtim e nuk gjeni shkruer, atëherë merrni kapar.”**

Ndoshta në pamje të parë të ajetit mund të thuhet se ligji i kaparit është i posaçëm për udhëtimin. Mirëpo, po të shihet fjalia e dytë: **“e nuk gjeni shkruer”** sqarohet se qëllimi është sqarimi i gjendjes kur nuk mund të ketë shkruer. Për këtë, të dy palët të mjaftohen me kaparin derisa të kthehen në vendbanimin e tyre. Në transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja e All'llabut qoftë mbi ta!*), në literaturat islame thuhet se profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medine i mori një burri jomysliman kredi (borxh) dhe la kapar mburojën e tij.¹

2- Duhet që kapari të qëndrojë tek borxhdhënësi që të bindet. **“...atëherë merrni kapar.”**

Në tefsirin “Ajjashij” gjendet një hadith i imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kapari njihet (quhet), kur paguhet.”²

3- Të gjitha këto rregulla: shkrimi i aktmarrëveshjes, dëshmia e dëshmitarëve dhe marrja e kaparit, zbatohen kur nuk gjendet besim i plotë mes palëve. Nëse gjendet besim tek ata, atëherë nuk është nevoja e shkrimit të aktmarrëveshjes.

Për këtë duhet që borxhliu të respektojë besimin e borxhdhënësit dhe ta shlyejë borxhin në kohën e caktuar. Gjithashtu, të mos harrojë devotshmërinë dhe përkushtimin ndaj All'llahut.

¹ Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëll. 2, f. 420. Tefsiri “El Meragi”, fundi i ajetit në fjalë.

² Tefsiri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 301.

“Dhe, nëse njëri prej jush ka besim tek tjetri, atëherë borxhliu le ta kthejë atë që i është besuar dhe le t’i frikësohet All’liahut, Zotit të vet.”

4- Ata, që kanë me të tjerët të drejta bashkëveprimi apo diçka tjetër, nëse ftohen për të dëshmuar, të mos e fshehin dëshminë, sepse fshehja e dëshmisë është mëkat i madh. **“Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare.”**

Natyrisht që dëshmia është obligim për ne kur të tjerët nuk arrijnë të konstatojnë të vërtetën me dëshminë e tyre. Ndërsa, kur konstatohet e vërteta, nuk është obligim dëshmia për të tjerët. Pra, dëshmimi i dëshmisë është (uaxhib kifaji).¹

Përderisa fshehja e dëshmisë dhe mos zbatimi i saj janë prej punëve me zemër, për këtë gjynahu i është ngjitur zemrës.² Në ajet thuhet: **“...zemra e tij është gjynahqare.”**

Në fund ajeti e përforcon edhe njëherë domosdoshmërinë e amanetit dhe ruajtjen e të drejtave të të tjerëve: **“All’lahu di çdo gjë që punoni ju.”**

¹ Uaxhib kifaji do të thotë se kur një person apo disa persona e kryejnë një detyrë, atëherë të tjerët nuk e kanë për detyrë ta bëjnë atë, siç është p.sh., falja e namazit të xhenazezë. (përkthyesi)

² Për sqarimin e kuptimit të zemrës shiko xhuzin e parë, f. 72. (Kuptimi i zemrës në Kur’an është shpirti dhe mendja.)

Ajeti 284

لَلّٰهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ ۗ وَاِنْ تُبَدُّوْا مَا فِيْ اَنْفُسِكُمْ اَوْ
تُخَفُّوْهُ يَحَاسِبْكُمْ بِهٖ اللّٰهُ ۗ فَيَغْفِرُ لِمَنْ يَشَآءُ وَيُعَذِّبُ مَنْ يَشَآءُ ۗ وَاللّٰهُ عَلٰى
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيْرٌ ﴿٢٨٤﴾

“All’llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj, All’llahu do t’ju kërkojë llogari për të. Dhe, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë. All’llahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

Komentimi

Sunduesi i gjithçkaje

Në të vërtetë ky ajet është plotësues i fjalisë së fundit të ajetit të mëparshëm.


Ajeti thotë: “All’llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë.” Për këtë shkak Ai është i Gjithëditur për punët e njeriut, qofshin të dukshme apo të padukshme. “Edhe nëse e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj..”

Kjo do të thotë: Ju mos kujtoni se punët tuaja të padukshme, si fshehja e dëshmisë dhe gjynahet e tjera të zemrës nuk i sheh All’llahu i Madhëruar, Sunduesi i gjithësisë. Atij nuk i fshihet asgjë.

Nuk është çudi kur thuhet se All'lahu do t'ju llogarisë për gjynahet e zemrës: **“Dhe, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë.”**

Supozohet se ajeti i lartpërmendur tregon për të gjitha rregullat e përmendura në ajetet e mëparshme, siç ishin shpenzimi i çiltër, shpenzimi i shoqëruar me mburrje dhe ofendim, po ashtu namazi, agjërimi e të tjera rregulla dhe besime që kanë lidhje me zemrën.

Në fund ajeti thotë: **“All'lahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”** Ai është i Gjithëditur për çdo gjë që lëviz në këtë botë. Ai është i Plotfuqishëm në dallimin e meritave dhe aftësive, i Plotfuqishëm për ndëshkimin e kundërshtarëve.



Dy hulumtime

1- Mund të përfytyrohet se ky ajet kundërshton shumë hadithe që vërtetojnë dhe përforcojnë qëllimin (nijetin). Por, përgjigjja është e qartë se këto hadithe kanë lidhje me ato gjynahe që zbatohen dhe praktikohen, ku edhe nijeti është kusht paraprak për to, si: padrejtësia, gënjeshtria, uzurpimi i të drejtave të të tjerëve, etj.

Gjendet komentim tjetër për këtë ajet: Ka mundësi që një punë e vetme të ketë forma të ndryshme, p.sh. shpenzimi herë bëhet në rrugën e All'llahut e herë tjetër bëhet për t'u dukur dhe për të fituar pushtet. Kështu që ajeti thotë: Nëse ju e shfaqni nijetin tuaj apo e fshihni atë, padyshim që All'llahu i Madhëruar është i Gjithëditur për të dhe do t'ju japë sipas nijetit. Në të vërtetë kjo tregon për përmbajtjen e hadithit të bekuar: ***“Punët njihen vetëm nga nijeti.”***¹

2- Është e qartë se thënia e All'llahut: ***“Dhe, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë.”***, ka kuptimin se dëshira e Tij nuk është pa argument. Përkundrazi, falja e Tij bazohet në argument dhe arsye, që është merita e një njeriu për të fituar faljen e All'llahut. Po kështu edhe për dënimin e Tij.

¹ “Usailu Shia, vëll”. 1, f. 33.

Ajeti 285

ءَامَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ ۚ وَالْمُؤْمِنُونَ ۚ كُلٌّ ءَامَنَ بِاللَّهِ
وَمَلَئِكْتِهِ ۚ وَكُتُبِهِ ۚ وَرُسُلِهِ ۚ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا
سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۗ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿٢٨٥﴾

“I Dërguari beson në atë që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në All’llahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”. Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!”

Komentimi

Shenjat e besimit dhe rrugët e tij

Surja “El-Bekare” filloi me sqarimin e disa njohurive islame dhe me besimin e drejtë dhe përfundon me po këto tema, siç është edhe ajeti në fjalë dhe ai pasardhës. Kështu që fillimi dhe fundi i kësaj sureje janë në përputhje.

Disa komentues, për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, kanë thënë se, kur zbriti ajeti i mëparshëm, që thoshte se All’llahu e di të fshehtën dhe të dukshmen tuaj, disa sahabë u frikësuan dhe thanë: “Çdokush nga ne ka mendime dhe vesvese djallëzore.”

Këtë ia thanë edhe Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atëherë zbriti ajeti i lartpërmendur dhe sqaroi rrugën e drejtë dhe besimin, mënyrën e përgjërimit dhe të lutjes, si dhe dorëzimin para urdhrave të All'llahut të Madhëruar.

Në fillim ajeti thotë: **“I Dërguari beson në atë që i është shpallur nga Zoti i tij.”** Ky kuptim dhe kjo veçori konsiderohet si tipar dallues i profetëve të All'llahut, të cilët besojnë me bindje të plotë në atë që iu shpall atyre. Në zemrat e tyre nuk gjendet dyshim për besimin. Ata i besuan atyre shpalljeve para të tjerëve. Qëndruan të palëkundur dhe duruan para të tjerëve.

Në ajetin 158 të sures “A’raf” lexojmë se kjo veçori konsiderohet si cilësi e profetit fisnik, Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe prej dallimeve të tij. Ajeti thotë: **“...besoni në All'llahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në All'llahun dhe Fjalët e Tij...”**

Pastaj ajeti shton: **“...e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në All'llahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij.”**

Fjalja e fundit është e vetë besimtarëve, të cilët besojnë në të gjithë të dërguarit dhe në legjislacionet e tyre. E kundërta është me disa njerëz të tjerë, siç thotë për ta ajeti 150 i sures “En-Nisa”: **“Vërtet, ata që mohojnë All'llahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë All'llahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë”...”**

Besimtarët nuk shohin dallim mes të dërguarve, sepse ata janë të gjithë të dërguarit e All'llahut. Ata i respektojnë dhe i quajnë të gjithë të shenjtë.

Është e qartë se kjo çështje nuk e mohon thënien e anulimit të sheriateve të mëparshme nëpërmjet sheriateve të mëpasshme. Vërtet mësimet e të dërguarve dhe shariatet e tyre kanë qenë si fazat e mësimave të ndryshme që fillojnë me filloren, nëntëvjeçaren të mesmen dhe universitetin.

Edhe pse të gjitha ato janë të përbashkëta në parime dhe baza themelore, ndryshojnë në sipërfaqe dhe praktikim. Kur njeriu ngrihet në një nivel më të lartë, ai e lë programin e mëparshëm dhe zbaton programin e këtij niveli që ka arritur. Megjithatë, respekti dhe konsiderata e tij për programin paraardhës qëndrojnë te ai.

Më pas ajeti shton se besimtarët janë të fortë në besim e në veprime: **“Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!””**

Fraza *semi'na-dëgjuam*, në disa vende do të thotë *kuptuam* dhe *dëshmuam*, që do të thotë: Ne e pranuan thirrjen e të dërguarve të Tu me gjithë ekzistencën tonë dhe jemi plotësisht të gatshëm për ndjekje dhe pasim.

Por, o Zoti ynë, o Sunduesi ynë, ne jemi njerëz dhe nganjëherë egoja jonë na mposht dhe dëshirat tona na çojnë në mëkate. Për këtë ne presim faljen tënde dhe besojmë se Ti do të na falësh, sepse rruga jonë është për tek Ti.

Në këtë mënyrë besimi na ngjan me fillimin e krijimit dhe me Ringjalljen, i shoqëruar me zbatimin praktik të rregullave të shariatit dhe të kushtetutave hyjnore.

Ajeti 286

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا ۚ لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ ۗ رَبَّنَا لَا
تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إِكْرَامًا كَمَا حَمَلْتَهُ
عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ ۗ وَاعْفُ عَنَّا

وَأَغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا ۗ أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٢٨٦﴾

“All’llahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”

Komentimi

Disa çështje të rëndësishme

Siç u tha në komentimin e ajetit të mëparshëm, këto dy ajete, ajeti 285 dhe 286, kanë lidhje me ata persona që u frikësuan nga fraza e ajetit 284, i cili thoshte se All'llahu e di nijetin tuaj dhe do të jepni llogari tek Ai sipas nijetit që keni pasur. Ata thanë se askush nga ne nuk e ka të pastër zemrën prej vesvesit dhe prej mendimeve djallëzore.

Ajeti në fjalë thotë: **“All'llahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.”**

Fjala *el Uns'u* në gjuhësi do të thotë *fuqi* dhe *afësi*. Për këtë, ajeti miraton të vërtetën e thënë logjike se detyrat dhe obligimet e All'llahut nuk e tejkalojnë fuqinë e njeriut dhe peshën e mbartjes së tyre. Prandaj, mund të thuhet se çdo rregull mund të kushtëzohet dhe të interpretohet me këtë ajet, i cili kufizon rrethin e fuqisë së njeriut. Është e natyrshme se Ligjvënësi i Urtë dhe i Drejtë nuk mund të vendosë një ligj në formë tjetër.

Gjithashtu, ajeti përforcon dhe dëshmon se rregullat e sheriatit nuk ndahen kurrë nga rregullat e logjikës dhe të urtësisë. Përkundrazi, ato janë pranë tyre në çdo fazë.

Më pas ajeti thotë: **“...në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon.”**

Është e vërtetë se çdo njeri do të korrë atë që ka bërë vetë, qoftë e mirë apo e keqe. Rezultatit e këtyre punëve do ta shikojë në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Ajeti u tërheq vëmendjen njerëzve që të bëjnë kujdes ndaj përgjegjësive të tyre dhe ndaj fundit të punëve të tyre. Po ashtu, zhduk legjendet, me të cilat disa njerëz shfajësojnë punët e tyre të këqija.

Duhet përmendur se ajeti i quan punët e mira me emrin “*el kesbu*” dhe punët e këqija “*el iktisa*”. Shkaku mund të jetë se fjala “*el kesbu*” përdoret për gjëra që i realizon njeriu me dëshirë dhe që janë në përshtatje me natyrën e tij krijuese (fitretun). Kurse “*el iktisab*” është e kundërta e fjalës “*el kesb*”, që do të thotë se *veprat janë në kundërshtim me natyrën krijuese*. Nga kjo kuptohet se punët e mira janë në përputhje me natyrën e njeriut, ndërsa punët e këqija janë në kundërshtim me natyrën e tij.

Ragibu Asfahani, në librin e tij “El Mufredat”, ka mendim tjetër. Ai thotë: “*El kesbu*” është veprimi i njeriut që i sjell dobi dhe arrin të fitojë, siç është fitimi i pasurisë. “*Kesbu*” i thuhet edhe asaj që bën për veten e tij dhe për të tjerët, siç është bamirësia, dobia e së cilës nuk është e kufizuar vetëm me bërësin e saj, por përfshin të afërmit dhe të tjerët. Kurse “*iktisab*” i thuhet vetëm asaj veprë, rezultati i së cilës i kthehet vetëm bërësit dhe ky është gjynahu.”

Ky ndryshim i kuptimeve është i rregullt kur njëra fjalë përdoret si antonim i tjetrës.

“Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim!”

Përderisa besimtarët e dinë se e ardhmja e tyre kufizohet me ato që kanë vepruar, punë të mira apo të këqija, mbështetur në ligjin “Leha ma kesebet ue alejha ma iktesebet”, ata luten duke iu drejtuar All'llahut me emrin Rabbun: “Nëse kemi bërë gjynah për shkak të harresës apo gabimit, na i fal gjynahet tona me mëshirën Tënde të gjerë dhe na e largo dënimin.”

Dënimi për shkak të harresës apo gabimit

A i fal All'llahu gjynahet e kryera me harresë dhe gabimisht? A dënon All'llahu për këto gjynahe?

Për përgjigjen duhet thënë: Ka raste që harresa është si me kuptimin e tolerimit nga ana e vetë njeriut. Natyrisht që kjo lloj harrese nuk ia heq përgjegjësinë njeriut. Ja si thuhet në Kur'an: (Ne do t'u themi atyre): **“Shijoni dënimin, sepse nuk e keni harruar takimin e kësaj dite.”**¹

Sipas këtij ajeti, harresa dhe tolerimi janë shkaktare të dënimit.

Duhet të dihet se ka dallim mes harresës dhe gabimit. Gabim u thuhet gjërave që bëhen nga pavëmendja dhe pakujdesia, p.sh: kur qëllon për të vrarë gjahun, por plumbi plagos një njeri; kurse harresa është kur njeriu drejtohet të bëjë një punë, por e harron se si të veprojë. Për shembull, kur harrohen dallimet e gjynahçarit të vërtetë, mund të ndëshkohet një njeri i pafajshëm, duke hamendësuar se është gjynahçar.

“Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh!”

Fjala *el isru* ka kuptimin e lidhjes së diçkaje dhe izolimin e saj. Përdoret edhe për peshën e rëndë, që e pengon njeriun për të lëvizur. Po ashtu, quhet edhe premtimi e besa e vërtetë, që e kufizon njeriun. Për këtë, kjo fjalë përdoret edhe për ndëshkimin.

Në këtë pjesë të ajetit besimtarët i kërkojnë All'llahut që t'ua heqë barrën e rëndë, e cila e pengon njeriun t'i bindet dhe të adhurojë All'llahun e Madhëruar.

¹ Sure “Sexhde”, ajeti 14.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Jam dërguar me sheriat të lehtë dhe tolerues.”**¹

Dikush mund të pyesë: “Kur toleranca dhe lehtësia qenkan të mira në fe, përse popujt e mëparshëm nuk e kanë pasur këtë?”

Përgjigjja: “Nga ajetet e Kur'anit përfitojmë se obligimet e rënda nuk ekzistonin në parimet e feve të mëparshme. Ato u bënë të detyrueshme si ndëshkim për shkak të mëkateve të përsëritura të atyre popujve, siç ishte ndalimi i ngrënies së disa mishrave të lejuara nga bijtë e Izraelit.”²

Më pas besimtarët i kërkojnë All'llahut që të mos i sprovtojë me sprova të rënda dhe me ndëshkime që nuk mbarten. **“Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim!”**

Në fjalinë e parë shohim frazën *la tehmil*, kurse në të dytën shohim frazën *la tubammi*. Faza *la tehmil*, përdoret në çështje të vështira, kurse fraza *la tammil* për çështje që nuk mbahen dot.

“Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro!”

Fjala *afū* ka kuptimin *e heqjes së gjurmëve të diçkaje*. Për gjynahet përdoret me kuptimin e fshirjes së tyre. Ajo përfshin gjurmët natyrore, kriminale dhe të dënimeve.

Ndërsa fjala *el gufran* ka kuptimin që All'llahu e mbron robin prej prekjes së dënimit.

Për këtë, përdorimi i këtyre dy fjalëve ka dobinë se besimtarët i kërkojnë All'llahut që t'i heqë gjurmët e gjynaheve prej shpirtrave dhe zemrave të tyre, me qëllim që të mos i godasë e keqja. Po ashtu, ata i kërkojnë Atij që të mos bien pre e të këqijave. Së fundi, dëshirojnë mëshirën e Tij të gjerë e cila përfshin çdo gjë.

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 65, f. 319, (botuar në Bejrut). “Furuul Kafij”, vëll. 5, f. 494, kreu: “Keraheti i rahbanijetit”.

² Sure “En'am”, ajeti 146 dhe sure “Nisa”, ajeti 160.

“Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”

Në fund të lutjes së tyre besimtarët i thonë All'llahut se Ti je Sunduesi ynë, Kujdestari ynë, Mbrojtësi ynë dhe na ke premtuar se do të na ruash. Ata i kërkojnë Atij që t'i triumfojë mbi armiqtë.

Në këto dy ajete gjendet përmbajtja e gjithë sures “El-Bekare”. Të dy këto ajete na udhëzojnë drejt shpirtit të dorëzimit para Sunduesit të gjithësisë. Ato u tregojnë besimtarëve se, nëse duan që All'llahu t'i falë gjynahet e tyre dhe të triumfojnë mbi armiqtë e tyre, ata duhet të zbatojnë programin “Dëgjuam dhe u bindëm”. Duhet të thonë: “Ne dëgjuam thirrjet e thirrësve dhe i pranuan ato me gjithë gjymtyrët dhe organet tona. Ne jemi ndjekës të atyre thirrjeve!”

Vërtet, përsëritja e fjalës *rabbun*, i cili i mirëson robtë, e plotëson këtë të vërtetë. Për këtë edhe imamët e fesë, në thëniet e tyre, na nxisin në leximin e këtyre dy ajeteve. Ata kanë sqaruar edhe shpërblimin e leximit të tyre. Nëse zemra dhe gjuha bashkohen në leximin e tyre dhe nuk lexohen thjesht duke shqiptuar fjalët, atëherë bëhen program i jetës. Leximi i tyre bën lidhjen e zemrës me Krijuesin e Gjithësisë. Pastron shpirtin dhe janë faktorë për lëvizjen dhe aktivizimin.

Nga ky ajet përfitohet dhe duket qartë se obligimet e rënda nuk ekzistojnë në sheriatin islam. Ato nuk gjenden as në Islam dhe as në fetë e tjera. Baza është liria e njeriut dhe dëshira e tij, sepse ajeti thotë që çdo njeri do të marrë shpërblimin e punëve të tij, qofshin të mira apo të këqija. Ato të mira, që ka bërë, do t'i kthehen po atij. Po ashtu, nëse ka bërë të këqija, i ka për veten e tij. Nga këtu e ka pikënisjen kërkimi i faljes dhe i mëshirës.

Ky kuptim është në përputhje të plotë me logjikën dhe me çështjen e së mirës dhe së keqes, sepse All'llahu është i Urtë dhe nuk mund ta ngarkojë robin me ato që nuk ka mundësi. Kjo në vetvete

është argument i mohimit të forcës dhe detyrimit. Si mund të mendohet që All'llahu t'i detyrojë njerëzit në kryerjen e mëkateve e të gjynaheve dhe në të njëjtën kohë t'i ndalojë ata në kryerjen e tyre?!

Mirëpo, obligimet e rënda nuk janë të pamundura, siç lexuam për obligimet e rënda të bijve të Izraelit. Këto obligime e kishin burimin tek punët e tyre dhe konsiderohen si dënim për ato gjynahe dhe mëkate që bënë.

Fundi i sures Bekare



Surja “Al Imran”

Zbritur në Medine

Numri i ajeteve të saj 200



Shoqata

Flladi

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Në një thënie të transmetuar nga profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: **“Cilido që lexon suren “Al Imran”, për çdo ajet, atij do t'i jepet siguria e kalimit mbi urën e Xhehennemit.”**¹

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Cilido që lexon suren “El-Bekare” dhe suren “Al Imran”, në Ditën e Gjykimit këto sure do të jenë hijezuese për atë person (do t'i bëjnë hije) njëlloj si dy re.”²

Përmbajtja e sures

Disa komentues të njohur mendojnë se kjo sure ka zbritur në mes të vitit të dytë dhe të tretë të hixhrit, pra, në mes Betejës së Bedrit dhe të Uhudit. Ajo pasqyron periudhën më të ashpër dhe më të ndërlikuar, e cila ishte ajo e fillimit të përhapjes së Islamit.³

Çështjet më kryesore që përmban kjo sure janë:

1- Një pjesë e rëndësishme të kësaj surjeje ka lidhje me Teuhidin dhe cilësitë e All'llahut, Ringjalljen dhe njohuri të tjera islame.

2- Një pjesë tjetër ka lidhje me Xhihadin dhe rregullat e domosdoshme e të hollësishme të tij. Po ashtu, gjenden mësimet përfituese tek dy betejat, e Bedrit dhe e Uhudit, ku u shfaq ndihma e All'llahut për besimtarët. Flet për jetën e përhershme të dëshmorëve në rrugën e All'llahut të Madhëruar.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 405.

² Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 309.

³ Ajeti 13 i kësaj sureje tregon për Betejën e Bedrit dhe nga ajeti 121 deri te ajeti 128 tregon për Betejën e Bedrit dhe të Uhudit. Po e njëjta çështje përmendet nga ajeti 139 deri te ajeti 144.

3- Një pjesë tjetër e kësaj sureje flet rreth disa rregullave islame, të cilat kanë të bëjnë me domosdoshmërinë e unitetit islam, me Haxhin, me Shtëpinë e Shenjtë të All'llahut, urdhërimin për të mira dhe largimin nga të këqijat, dashuria për hir të All'llahut dhe urrejtja po për hir të Tij, çështja e amanetit dhe e shpenzimit në rrugën e All'llahut, mënjanimi nga gënjeshtria, domosdoshmëria e të mbajturit qëndrim të drejtë, durimi përballë armiqve dhe sprovave të ndryshme nga ana e All'llahut dhe përkujtimi i Tij në çdo situatë.

4- Kjo sure flet për plotësimin e hulumtimeve, që flasin për historinë e disa profetëve, siç janë: Ademi, Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe profetëve të tjerë. Përmend historinë e hazreti Merjemes, fisnikërinë dhe pozitën e saj tek All'llahu i Madhëruar.

Gjithashtu, kjo sure flet edhe për kurthet e ndjekësve të jahudizmit (hebraizmit) dhe kristianizmit kundër Islamit dhe myslimanëve.

Të gjitha subjektet dhe çështjet e kësaj sureje janë të ndërlidhura dhe duket sikur ajo ka zbritur e tëra në një kohë.

Ajetet 1- 4

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾
الَمْ ﴿١﴾ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ﴿٢﴾ نَزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ
بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنْزَلَ التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ ﴿٣﴾ مِنْ قَبْلُ
هُدًى لِلنَّاسِ وَأَنْزَلَ الْفُرْقَانَ ﴿٤﴾ إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ
شَدِيدٌ ﴿٥﴾ وَاللَّهُ عَزِيزٌ ذُو انتِقَامٍ ﴿٦﴾

Me emrin e All'lahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Elif Lâm Mîm.

All'lahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përrjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje. Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai i ka zbritur Teuratin dhe Ungjillin më parë si udhërrëfyes për njerëzit dhe ka zbritur edhe Dalluesin (e së vërtetës nga e pavërteta). Ata që nuk besojnë shpalljet e All'lahut, i pret dënim i ashpër; All'lahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim.”

Shkaku i zbritjes

Disa komentues kanë thënë se më shumë se tetëdhjetë ajete të kësaj sureje kanë zbritur për delegatët kristianë të Nexhranit,¹ të cilët erdhën në Medine për të verifikuar çështjen e Islamit.

Delegacioni përbëhej prej gjashtëdhjetë vetësh. Nga këta, katërmëdhjetë vetë ishin prej personaliteteve dhe fisnikëve të Nexhranit. Tre nga këta katërmëdhjetë ishin me cilësinë e kryesisë, ku të krishterët shkonin për zgjidhjen e problemeve të tyre. Njëri prej tyre quhej Akib, por thirrej edhe me emrin Abdul Mesijh dhe ishte udhëheqësi i popullit të tij. I dyti quhej Es Sejjid dhe e quanin gjithashtu Ejhem. Ai ishte përgjegjësi i programit të udhëtimit dhe i besueshëm tek të krishterët. I treti quhej Ebu Harith, i cili ishte i ditur dhe me pushtet. Shumë kisha u ndërtuan me emrin e tij. Ai i dinte përmendësh të gjitha librat e krishterë.

Ata hynë në Medine të veshur me rrobat e fisit Beni Ka'b dhe shkuan te Xhamia e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në atë kohë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), së bashku me myslimanët, sapo kishin mbaruar së faluri namazin e ikindisë. Pamja e tyre, me veshjen e pastër e me ngjyra të hapura, u tërhoqi vëmendjen myslimanëve, sa që disa prej tyre thanë: “Nuk kemi parë të tillë bukuri!”

Kur mbërritën në Xhami, u afrua koha e ritit të tyre. Ata i ranë çangës sipas riteve të tyre dhe u kthyen nga lindja dhe filluan të luteshin. Disa nga shokët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përpoqën t'i ndalonin, por Profeti u kërkoi shokëve që t'i lënë të bëjnë si të duan.

¹ Nexhrani është një zonë malore në veri të Jemenit, rreth 10 shtëpi larg nga San'a, kryeqyteti i Jemenit. Aty banojnë fiset Hamdan, të cilët në kohën para Islamit kishin një idhull me emrin Jauk. Ju'akut el Hamevij në librin “Mu'xhemul Buldan” thotë: “Nexhrani është emër i disa vendeve.”

Pas lutjes, Akibi dhe Sejidi shkuan pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe filluan të bisedojnë me të. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ftoi të hyjnë në Islam dhe t'i dorëzohen All'llahut.

Ata të dy thanë: “Ne jemi myslimanë para teje.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Gënjeni. Ajo që ju pengon për në Islam është se ju thoni që All'llahu ka fëmijë, adhuron kryqin dhe hani mishin e derrit.”

Ata thanë: “Nëse Isai nuk është i biri i All'llahut, kush është babai i tij?”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “A nuk e dini që fëmija i ngjan babait?”

Ata thanë: “Po.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti: “A nuk e dini se Zoti ynë është i Gjallë dhe nuk vdes, kurse Isait i vjen zhdukja?”

Ata thanë: “Po.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “A nuk e dini që Zoti ynë është Sunduesi i Gjithçkaje, e mbron dhe e furnizon atë?”

Ata thanë: “Po.”

-“Vallë a zotëron Isai diçka prej saj?”

Ata thanë: “Jo.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “A nuk e dini që All'llahut nuk i fshihet asgjë që ndodhet në qiej e në tokë?”

Ata thanë: “Po.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “A di gjë tjetër Isai përveç asaj që iu mësuat?”

Ata thanë: “Jo.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Vërtet, All'llahu e formoi Isain në barkun e nënës së vet ashtu si deshi. All'llahu as nuk ha, as nuk pi e as nuk ndryshon.”

Ata thanë: “E vërtetë është.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “A nuk e dini se Isain e mbajti nëna e tij në bark njësoj siç mbajnë gratë e tjera fëmijët e tyre? Pastaj ai është ushqyer në barkun e nënës së tij njësoj si fëmijët e tjerë dhe, kur lindi, ai hante, pinte dhe ndryshonte.”

Ata thanë:”Po.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u tha: “Si mund të jetë kjo ajo që pretendoni?”

Ata heshtën dhe All'llahu zbriti për ta fillimin e sures “Al Imran” dhe më shumë se tetëdhjetë ajete.¹

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 406. Tefsijri “El Mijzan”, vëll. 3, f. 15.

Komentimi

Komentimi i shkronjave të veçuara me trurin elektronik

Përsa i përket thënieve rreth shkronjave të veçuara në Kur'an, u fol në fillim të sures “El-Bekare” dhe nuk është e domosdoshme përsëritja. Ajo që duhet thënë këtu është Teoria Muthireh, të cilën e sollli kohët e fundit dijetari egjiptian. Këtu do ta përmendim shkurtimisht për shkak të rëndësisë së saj. S’ka dyshim se gjykimi i rregullsisë apo i parregullsisë së kësaj teorie ka nevojë për kërkime të hollësishme, përgjegjësia e së cilës u bie brezave të ardhshëm. Këtu do ta përmendim thjesht si teori.¹

Revista e njohur egjiptiane “Akhiru Saatu” botoi artikull të habitshëm, të cilin e kishte kryer një dijetar mysliman nga Egjipti. Ky ishte i posaçëm për komentimin e disa ajeteve të Kur’anit Fisnik, nëpërmjet trurit elektronik. Kjo i habiti shumë njerëzit në mbarë botën.

Kërkimet, që i kreu doktor Reshad Khalife, dijetar i kimisë, gjatë tre vjetëve të pandërprera, konstatuan se ky Libër qiellor (Kur’ani) nuk është produkt i mendjes së njeriut, sepse njeriu nuk është i aftë të sjellë një libër të tillë.

Doktor Khalife i kreu këto studime në qytetin amerikan të Santa Luisit, në zonën Mejsuri. Në studimin e tij ai përdori për një kohë të gjatë mendjet elektronike, edhe pse qeraja e tyre kushtonte 10 dollarë në minutë, të cilën e paguanin myslimanët që banonin atje.

¹ Është për të ardhur keq se ky dijetar, që jeton në Amerikë, është ndikuar nga ambienti i shthurur që gjendet atje. Ai mohoi qartë disa rregulla të lejuara islame duke u mbështetur në pretendime të kota.

E gjithë përpjekja e doktorit ishte përqendruar në njohjen e kuptimit të shkronjave të veçanta që gjenden në Kur'an, si: shkronja *kaf, elif, lam, mim, ja, sin*, etj. Nëpërmjet llogaritjeve të vështira arriti të konstatojë praninë e lidhjes së fortë mes këtyre shkronjave që ndodhen në fillim të sureve.

Ai i përdori mendjet elektronike për ato llogaritje të posaçme, për të njohur numrin e shkronjave të sureve dhe përqindjen e pranisë së çdo shkronje në to dhe jo për të komentuar Kur'anin.

Po të mos ishin ato aparatura, askush nuk do të kryente llogari mbi letër.

Doktor Reshad thotë: “E dimë që Kur’ani përmban 114 sure. 86 prej tyre kanë zbritur në Mekë dhe 28 kanë zbritur ne Medine. 29 sure të Kur’anit fillojnë me shkronja të veçuara.”

Është për t’u përmendur se këto shkronja të veçuara përbëjnë gjysmën e shkronjave të alfabetit arab. Ato shkronja janë: (elif, ha, ra, sin, sad, ta, ajn, kaf, kef, lam, mijm, nun, he, je). Këto i cilësojnë si shkronja të ndritshme.

Doktori thotë: “Ka vite që unë dëshiroj të njoh kuptimin e këtyre shkronjave, të cilat, nga pamja të jashtme, duken se janë të shkëputura dhe ndodhen në krye të disa sureve. Megjithëse i kam lexuar komentimet e komentuesve të njohur, nuk gjeta tek ato përgjigje bindëse. I kërkova ndihmë All’llahut dhe iu mbështeta Atij e më pas fillova kërkimin tim.

Njëherë më erdhi në mendje së mund të ketë lidhje mes këtyre shkronjave dhe atyre që ndodhen në fillim të çdo sureje. Mirëpo studimi i katërmbëdhjetë shkronjave të ndritshme bashkë me shkronjat e 114 sureve, nxjerrja e llogarive me përqindje për çdo shkronjë dhe llogari të tjera të shumta, nuk mund të bëheshin pa mbështetjen e mendjes elektronike.

Për këtë, së pari fillova me përcaktimin e atyre shkronjave në të gjitha suret. Pastaj përcaktimin e shkronjave të çdo sureje. Të gjitha

këto, së bashku me numrin e sures, i hodha në mendjen elektronike. (Këtë e bëra me qëllim kryerjen e llogarive të vështira, të kërkuara më pas.)

Kjo punë, me gjithë punën paraprake e saj, zgjati dy vjet e gjysmë.

Pastaj punova një vit në kompjuter për të bërë ato llogaritje. Rezultatet ishin shumë të shkëlqyera. Për herë të parë në historinë islame u zbulua mbulesa e të vërtetave të mahnitshme që vërtetojnë mrekullinë e Kur'anit, lidhur me matematikën dhe përqindjen e shkronjave të Kur'anit, në shtesë të mrekullive të tjera.

Llogaritë kompjuterike na sqaruan përqindjen e pranisë së katërmbëdhjetë shkronjave në çdo sure të Kur'anit.

Për shembull: Nga llogaritjet gjetëm se përqindja e shkronjës *kaf*, që është një prej shkronjave të ndritshme, në suren “Felek” arrin më të lartën: 6/700%, kjo zë vendin e parë në mesin e sureve të Kur'anit, sigurisht me përjashtim të sures “Kaf”. Pas saj vjen surja “Kijame”, në të cilën përqindja e pranisë së shkronjës *kaf*, në krahasim me shkronjat e tjera të sures arrin në 30/907%. Pastaj vjen surja “Shems” në të cilën përqindja e pranisë së shkronjës *kaf*, në krahasim me shkronjat e tjera të sures arrin në 30/906%.

Nga kjo vëmë re se diferenca mes sures “Kijame” dhe sures “Shems” është 0/001%.

Kështu e nxorëm përqindjen e pranisë së kësaj shkronje dhe të shkronjave të tjera të ndritshme në të 114 suret. Në këtë mënyrë u shfaq përqindja e të gjitha shkronjave te çdo sureje dhe përqindja e shkronjave të ndritshme në çdo sure.

Më poshtë po përmendim rezultatet muthijreh, në të cilin arriti studimi:

1- Përqindja e shkronjës *kaf* në suren “Kaf” është më shumë se përqindja e saj në suret e tjera. Kjo do të thotë se në ajetet e 114 sureve të Kur'anit, të zbritura për 23 vjet, përqindja e përdorimit të

shkronjës *kaf* në të gjitha ajetet është më i pakët. Kjo është e habitshme, që njeriu të jetë i aftë të kontrollojë numrin e të gjitha shkronjave që janë përdorur gjatë 23 vjetëve. Pa dyshim që kjo është jashtë mundësive të njeriut, jo vetëm kaq, por thjesht llogaritja e tyre është e vështirë për më të madhen mendje matematikore, nëse nuk mbështetet tek kompjuteri.

Kjo tregon se jo vetëm suret dhe ajetet e Kur'anit janë vendosur sipas një llogarie të caktuar, por edhe shkronjat janë të vendosura në llogari dhe sistem të veçantë, të cilën nuk mund ta bëjë vetëm All'illahu i Madhëruar.

Llogaritjet kanë treguar se edhe shkronja *sad*, në suren "Sad", ka po këtë karakteristikë të veçantë, që do të thotë se përqindja e pranisë së saj në këtë sure është më e madhe se në suret e tjera të Kur'anit.

Po ashtu edhe shkronja *nun*, në suren "Kalem", dallohet për përqindjen e saj të lartë në këtë sure, në krahasim me suret e tjera. Përrjashtimi i vetëm është në suren "Hixhr", në të cilën përqindja e pranisë së shkronjës *nun* është më e lartë se në suren "Kalem". Por ajo që tërheq vëmendjen është se surja "Hixhr" fillon me shkronjat *elif, lam, ra*.

2- Shkronjat *elif, lam, sad*, që ndodhen në fillim të sures "A'raf", nëse do të llogarisim numrin e tyre në këtë sure, do të gjejmë se ato janë më shumë se në çdo sure tjetër.

Po kështu edhe shkronjat *elif, lam, ra*, që ndodhen në fillim të sures "Rra'd", *kef, he, je, ajn, sad*, që ndodhen në fillim të sures "Merjem", nëse i numërojmë këto pesë shkronja në suren "Merjem", do të jenë më shumë se në suret e tjera.

Këtu përballemi me një dukuri të re: Jo vetëm një shkronjë hyn në llogaritje në një sure, por edhe shkronjat e tjera vijnë në këtë formë të habitshme.

3- Deri tani fjalët ishin për shkronjat që ndodhen në fillim të sureve të Kur'anit. Kurse shkronjat e përsëritura, si: *elif, lam, mim, dhe elif, Lam, ra*, që ndodhen në fillim të Kur'anit marrin formë tjetër. Llogaritjet kompjuterike paraqesin se të tri këto shkronja, p.sh. *elifi, lami, mijmi* nëse llogariten në të gjitha suret, të cilat fillojnë me këto tri shkronja, nxjerrin përqindjen e tyre në këto sure. Llogaritjet nxjerrin se përqindja e pranisë së tyre në suret që fillojnë me këto shkronja është më e madhe se në suret e tjera të Kur'anit.

Këtu, përsëri çështja merr drejtim të habitshëm, se jo vetëm shkronjat e një sureje i nënshtrohen llogaritjes, por edhe shkronjat e sureve të ngjashme i nënshtrohen po së njëjtës llogari.

Me këtë sqarohet se pse disa sure të ndryshme fillojnë me shkronjat *elif, lam, mijm* apo me *elif, lam, ra*. Kjo nuk është se ka ardhur vetvetiu.

Doktor Reshadi ka bërë llogaritje edhe më të vështira për suret që fillojnë me shkronjat *ha, mijm*, të cilat nuk po i përmendim.

Nëpërmjet studimit të tij, dr. Reshadi arriti në të vërteta, të tjera, që janë:

1- Duhet patjetër që Kur'ani të shkruhet ashtu siç ka zbritur.

Doktori thotë: “Duhet patjetër që diktimi i Kur'anit të bëhet si origjinali. P.sh. fjalën (إسحق) , *is'hak*, (زكوة), *zekat*, (صلوة), *salat*, t'i shkruajmë të tilla, dhe jo: (اسحاق) (زكاة) (صلاة) përndryshe llogaritjet do të dalin të gabuara.

2- Argumenti i mospranisë së falsifikimit.

Këto studime tregojnë se në Kur'an nuk gjendet asnjë fjalë e tepërt dhe as e mangët. Përndryshe nuk do të dukeshin këto llogaritje në këtë formë.

3- Treguese të kuptimit të thellë.

Në shumicën e sureve, që fillojnë me shkronja të veçuara, vëmë re se pas tyre tregohet për vërtetësinë dhe madhësinë e

Kur'anit, p.sh.: *elif, lām, mīm*. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim.”¹

Kjo në vetvete është tregues i mahnitshëm për lidhjen mes këtyre shkronjave dhe mrekullisë së Kur'anit.

Rezultati i hulumtimit

Nga ky hulumtim nxjerrim përfundim se shkronjat e Kur'anit, që iu shpallën profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për gjatë 23 vjetëve, janë të sistemuara me një llogaritje të saktë. Çdo shkronjë e alfabetit, së bashku me shkronjat e tjera të çdo sureje, ka përqindje aritmetike të hollësishme, saqë mendja e njeriut nuk është e aftë t'i sistemojë dhe t'i ruajë, me përjashtim të kompjuterit.

Pa dyshim që studimet e bëra nga dijetari i lartpërmendur janë në fillim të rrugës së tyre dhe mund të kenë edhe mangësi. Prandaj, të tjerët duhet të përpiqen për plotësimin sado pak të këtyre mangësive. Në ajetin e dytë, i Madhëruari, i Larti thotë: **“All'llahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përvetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje.”**

Këtë ajet e sqaruar në suren “El-Bekare”, ajeti 255.

Ajeti i mëpasshëm i flet profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: **“Vërtet, All'llahu ta zbriti ty Kur'anin, në të cilin ka argumente të drejta dhe përmban vërtetësinë. Ai është plotësisht në përshtatje me librat që iu shpallën profetëve të mëparshëm (Teurati dhe Ungjilli), të cilët lajmërojnë për ty. Po ashtu, All'llahu e zbriti atë (Kur'anin) udhëzues për njerëzit: “Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai i ka**

¹ Sure “E- Bekare”, ajeti 1,2.

zbritur Teuratin dhe Ungjillin, më parë si udhërrëfyes për njerëzit.”

Pastaj shton: **“...dhe ka zbritur edhe Dalluesin...”** e së vërtetës nga e pavërteta.

Pas plotësimit të argumentit me zbritjen e ajeteve të bekuara nga All'llahu i Madhëruar, me dëshminë e natyrës krijuese dhe të logjikës për vërtetësinë e thirrjes së të dërguarve të mëparshëm, kundërshtarëve nuk u mbetet gjë tjetër veçse ndëshkimi. Për këtë, ajeti në fjalë, pasi përmend vërtetësinë e Profecisë së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Kur'anit Fisnik, thotë: “Ata që nuk besojnë shpalljet e All'llahut, i pret dënim i ashpër.”

Me qëllim që askush të mos hamendësojë apo të dyshojë në fuqinë absolute të All'llahut për ekzekutimin e kërcënimeve të Tij, në fund ajeti thotë: **“All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim.”**¹

Fjala *azijzun* në gjuhësi ka kuptimin e *çdo gjëje të vështirë dhe e padepërtueshme, e pazbatueshme*. Për këtë edhe tokës së vështirë për kalim i thuhet *uzaz*. Po ashtu, i thuhet çdo gjëje të vështirë e të paarritshme për shkak të pakicës apo rrallësisë.

Gjithashtu, me këtë fjalë emërtohet edhe personi i fuqishëm, i cili është i pamundur të mposhtet. Sa herë që kjo fjalë përdoret për All'llahun, vjen me këtë kuptim, që do të thotë se askush dhe asgjë nuk e mposht Atë dhe të gjitha krijesat janë të nënshtruara ndaj dëshirës dhe fuqisë së Tij.

¹ Disa komentues kanë përmendur se fjala *dbu*, që ndodhet në fund të ajetit, ka kuptim më të fortë se fjala *sabib*. Prandaj, fjalën *sabib* nuk e gjejmë te cilësitë (emrat) e All'llahut, por gjithmonë përdoret fjala *dbu*. Tefsijri “Bahrul Muhijj”, vëll. 2, f. 379.

Fjalia e mëparshme, për t'ua bërë të qartë se kërcënimi është i vërtetë, ky ajet u thotë se All'llahu është i Plotfuqishëm, i Pamposhtur dhe se askush nuk mund të qëndrojë përballë kërcënimit të Tij. Në të njëjtën kohë Ai është Falës dhe i Gjithëmëshirshëm dhe Dënues i ashpër për atë që nuk e meriton mëshirën.

Fjala *el intikam*, në kuptimin tonë të sotëm, përdoret për atë njeri që *nuk fal të tjerët dhe nuk ia pranon gabimin*. Ai është i ashpër deri edhe interesin e tij nuk e merr në konsideratë. Natyrisht që kjo cilësi është e keqe. Mirëpo, fjala *intikam* në gjuhësi nuk ka këtë kuptim, por ajo do të thotë *dhënia e dënimit për kriminelin*. S'ka dyshim se dënimi i kriminelëve mëkatarë është prej punëve të mira. Por, ky dënim nuk duhet neglizhuar e as nuk duhet harruar se ai përbën anën e drejtësisë e të urtësisë.

Këtu duhet përmendur një vëzhgim:

1- Baza e fjalës *el hake* është *përshtatshmëria* dhe *miratimi*. Për këtë i thuhet diçkaje kur përshtatet me realitetin. *El haku* - e vërtetë, e drejtë. Po ashtu, cilësimi i All'llahut me fjalën El Hak, buron nga qenia e Vetës së Tij të Shenjtë, e vërteta më e madhe që nuk mohohet. Me fjalë të tjera *el haku* është temë konstante, në të cilën nuk ka kotësi. Shkronja *ba*, që ndodhet para fjalës *el haku*, në këtë ajet ka kuptimin e *shoqërimit*, që do të thotë: “O i Dërguar, vërtet All'llahu ta zbriti ty Kur'anin, të shoqëruar me argumente të vërteta dhe të drejta.”

2- *Teurat* është shprehje hebranishtje që do të thotë *sheriat* dhe *ligj*.¹

Me këtë emër është quajtur Libri që All'llahu ia zbriti Musait, të birit të Imranit (*Paqja e All'llahut goftë mbi të!*).

Teurati përbëhet prej pesë pjesësh. Çdo pjesë quhet *seferen*, që janë: “Seferu Tekvijn”, “Seferul Khuruxh”, Seferul Lavij”, “Seferul idaad” dhe “Seferu Tethnijeh”. Këto pjesë të Dhjatës së Vjetër

¹ Tefsijrul “Mijzan”, vëll. 3, f. 9.

sqarojnë formimin e botës, të njeriut, të krijesave të tjera, disa tregime të profetëve të shkuar, të Musa ibn Imran, të bijve të Izraelit etj.

Ndërsa librat e tjerë janë ato që kanë shkruar historianët pas Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), që sqarojnë gjendjen e profetëve, mbretërve dhe të popujve që erdhën pas Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Është e natyrshme se këto libra, përveç pesë esfareve, nuk janë libra qiellorë. Edhe vetë jahuditët nuk e thonë këtë. Edhe “Zeburi” i Daudit, që e quajnë “El Mezamiyr” sqaron lutjet dhe përgjërimet e Daudit, si dhe porositë e tij.

Për pesë esfalet ka argumente që tregojnë se ato nuk janë libra qiellorë, por janë libra historie, që u shkruan pas profetit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), sepse në to shpjegohet vdekja e hazretit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ceremonia e varrimit të tij dhe disa ngjarje që ndodhën pas tij, veçanërisht në kapitullin e pestë të “Seferu Tethnijeh”, i cili konstaton se ai është shkruar pas vdekjes së hazretit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Në këto libra ka shumë paganizma dhe i veshin gjëra të shëmtuara profetëve.

Në to gjenden disa fjalë fëmijësh, që vërtetojnë falsifikimin e këtyre librave. Po ashtu, ka dëshmi që tregojnë se Teurati origjinal ka humbur dhe pasuesit e hazretit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i shkruan këto libra pas tij.¹

3- Ungjilli (Bibla) është fjalë greke dhe ka kuptimin *el besharatu - përgëzjim* ose *et ta'lijmul xhedijd-mësim i ri*.² Me këtë emër quhet edhe libri që iu shpall Isait, të birit të Merjemes (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ata të dy!*).

Duhet përmendur se sa herë që Kur'ani përmend emrin e librit të Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e përmend në njëjës dhe se ai ka

¹ Shiko librin “El Huda ila Dijnul Mustafa” dhe librin “Er Rihletul Medresijeh.”

² Tefsijrul “Mijzan”, vëll. 3, f. 9.

zbritur nga All'llahu. Për këtë, Ungjilli (Bibla), që gjendet sot në duart e të krishterëve dhe më të njohurit që janë katër: "Inxhijli Luka, Murkus, Meta dhe Juhana", nuk janë shpallje hyjnore. Këtë nuk e mohojnë as vetë të krishterët, që thonë se këto "bibla" janë shkruar nga duart e nxënësve të Sejjidu Mesijhut (Isait) (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*). Të krishterët pretendojnë se nxënësit i shkruan ato me frymëzim nga All'llahu.

Është mirë, qoftë edhe shkurtimisht, të njihemi me Dhjatën e Re dhe me katër Ungjillët dhe shkruesit e tyre.

Libri më i rëndësishëm të krishterët, për të cilin thonë se është libër qiellor, është Dhjata e Re.

Ai përmban dy të tretat e Dhjatës së Vjetër. Ai përbëhet prej 27 librash dhe porosish, që përfshijnë tematika të përgjithshme e të ndryshme, si vijon:

1- Inxhijli Meta:¹ Ky është inxhijli i shkruar nga një prej 12 apostujve të hazretit Isa, me emrin Meta. Ai është shkruar në vitin 38 Gregorian. Disa thonë në vitin 50 ose 60 Gregorian.²

2- Inxhijli Markus: Sipas thënies në "Kamusul mukades", faqe 792, Murkus nuk ka qenë prej apostujve, mirëpo ai e shkroi inxhijlin nën mbikëqyrjen e Butrusit. Murkusi u vra në vitin 68 Gregorian.

3- Inxhijli Luka: Luka ka qenë shoqëruar i Bulus resul. Në kohën e hazretit Isa, Bulus ka qenë jahudi fanatik. Pastaj përqafoi Krishterimin. Thuhet se ka vdekur në vitin 70 Gregorian. Autori i librit "Kamusul Mukades", në faqen 772, thotë: "Historia e shkrimit të inxhijlit të Lukës është afërsisht në vitin 63."

¹ Metta është në vaznin *batta*. Ai ka kuptimin e *a'taullab* - dhënia e All'llabut.

² "El Kamusul mukades", f. 782.

4- Inxhijlu Juhana: Juhanna ka qenë prej nxënësve të hazretit Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) dhe prej shokëve të Bulusit. Autori i librit “Kamusul Mukades”, mbështetur në thëniet e disa studiuesve, thotë se ky inxhijl është shkruar në fundin e shekullit të parë Gregorian.¹

5- Nga përmbajtja e këtyre “Ungjillëve”, të cilat flasin për kryqëzimin e Mesihut dhe çfarë ndodhi pas këtij veprimi, sqarohet se janë shkruar disa vite pas hazretit Isa dhe ato nuk janë libra qiellorë të shpallur prej Mesihut (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*).

6- Veprat e rusulve: Veprat e apostujve dhe thirrësit e parë.

7- Katërmbëdhjetë letrat e Bulusit: Në vende të ndryshme.

8- Mesazhi Ja'kub: “Risaleti i njëzetë prej njëzeteshtatë risaleve të Dhjata e Re.

9- Mesazhi i Butrusit: Dy mesazhet 21 dhe 22 prej Dhjata e Re.

10- Mesazhet e Juhan: Mesazhet 23, 24, 25 prej Dhjata e Re.

11- Mukashefetu juhana: Pjesa e fundit e Dhjatës së Re.

Sipas thënieve të historianëve të krishterë dhe dëshmive të këtyre “Ungjillëve”, librave dhe mesazheve të Dhjatës së Re, asnjë nga këta nuk është libër qiellor, por janë libra të shkruar pas hazretit Isa (Jezu Krishtit) (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*). nisur nga kjo, mund të themi se Ungjilli origjinal, i zbritur hazretit Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*), ka humbur dhe nuk ekziston. Nxënësit e tij shkruan prej tij disa prej ungjilleve, që për fat të keq, i përzjenë ato me paganizma.

Në xhuzin e parë e sqaruam këtë në komentimin e ajetit: **“Besoni në atë (Kur'an) që kam zbritur si vërtetues të Shkrimeve Tuaja.”**²

4- Pas përmendjes së Teuratit dhe Ungjillit, ajeti tregon për zbritjen e Kur'anit, mirëpo ai e quajti *el Furkan*. Shprehja *el Furkan*, përdoret në dallimin, ndarjen e së vërtetës nga e pavërteta. Këtë

¹ “El Kamusul mukaddes”, f. 966.

² Sure “El-Bekare”, ajeti 41.

Kur'ani e quan luftën e Bedrit *jeumul furkan*¹, dita e dallimit, ndarjes. Në atë ditë triumfoi grupi i vogël, të cilit i mungonin llojet e pajisjeve luftarake mbi ushtrinë e madhe e të armatosur dhe e nivelit të lartë.

Po ashtu, mrekullia e dhjetë e hazretit Musa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) është quajtur me emrin *el furkan*: **“Kujtoni kur Musait i dhamë Librin dhe Dalluesin që të udhëzoheni.”**²



¹ Sure “Enfal”, ajeti 41.

² Sure “EL-Bekare”, ajeti 53.

Ajetet 5 - 6

إِنَّ اللَّهَ لَا تَخْفَىٰ عَلَيْهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ ﴿٥﴾ هُوَ الَّذِي
يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ ۚ لَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٦﴾

“Pa dyshim, All’llahut nuk i fshihet asgjë në Tokë dhe as në qiell! Ai ju formon në mitër, ashtu siç dëshiron Vetë; s’ka zot tjetër që meriton të adhurohet, përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit!”

Komentimi

Dija dhe fuqia absolute e All’llahut

Këto dy ajete plotësojnë ajetet e mëparshme, në të cilat lexuam se All’llahu është i gjallë, Mbajtës i gjithçkaje dhe sistemues i mbarë gjithësisë. Ai do t’i dënojë mohuesit dhe kryeneçët (edhe nëse nuk e shfaqin mohimin dhe kokëfortësinë e tyre).

Është e natyrshme se kjo mbikqyrje dhe kjo forcë në sistemimin e gjithësisë ka nevojë për dije të pakufishme dhe për fuqi absolute. Ajeti i parë tregon për dijen e All’llahut dhe ajeti i dytë flet për fuqinë e Tij absolute.

Në fillim ajeti i bekuar thotë: **“Pa dyshim, All’llahut nuk i fshihet asgjë në Tokë dhe as në qiell!”**

Si mund t’i fshihet Atij diçka, ndërkohë që Ai është i pranishëm dhe mbikëqyrës në çdo vend?! Përderisa prania e tij është e pakufizuar, Ai është i Pranishëm në çdo vend. Për këtë All’llahu është më afër nesh se çdo gjë tjetër, deri edhe më afër se vetë vetja jonë. Meqenëse Ai nuk ka as vend e as kohë, Ai është Mbikëqyrës i gjithçkaje dhe kjo mbikëqyrje dhe prani e All’llahut përfshin gjithçka.

Ajeti i dytë sqaron një prej vërtetësive së dijes dhe fuqisë së All’llahut. Në të vërtetë, ajo është një prej mrekullive të botës së krijimit dhe shfaqje e qartë e dijes dhe e fuqisë absolute të All’llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: **“Ai ju formon në mitër, ashtu siç dëshiron Vetë.”** Pastaj shton: **“...s’ka Zot tjetër që meriton të adhurohet, përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit!”**

Vërtet, formimi i njeriut nga All’llahu në mitrën e nënës është diçka e mrekullueshme dhe e mahnitshme. Në këtë formim gjenden forma, dhuntia, cilësitë, instinktet dhe dëshirat.

Ky ajet dëshmon se i Adhuruari i vetëm e i vërtetë është All’llahu i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Vallë, përse zgjedhin krijesa si Jezu Krishti (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe i adhurojnë? Ka mundësi që kjo shprehje të tregojë për shkakun e zbritjes që u përmend në fillim të sures, në të cilin thuhej se vetë të krishterët e pranojnë që Jezu Krishti ka qenë foshnje në barkun e nënës së tij, pastaj ajo e lindi atë. Prandaj, ai është krijesë dhe jo krijues. Atëherë si mund të adhurohet?!

Dy hulumtime

1- Fazat e formimit të foshnjës janë prej mrekullive të krijimit. Kuptimi madhështor i këtij ajeti është sqaruar më së miri në ditët e sotme se sa më parë, për shkak të përparimit të madh të shkencës në fushën embrionit. Foshnja fillon me qelizën, e cila nuk ka as formë e as skelet, as gjymtyrë e as organe të tjera.

Mirëpo, për çdo ditë ajo merr formë të ndryshme në mitër, ku duket se ndodhet një grup talentesh, që punojnë natë e ditë, me shpejtësi të habitshme, për të formuar nga kjo grimcë e vogël njeriun e plotë nga paraqitja e jashtme dhe në brendinë e tij, aparatura delikate, të habitshme, të sakta dhe hutuese.

Sikur të filmoheshin fazat e zhvillimit të foshnjës në mitër, që në të vërtetë janë filmuar, do të duket shumë qartë Madhështia dhe Fuqia e Krijuesit.

E habitshme është se i gjithë ky vizatim (pikturim) bëhet mbi ujë, për të cilin thuhet edhe proverbi “Si vizatimi mbi ujë”, pra, uji nuk e ruan vizatimin, pikturimin.

Është për t'u përmendur se, kur ndodh pllenimi, së pari, me shpejtësi fillon ndarja dhe formohet foshnja, duke marrë formën e kokrrës së manit. Kokrrizat e saj janë të bashkuara, e cila quhet Murula. Brenda këtij zhvillimi formohet kërthiza - *el meshjmeb* dhe lidhet nga njëra anë me zemrën e nënës nëpërmjet damarëve dhe një vene dhe nga ana tjetër lidhet me kërthizën e foshnjës, që ushqehet me gjakun që vjen nga placenta (qesja ku rri foshnja).

Shkallë – shkallë, si rrjedhim i të ushqyerit, i zhvillimit dhe i drejtimit të qelizave për nga jashtë, e brendshmja murule thahet dhe pastaj quhet blastula. Kjo qëndron derisa shtohen qelizat e saj në formë qeseje me dy mure. Më pas foshnja ndahet në dy pjesë, gjoksi dhe barku.

Deri këtu të gjitha qelizat janë të ngjashme në pamje të jashtme. Por pas kësaj faze, foshnja fillon të formohet. Formohen pjesët e ndryshme sipas detyrave në të ardhmen. Formohen indet qelizore dhe aparaturat. Çdo grup qelizash fillon ndërtimin e një sistemi të trupit dhe e ruan atë, si: sistemi nervor, i qarkullimit të gjakut, i tretjes etj. Pas këtyre fazave, foshnja bëhet njeri i plotë, i fshehur në mitrën e nënës së tij.

Hulumtimin e kësaj çështjeje do ta paraqesim në mënyrë të detajuar në komentimin e ajetit 12 të sures “El Mu’minun”.

2- Fjala *el erham* është shumësi i fjalës *rahm*, që në origjinal ka kuptimin e zhvillimit të foshnjës në mitrën e nënës. Pastaj është përdorur për të gjithë të afërmit që kanë një nënë të përbashkët dhe kanë lindur prej një nëne. Meqenëse ka një gjendje dashurie dhe butësie që i lidh mes tyre, kjo fjalë përdoret për çdo dashuri dhe mëshirë (rahmetun). Disa kanë mendimin se kjo fjalë ka kuptimin e dobësisë së zemrës, të dashurisë dhe butësisë. Mirëpo, përderisa të afërmit janë të përbashkët në këtë cilësi mes tyre, me këtë fjalë është quajtur vendi nga i cili kanë lindur (rahm), mitra.

Ajeti 7

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخْرُ
مُتَشَبِهَاتٌ فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَبَهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ
الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ ۗ وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ ۗ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ
يَقُولُونَ ءَأَمَّنَّا بِهِ ۗ كُلٌّ مِّنْ عِنْدِ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٧﴾

“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhammed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All’llahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: “Ne i besojmë (Kur’anit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsirjin “Nuru Thakalejn”¹, marrë nga libri “Meanij Akhbar” përmendet hadithi i ardhur nga imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) përmbajtja e të cilit është se: “Disa jahudij, me të cilët ishte edhe Hajjun ibn Akhtab dhe vëllai i tij, shkuan tek profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe polemizuan rreth shkronjave të veçuara *elif, lam, mijm* që gjenden në Kur’an.

Ata thanë: “Sipas llogaritjeve të shkronjave të alfabetit shkronja *elif* është e barabartë me një (1), shkronja *lam* është e barabartë me 30 dhe shkronja *mijm* është e barabartë me (40). Kështu që ymmeti yt nuk do të qëndrojë më shumë se 71 vjet.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për t’i frenuar i pyeti ata: **“Përse llogaritët vetëm shkronjat *elif, lam, mijm*? A nuk e keni parë se në Kur’an ndodhet edhe *elif, lam, mijm, sad, dhe elif, lam, ra* e të tjera fjalë të veçuara? Në qoftë se këto shkronja tregojnë për kohën e qëndrimit të ymmetit tim, përse nuk i llogaritët të gjitha?”** (Dihet se qëllimi i këtyre shkronjave është diçka tjetër). Atëherë zbriti ajeti në fjalë.²

Në tefsirjin “Fi dhilalil Kur’an” përmendet shkak tjetër, i cili i bashkohet shkakut të lartpërmendur në konkluzion. Në të thuhet: “Një grup prej të krishterëve të Nexhranit shkuan tek profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të diskutuar për hazretin Isa duke përdorur fjalën e Kur’anit *kelimatullabi ue ruhuhu - fjala e All’llahut dhe shpirti i Tij*.

Këtë frazë, ata përpiqeshin ta përdornin për të konstatuar çështjen e trinisë dhe të hyjnisë së Mesijhut (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe hiqeshin si të paditur për ajetet e tjera, që thonë qartë se nuk gjendet shok e as i ngjashëm me All’llahun. Atëherë zbriti ajeti i lartpërmendur.”³

¹ Tefsiri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 313.

² Tefsirjull “Mijzan”, vëll. 18, f. 12, 13.

³ Tefsirji “Fi Dhilalil Kur’an”, vëll. 1, f. 542.

Komentimi

Muhkemi dhe muteshabihu në Kur'an

Në ajetet e mëparshme u fol për zbritjen e Kur'anit, duke e konsideruar atë si një nga argumentet e qarta dhe nga mrekullitë sqaruese të profecisë së tij. Në këtë ajet përmendet një prej të veçantave të Kur'anit dhe mënyra e sqarimit se ky Libër madhështor është qiellor. Në fillim ajeti thotë: **“Është Ai që të ka shpallur ty Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë.”**

Pra, janë ajete të qarta e të prera dhe konsiderohen si baza dhe themeli i këtij Libri qiellor: **“Ato janë themelet e Librit.”**

Pastaj thotë se ka edhe ajete të tjera, kuptimi i të cilave nuk është plotësisht i qartë, për shkak të kuptimit të lartë e të thellë apo për shkaqe të tjera. **“Të gjitha këto** (vargje të qarta e alegorike).

Këto ajete janë përmendur për të sprovuar dijetarët e vërtetë e të drejtë dhe t'i dallojë ata nga njerëzit kokëfortë që dëshirojnë përçarje. Për këtë ajeti thotë: **“Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim (përçarje) dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet.”**

Ata i komentojnë këto ajete sipas dëshirës së tyre, me qëllim që t'i largojnë njerëzit dhe t'i errësojnë ata. **“Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta¹, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All'illahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni...”**

¹ Fjala *zejgun* ka kuptimin e devijimit nga rruga e drejtë dhe prirja në anë tjetër. Zejgu në zemër ka kuptimin e devijimit në besim dhe nga rruga e drejtë.

Më pas ajeti thotë, se të thelluarit në dije, për shkak të kuptimit të tyre të drejtë si për ajetet me domethënie të drejtpërdrejtë, ashtu edhe të tërthortë: **“Ne i besojmë (Kur’anit). Të gjitha këto janë nga Zoti ynë!”**

Është e vërtetë se: **“Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”**



Hulumtime

1- Çfarë janë ajete muhkemeh dhe ato muteshabiha?

Fjala *el muhkem* vjen nga fjala *el abkam*, që do të thotë *men'un-pengim, ndalim*. Për këtë, temat konstante dhe të forta quhen *muhkemeh*. Ato ia ndalojnë vetes faktorët e zhdukjes. Po ashtu, çdo fjalë e qartë, e saktë, që nuk supozohet në të asnjë ndryshim, i thuhet *kaulun muhkem-thënie e fortë*.

Sipas kësaj, ajetet muhkemeh janë ato ajete që kanë kuptime të qarta, nuk gjendet vend për debat dhe mendim i ndershëm për to, siç është ajeti **Kul huall'Allahu ehad¹ - Thuaj All'Allahu është Një, i Vetëm, Lejse ke mithlihi shej'un² - Nuk i përngjan asgjëje; All'Allahu khaliku kul'li shej'in³ - All'Allahu është Krijuesi i gjithçkaje dhe Lidhekkeri hadhdhul unthejjejni - për mashkullin sa dy pjesë të dy femrave**, e me mijëra ajete të ngjashme si këto që flasin për besimin, rregullat, këshillën, porosinë, historinë. Të gjitha këto janë muhkemeh.

Këto ajete në Kur'an quhen *ummul kitab - themeli, baza e librit*, që do të thotë se ato janë burimi, konsultimi, sqarimi dhe komentimi i ajeteve të tjera.

Fjala *muteshabih* do të thotë *ngjashmëri e pjesëve të ndryshme*. Për këtë, fjalët dhe fjalitë që kanë kuptim të vështirë dhe përmbajnë alternativa të ndryshme, cilësohen se janë *muteshabihe*. Ky është edhe qëllimi i cilësimit të disa ajeteve të Kur'anit si *muteshabihat*, që do të thotë se në pamje të parë kuptimi i atyre ajeteve duket i vështirë dhe

¹ Sure "Ikhlas", ajeti 1.

² Sure "Shura", ajeti 11.

³ Sure "Ez-Zumer", ajeti 62, sure "En'am", ajeti 102, sure "Er-Rra'd", ajeti 16, sure "Gafir", ajeti 62.

ka alternativa të ndryshme, por kuptimi i tyre sqarohet kur i ballafaqojmë me ajete të tjera *mubkemameh*.

Edhe pse komentuesit kanë përmendur mendime të ndryshme për komentimin e *mubkem* dhe *muteshabih*¹, ajo që përmendëm, i përshtatet më tepër kuptimit origjinal të këtyre dy termave, po ashtu përputhet edhe me shkakun e zbritjes së ajetit. Gjithashtu, thënia është në përputhje si me hadithet e përcjella për tefsijrin (komentimin) e këtij ajeti, ashtu edhe me vetë ajetin, sepse në ajet lexojmë se ata, që nuk e duan të vërtetën, i përdorin ajetet muteshabiheh si mjet përçarjeje. Natyrisht, për këtë qëllim ata kërkojnë për të gjetur ajete që kanë komentime të ndryshme.

Si shembull rreth ajeteve *muteshabibe* po përmendim disa ajete, që janë të posaçme me cilësitë e All'llahut dhe të Ringjalljes. **Jedullahi feuka ejdihim**² - *ka kuptimin e fuqisë*; **uall'llahu semi'un alijm**³ - *flet për dijen e All'llabut*; **ue nedau el meuazijnel kisti li jeumil kijameti**⁴ - *flet për mënyrën e llogaritjes së punëve*.

Natyrisht që All'llahu nuk as ka “dorë” e as “veshë” si këto që kemi ne. Gjithashtu, nuk ka peshore si peshoret që përdorim ne. Të gjitha këto janë metafora për të kuptuar fuqinë e Tij të plotë dhe dijen e Tij.

Duhet përmendur patjetër se dy fjalët *el mubkem* dhe *el muteshabih* gjenden në Kur'an me kuptim tjetër, në ajetin e parë të sures “Hud” lexojmë: **“Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë radhitur mrekullueshëm dhe janë parashtruar me hollësi...”**,

¹ Tabarsiju në tefsijrin “Mexhmaul Bejan” përmend pesë komentime për këtë çështje. Fahu Raziu në tefsijrin “El Kebijr” përmend katër komentime, thëniet e eruditit Tabatabai në tefsijrin “El Mijzan” arrijnë në gjashtëmbëdhjetë, në tefsijrin “El Bahrul muhij” përmenden njëzet thënie të afërta në komentim.

² Sure “Fet’h”, ajeti 10.

³ Sure “El-Bekare”, ajeti 224.

⁴ Sure “Enbija”, ajeti 48.

këtu flitet për të gjitha ajetet muhkemat të Kur'anit. Kuptimi është për lidhjen e fortë mes tyre.

Kurse në ajetin 23 të sures “Ez-Zumer” lexojmë: **“All’llahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur’anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten...”**, që do të thotë se është Libër, ajetet e të cilit janë të ngjashme.

Nga ajo që përmendëm, sqarohet se njeriu real dhe hulumtues i së vërtetës duhet që t’i kuptojë mirë fjalët e All’llahut dhe ajetet t’i vendosë pranë njëra-tjetrës dhe të nxjerrë prej tyre të vërtetën. Nëse vëren nga pamja e jashtme e ajeteve ndonjë paqartësi apo vështirësi, ai duhet të kthehet dhe të shohë ajetet e tjera për heqjen e paqartësisë e të vështirësisë dhe të arrijë në domethënie të vërtetë të ajeteve.

Ajetet muhkemeh mund të konsiderohen si rruga kryesore dhe ato muteshabihe si rrugë dytësore. Kur njeriu humbet në rrugën dytësore, ai përpiqet të arrijë në rrugën kryesore, me qëllim që ta njohë rrugën e drejtë që do të përshkojë.

Konsiderimi i ajeteve muhkemeh se janë *ummul kitab - baza, themeli i librit*, e përforcon këtë të vërtetë, sepse fjala *ummu*, në origjinal, ka kuptimin e *bazës, themelit*. Përdorimi i saj për figurën e nënës (ummun) bëhet për faktin se nëna është baza e familjes dhe strehim për fëmijët e saj kur frikësohen dhe duan të zgjidhin problemet e tyre. Prandaj, muhkematet janë themeli, baza dhe nëna për ajetet e tjera.

2- Përse ka ajete muteshabiha në Kur’an?

Vërtet, Kur’ani është dritë për udhëzimin e njerëzve. Atëherë, cili është shkaku që ai përmban edhe ajete muteshabiha, të cilat janë të paqarta dhe të vështira për t’u kuptuar? Këtë kanë shfrytëzuar të padrejtët për të mbjellë përçarje në popull.

Kjo temë është shumë e rëndësishme dhe ka nevojë për hulumtim të hollësishëm.

Në përgjithësi, katër pikat e mëposhtme mund të jenë sekreti i pranisë së ajeteve muteshabihe në Kur'an:

Pika e parë: Fjalët dhe shprehjet që përdor njeriu në biseda janë për të plotësuar nevojën e tij të përditshme për të bashkëpunuar me të tjerët. Mirëpo, nëse dalim jashtë rrethit material të jetës dhe jashtë kufirit të materiales, p.sh të bisedojmë për Krijuesin, i cili nuk ka as vend e as kohë, atëherë do të shohim se fjalët dhe shprehjet e përditshme nuk i përmbajnë këto kuptime. Për këtë do të detyrohemi të përdorim fjalë dhe shprehje të tjera, edhe pse mund të jenë të paafta për plotësimin e qëllimit. Kjo paaftësi, në vetë shprehitë dhe fjalët, është edhe burim i muteshabihateve të Kur'anit. Ajetet: **“Jedullahi feuka ejdihim”**¹, **“Err Rrahmanu alal arshi isteua”**² dhe **“Ila rabbiha nadhireh”**³, të cilat do t'i komentojmë në vendet që ndodhen, konsiderohen shembull i muteshabihateve. Po ashtu, ka edhe fjalë dhe shprehje të tjera në Kur'an, si: *semi'un*, *basijrun*. Kthimi tek ajetet muhkemeh mund ta sqarojë qartë kuptimin e tyre.

Pika e dytë: Shumë të vërteta janë të posaçme për Botën Tjetër ose për metafizikën, që janë të largëta për mendimet tona. Përderisa prania jonë është e kufizuar nga vendi dhe koha, nuk jemi të aftë të perceptojmë të vërtetën e tyre të thellë. Kjo për arsye se, nga njëra anë, horizonti i mendimit tonë është i kufizuar dhe, nga ana tjetër, është shkaku i muteshabihuhut të disa ajeteve, siç janë ato që flasin për Ditën e Kiametit.

Kjo është e ngjashme me atë që kërkon të shpjegojë foshnjën në barkun e nënës së tij, që është prej çështjeve të kësaj bote, ndërkohë që nuk e ka parë atë. Nëse nuk thotë asgjë për atë, do të jetë

¹ Sure “Fet’h”, ajeti 10

² Sue “Taha”, ajeti 5.

³ Sure “Kijameh”, ajeti 23.

i paditur. Dhe, nëse do të flasë, ai duhet të flasë me metodën e përputhur me kuptimin e tij.

Pika e tretë: Prej sekreteve të pranisë së muteshabihateve në Kur'an është se ato ndikojnë në lëvizshmërinë e të menduarit e të arsyetuarit dhe në gjetjen e nivelit mendues në mesin e njerëzve. Kjo është e ngjashme me çështjet e vështira logjike, të cilat i zgjidhin dijetarët për forcimin e mendimeve të tyre dhe për thellimin e përqendrimit në çdo çështje.

Pika e katërt: Janë edhe hadithet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët thonë se prania e këtyre ajeteve në Kur'an nxit përvojën e njerëzve që kanë për një udhëheqës të drejtë nga ana e All'llahut, si Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pasardhësit e tij. Këto ajete janë shkak që njerëzit të kërkojnë për ta dhe të pohojnë udhëheqjen e tyre praktike, duke përfituar nga dijet e tyre. Kjo i përngjan librave shkollorë, temat e të cilave kanë nevojë për shpjegimin e mësuesit, me qëllim që marrëdhëniet e mësuesit me nxënësit të mos shpëputen, por të vazhdojnë për të përfituar më shumë prej dijeve të mësuesit. Kjo është vërtetësi e porosisë së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): ***“Unë po ju lë juve dy gjëra të rënda: Librin e All'llahut dhe Ehli Bejtin tim. Ato nuk ndahen kurrë nga njëri-tjetri derisa të vijnë tek unë në burimin e Keutherit.”***¹

3- Ç'është te'uili?

Ka shumë thënie për fjalën *te'uil*. Më e afërt tek e vërteta është se *te'uili* vjen nga *el eul*, që do të thotë *kbhim*. Pra, çuarja e fjalës apo e punës në rezultatin final e të qëllimshëm. Nëse dikush do të bëjë diçka, mirëpo dija e tij rreth kësaj pune nuk është e qartë dhe i

¹ “Mustedreul Hakim”, vëll. 3, f. 148. “Uesailu Shiah”, vëll. 27, f. 34.

sqarohet në fund, ky është *te'uil*, siç lexojmë në historinë e hazretit Musa (*Paqja e All'labut qoftë mbi të!*) me plakun e urtë, që bënte punë me qëllim të pakuptueshëm, siç ishte “prishja e anijes”, e cila e mërziti Musain. Por, kur i urti, në kohën që do të ndaheshin, ia shpjegoi qëllimin e asaj pune, duke i thënë se e shkatërroi anijen që të mos binte në dorën e të padrejtut, e përfundoi shpjegimin me thënien: **“Ky është shpjegimi i asaj, për të cilën ti s'munde të duroje!”**¹

Po ashtu, kur njeriu shikon një ëndërr dhe nuk e ka të qartë përfundimin e saj, e pastaj me anë të sqaruesit apo të shikimit të ndodhisë i bëhet e qartë, atij i thuhet *te'uili* i ëndrrës. Njësoj si hazreti Jusuf (*Paqja e All'labut qoftë mbi të!*), i cili, kur ëndrra arriti rezultatin e saj dhe u vërtetua, tha: **“O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme.”**²

Gjithashtu, kur njeriu bisedon me fjalë që kanë kuptime dhe sekrete të veçanta, që përbëjnë qëllimin e fundit të asaj bisede, ai është *te'uil*.

Ky është edhe kuptimi i *te'uilit* në ajet. Në Kur'an ka ajete që përmbajnë sekrete dhe kuptim të thellë. Mirëpo të devijuarit dhe qëllimkeqtë i komentojnë këto ajete pa asnjë bazë rregullsie dhe mbështeten në to për të mashtruar veten e tyre dhe të tjerët.

Sipas kësaj, kuptimi i frazës: **“dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet.”** është se ata devijues i komentojnë këto ajete sipas qejfit të tyre, kundër së vërtetës.

Në shkakun e zbritjes lexuam se jahudijtë i shpjeguan shkronjat e veçanta duke u larguar nga e vërteta. Ata thanë se këto shkronja caktojnë jetëgjatësinë e Islamit. Po ashtu, të krishterët e shpjeguan gabim thënien *ruhun minhu-shpirt prej Tij*, për të konstatuar hyjninë e Mesijhut (*Paqja e All'labut qoftë mbi të!*).

¹ Sure “Kehf”, ajeti 82.

² Sure “Jusuf”, ajeti 100.

Të gjitha këto janë prej “shpjegimit të kundërt me të vërtetën” dhe të gjitha ishin shpjegime larg së vërtetës.

4- Kush janë të thelluarit në dije?

Kjo shprehje kur'anore përmendet në dy vende. Njëra në këtë sure dhe në suren “En-Nisa”, ku thuhet: **“Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre (hebrejve) dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed) dhe në atë që është shpallur para teje.”**¹

Sipas kuptimit gjuhësor të fjalës *rasikbune*, janë të palëkundurit në dije dhe njohje.

Është e natyrshme që fjala të ketë kuptim të gjerë dhe përfshin të gjithë dijetarët dhe mendimtarët. Mirëpo në mesin e tyre ka njerëz të dalluar dhe me pozitë të veçantë, që zënë kreun e vërtetësisë së *rasikbinëve*.

Në disa hadithe thuhet se ata janë profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Berijd ibn Muavijeh transmeton: “I thashë Ebi Xha'ferit, (imam Bakir) (*Paqja qoftë mbi të!*): “Cili është kuptimi i thënies së All'llahut: **“Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All'llahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni...”?**

Ai më tha: “Shpjegimin e gjithë Kur'anit e di vetëm All'llahu dhe të thelluarit në dije. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është më i larti i tyre. Vërtet, All'llahu ia mësoi atij të gjitha ato që ia shpalli, tenzijlin (shpalljen) dhe te'uilin. Sa herë që

¹ Sure “En-Nisa”, ajeti 162.

All'llahu i shpallte diçka, ia mësonde te'uilin atij. Pas tij janë eusaijatë (Ehli Bejtë) ata që e dinë domethënien e gjithë Kur'anit.”¹

Në librin “Usulul Kafij”² dhe në libra të tjerë ndodhen hadithe të shumta, që flasin për këtë temë, të cilat i ka mbledhur autori i tefsijrit “Nuru Thakalejn” dhe autori i tefsijrit “El Burhan” në fundin e ajetit në fjalë. Siç e thamë, rasikhunët në dije janë Profeti (*Pagja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët e drejtë. Kjo thënie nuk bie në kundërshtim me kuptimin e gjerë të kësaj fjale.

Ibn Abbasi ka transmetuar: “Edhe unë jam prej të thelluarve në dije.”³

Çdo njeri, sipas aftësive të tij në dije, arrin të njihet me sekretet e te'uilit të ajeteve të Kur'anit. Pa dyshim, ata, që e kanë dijen nga dija e pakufishme e All'llahut, janë më të njohur me sekretet e te'uilit të Kur'anit, ndërsa të tjerët mësojnë një pjesë të atyre sekreteve.

5- Të thelluarit në dije e njohin kuptimin e muteshabihateve

Mes komentuesve dhe dijetarëve gjendet një diskutim i rëndësishëm rreth fjalisë: **“Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni.”** Vallë, ajo është fillim i fjalisë së pavarur apo është e lidhur me thënien: **“Vetëm All'llahu.”** Me fjalë të tjera, kuptimi i ajetit është: **“Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All'llahu dhe ata që janë thelluar në dijeni”** apo ka kuptimin: **“Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All'llahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni...”?**

Çdo grup ka argumentet dhe faktet e tij. Kurse argumentet që gjenden në ajet dhe në hadithet e njohura, që janë në përputhje me

¹ Tefsijru “Ajjashij”, vëll. 1, f. 164. “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 186, 213 dhe 415.

² “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 213.

³ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundii ajetit në fjalë. Sherhu “Nehxhul Belaga” i Ibn Ebil Hadijid, vëll. 6, f. 405.

ajetin, thonë se fjalia: **“Ata që janë thelluar në dijëni...”** është e lidhur me fjalën All'llah dhe kjo për faktin se:

Së pari: Është mëse e qartë që kuptimin e ajeteve e di vetëm All'llahu. A nuk kanë zbritur këto ajete për edukimin dhe udhëzimin e njerëzve? Si ka mundësi që Profeti të mos e dijë kuptimin dhe te'uilin e atyre që iu zbritën? Kjo është e ngjashme me një njeri që shkruan libër dhe disa pjesë të atij libri i kupton vetëm ai.

Së dyti: Tabarsiju, autori i tefsijrit “Mexhmaul Bejan” thotë: “Nuk kemi parë asnjë në mesin e dijetarëve islamë dhe komentuesve që të mos e kenë komentuar këtë ajet me argumentin se kuptimin e këtij ajeti e di vetëm All'llahu. Por të gjithë janë përpjekur për të zbuluar sekretet dhe kuptimet e Kur'anit.”

6- Konkluzioni i thënieve rreth komentimit të ajetit

Nga të gjitha që u thanë për komentimin e këtij ajeti nxjerrim si konkluzion se ajetet e Kur'anit ndahen në dy pjesë: Një pjesë e tyre kanë kuptim shumë të qartë, nuk kanë nevojë për te'uil. Këto ajete quhen muhkemat.

Pjesa tjetër kanë kuptim shumë të lartë ose kanë të bëjnë me të padukshmen, Ditën e Kiametit dhe cilësitë e All'llahut, të cilat kanë nevojë për një nivel të lartë dijeje, për t'u kuptuar të vërtetat e tyre. Këto ajete quhen muteshabhe.

Të devijuarit dhe njerëzit e padrejtë përpiqen që t'i komentojnë këto sipas dëshirës së tyre, larg së vërtetës, me qëllim që t'i devijojnë njerëzit dhe të përhapin përçarje në mesin e tyre.

All'llahu dhe të thelluarit në dije e njohin kuptimin e vërtetë të këtyre ajeteve, si dhe sqarimin e tyre për njerëzit. Me anë të dijes së tyre të gjerë, këta të thelluar në dije e njohje i kuptojnë muteshabihatet njësoj siç kuptojnë muhkematet. Ata pohojnë se të gjitha ajetet janë

nga All'llahu i Madhëruar: **“Ne i besojmë (Kur'anit). Të gjitha këto janë nga Zoti ynë!”**

Për këtë, të thelluarit në dije është shkak që njerëzit të shtojnë njohjen e tyre rreth sekreteve të Kur'anit. S'ka dyshim se ata që thellohen në dije, si: profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imamët udhëzues, i njohin të gjitha sekretet e Librit të All'llahut. Ndërsa të tjerët mësojnë prej këtyre sekreteve aq dije sa kanë. Kjo është e vërteta që i shtyn njerëzit në përgjithësi dhe dijetarët në veçanti të kërkojnë dijetarët e lartë, që të mësojnë prej tyre sekretet e Kur'anit.

7- “Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.”

Kjo fjali e fundit e ajetit tregon qartë se këto të vërteta i njohin dhe i kuptojnë vetëm mendimtarët. Ata e kuptojnë se pse duhet që në Kur'an të ketë edhe muhkemat edhe muteshabihat. Ata e kuptojnë se muteshabihatet duhet të vendosen në anë të muhkemateve për sqarimin e tyre. Për këtë, imam Ali ibn Musa Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që i kthen ajetet muteshabihatet e Kur'anit tek ajetet muhkematet të tij, është udhëzuar në rrugë të drejtë.”¹

¹ Tefsijru “Safij”, fundi i ajetit në fjalë. “Uesailu shiah”, vëll. 27, f. 115.

Ajetet 8 - 9

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ
الْوَهَّابُ ﴿٨﴾ رَبَّنَا إِنَّكَ جَامِعُ النَّاسِ لِيَوْمٍ لَا رَيْبَ فِيهِ إِنَّ اللَّهَ لَا
يُخَلِّفُ الْمِيعَادَ ﴿٩﴾

(Ata thonë:) “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh! O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, All'llahu nuk e shkel premtimin.”

Komentimi

Shpëtimi prej shmangies

Duke qenë mundësia se ajetet muteshabiha dhe sekretet e tyre bëhen shkak i rrëshqitjes së njeriut, besimtarët e thelluar në dije, së pari, strehohen te Zoti i tyre; së dyti, përdorin dijen e tyre për kuptimin e të vërtetave të ajeteve. Kjo është ajo për të cilën tregojnë edhe këto dy ajete me gjuhën e rasikhinëve në dije.

Këto ajete thonë se të thelluarit në dije dhe mendimtarët i mbikëqyrin shpirtërat dhe zemrat e tyre që të mos devijojë nga rruga e drejtë. Ata i kërkojnë ndihmë All'llahut të Madhëruar. Ka raste që mendjemadhësia i nxjerr disa dijetarë nga rruga e tyre dhe i çon në

humbje, sepse ata nuk vështrojnë madhësitinë e krijimit e të Krijuesit. Në këtë mënyrë ata ndalojnë veten e tyre prej udhëzimit të All'llahut.

Ndërsa dijetarët besimtarë thonë: **“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”**

Nuk ka gjë më të madhe se sa sundimi i mendimeve që të mos devijojnë prej besimit në Ditën e Kiametit dhe të Ringjalljes. Rasikhunët në dije e ndreqin mendimin e tyre nëpërmjet besimit në krijim dhe në Ringjallje. Ata nuk ndikohen prej shmangies dhe ndjenjave ekstreme, që të çojnë në rrëshqitje nga rruga e drejtë.

Si rezultat i kësaj, me mendimet e shëndosha që mbartin, ata janë të palëkundur në rrugën e drejtë. Vërtet, ata janë të aftë të përfitojnë plotësisht prej ajteve të All'llahut. **“O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, All'llahu nuk e shkel premtimin.”**

Vërtet, ajeti i parë tregon për besimin e plotë të tyre për krijimin, se çdo gjë e ka krijuar All'llahu Fuqiplotë, kurse ajeti i dytë tregon për besimin e rrënjosur të tyre në Ringjallje.

Ajetet 10 - 11

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ تُغْنِيَ عَنْهُمْ أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا
وَأُولَئِكَ هُمْ وَقُودُ النَّارِ ﴿١٠﴾ كَذَّابِ ءَالٍ فِرْعَوْنَ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ
كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا فَأَخَذَهُمُ اللَّهُ بِذُنُوبِهِمْ ۗ وَاللَّهُ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿١١﴾

“Në të vërtetë, atyre që nuk besojnë, nuk do t’u vlejnë aspak para All’llahut, - as pasuria dhe as fëmijët e tyre. Ata do të jenë lëndë djegëse e zjarrit, ashtu siç ishin ithtarët e Faraonit dhe ata që ishin para tyre. Ata i quajtën gënjeshtër Shenjat Tona. Prandaj, All’llahu i përllau ata për gjynahet që bënë. All’llahu është i rreptë në ndëshkim.”

Komentimi

Pas sqarimit të qëndrimit të jobesimtarëve, të hipokritëve dhe të besimtarëve ndaj ajeteve muhkemeh dhe muteshabihe, ky ajet thotë: Nëse mohuesit kokëfortë mendojnë se, me pasuritë dhe fëmijët e tyre, janë të aftë që t’i mbrojnë ata në Ahiret, ata gabojnë rëndë. Këto mjete mund të kenë ndikim të përkohshëm në këtë jetë, mirëpo tek All’llahu nuk kanë asnjë ndikim, as në këtë jetë dhe as në Jetën Tjetër.

Prandaj, njeriu nuk duhet të ndryshojë për shkak të këtyre mjeteve e të bëjë gjynahe dhe mëkate, përndryshe ai do të hyjë në

zjarr dhe po ai do të jetë lënda djegëse e zjarrit. **“Në të vërtetë, atyre që nuk besojnë, nuk do t’u vlejnjë aspak para All’llahut, - as pasuria dhe as fëmijët e tyre. Ata do të jenë lëndë djegëse e zjarrit...”**¹

Ky ajet tregon se zjarri i Xhehennemit është i ndezur me praninë e gjynahqarëve. Prania e tyre në të bën nxehtësia dhe përvëlimi i zjarrit të jenë të vazhdueshme. Ka ajete që thonë se, në shtesë të gjynahqarëve, edhe gurët janë lëndë djegëse e zjarrit të Xhehennemit, siç thotë ajeti 24 i sures “El-Bekare”.

Ka mundësi që këta gurë të jenë idhujt që prodhonin prej guri. Sido që të jetë, zjarri i Xhehennemit bëhet përvëlues me punët e gjynahqarëve dhe me adhurimin e tyre të kotë.

Pastaj ajeti sjell një shembull të popujve të shkuar, të cilët kishin pasuri të shumta humane dhe materiale, por kjo pasuri nuk mundi t’i mbrojë ata nga shkatërrimi. **“ ashtu siç ishin ithtarët e Faraonit dhe ata që ishin para tyre. Ata i quajtën gënjeshtër Shenjat Tona. Prandaj, All’llahu i përllau ata për gjynahet që bënë. All’llahu është i rreptë në ndëshkim.”**

Fjala *de’bun* do të thotë *vazhdim i ecjes* dhe *zakon i vazhdueshëm në një gjendje të pandryshuar*. Ky ajet e krahason gjendjen e mohuesve në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me gjendjen e popullit të Faraonit, si dhe të popujve të tjerë, të cilët përgënjeshtrojnë shenjat e All’llahut. Për këtë All’llahu i ndëshkoi rëndë në këtë jetë.

Në të vërtetë, ky është paralajmërim për mohuesit kryeneçë në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me qëllim që të mësojmë prej fundit të Faraonit dhe të popujve të mëparshëm dhe të ndreqin veprat e tyre.

¹ Në xhuzin e parë e thamë se *el nukudu* është lënda me të cilën zjarri mbahet i ndezur, si druri dhe jo lënda me të cilën ndizet zjarri, si shkrepësja.

Vërtet, All'llahu është “Më i Mëshirshmi i Mëshiruesve”, por në disa vende për shkak të edukimit të robëve, Ai është “Ndëshkues i rreptë”. Robi nuk duhet të jetë kryeneç përballë mëshirës së gjerë të All'llahut.

Nga fjala *de'bum* gjithashtu përfitohet se kokëfortësia ndaj së vërtetës dhe përgënjeshtrimi i shenjave të All'llahut ishte zakon te ata, prandaj i kërcënon me ndëshkim të rëndë. Përderisa gjynahu nuk bëhet zakon dhe rrugë në jetë, largimi prej tij është i thjeshtë dhe dënimi është i lehtë.

Ndërsa, kur ai depërton në thellësi të njeriut, largimi prej tij është i vështirë dhe dënimi do të jetë i rëndë e i rreptë. E mira e mohuesve është që të përfitojnë nga koha para se t'u ikë, të dalin nga humbja dhe të kthehen në rrugën e drejtë.

Ajeti 12

قُلْ لِلَّذِينَ كَفَرُوا سَتُغْلَبُونَ وَتُحْشَرُونَ إِلَىٰ جَهَنَّمَ ۖ وَبِئْسَ الْمِهَادُ ﴿١٢﴾

“Thuaju (o Muhammed) atyre që mohuan: “Ju do të mposhteni dhe do të tuboheni në Xhehennem. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”

Shkaku i zbritjes

Pas Betejës së Bedrit dhe fitores së myslimanëve, një grup jahudijshtanë: “Vërtet, Profeti, për të cilin na lajmëroi Musai (Pajja e Allllabat qoftë mbi të!) dhe e gjemë në librin tonë me po ato cilësi e veti, nuk mposhtet.”

Disa të tjerë thanë: “Mos u nxitoni, derisa ta shikoni atë në një betejë tjetër.”

Kur ndodhi Beteja e Uhudit, shokët e Profetit, u ankuan dhe thanë: “Jo për Allllahun. Ajo nuk është e tij. Ata i mposhti vështirësia dhe nuk u dorëzuan. Mes tyre dhe Profetit ka qenë një besëdhënie, të cilën e thyen parakohe.

Kab ibn Eshref, së bashku me gjashtëdhjetë kalorës, shkuan në Mekë. Ata ranë dakort që çështjen e tyre ta linin në dorën e profetit ku fjala jonë të ishte e përbashkët. Atëherë zbriti ajeti që u thotë jobesimtarëve llogaria do të jetë afër dhe se ju do të mposhteni së afërmi¹

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1, 2, f. 413.

Komentimi

Nga shkaku i zbritjes sqarohet se mohuesit mendjemëdhën prej pasurisë dhe fëmijëve, numrit dhe pajisjeve luftarake, mendonin se do ta mposhtin Islam. Por Kur'an Fisnik thotë qartë në këtë ajet se ata do të mposhten. Ajeti i thotë profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që t'u thotë atyre se do të mposhten dhe se fundi i tyre në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër do të jetë mposhtja, poshtërimi dhe ndëshkimi: **“Thuaju (o Muhammed) atyre që mohuan: “Ju do të mposhteni dhe do të tuboheni në Xhehennem. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”¹**

Hulumtim

Lajmërim i qartë

Në Kur'an ka shumë lajme për të ardhmen dhe konsiderohen prej argumenteve të madhështisë dhe të mrekullisë së tij. Ajeti i lartpërmendur është njëri prej tyre.

Në këtë ajet All'llahu e përgëzon të Dërguarin e Tij, profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se do të triumfojë mbi armiqtë. Po ashtu i paralajmëron mohuesit se ata, përveç mposhtjes në këtë jetë, do të kenë dënimin më të rëndë në Ahiret.

Nëse vështrojmë me kujdes shkakun e zbritjes, se ai zbriti pas dështimit të myslimanëve në Betejën e Uhudit, shfaqjes së dobësisë së tyre dhe shtimit të fuqisë së armiqtë me bashkimin e tyre, ky lajmërim i qartë flet për të ardhmen e afërt: **“Ju do të mposhteni.”**, do të

¹ Fjala *mihadun* ka kuptimin e vendit të përgatitur, siç thotë Ragibi në librin e tij “El Mufredat”. Ajo vjen nga lënda *mehdun*, që është shtrati i fëmijës.

shohim se është mjaft interesant. Nga këtu, këtë ajet mund ta konsiderojmë si ajetet i mrekullisë së Kur'anit, për shkak të lajmërimit për të ardhmen. Në të njëjtën kohë, nga paraqitja e jashtme nuk duken shenjat e triumfit të myslimanëve dhe të jahudijve.

Nuk kaloi gjatë derisa ky lajm u vërtetua. Jahudijtë e Medines, beni Kurejdheh dhe beni Nedhijr u mposhtën në Khajber, qendra më kryesore e tyre. Ata u mposhtën dhe fuqitë e tyre u shpërbënë, njësoj siç u mposhtën politeistët mekas në kohën e çlirimit të Mekës.



Ajeti 13

قَدْ كَانَ لَكُمْ آيَةٌ فِي فِئَتَيْنِ الَّذِينَ التَّقَاتِ فَعَثَّةٌ تُقْتَلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَأُخْرَى

كَافِرَةٌ يَرَوْنَهُمْ مِثْلِهِمْ رَأَى الْعَيْنِ وَاللَّهُ يُؤَيِّدُ بِنَصْرِهِ مَنْ يَشَاءُ إِنَّ

فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةٌ لِّأُولِي الْأَبْصَارِ ﴿١٣﴾


“Sigurisht që kishte shenjë për ju në dy ushtritë që u ndeshën: njëra që luftonte në rrugën e All’llahut dhe tjetra - e mohuesve, së cilës i dukej se para vetes kishte dy herë më shumë kundërshtarë. All’llahu, me ndihmën e Vet, forcon kë të dëshirojë. Kjo, me të vërtetë, është mësim për largpamësit.”

Shkaku i zbritjes

Ky ajet ka zbritur për Betejën e Bedrit. Komentuesit thonë se numri i myslimanëve në Betejën e Bedrit ka qenë 313 vetë, 77 kanë qenë emigrues (muahaxhirin) dhe 236 kanë qenë përkrahës (ensarë). Flamurin e muhaxhirëve e mbante imam Aliu (Paqja qoftë mbit të!), ndërsa flamurin e ensarëve e mbante Sa’d ibn Ibadeh. Myslimanët kishin 70 mushka, dy kuaj, gjashtë mburoja dhe gjashtëdhjetë shpata. Me këto pajisje hynë në betejën e madhe përballë një ushtrie, numri i së cilës i

kalonte të njëmijë vetët, ishin të armatosur dhe kishin njëqind kuaj. Edhe pse ajo ushtri ishte e tillë, myslimanët triumfuan. Nga myslimanët ranë dëshmorë 22 veta, 14 prej muhaxhirëve dhe 8 prej ensarëve. Ndërsa nga ushtria përballë u vranë 70 ushtarë dhe u arrestuan 70 të tjerë. Myslimanët u kthyen në Medine me bukurinë e fitores.

Ky ajet flet për një anë të Betejës së Bedrit.¹



Beteja e Bedrit dhe ndihma e All'llahut

Pas ajeteve të mëparshme, të cilat paralajmërojnë mohuesit që të mos krenohen me pasurinë, fëmijët dhe pasuesit e shumtë, vjen ky ajet, dëshmues i gjallë për këtë çështje. Ajeti i fton që të marrin mësim prej Betejës historike të Bedrit.

“Sigurisht që kishte shenjë për ju në dy ushtritë që u ndeshën: njëra që luftonte në rrugën e All'llahut dhe tjetra - e mohuesve.”

Si të mos marrin mësim, ndërkohë që shohin ushtrinë e vogël në numër, e cila nuk zotëron pajisje luftarake përveç besimit të patundur dhe fiton mbi ushtrinë e shumtë në numër e në pajisje? Sikur të ishte pasuria dhe numri i madh - pa besimin- të mundshme për të bërë diçka, ajo do të dukej në Betejën e Bedrit. Mirëpo rezultati ishte i kundërt.

¹ Ajo që u përmend në shkakun e zbritjes gjendet tek tefsijri “Mexhmaul Bejan”. Po ashtu përmendet te libri “El Kamilu” i ibn Ethijrit, vëll. 3, f. 136: “Numri i përgjithshëm i të vrarëve myslimanë në këtë betejë ka qenë 14 vetë. 6 prej muhaxhirëve dhe 8 prej ensarëve.” “Biharul Anuar”, vëll. 19, f. 205, 206 dhe 360.

“...së cilës i dukej se para vetes kishte dy herë më shumë kundërshtarë.”

Ajeti thotë se mohuesit i shihnin luftëtarët myslimanë të shumtë në numër. Ata ishin 313 luftëtarë, mohuesit i shihnin se ishin më shumë se 600 luftëtarë. Ky ishte një prej shkaqeve të mposhtjes së mohuesve.

Myslimanët fituan, sepse All'llahu i ndihmon robtë e tij besimtarë me rrugë të ndryshme. Kjo ishte e natyrshme përsa i përket anës së dukshme, sepse gjuajtjet e forta të myslimanëve, që buronin nga besimi i fortë dhe nga njohjet islame, përcollin frikë e tmerr te armiqtë, aq sa mendonin se një fuqi tjetër ishte bashkuar me myslimanët. Prandaj, ata mendonin se myslimanët ishin më shumë se ç'ishin në fillim të betejës dhe se ata po sundojnë fushën e betejës.

Në ajetin 44 të sures “Enfal” tregohet po kjo ndodhi: **“Kur u përballët (me armikun), Ai ua shfaqti ata në sytë tuaj sikur ishin pak, ndërsa juve ju bëri të dukeshit pak në sytë e atyre, për të përmbushur atë që ishte caktuar. Tek All'llahu kthehen të gjitha çështjet.”**

Kujtojeni ditën e takimit tuaj me myslimanët në fushën e betejës. Ne ua shfaqëm para syve tuaj numrin e pakët të tyre, që të mos largoheshit nga lufta me mendimin se do t'i mposhtni ata. Por, kur filloi beteja, skema u ndryshua dhe myslimanët dukeshin të shumtë në sytë tuaj.

Në disa transmetime thuhet se një mysliman ka thënë: “Para se të mbaronim Betejën e Bedrit i thashë një shokut tim: “A mendon se numri i mohuesve është 70 vetë?” Ai më tha: “Unë i llogarita 100.

Por, kur fituam betejën dhe morëm robër një numër të madh të tyre, dëgjuam se numri i tyre kishte qenë njëmijë ushtarë.”¹

“All’llahu, me ndihmën e Vet forcon kë të dëshirojë.”

Ajeti tregon për një të vërtetë, se All’llahu i jep triumfin atij që do. Më parë përmendëm veprat dhe dëshira e Tij nuk janë pa llogaritje. Por ato janë sipas urtësisë së Tij në kufijtë e aftësive të njeriut, që do të thotë: All’llahu përkrah ata që e meritojnë.

Është për t’u përmendur se fitorja hyjnore e myslimanëve në këtë betejë historike ka qenë e dyanshme: Fitore ushtarake dhe fitore logjike. Nga ana ushtarake u arrit me triumfin e pakicës, që nuk kishte pajisjet e domosdoshme të luftës, përballë ushtrisë së madhe dhe të armatosur gjer në dhëmbë. Nga ana logjike: All’llahu i lajmëroi myslimanët para betejës se do të triumfonin.

“Kjo, me të vërtetë, është mësim për largpamësit.”

Në fund ajeti dëshmon se ata, të cilët i shohin të vërtetat ashtu siç janë, nxjerrin mësim nga ky triumf. Ata e kuptojnë shumë mirë se baza kryesore e kësaj fitoreje ka qenë vetëm besimi.²

¹ Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 2, f. 1268.

² Fjala *ibretun* në origjinë vjen nga lënda *ubuur*, që do të thotë *kalim nga një fazë në tjetrën ose kalim nga një vend tek tjetri*. Edhe lotit të syrit i thuhet *abretun*, sepse ai kalon nga syri. Edhe fjalëve që kalojnë nga gjuha dhe veshi u thuhet *ibaratun*. Po ashtu edhe ndodhisë i thuhet *ibretun*, me qëllim që njeriu, kur ta shohë, t’i njohë të kundërtat e saj nga e vërteta.

Ajeti 14

زَيْنَ لِلنَّاسِ حُبُّ الشَّهَوَاتِ مِنَ النِّسَاءِ وَالْبَنِينَ وَالْقَنَاطِيرِ الْمُقَنْطَرَةِ
مِنَ الذَّهَبِ وَالْفِضَّةِ وَالْخَيْلِ الْمُسَوَّمَةِ وَالْأَنْعَامِ وَالْحَرْثِ ۗ ذَٰلِكَ
مَتَاعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ وَاللَّهُ عِنْدَهُ حُسْبُ الْمَآبِ ﴿١٤﴾

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek All'Ilahu.”

Komentimi

Joshja me kënaqësive të kësaj dynjaje

Në vazhdim të ajeteve të mëparshme, që e konsideronin besimin kapitalin bazë e të vërtetë për njeriun dhe jo pasurinë, as fëmijën dhe as pasuesit e shumtë, ky ajet tregon për një të vërtetë tjetër, se bashkëshortja, fëmijët dhe pasuria nuk janë tjetër veçse pasuri në dobi të kësaj jete.

Ato nuk formojnë qëllimin themelor të njeriut. Është e vërtetë se pa këto nuk mund të ecet në rrugën e lumturisë dhe të plotësisht shpirtëror. Mirëpo përfitimi prej tyre në këtë rrugë është një anë dhe dashuria ndaj tyre dhe adhurimi i tyre, duke i konsideruar jo vetëm si mjete përfitimi, është anë tjetër.

Ky ajet përmban disa pika, mbi të cilat duhet hedhur vështrimi:

1- Kush i zbukuroi gjërat materiale për njerëzit?

Në thënien: **“Njerëzve u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara.”**, folja *zujjine* është në formë abstrakte. Kjo do të thotë se vepruesi, i cili ua zbukuroi njerëzve dashurinë për bashkëshorten, për fëmijët dhe pasurinë nuk dihet. Në këtë gjendje, njeriu pyet: Vallë, kush është zbukuruesi i këtyre gjërave për njerëzit?

Disa komentues kanë mendimin se këto kënaqësi janë prej punës së djallit, i cili i zbukuron këto në sytë e njerëzve. Ata sjellin si argument ajetin 24 të sures “Neml”: **“Djali ua zbukuron atyre punët..”** si dhe ajete të tjera.¹

Mirëpo ky argumentim nuk duket i rregullt, sepse ajeti në fjalë nuk flet për punët, por për pasurinë, gratë dhe fëmijët.

Komentimi i rregullt është se All’llahu ua zbukuron ato gjëra njerëzve nëpërmjet krijimit, natyrës krijuese dhe natyrës së njeriut.

All’llahu është Ai që ka vendosur dashurinë për fëmijët dhe pasurinë në natyrën e njeriut, me qëllim që ta sprovojë dhe nëpërmjet saj të vazhdojë rrugën drejt edukimit dhe plotësimit, siç thotë Kur’ani: **“Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë.”**²

Ajo që tërheq vëmendjen në ajet është se bashkëshortja përmendet e para. Dijetarët e sotëm pohojnë se instinkti seksual është më i forti tek njeriu. Po ashtu edhe historia e shkuar dhe e tanishme dëshmon se shumë prej shkatërrimeve sociale e kanë burimin tek tirania e këtij instinkti.

¹ Sure “Enfal”, ajeti 48, sure “Ankebut”, ajeti 38.

² Sure “Kehf”, ajeti 7.

Gjithashtu, duhet thënë se ky ajet dhe ajetet e ngjashme me të nuk i qortojnë marrëdhëniet e ekuilibruara me gruan, fëmijët dhe pasurinë, sepse përparimi drejt qëllimeve shpirtërore nuk mund të arrihet pa praninë e këtyre gjërave. Ato nuk janë në kundërshtim me natyrën e njeriut. Ajo që nuk lavdërohet është ekstremizmi në këto marrëdhënie. Me fjalë të tjera: i qortuar është adhurimi i këtyre gjërave.

2- Çfarë janë “Kanatirul mukantareh” dhe “el khajlu museumeh”?

Fjala *kanatiru* është shumësi i fjalës *kintarun*, që do të thotë *diçka e fortë, konstante*. Më pas është përdorur për pasurinë e madhe, për *urën-kantarab* dhe për *njeriun e zgjuar el kintar*. *El mukantarah* është kundërinor dhe tregon për shumicë dhe shtesë. Përmendja e tyre njëra pas tjetres është përforsim, siç themi nganjëherë *ulufun muel'lefeh-mijëra e mijëra*, me të cilën synojmë të japim më të shumtën e gjërave.

Disa e kanë përcaktuar masën e kintarit. Kanë thënë se është baras me shtatëdhjetë mijë dinarë floriri, ose njëqindmijë dinarë, ose dymbëdhjetëmijë derhem. Një grup dijetarësh të tjerë kanë thënë se kintari është një qese e mbushur me flori ose argjend.

Në një hadith të imam Bakirit dhe imam Sadikut thuhet se kintari ka masën e floririt, me të cilin mbushet lëkura e lopës.¹

“Sido që të jetë, të gjitha këto tregojnë për pasuri të shumtë.”

Fjala *el kajl* është *emër i kalit*. Po ashtu përdoret edhe për kalorësit. Tek ajeti ka kuptimin e kuajve.

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 2, f. 5.

Fjala *el museummeh* do të thotë *e shenjuar*. Ka raste që kuajve u vihet një shenjë për zbukurim ose që të njihet se është i stërvitur mirë dhe është i gatshëm për t'u shaluar për në fushat e betejës.

Këtu themi se ajeti përmend gjashtë pasuri të kësaj jete: gruan, fëmijët, pasurinë, kuajt asileh (racë e mirë), bagëtitë, devenë dhe bujqësinë, të cilat janë prej bazave të jetës materiale.

3- Çfarë kuptimi ka fraza: kënaqësitë e kësaj jete?

Fjala *el metau* është përfitimi prej *dijçkaje përkohësisht*. Atëherë kuptimi i ajetit është: Nëse dikush mallëngjehet me një prej këtyre gjashtë gjërave të përmendura dhe i konsideron qëllimin final të jetës dhe nuk përfiton prej tyre vetëm sa përfitimi i shkallëve për të hipur në një lartësi, ai ka zgjedhur jetën e zhdukur.

Në të vërtetë, shprehja *el hajatu dunja* tregon për ecjen drejt jetës plotësuese, sepse kjo jetë është faza e parë e kësaj ecjeje. Prandaj, në fund ajeti tregon se njeriun e pret një jetë më e lartë: **“...por shumë më i mirë është kthimi tek All'llahu.”**

4- Siç u tha edhe më parë gjatë komentimit, ajeti thotë se gratë janë një prej atyre mirësive materiale dhe e përmend të parën, sepse, në krahasim me mirësitë e tjera, gratë kanë ndikim më të madh dhe më tërheqës dhe ka raste që çojnë në bërjen e gjynaheve më të mëdha në këtë jetë.

Ajetet 15 – 17

قُلْ أُوْنِبْتُكُمْ بِخَيْرٍ مِّنْ ذَالِكُمْ ۚ لِلَّذِينَ اتَّقَوْا عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَأَزْوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ وَرِضْوَانٌ مِّنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ
بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ ﴿١٥﴾ الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا إِنَّا أَمْنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا
وَقَنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٦﴾ الصَّابِرِينَ وَالصَّادِقِينَ وَالْقَانِتِينَ
وَالْمُنْفِقِينَ وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ ﴿١٧﴾

“Thuaj (o Muhammed!): “A doni t’ju tregoj për gjëra më të mira se ato? Për ata që janë të devotshëm, te Zoti i tyre do të ketë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe kënaqësi nga All’llahu”. All’llahu i vrojton robërit e Vet që thonë: “Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!”; që janë të durueshëm, të sinqertë, të devotshëm në adhurimin e All’llahut; që japin lëmoshë dhe që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.”

Komentimi

Ky ajet sqaron rrugën e qartë të përsosmërisë së jetës njerëzore. Ajeti thotë: A t’ju tregoj për jetën, që është më e larta dhe më e mira se sa kjo jetë materiale dhe e kufizuar? Në atë Jetë gjenden të gjitha mirësitë e kësaj jete, por atje janë në formë më të plotë, pa mangësi e pa të meta dhe këto janë të posaçme për të devotshmit.

“Thuaj (o Muhammed!): “A doni t’ju tregoj për gjëra më të mira se ato? Për ata që janë të devotshëm, te Zoti i tyre do të ketë kopshte...” Kopshtet e asaj Jete nuk janë si kopshtet e dynjasë dhe uji është gjithmonë i rrjedhshëm në anë të pemëve të atij kopshti. **“...nëpër të cilat rrjedhin lumenj...”**

Mirësitë e asaj Jete janë të përhershme dhe jo si mirësitë e kësaj jete që zhduken shpejt: **“...dhe ku do të banojnë përgjithmonë...”**

Gratë në atë Jetë janë të ndryshme nga ato të kësaj jete. Në trupat dhe në shpirtërat e tyre nuk gjendet asnjë grimcë papastërtie e errësire. **“...Aty do të kenë bashkëshorte të pastra...”**

Të gjitha këto janë në pritje të të devotshmëve. Më të shumta se këto janë mirësitë shpirtërore, të cilat janë mbi imagjinatën. E këto mirësi janë: **“...dhe kënaqësi nga All’Ilahu.”**

Në ajet vëmë re se ai fillon me frazën *unebi’ukum-a t’ju tregoj*, që është në formë pyetëse dhe i drejtohet natyrës krijuese të njeriut, me qëllim që të jetë më depërtuese dhe më ndikuese për dëgjuesin. Pyetja përdoret për lajmërimin e një lajmi të rëndësishëm, që është i aftë për t’u kuptuar.

Ajeti i lajmëron besimtarët se, nëse e ndalojnë veten e tyre nga kënaqësitë e paligjshme, të përziera me mëkate, ata do të fitojnë në Ahiret të njëjtat kënaqësi, por që janë me nivel më të lartë dhe të zbrazëta nga papastërtia dhe e meta. Mirëpo kjo nuk do të thotë që të mos përdoren kënaqësitë e lejuara të kësaj jete.

A ka në Xhennet kënaqësi materiale?

Disa kanë mendimin se kënaqësitë materiale janë të kufizuara vetëm për këtë jetë dhe se Jeta Tjetër është e zbrazët prej tyre. Ata thonë se të gjitha ato që përmenden në Kur'an, si: kopshtet, frutat, ujërat e rrjedhshme, bashkëshortet e pastra janë aludim dhe se mirësitë shpirtërore janë njësoj si thënia: “Bisedo me njerëzit sipas aftësisë së tyre mendore.”¹

Duhet të themi se, pasi e pranuar ringjalljen trupore, duke u mbështetur në disa ajete të qarta të Kur'anit, patjetër duhet të jenë të pranishme mirësitë që përputhen me trupin dhe shpirtin, por në një formë më të lartë. Në këtë ajet tregohet për praninë e kënaqësive materiale, që janë në përputhje si me ringjalljen trupore, ashtu edhe shpirtëroren.

Në realitet, ata që i konsiderojnë kënaqësitë materiale aludim ndaj kënaqësive shpirtërore, bëjnë te'uil të të jashtmes së ajeteve të Kur'anit pa asnjë shkak. Po ashtu, ata harrojnë edhe ringjalljen trupore.

Ndoshta fjalia e fundit e ajetit: **“All’llahu i vrojton robërit e Vet.”**, tregon për këtë të vërtetë, që do të thotë se Ai e di nevojën e trupit e të shpirtit në Jetën Tjetër dhe i di kërkesat e tyre. Për këtë Ai ua siguron këto nevoja në formën më të përkryer.

“...që thonë: **“Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar...”**

Në këtë ajet dhe në atë pas tij njihemi me të devotshmit, që u përmendën në ajetin paraardhës, që ishin të përfshirë në mirësitë e All’llahut në Jetën Tjetër. Të dy ajetet përmbajnë gjashtë cilësi prej cilësive dalluese të tyre:

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 23.

1- Ata i drejtohen All'lahut me gjithë praninë e tyre. Besimi ndriçon zemrat e tyre, prandaj ata e ndiejnë përgjegjësinë e madhe në çdo punë të tyre. Ata i frikësohen dënimit të ashpër dhe kërkojnë prej All'lahut që t'i falë dhe t'i shpëtojë prej zjarrit: **"...prandaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!"**

2- Ata janë durimtarë, të palëkundur dhe mbartës të përgjegjësisë, rezistues ndaj vështirësive që hasin në rrugën e adhurimit të All'lahut dhe u largohen gjynaheve. Ata e përballojnë çdo sprovë, sado e fortë dhe e vështirë të jetë: **"që janë të durueshëm..."**

3- Janë të vërtetë dhe të drejtë. Atë, që e besojnë me zemër, e shfaqin me vepra. Ata i mënjanohen dyfytirësisë, gënjeshtërisë, tradhtisë dhe çdo papastërtie shpirtërore. **"...të vërtetë..."**

4- Ata janë të përkushtuar dhe të thjeshtë në rrugën e adhurimit dhe të devotshëm në këtë rrugë: **"...të devotshëm¹ në adhurimin e All'lahut..."**

5- Ata nuk japin vetëm prej pasurisë së tyre, por japin në rrugën e All'lahut prej çdo mirësie që zotërojnë, qoftë materiale apo shpirtërore. Me këtë veprim shërojnë çdo sëmundje të shoqërisë: **"...që shpenzojnë..."**

6- Nga fundi i natës, para agimit, pra, në kohën që sundon qetësia, kthjelltësia dhe në kohën që të pavëmendshmit i kaplon gjumi i rëndë, ata, me zemra të zgjuara, çohen dhe kujtojnë All'lahun duke i kërkuar Atij falje. Në këtë kohë ata janë të ndriçuar me dritën e All'lahut dhe çdo grimcë e trupit të tyre pohon Njëshmërinë e All'lahut të Madhëruar: **"...dhe që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit."**

¹ Fjala *kanitine*, vjen nga lënda *kunut*, që do të thotë *nënshtrim, përulje para All'lahut*. Po ashtu ka edhe kuptimin e vazhdimësisë së përuljes dhe të adhurimit.

Dy hulumtime

1- Për komentimin e këtij ajeti është transmetuar se imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai që në fundin e Namazit të Vitrit, para agimit thotë shtatëdhjetë herë: *Estagfirullah ue etubu ilejbi - I kërkoj pendim dhe falje All'llahut*, dhe e vazhdon këtë veprim një vit, All'llahu do ta shënojë ndër të falurit para agimit.”¹

2- Fjala *es sabr* në gjuhësi do të thotë *mbulim* dhe *ikhfa-mbulim*, *fshehje*. Përderisa orët e vona të natës mbulojnë çdo gjë me mbulesë të posaçme, është quajtur *es sabr*. Edhe fjala *sibrun* vjen nga e njëjta rrënjë, kjo për faktin se magjistari bën disa veprime, në të cilën fsheh sekretet e tij nga të tjerët. Me këtë emër arabët quajnë edhe mushkërinë për shkak se fsheh ato që ka.

Përse flitet për kohën para agimit, ndërkohë që përmendja e All'llahut dhe kërkimi i faljes së gjynaheve duhet bërë në çdo kohë?

Shkaku është se orët e kësaj kohe dallohen për qetësinë, largimin prej punëve materiale dhe pas çlodhjes e gjumit njeriu ndien energji të reja. Për këtë ai është më aktiv në kryerjen e adhurimit. Kjo kohë është e përshtatshme edhe për zgjidhjen e disa çështjeve shkencore deri edhe disa dijetarë e shfrytëzojnë këtë kohë. Kjo, sepse kthjelltësia e mendimit dhe e shpirtit është më e madhe se në çdo kohë tjetër.

Përderisa shpirti i adhurimit dhe i kërkimit të faljes kanë nevojë për praninë e plotë të zemrës, atëherë kjo kohë është më e përkryera se kohët e tjera.

¹ Tefsijri “El Burhan”, vëll. 1, f. 489.

Ajeti 18

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ ۚ لَا

إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١٨﴾

“All’llahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”

Komentimi

Gjithçka dëshmon për Njeshmërinë e All’llahut

Pas komentimit të ajeteve të mëparshme, që flisnin për besimtarët e vërtetë, ky ajet flet për disa argumente të Njeshmërisë dhe njohjes së All’llahut të Madhëruar. Ajeti thotë se All’llahu i Madhëruar dëshmon për Njeshmërinë e Tij (nëpërmjet gjetjes dhe vendosjes së ligjit të mrekullueshëm të gjithësisë).

Po ashtu, edhe engjëjt edhe dijetarët që i shohin të vërtetat e gjithësisë me dritën e dijes e të njohjes, dëshmojnë se All’llahu është një e i Vetëm: “All’llahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes...”

Hulumtime

1- Si dëshmon All'llahu për Njeshmërinë e Tij?

Kuptimi i dëshmisë së Njeshmërisë së All'llahut këtu është dëshmi praktike dhe logjike dhe jo thjesht një fjalë, që do të thotë se, nëpërmjet krijimit të Tij të botës dhe krijesave, të cilat i udhëheq një sistem unik, me ngjashmërinë e ligjeve të Tij për çdo kohë dhe vend, që kanë një program të vetëm, Ai e ka shfaqur praktikisht se nuk ka Krijues dhe Adhures tjetër në botë përveç Tij.

Gjithçka e ka zanafillën tek një burim i përbashkët. Krijimi i këtij sistemi unik është argument dhe fakt për Njeshmërinë e Tij.

Dëshmia e engjëjve dhe e dijetarëve është shprehimore. Ata, nëpërmjet shprehjes, e pohojnë këtë të vërtetë. Kjo lloj ndarjeje në ajete është e shumtë, siç është ajeti: **“Vërtet, All'llahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë...”**¹

S'ka dyshim se salavati i All'llahut për profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*) ndryshon nga salavati i engjëjve.

Salavati i All'llahut është dërgimi i mëshirës, kurse salavati i engjëjve është kërkimi i mëshirës.

Natyrisht që dëshmia e engjëjve dhe e dijetarëve ka edhe anën praktike, sepse ata nuk adhurojnë tjetërkënd përveç Tij.

2- Ç'është *kajmi bil kist*?

Fraza *kaimen bil kist-bën drejtësi*, është gjendje e foljes *shebide-dëshmoi*, që është All'llahu. Kjo do të thotë se All'llahu dëshmon për Njeshmërinë e Tij, se Ai bën drejtësi në botën ekzistuese. Në të vërtetë, kjo është argument i dëshmisë së Tij, sepse drejtësia është

¹ Sure “Ahzab”, ajeti 56.

zgjedhja e rrugës së mesme e të drejtë, larg çdo ekstremizmi e indiference.

Ne e dimë që rruga e mesme dhe e drejtë është një e vetme, siç thotë ajeti 153 i sures “En’am”: **“Kjo është rruga ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij...”**

Ky ajet thotë se rruga e All’llahut është një dhe e vetme. Kurse rrugët e të larguarve nga All’llahu janë të shumta dhe të ndara. Kjo vërtetohet se fjala *sirati-rruga ime*, përmendet në njëjës, ndërsa ato të të devijuarve përmenden në shumës *subul-rrugët*.

Konkluzioni: S’ka dyshim se drejtësia është e shoqëruar me sistemin unik. Ky sistem unik argumenton se Krijuesi është Një. Sipas kësaj, drejtësia, me kuptimin e saj të vërtetë në botën e krijesave, është argument i Njëshmërisë së Krijuesit. (Mendo thellë)

3- Rëndësia e dijetarëve

Në këtë ajet dijetarët përmenden në anë të engjëjve. Kjo në vetvete është shenjë dalluese vetëm për ata. Po ashtu, nga ajeti përfitohet se dijetarët dallohen nga të tjerët, sepse, me dijen e tyre, arritën t’i njohin të vërtetat. Në krye të tyre qëndron njohja e All’llahut.

Është e qartë se ajeti i përfshin të gjithë dijetarët. Thënia e disa komentuesve, se fraza *ulul ilmi-dijetarët* janë imamët prej Ehli Bejtit (*Paqja goftë mbi ta!*) është e vërteta më e dukshme.¹

I ndjeri Tabarsij në tefsijrin “Mexhmaul Bejan” në komentimin e këtij ajeti përmend një hadith të transmetuar nga Xhabir ibn Abdullah el Ensarij, ku Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Qëndrimi i dijetarit një orë në shtratin e**

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 23, f. 204. Tefsijru “Ajjashij”, vëll. 1, f. 166.

tij, duke menduar për dijen që ka, është më i mirë se adhurimi i robit për shtatëdhjetë vjet.”¹

Në fund të ajetit përsëritet fraza *la ilahe il'la hue-s'ka Zot tjetër përveç Tij*. Ka mundësi që kjo përsëritje të tregojë se ajo dëshmi, që përmendet në fillim, dëshmia e All'llahut e engjëjve dhe e dijetarëve, kushdo që t'i dëgjojë, t'i përsërisë dhe të dëshmojë për Njëshmërinë e Adhuresit.

Përderisa fraza *la ilahe il'la hue-s'ka Zot tjetër përveç Tij* është madhështi dhe shfaqje e Njëshmërisë së Tij, ajeti përfundon me përmendjen e dy cilësive *el Azijzu-i Plotfuqishëm* dhe *el Hakijmu-i Urti*, sepse zbatimi i drejtësisë ka nevojë për fuqi dhe urtësi. All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë, i Gjithëditur për gjithçka. Ai është i vetmi që e zbaton drejtësinë në botën ekzistuese.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përmendte shumë këtë ajet në vende të ndryshme. Zubejr ibn Auam ka thënë: “Sonte, e cila është Nata e Arafatit, do të shkoj pranë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ta dëgjoj se çfarë thotë. Kur shkova e dëgjova duke thënë ajetin: ***“Shehide All'llahu ennehu la ilahe il'la hue-All'llahu dëshmon se s'ka Zot tjetër përveç Tij.”*** Këtë e bëri derisa u ngrit.”²

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 2, f. 23. Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 2, f. 258.

² Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 2, f. 421.

Ajeti 19

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ ۗ وَمَا اخْتَلَفَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا
مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بَغْيًا بَيْنَهُمْ ۗ وَمَنْ يَكْفُرْ بِآيَاتِ اللَّهِ فَإِنَّ اللَّهَ
سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿١٩﴾

“Feja e vërtetë tek All’llahu është vetëm Islami. Atyre që u është dhënë Libri, patën mospajtme nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e All’llahut, ta dijë se All’llahu është i shpejtë në llogari.”

Komentimi

Shpirti i fesë është dorëzimi ndaj së vërtetës

Fjala *ed dijn* në origjinal ka kuptimin e *shpërblimit* dhe *sevabit*. Përdoret edhe për *përuljen*, *nënsbtrimin* dhe *zbatimin e urdhrave*. Në terminologji, kjo fjalë ka kuptimin e besimit, rregullave dhe moraleve, me anë të të cilave njeriu arrin lumturinë në këtë jetë dhe ecën në rrugën e saktë nëpërmjet edukatës dhe moralit individual dhe shoqëror.

Fjala *el islam* do të thotë *dorëzimi*. Këtu ka kuptimin e *dorëzimit para All’llahut*. Sipas kësaj, kuptimi i frazës: “**Feja e vërtetë tek All’llahu është vetëm Islami...**” është: Feja e vërtetë tek All’llahu është dorëzimi para urdhrave të Tij dhe para së vërtetës. Është e

vërtetë se shpirti i fesë, në të gjitha kohët, është vetëm nënshtrimi dhe dorëzimi për të vërtetën.

Shkaku se pse profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) fenë që solli e quajti Islam është se është feja më e përkryer.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e sqaron këtë kuptim në thënien e tij shumë domethënëse: “Do ta njoh Islamin me njohjen që askush nuk e ka bërë më parë: Islami është dorëzim, dorëzimi është bindje, bindja është vërtetësi, vërtetësia është dëshmi, dëshmia është zbatim dhe zbatimi është punë.”¹

Në thënien e tij imam Aliu për Islamin përmend gjashtë faza.

Së pari, dorëzimin e vendos përballë së vërtetës. Pastaj thotë se dorëzimi pa bindje nuk arrihet, sepse dorëzim pa bindje do të thotë dorëzim i verbër dhe jo dorëzim i saktë. Më pas thotë se bindja është vërtetësi, që ka kuptimin se vetëm dija nuk mjafton, por duhet edhe besimi dhe vërtetimi me zemër. Vërtetësia është dëshmi (besimi me zemër nuk është i mjaftueshëm, por ai duhet shfaqur me guxim dhe fuqi.)

Pastaj thotë se dëshmia është zbatim (dëshmia nuk duhet të jetë vetëm me fjalë, por duhen zbatuar përgjegjësitë.) Së fundi, thotë se zbatimi është veprim, punë (është nënshtrim para urdhrave dhe zbatimi i programit hyjnor), sepse përgjegjësia shlyhet me punë.

Kurse ata, që i harxhojnë fuqitë e tyre në mbledhje a tubime dhe paraqesin propozime e sugjerime dhe vetëm flasin, nuk janë as zbatues e as mbajtës të përgjegjësisë. Ata nuk e kanë kuptuar ashtu siç duhet Islamin.

Këto fjalë rreth njohjes së Islamit, vërtet janë të larta nga të gjitha anët.

¹ “Nehxhul Belaga”, thënie dhe urtësi, thënia 125. “Usulul kafij”, vëll. 2, f. 45 (me ndryshim të vogël shprehimor)

Më poshtë ajeti përmend shkakun e ndryshimit të religjioneve, edhe pse të gjitha kanë një të vërtetë dhe vijnë nga All'llahu. Ajeti thotë: **“Atyre që u është dhënë Libri, patën mospajtime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria...”**

Sipas ajetit, së pari, mospajtimi u shfaq pas dijes dhe njohjes së të vërtetave.

Së dyti, kanë qenë faktorët, si: padrejtësia, tirania dhe zilia. Jahuditët kishin mospajtime ndaj Musait, të birit të Imranit dhe luftuan njëri-tjetrin. Të krishterët ndryshuan në çështjen e Teuhidit, duke e përzierë atë me shirkun dhe trininë.

Të dy grupet, si jahuditët, ashtu edhe të krishterët, ndryshuan rreth çështjes së Islamit dhe argumenteve të vërtetësisë së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që gjendeshin në librat e tyre. Disa i pranorin e disa të tjerë i mohonin.

Çdo fe qiellore ka argumentet e saj të qarta dhe nuk gjendet paqartësi në to për çdo hulumtues rreth së vërtetës, p.sh. profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në shtesë të mrekullive dhe argumenteve të qarta në tekstet e fesë së tij, që dëshmojnë për vërtetësinë e profecisë së tij, shenjat dhe cilësitë e tij janë përmendur edhe në librat e mëparshëm qiellorë, një pjesë e të cilëve mbeti në duart e jahudijve dhe një tjetër në duart e të krishterëve.

Për këtë, dijetarët e tyre përgëzonin për ardhjen e tij (profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)) para se të vinte. Mirëpo, pasi erdhi dhe ata panë se interesi i tyre personal rrezikohej, e mohuan atë përgëzim dhe lajmërim.

“...Por kushdo që i mohon argumentet e All'llahut, ta dijë se All'llahu është i shpejtë në llogari.”

Ky është sqarim për fundin e atyre që mohojnë argumentet e All'llahut dhe shenjat e Tij. Vërtet, ata do ta shohin rezultatit e kësaj

pune të tyre, sepse All'llahu është i shpejtë dhe preçiz në llogaritjen e tyre.¹

Kuptimi i frazës *argumentet e All'llahut* përfshin shenjat, faktet dhe Librat e Tij qiellorë. Ajo, që thonë disa komentues se është e veçantë për Teuratin dhe Ungjillin, nuk ka argument.



¹ Shiko komentimin e ajetit 202 të sures “El-Bekare” për çështjen e *serial hisab-i shpejtë në llogaritje*.

Hulumtim

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se mospajtimet fetare nuk kanë ardhur nga padituria dhe mosnjohja e përhershme. Shkaku më i madh është padrejtësia, devijimi nga e vërteta dhe ndjekja e ideve të veçanta.

Sikur njerëzit, në përgjithësi, dhe dijetarët, në veçanti, të heqin dorë nga fanatizmi, zilia, mendimi i ngushtë, interesi individual, tejkalimi i kufijve dhe padrejtësia ndaj të tjerëve dhe të thelloheshin në studimet e rregullave të All'lahut, me shikim real dhe me shpirt drejtësie, do të gjejnë rrugën e vërtetë e të ndritur dhe shumë shpejt do t'i zgjidhin të gjitha mospajtimet.

Ky ajet është përgjigje për të gjithë ata që thonë se feja është shkak i gjakderdhjes në mesin e njerëzve gjatë historisë.

Ata e përziejnë fenë me fanatizmin fetar dhe me devijimet mendore. Nëse do t'i studiojmë mësimet e feve qiellore, do të gjejmë se të gjitha ato kanë një qëllim të vetëm e të përbashkët. Të gjitha kanë ardhur për lumturinë e njeriut, edhe pse janë plotësuar gradualisht me kalimin e kohës.

Fetë qiellore i përngajnë pikave të shiut, të cilat mbartin jetë. Nëse ato pika zbresin në toka jopjellore, si ato kripore, do të marrin vetinë e kësaj toke, pra, do të përzihen me kripën që mban toka. Ndryshimi nuk ndodhet tek pikat e ujit, por tek tokat. Mirëpo, sipas Parimit të plotësimit, feja e fundit e atyre feve është më e plota.

Ajeti 20

فَإِنْ حَاجُّوكَ فَقُلْ أَسْلَمْتُ وَجْهِيَ لِلَّهِ وَمَنِ اتَّبَعَنِ ۗ وَقُلْ لِلَّذِينَ أُوتُوا
 الْكِتَابَ وَالْأُمِّيِّينَ ءَأَسْلَمْتُمْ ۚ فَإِنْ أَسْلَمُوا فَقَدِ اهْتَدَوْا ۗ وَإِنْ تَوَلَّوْا
 فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلْغُ ۗ وَاللَّهُ بِصِيرِ الْعِبَادِ ۖ عَلِيمٌ

“Nëse ata të kundërshtojnë ty thuaju: “Unë i përulem vetëm All’llahut, e po ashtu edhe ata që më pasojnë mua.” Dhe thuaju atyre që u është dhënë Libri, si dhe analfabetëve: “A i përuleni All’llahut?” Nëse e pranojnë Islamin, atëherë kanë gjetur udhën e drejtë. Por, nëse refuzojnë, detyra jote është vetëm që t’ua përcjellësh dijen. All’llahu i vrojton robtë e Vet.”

Komentimi

El mehaxhaxhetu do të thotë përpjekje e njërit për të kundërshtuar tjetrin me argumentet që ka në mbrojtje të besimit të tij.

Është e natyrshme që ndjekësit e çdo feje të mbrojnë fenë e tyre, duke menduar se e drejta dhe e vërteta është me të. Për këtë, Kur’ani i drejtohet profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: “Ka mundësi që ithtarët e Librit (jahudijtë dhe të krishterët) të dialogojnë me ty dhe të këmbëngulin se janë myslimanë, me kuptimin që janë dorëzuar para së vërtetës, siç vepruan të krishterët e Nexhranit.”

Ajeti nuk i kërkon Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i shmanget debatit me ta, por e urdhëron që të ndjekë metodë tjetër. Kur biseda të arrijë në fund dhe, me qëllim që t'i udhëzojë, ta ndërpresë debatin dhe mosmarrëveshjen, t'u thotë atyre se unë dhe ndjekësit e mi i jemi dorëzuar All'llahut dhe ndjekim të vërtetën: **“Nëse ata të kundërshtojnë ty, thuaju: “Unë i përulem vetëm All'llahut, e po ashtu edhe ata që më pasojnë mua.”**

Pastaj, të pyesin ithtarët e Librit dhe politeistët se a janë dorëzuar para All'llahut dhe ndjekin të vërtetën? Nëse jo, atëherë ata duhet t'i binden logjikës së shëndoshë: **“Dhe thuaju atyre që u është dhënë Libri, si dhe analfabetëve: “A i përuleni All'llahut?” Nëse e pranojnë Islamën, atëherë kanë gjetur udhën e drejtë...”** Nëse nuk e pranojnë të vërtetën që gjendet para tyre, ata nuk janë përulur. Atëherë mos e vazhdo debatin me ta, sepse fjalët në këtë gjendje nuk gjejnë ndikim. Detyra jote është vetëm të përcjellësh mesazhin: **“Por, nëse refuzojnë, detyra jote është vetëm që t'ua përcjellësh dijen.”**

Është e qartë se kuptimi i dorëzimit nuk është ai që bëhet me fjalë. Kuptimi është për dorëzimin e vërtetë dhe praktik. Nëse ata u binden fjalëve të vërteta, patjetër do ta besojnë thirrjen tënde që bazohet te logjika dhe argumenti i qartë. Përndryshe ata nuk janë dorëzues para së vërtetës.

Shkurtimisht: Detyra jote o i Dërguar është përcjellja e mesazhit të mbushur me argumente dhe fakte. Nëse tek ata gjendet shpirti i hulumtimit dhe i studimit për të vërtetën, patjetër do të bëhen besimtarë. Nëse jo, padyshim që ti e kreve detyrën tënde ndaj tyre. Në fund ajeti thotë: **“...All'llahu i vrojton robtë e Vet.”**

All'llahu i Madhëruar e di kush është i vërtetë e kush jo. Po ashtu, Ai i di qëllimet e debatuesve dhe është i Mirinformuar për punët e tyre, të mirat dhe të këqijat, dhe sipas këtyre punëve do të shpërblejë dhe do të dënojë çdo njeri.

Hulumtime

1- Nga përmbajtja e ajetit përfitohet domosdoshmëria e largimit prej debatit me kokëfortët dhe ata që nuk i binden logjikës së shëndoshë.

2- Qëllimi i fjalës *ummijine-analfabetë*, që përmendet në ajet është për mushrikët. Shkaku se pse mushrikët quhen analfabetë është se ata nuk kanë libër qiellor, që t'i nxisë ata në lexim e shkrim, ndryshe nga jahudijtët dhe të krishterët.

3- Nga ky ajet sqarohet shumë mirë se metoda e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ka qenë imponimi i mendimit dhe i besimit. Metoda e tij ishte përpjekje për sqarimin e të vërtetave për njerëzit e më pas i lë ata të zgjedhin dhe të vendosin vetë për çështjen e ndjekjes së të vërtetës.

Ajetet 21 - 22

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ النَّبِيَّ بِغَيْرِ حَقٍّ
وَيَقْتُلُونَ الَّذِينَ يَأْمُرُونَ بِالْقِسْطِ مِنَ النَّاسِ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ
أَلِيمٍ ﴿٢١﴾ أُولَئِكَ الَّذِينَ حَبِطَتِ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمَا
لَهُمْ مِنْ نَّاصِرِينَ ﴿٢٢﴾

“Vërtet, ata që mohojnë shpalljet e All’l’lahut, vrasin profetët padrejtësisht dhe vrasin edhe ata që urdhërojnë të veprohet me drejtësi, lajmëroi për dënimin e dhembshëm që i pret. Këta janë ata, veprat e të cilëve nuk do të kenë vlerë në këtë botë dhe në Tjetrën. Për ata nuk do të ketë asnjë ndihmues.”

Komentimi

Shenjat e tiranisë

Pas ajetit të mëparshëm, që fliste për debatin e jahudijve dhe të krishterëve me profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për mosnënshtrimin e tyre ndaj së vërtetës, në ajetin e parë të ajeteve në fjalë tregohen disa shenja të kësaj çështjeje. Ajeti thotë: **“Vërtet, ata që mohojnë shpalljet e All'llahut, vrasin profetët padrejtësisht dhe vrasin edhe ata që urdhërojnë të veprohet me drejtësi...”**

Në fillim ajeti përmend tre gjynahe të mëdha: mohimi i shenjave të All'llahut, vrasja e profetëve padrejtësisht dhe vrasja e atyre që ftojnë në drejtësi dhe mbrojnë qëllimet e profetëve. Një gjynah prej këtyre është i mjaftueshëm që njeriun ta bëjë të pabindur, këmbëngulës në mohim dhe kokëfortë ndaj së vërtetës. Jo vetëm kaq, me këto gjynahe përpiqet të mbytytë çdo zë që fton në drejtësi dhe vërtetësi.

Frazat *jekfurune-mohojnë* dhe *jektulune-vrasin*, përmenden në formën e foljes së tashme, që tregon se mohimi i tyre dhe vrasja e të dërguarve dhe urdhëruesve në drejtësi, ka qenë prej programit të tyre dhe këto vepra i kryenin gjithmonë. (Në sintaksën e gjuhës arabe folja në kohën e tashme tregon vazhdimësi.)

Këto vepra, në të shumtën e rasteve, kryheshin nga jahudijtët dhe këtë e shohim edhe në ditët e sotme, por në një formë tjetër. Mirëpo kjo nuk e kufizon kuptimin e përgjithshëm të ajetit.

Më pas ajeti tregon tri dënime që i presin vepruesit e këtyre gjynaheve. Në fundin e ajetit të parë thuhet: **“...lajmëroi për dënimin e dhembshëm që i pret.”**

Fillimi i ajetit të dytë thotë: **“Këta janë ata, veprat e të cilëve nuk do të kenë vlerë në këtë botë dhe në Tjetrën...”**

Nëse supozohet se kanë bërë disa punë të mira, ato do të fshihen dhe do të zhduken për shkak të këtyre gjynaheve të mëdha që kryejnë.

Më pas ajeti thotë: **“...Për ata nuk do të ketë asnjë ndihmues.”** Askush nuk i mbron ata prej dënimit të All'llahut që i pret dhe askush nuk bën për ta shefat në atë Ditë.

Në komentimin e ajetit 61 të sures “Bekare” folëm për historinë e zezë të jahudijve, të cilët, përveç mohimit të shenjave të All'llahut, guxuan të vrisnin edhe të dërguarit, si dhe ndjekësit e të dërguarve. Mirëpo kjo nuk është e posaçme vetëm për jahudijtët, por përfshin çdo popull që vepruan dhe veprojnë si ata (jahudijtët).

Hulumtime

1- Thirrësit në drejtësi dhe urdhëruesit në punë të mira, ajeti i ka vendosur me profetët, ndërsa mohuesit e shenjave të All'llahut, vrasësit e profetëve dhe të të drejtëve i ka vendosur përkrah njëri-tjetrit. Kjo nxjerr në pah interesimin e Islamit për përhapjen e drejtësisë në shoqëri.

Në ajetin e dytë sqarohet dënimi i ashpër që bie mbi ata që vrasin njerëzit e drejtë. Më parë thamë se fjala *el habtu* nuk i përfshin të gjitha gjynahet, por përfshin vetëm gjynahet e mëdha, që zhdukin gjurmët e punëve të mira.¹

2- Frazja *bi gajri hake-padrejtësisht*, nuk do të thotë se është e mundur vrasja e tyre me të drejtë. Por kuptimi i saj është se vrasja e profetëve kryhej gjithmonë padrejtësisht. Kjo frazë është sqaruese dhe përforcuese.

3- Nga fraza: **“...lajmëroi për dënimin e dhembshëm që i pret.”**, përfitohet se ai përfshin edhe mohuesit në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndërkohë që ne e dimë se ata nuk kanë vrarë asnjë profet. Më parë kemi thënë se, kushdo që është i kënaqur me punën e një populli, ose me sjelljet e tyre, ose me mendimet e tyre, ai është partner i tyre në të mira apo në të këqija.

Përderisa mohuesit në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), veçanërisht jahudijtët, ishin të kënaqur me punët e këqija dhe krimet e të shkuarve të tyre, ata do të jenë partnerët e tyre edhe në dënimin që i pret ata.

4- *El Besharatu* do të thotë *përgëzimi i një tjetri me lajm të kënaqur*. Përdorimi i kësaj fjale në këtë ajet dhe në ajete të tjera, është një lloj kërcënimi dhe talljeje me të menduarit e gjynahqarëve.

¹ Shiko komentimin e ajetit 217 të sures “El-Bekare”.

Kjo është e ngjashme me thënien që përdorim kur i themi atij që punon keq: “Mirë, do të të shpërblej për atë që bëre.”

5- Në një transmetim thuhet se Ebi Ubejdeh el Xherah e ka pyetur profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Cilët njerëz do të dënohen më rëndë në Ahiret?”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë: **“Ai njeri, që vret një të dërguar apo vret një njeri që urdhëron në të mira dhe ndalon nga të këqijat...”** Pastaj lexoi: “...vrasin profetët padrejtësisht dhe vrasin edhe ata që urdhërojnë të veprohet me drejtësi...”

Pastaj Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“O Aba Ubejdeh. Bijtë e Izraelit kanë vranë dyzet e tre të dërguar në fillim të ditës dhe për një orë.”**

Pas kësaj ndodhie u ngritën njëqind e dymbëdhjetë burra prej robve të bijve të Izraelit për të urdhëruar për mirë dhe për të ndaluar të këqijat. Ata u vranë të gjithë në fundin e ditës. Kjo është ajo që përmend All'llahu: **“...lajmëroi për dënimin e dhembshëm që i pret.”¹**

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 423. Tefsijri “Durrul Menthur”, vëll. 2, f. 13.

Ajetet 23 – 25

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيبًا مِّنَ الْكِتَابِ يُدْعَوْنَ إِلَى كِتَابِ اللَّهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ يَتَوَلَّى فَرِيقٌ مِّنْهُمْ وَهُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿٢٣﴾ ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا لَنْ تَمَسَّنَا النَّارُ إِلَّا أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ وَغَرَّهُمْ فِي دِينِهِمْ مَا كَانُوا يَفْتُرُونَ ﴿٢٤﴾ فَكَيْفَ إِذَا جُمِعْتَهُمْ لِيَوْمٍ لَا رَيْبَ فِيهِ وَوُفِّيَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٥﴾

“A nuk i sheh ata (hebrenj) që u është dhënë një pjesë e Librit?! A tyre iu bëhet thirrje të vijnë te Libri i All’llahut për të gjykuar mes tyre, por një pjesë e tyre kthejnë shpinën, duke mos ia vënë veshin.

Kjo, sepse ata thonë: “Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehennemit, përveçse disa ditë.” Shpifjet që bënin i kanë mashtruar ata në besimin e vet. Çfarë do të ndodhë me ata, kur t’i tubojmë në Ditën (e Gjykimit), për të cilën s’ka pikë dyshimi, kur çdokujt do t’i jepet shpërblimi i veprave të veta e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi?”

Shkaku i zbritjes

Në tefsijrin “Mexhmaul Bejan” ndodhet një transmetim nga Ibn Abbasi, i cili ka transmetuar se në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) një jahudi bëri zina (kurvllëk) me një grua të martuar.

Edhe pse në Teurat thuhet se këta të dy duhen dënuar me gjuajtje gurësh, ata nuk u dënuan, sepse ishin prej të mëdhenjve dhe të pasurve. Jahudijtët ranë dakord që të shkojnë tek Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të gjykonte, duke shpresuar që këta të dy të merrnin një dënim të lehtë.

Mirëpo profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e miratoi dënimin e caktuar për ta. Disa të mëdhenj jahudij e kundërshtuan vendimin e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e mohuan praninë e këtij dënimi tek jahudijtët.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: **“Mes meje dhe jush është Teurati.”**

Ata pranuan dhe ftuan Ibn Surenë, një nga dijetarët e tyre të mëdhenj, që ndodhej në Fedek, në Medine. Kur Ibn Sureja mbërriti, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e njohu dhe e pyeti: **“Ti je Ibn Sureja?”**

-“Po.” - iu përgjigj.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: **“Ti je më i dituri i jahudijve?”**

Jahuditi i tha: “Kështu më llogarisin.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi që të hapin Teuratin aty ku përmendet gurëzimi (rexhmi) dhe ta lexojë. Mirëpo ai, duke qenë i ditur për detajet e Teuratit, lexoi një pjesë të Teuratit dhe, kur arriti te fjala e rexhmit quajtes me gurë,

vendosi dorën e tij mbi të dhe e kaloi duke mos e lexuar. Këtë e kuptoi Abdullah ibn Selam, i cili ishte prej dijetarëve jahudij, pastaj u bë mysliman. Iu afrua dhe ia ngriti dorën nga verseti që e kishte mbuluar dhe i tha: “Nëse konstatohet kurvëria e burrit të martuar me gruan e martuar, jahudijtët duhet t’i gurëzojnë.”

Atëherë, profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi zbatimin e dënimit sipas sheriatit të tyre. Disa jahudij u zemëruan dhe për ta zbriti ajeti.¹



Shoqata

Komentimi

Fladi

Ky ajet flet qartë për disa devijime dhe falsifikime të ithtarëve të Librit, të cilët përdornin mënyra dhe shkaqe të pabaza për shfajësim, që të mos zbatonin urdhrat e All’llahut. Përderisa Libri i tyre e qartësonte rregullin e All’llahut, për këtë ata u ftuan që t’i nënshtrohen rregullit që ndodhej në Librin e tyre. **“A nuk i sheh ata (hebrenj) që u është dhënë një pjesë e Librit?! Atyre iu bëhet thirrje të vijnë te Libri i All’llahut për të gjykuar mes tyre ...”**

Mirëpo, kundërshtimi i tyre ishte i dukshëm dhe i shoqëruar me qëndrim negativ ndaj rregullave të All’llahut. **“...por një pjesë e tyre kthejnë shpinën, duke mos ia vënë veshin.”**

¹ Në Teuratin sotëm, tek Seferul Evvelijne, kreu i njëzetë, fjalja e dhjetë thotë: “Kur një burrë bën kurvëri me një grua tjetër, p.sh., gruan e komshiut, jahudijtët duhet t’i vrasin, si kurvarin, ashtu edhe kurvën.”

Edhe pse gurëzimi nuk përmendet, por thuhet dënimi me vdekje. Ka mundësi që rregulli i gurëzimit ndodhej në kopjen që gjendej në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 9, f. 69.

Nga fjalia “...që u është dhënë një pjesë e Librit...” mund të arrihet në përfundim se Teurati dhe Ungjilli, që ndodhej në duart e jahudijve dhe të krishterëve, nuk kanë qenë të plotë, por ishte një pjesë atyre librave në duart e tyre, sepse pjesa më e madhe e këtyre dy librave qiellorë kishte humbur ose ishte devijuar.

Këtë ajet e përforcojnë ajetet e tjera të Kur’anit. Po ashtu, ka edhe dëshmi dhe argumente historike, që dëshmojnë dhe përforcojnë atë që thamë.

Në ajetin e dytë sqarohet shkaku i kundërshtimit, i kokëforcisë dhe i mosbindjes së tyre. Ai është se ata kishin mendim të gabuar dhe hiqeshin si populli i zgjedhur. Edhe sot në librat e tyre po të njëjtin mendim të kotë kanë.

Ata mendonin se kanë marrëdhënie të veçanta me All’llahun, sa dhe veten e tyre e quanin “bir i All’llahut”, siç e përmend Kur’ani nëpërmjet gjuhës së jahudijve dhe të krishterëve në ajetin 18 të sures “El-Maide”: **“Hebrenjtë dhe të krishterët thonë: “Ne jemi bijtë e All’llahut dhe të dashurit e Tij.”**

Sipas kësaj, ata mendonin se janë të mbrojtur nga dënimi i All’llahut, duke thënë se All’llahu u ka thënë. Për këtë ata besonin se në Ditën e Kiametit nuk do të dënoheshin për gjynahet e bëra më shumë se disa ditë: **“Kjo, sepse ata thonë: “Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehennemit, përveçse disa ditë.”**

Ka mundësi që qëllimi i thënies **“përveç disa ditë”** të jetë për dyzet ditët që adhuruan viçin, kur nuk ishte i pranishëm hazreti Musa (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!). Adhurimi i viçit ishte një gjynah aq i madh, saqë as vetë ata nuk mund ta mohonin. Mund të jetë fjala për ditët e pakta prej jetës së tyre, në të cilat bënë gjynahe të mëdha, që nuk mohoheshin dhe as që mund të fshiheshin.

Këto dallime të kota dhe shpifjet, me të cilat ngjyrosën veten e tyre dhe ia mvëshën All’llahut, dalëngadalë u bënë pjesë e besimit dhe e mendjemadhësisë së tyre. Ata filluan të kundërshtojnë rregullat e

All'lahut. **“Shpifjet që bënëin i kanë mashtruar ata në besimin e vet.”**

Ajeti i tretë ua fshin të gjitha këto hamendësime dhe fantazi të pabaza. Ajeti thotë se ata padyshim do të tubohen në Ditën ku të gjithë njerëzit do të dalin përpara Gjykatës së drejtë të All'lahut dhe secilit prej tyre do t'i jepet regjistri i punëve të veta.

Ata do të korrin atë çfarë mbollën. Sido dhe sado që të jetë dënimi i tyre, atyre nuk u bëhet padrejtësi, sepse ai dënim vjen nga punët që kanë bërë: **“Çfarë do të ndodhë me ata, kur t'i tubojmë në Ditën (e Gjykimit), për të cilën s'ka pikë dyshimi, kur çdokujt do t'i jepet shpërblimi i veprave të veta e askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi?”**

Nga fraza *ma kesebet-ato që ka bërë*, sqarohet se dënimi dhe shpërblimi i njeriut në Ditën e Kiametit janë të lidhur me vetë punët e tyre dhe asgjë tjetër nuk ndikon në atë ditë. Kjo e vërtetë përmendet në disa ajete të Kur'anit Fisnik.

Dy pyetje

1- A mundet që njeriu të shpifë dhe t'ia mveshë All'lahut, pastaj të ndikohet prej saj, duke u bërë mendjemadh deri në atë shkallë që e përmendi Kur'ani për jahudijtët?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk është e vështirë, sepse çështja e mashtrimit të vetes është prej çështjeve që e pohon edhe shkenca e psikologjisë bashkëkohore. Ka raste që mendja e njeriut përpiket ta bëjë të pavëmendshme ndërgjegjen, duke ia ndryshuar formën së vërtetës. Të shumtë janë njerëzit e ndotur me gjynahe të mëdha, si: vrasja, vjedhja e të ngjashme me to.

Edhe pse ata e kuptojnë të shëmtuarën e këtyre punëve, përpiqen që t'i paraqesin si viktima të tyre, duke ngjyrosur ndërgjegjen me ngjyrën e qetësisë. Të shumtë janë të droguarit që e shfajësojnë

këtë vepër të tyre, duke thënë se duan t'i largohen vështirësive të jetës dhe problemeve të saj.

Pastaj, ato shpifje dhe gënjeshtër raciste, që ndodheshin te brezat e shkuar të ithtarëve të Librit, gradualisht arritën edhe tek brezat pasardhës, të cilët as nuk i njohin këto çështje dhe as që hulumtojnë për të vërtetën, si pjesë e besimit të tyre.

2- Mund të thuhet se besimi i dënimit vetëm për disa ditë të numëruara është përhapur edhe në mesin e myslimanëve, sepse ne besojmë që myslimani nuk qëndron përherë në dënim dhe se besimi i tyre do t'i shpëtojë ata prej zjarrit.

Këtu duhet të përforcojmë se ne nuk mund të besojmë që një mysliman i ndotur me gjynahe të ndryshme, do të dënohet vetëm disa ditë. Ne besojmë se dënimi i tyre zgjat me vite e vite, që askush nuk e di gjatësinë e tij. Atë e di vetëm All'llahu. Por dënimi i tyre nuk është i përhershëm. Nëse në mesin e myslimanëve ka të tillë, që mendojnë se janë të mbrojtur nga Islami dhe nga besimi te profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe u lejohet të bëjnë çfarë të duan prej gjynaheve, se do të dënohen veçse disa ditë, gabojnë rëndë dhe janë të paditur për mësimet e Islamit.

Ne nuk pohojmë për asnjë dallim të myslimanëve. Ne besojmë se çdo popull, që ndjek profetin e kohës së tij dhe bën gjynahe, është i përfshirë në ligjin e dënimit.

Në ajetin 18 të sures "El-Maide" ndodhet përgjigjja për jahudijtët, që e veçojnë veten e tyre nga të tjerët, duke thënë se janë të zgjedhur: **"Jo! Ju jeni njerëz nga ata që Ai ka krijuar..."**

Ajetet 26 - 27

قُلِ اللَّهُمَّ مَلِكُ الْمَلِكِ تُؤْتِي الْمَلِكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمَلِكَ مِمَّنْ تَشَاءُ
وَتُعِزُّ مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ بِيَدِكَ الْخَيْرُ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٦﴾
تُولِجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَتُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَمِيتِ
وَتُخْرِجُ الْمَمِيتَ مِنَ الْحَيِّ وَتَرزُقُ مَنْ تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٢٧﴾

“Thuaj: “O All'lah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe që dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.”

Shkaku i zbritjes

Komentuesi i njohur Tabarsiu, në komentimin e tij “Mexhmaul Bejan”, përmend dy shkaqe të zbritjes së këtyre dy ajeteve, që flasin për një të vërtetë të përbashkët.

1- Kur u çlirua Meka, profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i përgëzoi myslimanët se perandoria perse dhe ajo romake së shpejti do të mposhten nën flamurin e Islamit.

Mirëpo, hipokritët, zemrat e të cilëve nuk ishin ndriçuar me dritën e besimit dhe nuk e kishin kuptuar të vërtetën e Islamit, e konsideruan këtë lajm përgëzues si ekzagjerim. Të habitur thanë: “Muhammedi nuk është kënaqur me Mekën dhe Medinen. Ai lakmon të pushtojë persët dhe romakët.” Atëherë zbrit ajeti.¹

2- Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët po punonin për hapjen e hendeqeve në dalje të Medines. Myslmanët u ndanë në grupe dhe punonin shpejt, me qëllim që ta mbaronin këtë barrikadë mbrojtëse para mbërritjes së ushtrisë së armikut.

Papritur, në mes të hendekut, doli një shkëmb i madh, i bardhë dhe i lëmuar. Myslmanët nuk kishin mundësi ta thyenin e ta lëviznin shkëmbin. Selman Farisiu shkoi te profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e lajmëroi. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) zbriti në hendek. Ia mori levën Selmanit dhe i gjuajti fort shkëmbit. Prej tij dolën shkëndija. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bërtiti duke bërë tekbiyr triumfi. Myslmanët e përsërisnin pas tij dhe zëri i tyre u përhap në gjithë vendin.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan” fundi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 17, f. 169 dhe 170.

Përsëri Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e goditi shkëmbin me levën dhe nga ai dolën shkëndija. U thye një copë prej tij. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët brohoritën “All'llahu ekber!”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e goditi për herë të tretë shkëmbin dhe përsëri dolën shkëndija, që e ndriçuan vendin dhe shkëmbi u thye. Në hendeqe u dëgjuan brohoritmat e myslimanëve.

Selmani i tha Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Ti je babai dhe nëna ime o i dërguar i All'llahut! Unë pashë diçka që s’e kam parë deri tani tek ti.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ktheu kokën dhe u tha të pranishmëve: **“A e dëgjuat çfarë tha Selmani?”**

Ata u përgjigjën: “Po, o i Dërguari i All'llahut.”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: **“Kur godita herën e parë, ju i patë shkëndijat që dolën. Ato shkëndija ndriçuan pallatet e Hijerah dhe qytetet e Kisras dhe dukeshin si dhëmbët e qenve. Xhebraili më lajmëroi se ymmeti im do ta sundojë atë. Pastaj godita për së dyti dhe, nga shkëndijat që ju patë, m’u ndriçuan pallatet e kuqe të romakëve, që dukeshin si dhëmbët e qenit. Kur godita për së treti dhe dolën shkëndijat që ju i patë, m’u ndriçuan pallatet e San’asit, që dukeshin si dhëmbët e qenit. Xhebraili më lajmëroi se ymmeti im do të jetë do ta sundojë. Gëzohuni o myslimanë dhe falënderojeni All'llahun!”**

Hipokritët u vrenjtën në fytyrë dhe thanë me zë kundërshtimi: “Ëndërr e kotë dhe premtim i pamundur! Ata po gërmojnë hendeqe

prej frikës së ushtrisë së vogël dhe i frikësohen përbaljes me të e dashkan të përballen me më të madhin shtet në botë.”

Pastaj zbriti ajeti në fjalë.¹

Komentimi

Në dorë të Tij është gjithçka

Në ajetet e mëparshme u fol për mushrikët dhe për ithtarët e Librit, të cilët e quanin veten e tyre më të fortë dhe zotëronin pushtet. Po ashtu flisnin se si ata mendonin se nuk ia kanë nevojën Islamit.

Këto dy ajete zbritën për të hedhur poshtë pretendimet e tyre të kota. Ajeti thotë: **“Thuaj: “O All’llah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash...”**

Padyshim, pronari i vërtetë i gjithçkaje është Krijuesi i tyre. Ai i jep pushtet kujt të dojë dhe ia heq atij që do. Ai lartëson dhe poshtëron. Ai është i Plotfuqishëm për të gjitha këto. **“...Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”**

Nuk është nevoja të thuhet se dëshira e All’llahut në këto ajete nuk ka kuptimin se Ai jep e heq pa llogari dhe pa shkak. Por, dëshira e Tij është e bazuar te urtësia, rregulli dhe interesi i botës krijuese. Sipas kësaj, çdo vepër e All’llahut është më e mira dhe më e sakta.

“...Çdo e mirë është në Dorën Tënde...”

Fjala *kebajrun* është në formën e *sipërorit* dhe ka kuptimin e *epërsisë së diçkaje mbi diçka tjetër*. Kjo fjalë përdoret edhe për çdo gjë të mirë pa kuptimin e sipërorit.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan” fundi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 17, f. 170 dhe 171.

Fraza: “...Çdo e mirë është në Dorën Tënde...” e kufizon të qenit e çdo të mire në dorën e All'llahut në dy anë:

1- Prania e shkronjës *elif* dhe *lam* që janë për *istigrakë-gjithëpërshirje*.

2- Përmendja në fillim e kallëzuesit *në dorën Tënde* para kryefjalës *el kbajr*, e mira tregon për kufizim. Atëherë kuptimi është: Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde dhe jo në dorë të dikujt tjetër.

Po ashtu, nga fraza “...Çdo e mirë është në Dorën Tënde...” përfitohet se All'llahu është burimi i të gjitha të mirave dhe i lumturisë. Nëse e lartëson dikë apo e poshtëron, ose i jep pushtet dhe sundim, ose ia heq, këtë e bën me drejtësi dhe në këto veprime të Tij nuk ka të keqe, sepse e mira e të këqijve është që të jenë në burg dhe e mira e të mirëve është që të jenë të lirë.

Me fjalë të tjera: Në këtë botë nuk ka të keqe. Ne jemi ata që e shndërrojmë të mirën në të keqe. Ajeti kufizon vetëm të mirën në dorën e All'llahut dhe nuk flet për të keqen, kjo për shkak se e keqja nuk buron kurrë nga Veta e Shenjtë.

“Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”

Ky është argument i ajetit të mëparshëm, që do të thotë se, përderisa All'llahu ka fuqi absolute, Atë nuk e pengon asgjë që të gjitha të mirat t'i jenë nënshtruar dëshirës së Tij.

Udhëheqjet e drejta dhe të padrejta

Këtu lind një pyetje e rëndësishme: Disa mund të nxjerrin si përfundim se ai, që arrin në postin e pushtetit ose rrëzohet prej tij, bëhet me dëshirën e All'llahut. Prandaj duhet të pranohen udhëheqjet e të padrejtëve në histori, si: Xhengiz Khan, Hitleri, etj. Në histori lexojmë se Jezid ibn Muavijeh, për të shfajësuar udhëheqjen e tij të padrejtë, u bazua te ky ajet.¹

¹ Tefsijri “Mizan”, vëll. 3, f. 143.

Për këtë, në librat e komentimit shohim sqarime të ndryshme rreth kësaj paqartësie. Prej atyre është mendimi se ajeti është i veçantë për qeverisjet hyjnore apo mendimi se është e posaçme për udhëheqjen e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e cila e zhduku udhëheqjen tirane të kurejshëve.

Duhet të dimë që All'llahu ka vendosur shkaqe për përparimin dhe suksesin në jetë. Përfitimi nga ato shkaqe dhe faktorë është vetë dëshira e All'llahut, që do të thotë se dëshira e All'llahut janë gjurmët që gjenden në ato shkaqe dhe faktorë. Nëse të padrejtët, si: Xhengijzi, Jezidi dhe Faraoni, i shfrytëzojnë ato shkaqe dhe faktorë të suksesit dhe njerëzit e dobët e frikacakë u nënshtrohen atyre, duke përballuar udhëheqjen e tyre të padrejtë, kjo është prej punëve të atij populli. Më parë thuhej: Si të jeni, do te keni udhëheqës.

Mirëpo, nëse popujt janë të vëmendshëm, kuptues dhe ato shkaqe apo faktorë ua heqin nga duart të padrejtëve dhe ia japin të drejtëve për të formuar qeveri të drejtë, edhe kjo është si pasojë e punëve të tyre dhe rezultat i mënyrës së përfitimit prej atyre shkaqeve të All'llahut.

Në realitet ajeti fton njerëzit dhe shoqëritë që gjithmonë të jenë të vëmendshëm dhe syçelë dhe të përfitojnë prej shkaqeve dhe faktorëve të suksesit e të triumfit. Ata duhet t'i zotërojnë postet delikate para se t'i zënë njerëzit e padrejtë.

Përmbledhje e fjalëve: Vërtet, dëshira e All'llahut është vetë bota e shkaqeve. Ndryshimi është te mënyra e përfitimit prej këtyre shkaqeve.

Në ajetin pasardhës gjendet dëshmi dhe përforcim i sundimit absolut të All'llahut mbi të gjitha krijesat. Ajeti thotë:

1- “Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe që dita të hyjë tek nata...”

Këtu ajeti tregon për disa nga të vërtetat e dukshme të fuqisë së All'llahut të Madhëruar. Prej tyre është ndryshimi gradual i natës dhe i ditës. Me kuptimin që nata shkurtohet në gjysmën e vitit, si rrjedhim ne themi që nata ka hyrë te dita. Ndërsa dita shkurtohet në gjysmën tjetër të vitit, që është hyrja e ditës te nata.

Po ashtu, prej atyre të vërtetave të fuqisë absolute të All'llahut është nxjerrja e së gjallës prej së vdekurës dhe e kundërta, dhurimi i shumtë që është pjesë e disa njerëzve dhe disa të tjerëve jo. Të gjitha këto janë Shenja të fuqisë absolute të All'llahut të Madhëruar.



**Shoqata
Hulumtim**

Fladi

Fjala *el uluxh* do të thotë *hyrje*. Qëllimi i kësaj fjale në këtë ajet është ndryshimi gradual mes natës dhe ditës, që e shohim gjatë vitit. Ky ndryshim ndodh nga devijimi i boshtit të tokës nga epiqendra e saj rreth 23 gradë, si dhe nga ndryshimi i rënies së rrezeve të diellit mbi të.

Shohim se ditët e dimrit, në pjesën veriore të Ekuatorit, zgjaten gradualisht, kurse nata shkurtohet gradualisht. Kjo vazhdon deri në fillim të verës, ku ndryshimi merr drejtim tjetër, nata shkurtohet dhe dita zgjatet. E kundërta ndodh në dimër, ku nata zgjatet dhe dita shkurtohet, kurse në jug të ekuatorit është e kundërta.

Bazuar në këtë, All'llahu e fut natën në ditë dhe ditën në natë gjithmonë, që do të thotë, pakëson njëren dhe shton tjetren.

Dikush mund të thotë se dita dhe nata në Ekuator dhe në Polin e Veriut e të Jugut janë të barabarta dhe nuk shihet asnjë ndryshim. Në Ekuator nata dhe dita janë nga 12 orë secila gjatë gjithë vitit, dhe në Polin e Veriut dhe të Jugut nata është gjashtë muaj, po ashtu dita është gjashtë muaj. Prandaj, ajeti nuk është përgjithësues.

Përgjigjja: Vija ekuatoriale nuk është e vërtetë, ajo është imagjinare. Zakonisht njerëzit banojnë në të dy anët e ekuatorit. Po ashtu, edhe dy polet janë dy pika imagjinare. Banorët e dy poleve, nëse ka, natyrisht që jetojnë në zona më të gjera prej pikës së polit të vërtetë. Kështu që ndryshimi është i pranishëm në çdo rrethanë.

Ka mundësi që ajeti të ketë edhe kuptim tjetër, në shtesë të atij që përmendëm, që është: Nata dhe dita nuk ndodhin befasisht në rruzullin tokësor për shkak të shtresave të ajrit rreth saj. Dita fillon gradualisht prej agimit dhe hapet, zgjerohet. Nata fillon prej horizontit të kuq perëndimor dhe muzgut e pastaj errësira mbulon çdo gjë.

Vërtet, në ndryshimin gradual të natës dhe të ditës, me çdo lloj kuptimi qoftë, ka shenja të dobishme në jetën e njerëzve dhe të krijesave të tjera në tokë, sepse, rritja dhe zhvillimi i shumicës së bimëve dhe kafshëve arrihet nëpërmjet dritës së diellit dhe ngrohtësisë së tij graduale.

Në fillim të pranverës, në të cilën drita dhe nxehtësia e diellit shtohen gradualisht, bimët dhe kafshët për çdo ditë shpалosin një fazë të re në rritjen dhe zhvillimin e tyre. Përderisa këto krijesa, me kalimin e kohës, kanë nevojë për më shumë dritë dhe nxehtësi, për të arritur në fazën përfundimtare të rritjes, kjo nevojë e tyre plotësohet me ndryshimet graduale të natës dhe të ditës.

Sikur nata dhe dita të mos jenë të tilla, shumë bimë dhe kafshë nuk mund të rriten e të zhvillohen. Po ashtu, do të ndryshojnë edhe katër stinët, të cilat lindin si rezultat i natës dhe i ditës dhe i rënies së dritës së diellit.

Edhe sikur të marrim në konsideratë kuptimin e dytë në komentimin e ajetit, dukuria e natës dhe e ditës janë graduale dhe jo të papritura dhe të themi se janë dy lindjet që i ndajnë me njëra-tjetrën.

Nga kjo sqarohet se gradualiteti në ardhjen e ditës e të natës është mirësi e madhe për banorët e tokës, sepse ata njihen gradualisht

me dritën dhe errësirën, dhe, si pasojë, fuqitë e tyre trupore dhe jeta e tyre shoqërore përputhen me këtë ndryshim. Nëse do të ndodhte e kundërta, do të kishim probleme të mëdha.

2- “Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës.”

Kuptimi i nxjerrjes së gjallës nga e vdekura është dukja e jetës prej gjallesave që nuk ekzistonin. Ne e dimë se ditën që toka u bë e aftë dhe u përgatit për jetë, erdhën edhe krijesat nga e paqena. Në shtesë të kësaj, lëndët jojetësore të saj në vazhdim bëhen pjesë e qelizave të gjalla dhe qelizat e të gjitha gjallesave në botë dhe shndërrohen në lëndë jetësore.

Ndërsa nxjerrja e së vdekurës nga e gjalla është dukuri e përhershme, që e shohim edhe me sytë tanë.

Ajeti tregon për ligjin e ndryshimit të përhershëm mes jetës dhe vdekjes. Ky është ligji më i përgjithshëm dhe më delikati që na sundon. Në të njëjtën kohë është më i mrekullueshmi.

Për këtë ajet gjendet edhe një komentim tjetër, i cili nuk e kundërshton komentimin e parë. Ai ka të bëjë me jetën dhe vdekjen shpirtërore.

Kur'ani, në shumë ajete të tija, e konsideron jetën dhe vdekjen shpirtërore me besimin dhe mohimin.

Njeriu dallohet me lirinë e dëshirës dhe nuk është si krijesat e tjera jofrymore, të cilat ndikohen nga faktorë të ndryshëm. Kjo në vetvete është dukuri e fuqisë së All'llahut, me të cilën heq gjurmët dhe ndikimet e mohimit prej shpirtëve të atyre që kërkojnë pastrim dhe dëshirojnë vërtet të jenë besimtarë. Po ashtu, heq gjurmët e besimit prej besimtarëve që dëshirojnë të jenë jobesimtarë. Kjo pavarësi në

dëshirë, e aftë për triumf edhe në situatë jo normale, është prej dukurive të fuqisë së All'llahut të Madhëruar.

Ky kuptim gjendet edhe në një hadith të profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*), që ndodhet në tefsijrin “Durrul Menthur”, i cili e ka komentuar fjalinë e ajetit: **“Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës...”** duke thënë: “Ai e nxjerr besimtarin prej shtyllës kurrizore të mohuesit dhe e nxjerr mohuesin prej shtyllës kurrizore të besimtarit.”¹

3- “Ti i jep kujt të duash pa kufij.”

Kjo fjali e ajetit konsiderohet si përmendje e së përgjithshmes pas së veçantës. Ajetet e mëparshme përmendën shembuj prej mirësive të All'llahut, kurse këtu, ajeti tregon për të gjitha mirësitë në përgjithësi, që do të thotë se, jo vetëm krenaria, pushteti, jeta, vdekja janë në dorën e All'llahut, por të gjitha mirësitë dhe begatitë.

Shprehja *pa llogari* tregon se deti i pafund i mirësive të All'llahut kurrë nuk pakësohet dhe nuk mund të llogaritet, sado që të japë. Regjistrimi i llogaritjeve në fletore financiare është zakon i të pasurve që zotërojnë pasuri të përkohshme, të cilët frikësohen prej pakësimit dhe zhdukjes. Ata bëjnë llogari para se të japin diçka. All'llahu nuk i frikësohet pakësimit, askush nuk i kërkon Atij llogari dhe Ai nuk ka nevojë për llogaritë.

Nga ajo që thamë sqarohet se ky ajet nuk është në kundërshtim me ajetet që flasin për caktimin e All'llahut.

4- Në këtë çështje nuk ka detyrim

Këtu shtrohet një pyetje: Ne e dimë që njeriu është i lirë në fitimin e riskut të tij dhe nuk është i detyruar. E kjo sipas ligjit të

¹ Tefsijri “Durrul Menthur”, vëll. 2, f. 15. “Biharul Anuar”, vëll. 6, f. 156.

krijimit, thëniet e profetëve dhe gjykimit të mendjes. Atëherë, përse ky ajet thotë që çdo gjë është në dorën e All'llahut?

Në përgjigje të pyetjes themi se burimi dhe zanafilla e krijimit dhe e gjithçkaje që ekziston dhe që ndodhet në duart e njerëzve është All'llahu i Vetëm e i Pashoq. Ai i ka vendosur shkaqet dhe mjetet për njerëzit, që të arrijnë lumturinë.

Ai ka vendosur ligjet në galaktikë, të cilat, nëse njerëzit nuk do të interesoheshin, do të përfundonin në poshtërim dhe fatkeqësi. Për këtë, çdo gjë është në dorën e Tij dhe nuk gjendet kundërshtim mes kësaj dhe dëshirës së njerëzve, sepse njeriu është ai që i përdor këto ligje, rregulla, dhunti e fuqi në mënyrë të rregullt ose të parregullt.



*Shaykh
Flladi*

Ajeti 28

لَا يَتَّخِذِ الْمُؤْمِنُونَ الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ وَمَنْ يَفْعَلْ
ذَلِكَ فَلَيْسَ مِنَ اللَّهِ فِي شَيْءٍ إِلَّا أَنْ تَتَّقُوا مِنْهُمْ تُقَنَّةً وَيُحَذِّرْكُمْ
اللَّهُ نَفْسَهُ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ

“Besimtarët të mos i marrin për miq e mbrojtës mohuesit, në vend të besimtarëve. Ata që veprojnë kështu, nuk kanë çfarë të shpresojnë tek All’llahu, vetëm nëse këtë e bëjnë (me gojë e jo me zemër) për t’u ruajtur nga ata. All’llahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij, sepse të gjithë do të ktheheni tek All’llahu.”

Komentimi

Marrëdhëniet me të huajt

Ajeti i mëparshëm përmendi se krenaria, lartësimi, poshtërimi dhe të gjitha të mirat janë në dorën e All’llahut të Madhëruar. Ky ajet i paralajmëron besimtarët që të mos shoqërohen me mohuesit dhe i ndalon rreptësisht që t’i marrin për miq e mbrojtës ata.

Kjo sepse, nëse kjo miqësi dhe shoqëri do të jetë për qëllim lartësie, krenarie dhe pasurie, të gjitha këto janë në dorën e All’llahut. Prandaj, edhe ajeti thotë: “Besimtarët të mos i marrin për miq e mbrojtës mohuesit, në vend të besimtarëve...”

Sikur një besimtar ta bëjë këtë punë, ai i ka prerë plotësisht lidhjet me All'llahun: **“Ata që veprojnë kështu, nuk kanë çfarë të shpresojnë tek All'llahu...”**

Ky ajet ka zbritur në kohën që mes myslimanëve, mohuesve e politeistëve prej jahudijve dhe të krishterëve gjendeshin lidhje.

Ky ajet është një mësim politik dhe social për myslimanët. Ai i paralajmëron ata që të mos mashtrohen prej fjalëve të ëmbla të tyre dhe as nga shfaqja e dashurisë që ata paraqesin, se gjoja janë të dashur me myslimanët. Historia ka treguar se goditjet më të forta myslimanët i kanë marrë nga kjo lloj metode.

Sikur t'i hedhim një vështrim historisë kolonizuese, do të vërejmë se kolonizuesit gjithmonë kanë hyrë në një vend me petkun e miqësisë, dhembshurisë, dëshirës për ta ndërtuar një vend, duke depërtuar në mesin e shtresave të shoqërisë.

Fjala *isti'mar*, që ka kuptimin *e ndërtimit*, është argument i këtij mashtrimi. Pasi forcohen në një vend nëpërmjet kthetrave të tyre në rrënjët e shoqërisë së atij vendi, fillojnë me pirjen e gjakut të popullit të atij vendi pa mëshirë e dhembshuri.

Togfjalëshi i ajetit: **“...në vend të besimtarëve...”** tregon se njerëzit në jetën e tyre shoqërore duhet të kenë miq dhe shokë. Prandaj besimtarët duhet t'i zgjedhin miqtë nga mesi i tyre dhe jo nga mesi i mohuesve.

“...nuk kanë çfarë të shpresojnë tek All'llahu...”

Kuptimi i kësaj fjalie të ajetit është se ata, që lidhin shoqëri me armiqtë e All'llahut, nuk marrin asgjë prej All'llahut, sepse ata u larguan nga përrulja dhe urdhrat e All'llahut, si dhe i shkëputën lidhjet e tyre me besimtarët monoteistë. Këto lidhje janë shkëputur nga të gjitha anët.

“...vetëm nëse këtë e bëjnë (me gojë e jo me zemër) për t’u ruajtur nga ata...”

Ky është përjashtim i rregullit të përmendur, që do të thotë: Nëse situata dhe rrethanat e kërkojnë *tekijën*, fshehjen, maskimin, atëherë myslimanët duhet të shfaqin miqësinë ndaj jobesimtarëve për hir të frikës për jetën e tyre. Mirëpo në fund ajeti e përforcon rregullin e parë dhe thotë: **“...All’llahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij, sepse të gjithë do të ktheheni tek All’llahu.”**

Së pari, All’llahu i paralajmëron njerëzit për zemërimin dhe dënimin e Tij. **Së dyti**, u thotë se të gjithë njerëzit do të kthehen tek Ai. Nëse kanë miq armiqtë e All’llahut, herët a vonë, do të marrin rezultatin e punëve të tyre.

Dy hulumtime

1 -Maskimi ose mburoja mbrojtëse

Është e vërtetë se njeriu sakrifikon edhe jetën e tij për një qëllim madhor, si qëllimi i nderit apo i përkrahjes së drejtësisë përballë padrejtësisë. Vallë, a ia lejon vetes së vet një njeriu me logjikë të shëndoshë që të rrezikojë pa pasur një qëllim madhor e të rëndësishëm?

Kur shikohet se ka rrezik për jetën, pasurinë nderin dhe, kur nuk gjendet qëllim madhor dhe i rëndësishëm, Islami e lejon fshehjen e së vërtetës për kohësisht për kryerjen e detyrës me qëllim madhor. Ajeti 106 i sures “En-Nahl” thotë: **“Përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim.”**

Librat e historisë dhe hadithet islame e përmendin historinë e Ammarit, të babait dhe të nënës së tij, të cilët i arrestuan idhujtarët dhe i torturuan shumë, me qëllim që të mohonin Islamin. Prindërit e Ammarit refuzuan dhe idhujtarët i vranë. Ammari e tha me gojë atë

që donin. Pastaj u hodh te këmbët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke qarë prej frikës ndaj All'llahut. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha Ammarit: **“Nëse të kapin përsëri dhe të kërkojnë të thuash diçka, thuaja.”**

Me këtë thënie Ammari u qetësua dhe iu largua frika.

Duhet thënë se rregulli i maskimit ndryshon me ndryshimin e rrethanave. Ai mund të jetë i detyruar, i ndaluar dhe i pëlqyer.

Është i detyruar kur jeta e njeriut përballet me rrezik. Ndërsa, kur maskimi është shkak i përhapjes së kotësisë, i devijimit të njerëzve dhe i mbështetjes së padrejtësisë, atëherë ajo është e ndaluar (haram).

Kjo përgjigje është për të gjithë ata që e kundërshtojnë këtë çështje. Sikur kundërshtarët të studiojnë me hollësi maskimin (tekijen), do të kuptojnë se shiat nuk janë të vetmit në këtë besim. Por, sipas gjykimit të logjikës, është e saktë dhe përputhet me natyrën krijuese të njeriut.

Të gjithë mendimtarët e botës, kur e shohin veten e tyre para dy rrugëve: ose të shfaqin idetë e tyre, duke rrezikuar jetën, dinjitetin dhe pasurinë, ose t'i fshehin ato, ata e hedhin vështrimin e tyre tek rrethanat e pranishme. Nëse shfaqja e ideve e meriton këtë sakrificë të jetës, pasurisë dhe dinjitetit, e konsiderojnë shfaqjen si punë të rregullt. Nëse me shfaqje nuk gjendet qëllim madhor, nuk e shfaqin.

2- Maskimi dhe ndryshimi i triumfit

Në historinë e luftërave fetare, sociale dhe politike ka raste që mbrojtësit e së vërtetës që të luftojnë hapur kur ata dhe parimet përballen me shtypje dhe me rrezik, siç ishte gjendja e pasuesve të imam Aliut në kohën e dinastisë umovite.

Në situata të tilla, rruga më e mirë është që të mos konsumohen fuqitë, por të vazhdojë përpjekja në fshehtësi. Në këtë

rast maskimit është e ngjashme me ndryshimin e metodës së luftimit, e cila u mundëson qëndrimin dhe i çon në triumf. Ata që e kundërshtojnë plotësisht maskimin dhe japin përgjigje (fetva) për parregullsinë e saj, nuk e dinë se çfarë propozojnë në situata të tilla. Ata mendojnë se zhdukja është më e mirë apo vazhdimësia e luftës dhe i përbaljes në formë të rregullt e logjike? Rruga e dytë është tekijeh, kurse rrugën e parë askush nuk mund ta lejojë.

Nga ato që u thanë sqarohet se maskimi është parim i padiskutueshëm kur'anor. Mirëpo, është e ligjshme në çështje të caktuara dhe sipas rregullave të veçanta. Atë që shohim te disa të paditur, të cilët hamendësojnë se maskimi është shpikje e pasuesve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), është argument i mosnjohjes së Kur'anit në formë të plotë.

Fladi

Ajeti 29

قُلْ إِنْ تَخْضُوا مَا فِي صُدُورِكُمْ أَوْ تُبَدُّوهُ يَعْلَمُهُ اللَّهُ وَيَعْلَمُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٩﴾

“Thuaju: “Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja apo e shpallni hapur, All’llahu e di atë. Ai di çfarë gjendet në qiej dhe çfarë gjendet në Tokë. All’llahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

Komentimi

I Gjithëditur për të fshehtat tuaja

Ajeti i mëparshëm ndalonte reптësisht miqësinë, shoqërinë, bashkëpunimin dhe mbështetjen në ta, me përjashtim të maskimit.

Ka njerëz që e përdorin maskimin si mjet për t’i zgatur dorën e miqësisë mohuesve ose për t’iu nënshtruar kujdestarisë dhe sundimit të tyre. Me fjalë të tjera: Ata e shfrytëzojnë maskimin si shfajësim për lidhjen e marrëdhënieve me armiqtë e Islamit.

Ky ajet i paralajmëron këta njerëz dhe i urdhëron që të kujtojnë dijen e All’llahut, i Cili është i Mirinformuar për të fshehtat e zemrave. Ai di të dukshmet dhe të padukshmet.

Ajeti thotë: **“Thuaju: “Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja apo e shpallni hapur, All’llahu e di atë.”**

Dija e All'lahut nuk është e kufizuar vetëm në këto, por: **“Ai di çfarë gjendet në qiej dhe çfarë gjendet në Tokë.”**

Në realitet, ky ajet tregon se njohja e All'lahut për të fshehtat e tyre është një anë e vogël e dijes së tij të pakufishme, që përfshin qiejt dhe tokën. Ai është i Plotfuqishëm për dënimin e gjynahqarëve: **“All'lahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”**



Ajeti 30

يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُّحَضَّرًا وَمَا عَمِلَتْ مِنْ سُوءٍ
تَوَدُّ لَوْ أَنَّ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُ أَمَدًا بَعِيدًا وَيُحَذِّرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ وَاللَّهُ رَءُوفٌ
بِالْعِبَادِ

“Ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe. All'lahu ju paralajmëron që t'i ruheni Vetes së Tij. All'lahu është i Butë e i Mëshirshëm me robërit e Vet.”

Komentimi

Paraqitja e punëve në Ditën e Kiametit

Ky ajet tregon për paraqitjen e punëve të mira dhe të këqija në Ditën e Kiametit. Çdo njeri do të shohë ato që punoi në këtë jetë. Ata, që shohin punët e mira, do të gëzohen dhe do të përgëzohen.

Ndërsa ata, që do të shohin punët e këqija të tyre, do t'i mbulojë tmërr dhe do të donin sikur të ishin larguar prej tyre: “...ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së

keqes së tij, të ketë largësi të madhe.”¹ Ajeti nuk thotë se dëshiron fshirjen e punëve të këqija, sepse ai e di që kjo nuk bëhet, por dëshiron të largohet prej atyre punëve.

Fjala *el emedu* do të thotë *kohë e kufizuar* dhe fjala *el ebedu* është *kohë e pakufizuar*. Në të shumtën e rasteve përdorimi i fjalës *el emedu* ka si qëllim përfundimin e kohës, megjithëse ka raste që përdoret për çdo kohë të kufizuar.

Bazuar në këtë që u tha, gjynahqarët, siç thotë ajeti në fjalë, dëshiron që koha ndarëse mes tyre dhe e gjynaheve të tyre të zgjatet më shumë. Kjo shpreh fatkeqësinë që ndiejnë ata për shkak të kryerjes së punëve të këqija, sepse kërkimi i largësisë së kohës është më retorik në shprehje ndaj fatkeqësisë se sa kërkimi i largësisë vendore.

Alternativa e pranisë në distancën vendore mundet, ndërsa kjo alternativë në largësinë kohore nuk mundet. Për shembull: nëse një njeri jeton në kohën e luftës botërore, atë do ta kaplojë mërzitja dhe zemërimi, edhe nëse largohet nga vendi i luftës, kurse një tjetër, që jeton në një kohë të largët të luftës, nuk e ndien atë zemërim e mërzitje.

Disa komentues kanë mendimin se fjala *el emedu* ka kuptimin e *largësisë vendore*.² Mirëpo, me sa duket, kjo nuk përmendet në gjuhësi.

“All’llahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij. All’llahu është i Butë e i Mëshirshëm me robtë e Vet.”

Në pjesën e parë të kësaj shprehjeje All’llahu i paralajmëron njerëzit nga kundërshtimi i urdhrave të Tij, kurse në pjesën e dytë u përmend atyre butësinë dhe mëshirën e Tij. Me sa duket, këto dy pjesë, të cilat hasen shpesh në Kur’an, përmendja bashkë e premtimit dhe kërcënimit.

¹ *Jeumun*, ditën që përmendet në ajet është *mef’ul* i foljes *mukadder-papërmendur*) si *udhkurruu jeume-përmendeni ditën*, ose *ehdberu jeume-kujdesuni për ditën*.

² Siç i përmend autori i tefsijrit “*Mexhmaul Bejan*”, të përcjella nga disa komentime të komentuesve.

Është e mundur që pjesa e dytë: **“All’llahu është i Butë e i Mëshirshëm me robtë e Vet.”** të jetë përforcuese e pjesës së parë: **“All’llahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij...”**. Kjo është sikur ti të thuash: “Unë të paralajmëroj nga kjo punë e rrezikshme. Dhe paralajmërimi im për ty është tregues i dhembshurisë që kam ndaj teje, sepse, po të mos të doja, nuk do të të paralajmëroja.

Kur’ani, trupëzimi i punëve dhe prania e tyre

Ky ajet sqaron shumë qartë trupëzimin dhe praninë e punëve në Ditën e Kiametit. Fjala *texbidu* vjen nga fjala *el vuxhud-prani, ekzistencë, gjetje*, etj. E kundërta e kësaj fjale është *el ademm, mosekzistencë, mosqenie*.

Fjala *kbajrin-e mirë* dhe fjala *su’un- e keqja*, përmenden në trajtën e pashquar, që të përfitohet përgjithësisht. Kjo do të thotë se në Ditën e Kiametit njeriu do t’i shohë të gjitha punët dhe veprat e tij, të mira dhe të këqija, sado që të jenë.

Disa komentues i kanë bërë interpretim ajetit, duke thënë se qëllimi i pranisë së punëve është për praninë e shpërblimit dhe të dënimit të këtyre punëve, ose për praninë e regjistrimit në të cilin janë shënuar të gjitha punët e njeriut.

Ky mendim, nëpërmjet interpretimit, nuk përputhet me të dukshmen e ajetit, sepse ai thotë qartë që në Ditën e Gjykimit njeriu do t’i gjejë punët e tij të pranishme. Po ashtu, thotë se i keqi do të dëshirojë në atë Ditë sikur të gjendej distancë ndarëse mes tij dhe punëve të veta të këqija që ka bërë në këtë jetë. Pra, në ajet bëhet fjalë për praninë e vetë punëve dhe jo të regjistrimit të punëve dhe as për shpërblimin apo dënimin.

Gjithashtu, në ajet lexojmë se punëkeqi do të dëshirojë të largohet nga punët e tij të këqija dhe nuk dëshiron heqjen e punëve të tij, sepse kjo është e pamundur.

Ka ajete të tjera që e përforcojnë këtë çështje, siç është ajeti 49 i sures “Kehf”: **“...Aty do të gjejnë të pranishme gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.”** Po ashtu edhe ajeti 7 dhe 8 i sures “Zelzele”: **“...kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”**

Nga disa ajete përfitohet se dynjaja është ara mbjellëse për Ahiretin dhe punët e njeriut janë të ngjashme me farën që mbillet në tokë. Ajo kokërr mbin, rritet dhe pastaj njeriu e korr duke marrë kokrra të shumta. Po ashtu edhe punët e njeriut, siç thuhet në ajetin 20 të sures “Shura”: **“Atij që dëshiron në Jetën Tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë.”**

Në disa ajete të tjera përfitohet se në Ahiret punët e mira në këtë dynja vijnë në formë drite dhe hipokritët u kërkojnë besimtarëve: **“Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!”** Por atyre do t’u thuhet: **“Kthehuni prapa e kërkonit tjetër dritë!”¹**

Këto ajete e dhjetëra të tjerë tregojnë se në Ditën e Kiametit do të gjejnë të pranishme po atë punë dhe vepër që bëmë në këtë jetë. Ky është trupëzimi i punëve që thonë dijetarët e Islamit.

Ka transmetime të shumta që e përforcojnë këtë kuptim. Ndër to është thënia e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili i ka thënë një personi me emrin Kajs, që kërkonte këshillë: **“O Kajs. Ty patjetër do të të duhet një shoqërues që të varroset me ty dhe ai është i gjallë. Ti je i vdekur dhe ai i gjallë. Nëse do të jetë i ndershëm, do të të nderojë edhe ty. Nëse do të jetë i keq, do të të bëjë keq edhe ty.**

¹ Sure “Hadid”, ajeti 13.

Ai do të tubohet vetëm me ty dhe ti vetëm me atë. Ti do të pyetesh vetëm për atë. Do të ringjalleth dhe ai do të jetë me ty. Kryeje atë vetëm të mirë, sepse, nëse është i mirë, do të kënaqesh me të. Nëse është i keq, do të tmerrohesh prej tij. Ky shoqërues është puna jote.”

Për t'u sqaruar më tepër kjo çështje, duhet të hidhet dritë mbi njohjen e mënyrës së shpërblimit e të dënimit prej punëve.

Mendimi i dijetarëve për shpërblimin dhe dënimin

Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth shpërblimit dhe dënimit:

1- Disa mendojnë se shpërblimi dhe dënimi i punëve në Ahiret është çështje konsideruese, njësoj si shpërblimi dhe dënimi në këtë jetë, që do të thotë se në këtë dynja, sipas ligjit të vendosur, ka dënim për çdo punë të keqe. Po ashtu edhe All'llahu ka vendosur shpërblim dhe dënim të caktuar për çdo punë.

2- Disa të tjerë mendojnë se vetë njeriu e krijon shpërblimin dhe dënimin. Dhe kjo vetë do të krijohet në ahiret pa asnjë zgjedhje, që do të thotë se punët e mira dhe punët e këqija në këtë botë krijojnë te njeriu cilësitë e mira dhe të këqija. Këto cilësi bëhen pjesë e pandarë te njeriu dhe fillojnë të gjejnë formën që i përshtatet, atë të lumturisë apo të dënimit. Ai, që zotëron brendi të mirë në këtë jetë, e punëson mendjen e tij me mendimet dhe idetë e mira, ndërsa të këqijtë i punësojnë mendjet e tyre me mendime dhe me imagjinata të kota e të pavlefshme.

Dhe, në Ditën e Kiametit këto cilësi do të krijojnë ose shpërblimin ose dënimin, ose fatkeqësinë ose lumturinë. Me fjalë të tjera: Ato që lexojmë për Xhennetin dhe për Xhehennemin nuk janë tjetër veçse ajo që krijojnë këto cilësi të mira apo të këqija të njeriut.

3- Grupi i tretë prej dijetarëve të mëdhenj të Islamit kanë zgjedhur një rrugë tjetër dhe e mbështesin me shumë ajete nga Kur’ani dhe me hadithe. Ata thonë: “Çdo punë e jona, qoftë e mirë apo e keqe, ka një pamje në këtë jetë që ne e shohim. Po ashtu, ka një pamje Ahireti, që ndodhet në brendësi të këtyre punëve. Në Ditën e Kiametit, pas një ndryshimi, këto punë e humbasin formën që kishin në këtë jetë, duke shfaqur formën e tyre të Ahiretit, që e çojnë vepruesin e atyre punëve në rehati apo në dënim e fatkeqësi.

Ky mendim, ndër mendimet e tjera, përputhet me shumë ajete të Kur’anit. Bazuar në këtë, punët e njeriut nuk zhduken me ligjin e qëndrimit të materies/fuqisë. Ato qëndrojnë gjithmonë në këtë jetë, edhe se shikuesi sipërfaqësor mendon se ato janë shpërbërë.

Vërtet, qëndrimi i përhershëm i këtyre punëve, nga njëra anë, e mundësojnë njeriun që t’i shohë ato në Ditën e Kiametit dhe, nga ana tjetër, i jep mundësinë që të jetojë në mesin e punëve të tij, të lumturohet ose të dënohet. Megjithëse dija e njeriut nuk ka arritur akoma të zbulojë të gjithë të shkuarën me përjashtim të disa momenteve të pakta.¹ Nuk ka dyshim se, po të prodhonin një aparat të saktë ose të zotëronin njohje dhe perceptim më të plotë, atëherë do të ishin të mundur të njihnin dhe të perceptonin çdo gjë të shkuar.

¹ Dijetarët kanë zbuluar një aparat filmik që punon me rreze ultravjollcë. Aparati ka mundësinë që të filmojë një ngjarje që ndodh para pak momentesh. Ky punon sipas sistemit të ngrohtësisë që tërheq valët që dalin nga trupi dhe nëpërmjet aparaturës që quhet “Thermuxhram” i shndërron në pozitive dhe negative. Pastaj i filmon në bardhë e zi, siç thonë mjetet e informacionit. Me këtë aparat mund të njihet mënyra e kryerjes së kriminit dhe veprat e shkuara të kriminelëve. Më pas u paraqitet atyre zbulimi i gënjeshtërs.

Shkenca dhe trupëzimi i punëve

Për të argumentuar mundësinë e trupëzimit të punëve në të shkuarën mund të mbështetesh te parimet e konstatuara të fizikës së sotme dhe te ligjet e saj. Ajo thotë se lënda shndërrohet në fuqi. Lënda dhe energjia, janë dy dukuri për një të vërtetë.

Teoria më bashkëkohore thotë se lënda dhe energjia, të grumbulluara, shndërrohen në fuqi në situata të caktuara. Ka mundësi që energjia, që ndodhet në një gram lënde, të jetë e barabartë me shpërthimin e më shumë se tridhjetë mijë ton dinamiti.

Përmbledhja e thënieve: Lënda dhe fuqia janë dy dukuri për një të vërtetë. Duke parë moszhdukjen e fuqisë dhe të lëndës, atëherë nuk gjendet pengesë që fuqitë e përhapura të mbliidhen përsëri dhe të marrin formën e lëndës apo të trupit.

Ajetet 31 - 32

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ
غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٣١﴾ قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ
الْكَافِرِينَ ﴿٣٢﴾

“Thuaju: “Nëse ju e doni All’llahun, atëherë më ndiqni mua, që All’llahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! All’llahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë. Thuaju: “Bindjuni All’llahut dhe të Dërguarit!” Në qoftë se kthejnë shpinën, All’llahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve ka dy transmetime: njëri ndodhet në tefsirin “Mexhmaul Bejan” dhe tjetri në tefsirin “El Menar”.

Transmetimi i parë thotë: “Disa të pranishëm që, po rrinin me profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thanë se e duan All’llahun, edhe pse praktikimi i njohjeve dhe mësimave islame ishte i pakët në paraqitje. Për këtë zbritën këto dy ajete.”¹

Transmetimi i dytë thotë: “Disa të krishterë të Nexhranit u takuan me profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe*

¹ Tefsiri i Kurtubiut, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 17.

mbi familjen e tij!). Gjatë bisedës së tyre thanë se ekzagjerimi i tyre në shenjtërinë e Mesijhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) buron te dashuria që kanë për All'llahun. Atëherë zbritën këto dy ajete.”¹

Komentimi

Dashuria e vërtetë

Ajeti i parë thotë se dashuria nuk ka lidhje vetëm me zemrën, por ndikimet e saj duhet të shfaqen në punët e njeriut. Ai që thotë se e dua All'llahun, së pari, duhet të ndjekë të Dërguarin e Tij: **“Thuaju: “Nëse ju e doni All'llahun, atëherë më ndiqni mua.”**

Në të vërtetë, prej gjurmëve normale të dashurisë është tërheqja e të dashurit nga i dashuruari dhe pranimi i tij. Është e qartë se ka edhe dashuri të dobët, rrezet e së cilës nuk i kalojnë muret e zemrës. Kjo është prej dashurisë së pavlerë dhe nuk mund të konsiderohet dashuri. S'ka dyshim se në dashurinë e vërtetë gjenden gjurmë praktike, që e lidhin të dashurin me të dashuarin dhe e shtojnë atë në realizimin e kërkesave të tij.

Argumenti rreth kësaj është i qartë, sepse dashuria e njeriut për diçka duhet patjetër të jetë shkak që ai të arrijë një nga plotësueset e vetes së tij. Njeriu nuk mund të dojë një krijesë nëse nuk gjendet në të diçka prej fuqisë tërheqëse. Për këtë, dashuria e njeriut për All'llahun buron në të qenit e All'llahut burimi dhe origjina e të gjitha attributeve të plota.

Prandaj, urdhrat e një të dashuri të tillë duhet të jenë të plota e të përkryera. Si është e mundur që njeriu të dojë përsosmërinë absolute dhe në të njëjtën kohë të kundërshtojë urdhrat dhe mësimet

¹ Tefsijri i Kurtubiut, fundi i ajetit në fjalë. Tefsijri “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 17.

e të dashurit të tij? Nëse i kundërshton, kjo tregon se dashuria e tij nuk është e vërtetë.

Ky ajet nuk është i kufizuar me përgjigjen e të krishterëve të Nexhranit, të cilët pretenduan se e donin All'llahun, por është përgjigje e përgjithshme dhe autentike në Islam dhe përfshin të gjitha kohët. Ata, të cilët vetëm flasin natë e ditë për dashurinë ndaj All'llahut, ndaj Profetit, ndaj imamëve të Islamit, ndaj muxhahidinëve në rrugën e All'llahut, ndaj të mirëve dhe reformuesve, dhe nuk u ngjajnë atyre në vepra, janë gënjeshtarë.

Ata janë të zhytur nga koka deri te këmbët në gjynahe. Megjithëse mendojnë se zemrat e tyre janë të mbushura më dashurinë ndaj All'llahut, ndaj Profetit, ndaj prijësit të besimtarëve dhe imamëve të mëdhenj; ose mendojnë se besimi dhe dashuria janë vetëm me zemër, këta janë plotësisht larg logjikës së Islamit.

Në librin “Meanij Akhbar” transmetohet se imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai, që bën mëkate ndaj All'llahut, nuk e ka dashuruar Atë.” Pastaj lexoi këto dy vargje: “I bën mëkat All'llahut dhe shfaq dashurinë ndaj Tij.

Sikur dashuria jote të ishte e vërtetë, do t'i bindeshe Atij, sepse i dashuruari ndaj atij që dashuron është i bindur.”

“...që All'llahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! All'llahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”

Kjo fjali e ajetit thotë: “Nëse ju e doni All'llahun dhe ndikimi i kësaj dashurie duket në jetën dhe në veprat tuaja, me të vërtetë, edhe All'llahu do t'ju dojë juve. Gjurmët e dashurisë së Tij do të duken, sepse Ai do t'jua falë juve gjynahet dhe do t'ju përfshijë në mëshirën e Tij.

Argumenti i kësaj dashurie, nga ana e All'llahut, është i qartë, sepse Ai është Ekzistenca Absolute.

Hulumtim

Në shumë transmetime islame thuhet se udhëheqësit e Islamit thoshin se feja është veçse dashuri. Ndër ato transmetime, që gjenden në librat “El Khisal” dhe “El Kafij”, përmendet se imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Vallë, a nuk është feja vetëm dashuri?” Pastaj lexoi ajetin: “Thuaju: **“Nëse ju e doni All’llahun, atëherë më ndiqni mua.”**

Hadithet e përcjella për këtë temë sqarojnë se e vërteta e fesë dhe shpirti i saj është besimi në All’llahun dhe dashuria ndaj Tij, sepse drita e besimit dhe e dashurisë së zjarrtë ndaj All’llahut përfshin të gjithë praninë e njeriut dhe i ndriçon atij rrugët e jetës. Nëpërmjet këtij besimi dhe kësaj dashurie të zjarrtë ndikohen të gjitha gjymtyrët e tij dhe shfaqet ndikimi i tyre në zbatimin e urdhrave të All’llahut.

“Thuaju: “Binduni All’llahut dhe të Dërguarit!”

Edhe kjo fjali pason përmbajtjen e fjalisë së mëparshme, duke u tërhequr vëmendjen se përderisa thoni se e doni All’llahun, atëherë ndiqini dhe zbatojini urdhrat e All’llahut dhe të Profetit. Nëse nuk e bëni, ju nuk e doni All’llahun dhe All’llahu nuk ju do juve. “Në qoftë se kthejnë shpinën, All’llahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.”

Nga fjalia: **“Binduni All’llahut dhe të Dërguarit!”** përfitohet se përulja ndaj All’llahut dhe pasimi i Profetit janë të pandara. Ndjekja e Profetit është bindje ndaj All’llahut dhe bindja ndaj All’llahut është ndjekja e Profetit.

Në ajetin e parë të ajeteve në fjalë flitej për ndjekjen e Profetit, ndërsa ky ajet flet edhe për bindjen ndaj All’llahut dhe për ndjekjen e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

Ajetet 33 – 34

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ
ذُرِّيَّةً بَعْضُهَا مِنْ بَعْضٍ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٣٣﴾

“All’llahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit. Pasardhës të njëri-tjetrit. All’llahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur.”

Komentimi

Këto ajete fillojnë me prezantimin e tregimit të Merjemes, pozitës dhe të gjyshërve të saj. Ata janë shembulli model i dashurisë së vërtetë ndaj All’llahut dhe i shfaqjes së asaj dashurie në punë e vepra: **“All’llahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit.”**

Fjala *istafa* vjen nga *el safu*, që do të thotë *i pastër nga papastërtitë*. Kështu quhet edhe guri i pastër *es safa*. Në këtë mënyrë, fjala *el istifaa* është përdorimi i diçkaje të pastër.

Ajeti thotë: All’llahu e zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit. Kjo zgjedhje do të thotë se All’llahu i krijoi që në fillim këta njerëz të ndryshëm e të dallueshëm.

Ata nuk kanë qenë të detyruar të ndjekin këtë rrugë, por me zgjedhjen dhe dëshirën e tyre e zgjodhën këtë rrugë. Ky dallim i bëri të aftë që të udhëzojnë njerëzit. Po ashtu, përlulja ndaj All’llahut, zbatimi i urdhrave të Tij, devotshmëria dhe përpjekja në rrugën e

All'lahut për udhëzimin e njerëzve, i bëri ata që të fitojnë dallueshmërinë, e cila u bashkua me dallueshmërinë e tyre krijuese. Për këtë ata janë të zgjedhur.

“Pasardhës të njëri-tjetrit.”

Kjo fjali e ajetit tregon se ata të zgjedhur, për nga besimi, pastërtia, devotshmëria dhe përpjekja në rrugën e All'lahut për udhëzimin e njerëzve, ishin të ngjashëm si kopjet e një libri dhe referoheshin te njëri-tjetri.

“All'lahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur.”

Në fund ajeti tregon për një të vërtetë se All'lahu ka qenë Mbikëqyrës i lëvizjeve dhe i aktiviteteve të tyre, Dëgjues i thënieve të tyre si dhe i Gjithëditur për punët e tyre. Po ashtu, ajeti tregon se përgjegjësia e të zgjedhurve ndaj All'lahut dhe krijesave të Tij është e rëndë.

Në këtë ajet flitet edhe për profetët e vendosmërisë së lartë (ulul azm). Pas përmendjes së emrit të Nuhut, përmendet familja e Ibrahimit, e cila përfshin Musain, Isain dhe profetin e Islamit, hazretin Muhammed. Kur'ani e përsërit përmendjen e familjes së Imranit për të treguar për Merjemen dhe Mesijhun, megjithëse ky ajet është parathënie për sqarimin e gjendjes së Merjemes dhe birit të saj, hazretit Isa.

Dallimi i profetëve

Edhe pse ky dallim nuk i detyron profetët të ndjekin rrugën e drejtë, edhe pse nuk është në kundërshtim me dëshirën dhe zgjedhjen, lind pyetja: A nuk është ky një lloj privilegji?

Në përgjigje të pyetjes themi: Krijimi i shoqëruar me sistem të shëndoshë e pason domosdoshmëria e privilegjimi. P.sh., vështroje me vëmendje trupin e njeriut, që është krijesë e sistemuar.

Për ta ruajtur këtë sistem duhet të pohohet privilegjimi mes gjymtyrëve dhe organeve që ndodhen në trup. Sikur të gjitha qelizat të ishin të ngjashme për nga delikatesa me qelizat e syrit apo të ngjashme me qelizat e këmbës për nga fuqia, apo me ato të mendjes për nga delikatesa, apo të ngjashme me qelizat e zemrës për nga lëvizjet e tyre, atëherë sistemi i trupit do të çrregullohej.

Prandaj, duhet patjetër të gjenden qeliza që të kryejnë funksionin e drejtimit, siç janë ato të mendjes, apo qeliza për kockat e forta, që të kryejnë funksionin e qëndrimit drejt të trupit, apo qelizat lëvizëse që të kryejnë funksionin e lëvizjeve në trup.

Askush nuk mund të thotë se përse i gjithë trupi nuk është mendje? Apo të thotë për bimët: Përse të gjitha qelizat e bimës nuk janë si ato të petaleve të luleve? Kjo gjendje do ta përballte bimën me shkatërrim dhe me zhdukje.

Pika më e rëndësishme është se ky dallim i domosdoshëm vetor nuk është i thjeshtë për gjetjen e një ndërtimi të sistemuar, por ai është i shoqëruar me përgjegjësi të madhe. Ky “dallim” dhe kjo përgjegjësi e madhe janë po ato që ruajnë ekuilibrin e krijimit, që do të thotë se raporti i dallimit të profetëve me atë të njerëzve është në përputhje me rëndësinë e përgjegjësisë që mbartin profetët. Po ashtu, edhe dallimi te njerëzit përputhet me përgjegjësitë e tyre.

Ky dallim vetor nuk është i mjaftueshëm për t’u afruar tek All’llahu, prandaj duhet edhe dallimi i fituar.

Hulumtime

Në ajet gjenden disa çështje që duhen përmendur.

1- Ajeti nuk i përmend të gjithë të zgjedhurit e All'llahut, por vetëm disa prej tyre. Kjo nuk do të thotë se të tjerët nuk kanë qenë të zgjedhur. Fjala *Ale Ibrahim*-familja e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), përfshin Musain, të birin e Imranit dhe profetin e Islamit, hazretin Muhammed dhe të zgjedhurit prej familjes së tij, sepse të gjithë e kanë prejardhjen prej Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

2- Ragibi, në librin e tij “El Mufredat”, ka mendimin se fjala *alun* është prej fjalës *ehleun*, por fjala *alun* është veçuar me shtimin e pjesëtarëve të mëdhenj e fisnikë prej njerëzve, por jo në kohë e në vende. Mirëpo, fjala *el ehl* përdoret për të gjithë njerëzit, në çdo kohë e në çdo vend, p.sh: thuhet *ehlul medineh*, njerëzit apo banorët e qytetit, por nuk mund të thuhet *alul medineh*.

3- Zgjedhja e familjes së Ibrahimit dhe e Imranit nuk ka kuptimin e zgjedhjes së bijve të Ibrahimit dhe Imranit, sepse ka mundësi që në mesin e tyre të ketë edhe jobesimtarë. Por kuptimi është për disa prej familjes së Ibrahimit dhe familjes së Imranit.

4- Imrani, që përmendet në ajet, nuk është babai i hazretit Musa, por është babai i hazretit Merjeme, sepse, sa herë që përmendet emri i Imranit në Kur'an, kuptimi është për babain e Merjemes. Këtë e tregojnë edhe ajetet e mëpasshme, të cilat sqarojnë gjendjen e Merjemes.

5- Shumë hadithe të Ehli Bejtit e konsiderojnë këtë ajet argument të pagabueshmërisë së profetëve dhe imamëve,¹ sepse All'llahu nuk mund të zgjedhë gjynahqarët (të përlyerit me politeizëm, mohim dhe devijim), por Ai zgjedh të pastrit dhe të pagabueshmit. (Ajeti tregon edhe për shkallët e pagabueshmërisë.)

¹ Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 50. “Biharul Anuar”, vëll. 11, f. 72, 78 dhe 167.

6- Me këtë ajet disa shkrimtarë dhe transmetues argumentojnë teorinë e fillimit e të ngritjes. Ata mendojnë se ajeti tregon që Ademi nuk ka qenë njeriu i parë, por gjendeshin shumë njerëz dhe në mesin e tyre All'llahu zgjodhi Ademin, i cili la pas gjenezë të dallueshme. Frazja **“mbi të gjithë njerëzit.”** është treguese e kësaj thënieje.

Ata thonë: Në kohën e Ademit gjendej shoqëri njerëzore. Për këtë nuk gjendet pengesë, që njeriu i parë, i cili u krijua (u gjet) para miliona viteve, të ketë ardhur prej kafshëve të tjera e më pas u zhvillua. Dhe Ademi është i vetmi i zgjedhur.

Në përgjigje të këtij mendimi mund të thuhet se nuk ka argument që fjala *alemijne* të tregojë për njerëzit në kohën e Ademit. Kjo ka kuptimin e shoqërisë njerëzore gjatë gjithë historisë. Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është: Gjatë gjithë historisë njerëzore, në mesin e njerëzve, All'llahu zgjodhi disa prej tyre, si: Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit.

Përderisa secili prej tyre jetonte në kohë të ndryshme, nga kjo kuptojmë se kuptimi i fjalës *alemijne* është për të gjithë njerëzit, pavarësisht ndryshimit të kohës së tyre. Për këtë nuk gjendet asgjë ku të mbështetemi për të menduar se në kohën e Ademit gjendeshin njerëz të tjerë dhe All'llahu e zgjodhi atë (Ademin) nga mesi i tyre. (Mendo thellë)

Ajetet 35 - 36

إِذْ قَالَتِ امْرَأَتُ عِمْرَانَ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ
مِنِّي إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿٣٥﴾ فَلَمَّا وَضَعَتْهَا قَالَتْ رَبِّ إِنِّي وَضَعْتُهَا
أُنْثَىٰ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ وَلَيْسَ الذَّكَرُ كَالْأُنْثَىٰ ۗ وَإِنِّي سَمَّيْتُهَا مَرْيَمَ وَإِنِّي
أُعِيدُهَا بِكَ وَذُرِّيَّتَهَا مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ﴿٣٦﴾

“Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të të shërbejë vetëm Ty; andaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë. E kur ajo lindi, tha: “Zoti im! Unë linda femër, - All’Ilahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra. Unë e quajta atë Merjeme dhe unë kërkoj mbrojtjen Tënde për atë dhe për pasardhësit e saj nga djalli i mallkuar.”

Komentimi

Mënyra e lindjes së Merjemes

Pas thënies së ajetit të mëparshëm, që tregonte për familjen e Imranit, këto dy ajete fillojnë të flasin për Merjemen, të bijën e Imranit, për mënyrën e lindjes, të edukimit dhe çfarë i ndodhi kësaj zonje të madhe.

Në historinë dhe transmetimet islame, si dhe sipas mendimeve të komentuesve, Hannah dhe Ashja kanë qenë motra. Hannah u martua me Imranin¹, i cili ishte prej udhëheqësve të bijve të Izraelit, kurse Ashja u martua me profetin Zekeria.

Kaluan vite nga martesja e Hannasit dhe ajo nuk kishte fëmijë. Një ditë, tek ishte ulur nën një pemë, pa një zog duke ushqyer të voglin e saj. Kjo pamje ia ndezi zjarrin e dashurisë Hannës për t'u bërë nënë. Ajo iu drejtua All'llahut me gjithë zemër, duke i kërkuar që t'i dhurojë fëmijë. All'llahu iu përgjigj lutjes së saj të sinqertë. Nuk kaloi shumë kohë dhe ajo mbeti shtatzënë.

Në disa hadithe thuhet se All'llahu e frymëzoi Imranin se do t'i dhurojë atij një fëmijë të bekuar, i cili do të shërojë të sëmurët me sëmundje të rëndë, do të ringjallë të vdekurit me lejen e All'llahut dhe do ta dërgojë profet te bijtë e Izraelit. Këtë lajm Imrani ia tha bashkëshortes së tij, Hannës. Kur mbeti shtatzënë, ajo mendonte se fëmija, që kishte në barkun e saj, ishte djali i premtuar.

Ajo nuk e dinte që në barkun e saj ndodhej Merjemja. Ajo u betua se fëmijën do ta linte në shërbim të Shtëpisë së All'llahut (Bejtul Makdis). Kur lindi dhe pa që ishte femër, u hutua (çorodit) dhe nuk

¹ Disa hadithe thonë se Imrani ka qenë profet dhe ka pasur shpallje. Ky Imran nuk është babai i Musait, sepse mes tyre ka pasur një periudhë kohore prej 1800 vjetësh. (Tefsijri "Mexhmaul Bejan", tefsijri "El Meragij", fundi (shitesa, shtojca, fundi) i ajetit në fjalë.

dinte çfarë të bënte, sepse shërbimi në Shtëpinë e All'llahut ishte për meshkujt dhe jo për femrat.

Tani të fillojmë me komentimin e ajeteve dhe nëpërmjet tij të njihemi me vazhdimësinë e ngjarjes.

“Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të të shërbejë vetëm Ty.”

Këtu tregohet për betimin e gruas së Imranit kur ishte shtatzënë se fëmijën e saj do ta linte në shërbim të Shtëpisë së All'llahut, Bejtul Makdisit, sepse ajo mendonte se fëmija ishte djalë, sipas përgëzimit që i solli burri i saj.

Për këtë ajo tha *mubareren-të lirshëm* dhe nuk ka thënë *mubareretun-të lirshme*. Ajo iu lut All'llahut që t'ia pranojë betimin e saj: **“...prandaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, Ti je Dëgjues dhe i Gjithëditur.”**

Fjala *mubarerun* vjen prej *tebrir-lirim, çlirim*. Në atë kohë përdorej për fëmijët djem, që caktoheshin në shërbim të vendadhurimit, për ta pastruar e për ta mirëmbajtur atë, me qëllim që të kryenin adhurimet e tyre në kohët e lira. Për këtë, ai djalë quhej *mubarerun*, sepse ishte i çliruar nga shërbimi ndaj prindërve. Kjo konsiderohej krenari për atë popull.

Thuhet se djemtë e aftë për këtë shërbim e kryenin misionin e tyre nën mbikëqyrjen e prindërve deri në moshën e pjekurisë, pastaj kjo u lihej në dorë djemve, nëse donin, qëndronin, nëse jo, largoheshin.

Disa kanë mendimin se betimi i Hannës tregon se Imrani kishte vdekur në kohën që ajo ishte shtatzënë, përndryshe ishte e largët që nëna të betohej.

“E kur ajo lindi, tha: “Zoti im! Unë linda femër.”

Ky ajet sqaron gjendjen e nënës së Merjemes pas lindjes së saj. Ajo u mërzit me lindjen e femrës dhe filloi t'i thotë All'llahut: "Ajo është vajzë dhe Ti je i Gjithëditur, se femra nuk është si mashkulli në zbatimin e betimit. Femra nuk mund ta kryejë detyrën e shërbimit njësoj si mashkulli."

Femrës, pas moshës së pubertit, i vijnë periodat mujore dhe ajo nuk mund të hyjë në xhami. Përveç kësaj, fuqia trupore e saj është e dobët. Po ashtu ka edhe çështje që kanë të bëjnë me hixhabin (mbulimin) dhe shtatzëninë.

"All'llahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra."

Sipas treguesve të ajetit dhe haditheve të ardhura për komentimin e kësaj thënieje, duket se thënia: **"e mashkulli nuk është si femra."**, është e nënës së Merjemes dhe jo e All'llahut, siç kanë thënë disa komentues.

Mirëpo, ajo duhet të thoshte se femra nuk është si mashkulli, duke e ditur se ajo lindi femër. Ka mundësi që zemërimi se lindi femër e bëri të shprehet në këtë mënyrë, sepse ajo besonte se fëmija, që do të lindte, ishte mashkull dhe do t'ia kushtonte Shtëpisë së All'llahut për t'i shërbyer. Ai besim dhe ajo pritje e bënë që të shqiptojë në fillim mashkullin, pastaj femrën, edhe pse zanafilla e shtatzënisë dhe lloji i fëmijës, që ndodhej në bark, duhet të shqiptonte në fillim femrën.

Fjalja ndërmjetëse, kundërshtuese: **"All'llahu e di më mirë se çfarë lindi ajo."** është prej thënies së All'llahut, që do të thotë: Nuk duhet të thoshe se linda femër, sepse All'llahu është më i Ditur për Hannën dhe fëmijën e saj të porsalindur, që kur mbeti shtatzënë e deri në formimin e foshnjës në mitër.

"Unë e quajta atë Merjeme..."

Nga kjo fjali sqarohet se nëna e quajti Merjeme foshnjën e saj. Në gjuhësi fjala Merjem ka kuptimin e adhurueses. Që këtu duket mallëngjimi i kësaj nëne të pastër, që fëmijën e saj ta lërë në shërbim

të Shtëpisë së All'lahut-Bejtul Makdisit. Prandaj, pasi ia vuri emrin, i kërkoi All'lahut që ta mbrojë atë dhe pasardhësit e saj prej cytjeve të djajve të mallkuar dhe ta ruajë atë me mirësinë e Tij: **“...dhe unë kërkoi mbrojtjen Tënde për atë dhe për pasardhësit e saj nga djalli i mallkuar.”**



Ajeti 37

فَتَقَبَّلَهَا رَبُّهَا بِقَبُولٍ حَسَنٍ وَأَنْبَتَهَا نَبَاتًا حَسَنًا وَكَفَّلَهَا زَكَرِيَّا كُلَّمَا دَخَلَ
عَلَيْهَا زَكَرِيَّا الْمِحْرَابَ وَجَدَ عِنْدَهَا رِزْقًا قَالَ يَمْرِئُ أُنَى لَكَ هَذَا
قَالَتْ هُوَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٣٧﴾

“Zoti e pranoi atë (Merjemen) me ëndje, e bëri që të rritet mirë dhe e la nën kujdestarinë e Zekerijas. Sa herë që hynte Zekerija në mihrabin (vendadhurimin) e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste: “O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?” Ajo përgjigjej: “Ky është nga All’llahu, se All’llahu e furnizon kë të dojë, pa llogari.”

Komentimi

Ky ajet vazhdon me prezantimin e historisë së Merjemes. Më parë thamë se nëna e Merjemes nuk e besonte mundësinë e pranimit të femrës si shërbëtore e shtëpisë së All’llahut, prandaj dëshironte që të lindte mashkull, sepse më parë nuk kishte ndodhur që të zgjidhej femër në shërbim të Bejtul Makdisit.

Ajeti thotë se All’llahu e pranoi që për herë të parë kjo femër e pastër të jetë në shërbim shpirtëror. Disa komentues thonë: Argumenti i pranimit të saj për këtë shërbim ishte se, në kohën që ishte në shërbim të Bejtul Makdisit, nuk i kishin ardhur asnjëherë

periodat mujore, që ta detyronin në lënien e këtij shërbimi. Po ashtu, ardhja e ushqimit nga Xhenneti, në vendfaljen e saj, ishte argument i pranimit të saj. Ka mundësi që pranimi i betimit dhe i Merjemes t'i jetë komunikuar nënës së saj nëpërmjet frymëzimit.

Fjala *enbeteba-e rriti* tregon për përsosmërinë e Merjemes nga ana shpirtërore dhe morale. Po ashtu, kjo fjalë përmban diçka interesante, se vepra e All'llahut është rritja, që do të thotë se, ashtu si fara e bimës përmban aftësi dhe këtë aftësi e shfaq kur bujku e hedh në tokë, po ashtu edhe tek njeriu gjenden aftësi të mëdha njerëzore, të cilat rriten me shpejtësi nëse u nënshtrohen edukuesve hyjnorë dhe mbjellësve të kopshtit të madh human, duke realizuar rritjen me kuptim të vërtetë.

“Zoti e pranoi atë (Merjemen) me ëndje, e bëri që të rritet mirë dhe e la nën kujdestarinë e Zekerijas.”

Fjala *el kefaletu* ka kuptimin e bashkëngjijtes, bashkimit së diçkaje me një tjetër. Ai që kujdeset për çështjet e fëmijëve quhet *el kafilu* ose *el qefil*, pra, ai e bashkëngjijt fëmijën me të. Kur kjo fjalë përdoret në formën e tri shkronjave, atëherë ajo është folje *lazimu*, që do të thotë *zgjedhja e një sipërmarrësi, kujdestari për një njeri tjetër*.

Ky ajet thotë se All'llahu e zgjodhi Zekerijan kujdestar të Merjemes, sepse babai i saj, Imrani, kishte ndërruar jetë para lindjes së saj. Nëna e saj e dërgoi Merjemen te Bejtul Makdisi dhe ua prezantoi dijetarëve jahudij, duke u thënë: “Kjo vajzë është dhuratë për Bejtun Makdisin, prandaj le ta marrë dikush nga ju, të angazhohet për të.” Fjalët u shtuan në mesin e dijetarëve jahudij dhe secili donte të kishte fatin e krenarisë. Në një festë të veçantë, të cilën do ta përmendim në komentimin e ajetit 44 të kësaj sureje, zgjidhet Zekerija kujdestar i Merjemes.

Sa më shumë rritej, aq më shumë dukeshin gjurmët e madhësisë e të lartësisë së Merjemes, për të cilën Kur'ani thotë: **“Sa herë që hynte Zekerija në mihrabin (vendadhurimin) e saj, gjente pranë saj ushqim...”**

Fjala *el mihrab* është vendi i veçantë në vendfalje për imamin apo për njerëz të zgjedhur. Për shkakun e këtij emërtimi ka mendime të ndryshme, ndër to tre janë më të saktë (konsiderueshëm):

I pari: Kjo fjalë vjen nga fjala *el barb-luftë*. Është quajtur i tillë për shkak se ai është vendi i luftës së shejtanit dhe i egos.

I dyti: El mihrab, është balli i vendgrumbullimeve. Më pas me këtë emër është quajtur edhe qoshja e vendadhurimit. (tek jahudijtët ndërtimi i mihrabit ndryshon nga i yni. Ata e ndërtonin mihrabin disa shkallë mbi sipërfaqen e tokës mes dy mureve të larta, që ta mbronin mihrabin. Ishte e vështirë të dukej se kush ndodhej brenda në mihrab.)

I treti: Me këtë emër quhet i gjithë vendadhurimi, që është vend i posaçëm për adhurim dhe për luftimin e vetvetes e të shejtanit. Merjemja u rrit nën kujdesin e Zekerijas dhe ishte e zhytur në adhurim deri në atë masë, siç thotë ibn Abbasi sa, kur mbushi nëntë vjeç, ajo agjëronte ditën dhe bënte adhurime natën. Ajo ishte në gradë të lartë të devotshmërisë dhe të njohjes së All'lahut, sa që doli mbi dijetarët e kohës së saj.¹

Sa herë që Zekerija e vizitonte Merjemen në vendfaljen e saj, gjente në të ushqim të veçantë. Ai habitej dhe një ditë e pyeti: **“O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?”** Ajo përgjigjej: **“Ky është nga All'lahu, se All'lahu e furnizon kë të dojë, pa llogari.”**

Ajeti nuk e përmend llojin e ushqimeve, mirëpo disa transmetime të përmendura në tefsijrij e Ajjashit dhe në librat e tjerë të myslimanëve thonë se ato ishin fruta nga Xhenneti, nuk ishin fruta

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 2, f. 436. “Biharul Anuar”, vëll. 14, f. 196.

të stinës. Ato vinin në mihrab me urdhrin e All'llahut. Nuk është e habitshme që një rob i devotshëm të jetë në mikpritjen e All'llahut.¹

Po ashtu, prania e ushqimit prej Xhennetit sqarohet me praninë e treguesve brenda ajetit. Së pari, fjala *rizkan* përmendet në trajtën e pashquar, që tregon se Zekeria nuk e njihje këtë lloj ushqimi. Së dyti, përgjigjja e Merjemes ishte: “Ky është nga All'llahu.”

Së treti, reagimi i Zekerijas, i cili i kërkoi All'llahut t'i dhuronte një fëmijë, siç do ta lexojmë në ajetin pasardhës.

Mirëpo disa komentues, siç është autori i komentimit “El Manar”, kanë mendimin se fjala *rizkan* ka kuptimin e ushqimeve të njohura të kësaj jete. Ibn Xherijri thotë: “Bijtë e Izraelit i goditi një thatësi e ashpër në atë kohë dhe Zekerija nuk ishte në gjendje t'i siguronte ushqim Merjemes. Për këtë ata hodhën një short se kush do t'ia sigurojë ushqimin asaj.

Shorti i ra një zdrukthuari. Ai filloi të kursente nga fitimet e tij të lejuara për t'i përgatitur ushqim Merjemes. Ky ka qenë ai ushqimi që shihte Zekerija në mihrabin e Merjemes dhe habitej nga prania e tij në atë situatë të vështirë. Kuptimi i përgjigjes së Merjemes ka qenë se All'llahu vendosi në shërbimin tim një besimtar, i cili dëshironte ta bënte këtë punë të vështirë.

Ky komentim nuk është në përputhje me treguesit që ndodhen në ajet, të cilët i përmendëm më lart, e as me hadithet e ardhura për komentimin e këtij ajeti. Ndër ato hadithe është hadithi i ardhur nga imam Bakiri, që përmenden në tefsirin “Ajjashi”. Përmbledhja e hadithit është: “Një ditë profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi te shtëpia e vajzës së tij, Fatimeja.

Ai e dinte se ajo nuk kishte ushqim në shtëpi. Kur hyri, pa ushqim të bollshëm e të veçantë. Ai e pyeti se nga është ky ushqim?

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 14, f. 169, 186, 196, 200, 203 dhe 204.

Ajo iu përgjigj: “Nga All’llahu, vërtet All’llahu furnizon atë që do pa llogari.”

Profeti i tha Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “A të bisedoj për të ngjashëm me ty dhe të ngjashme me të?”

Ai iu përgjigj: “Po.”

Profeti tha: “Njësoj si Zekerija, kur hynte tek Merjemeja dhe në mihrab gjente ushqim.”

Ai i tha: “O Merjem, nga të ka ardhur ky ushqim?”

Ajo i thoshte: “Nga All’llahu, vërtet All’llahu furnizon kë të dojë pa llogari...”¹

Përsa i përket shprehjes: “Pa llogari”, këtë e sqaruam në komentimin e ajetit 212 të sures “El-Bekare” dhe në komentimin e ajetit 27 të kësaj sureje.

¹ Tefsijrul “Ajjashi”, vëll. 1, f. 171. Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 333.

Ajetet 38 – 40

هُنَالِكَ دَعَا زَكَرِيَّا رَبَّهُ ^ط قَالَ رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً ^ط
إِنَّكَ سَمِيعُ الدُّعَاءِ ﴿٣٨﴾ فَنَادَتْهُ الْمَلٰٓئِكَةُ وَهُوَ قَائِمٌ يُصَلِّي فِي الْمِحْرَابِ
أَنَّ اللَّهَ يُبَشِّرُكَ بِيَحْيَىٰ مُصَدِّقًا بِكَلِمَةٍ مِّنَ اللَّهِ وَسَيِّدًا وَحَصُورًا وَنَبِيًّا مِّنَ
الصَّٰلِحِينَ ﴿٣٩﴾ قَالَ رَبِّ إِنِّي يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَقَدْ بَلَغَنِيَ الْكِبَرُ وَامْرَأَتِي
عَاقِرٌ قَالَ كَذٰلِكَ أَلَّهٗ يُفَعِّلُ مَا يَشَآءُ ﴿٤٠﴾

“Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: “Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes! E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, engjëjt e thirrën (Zekerijan): “All’llahu të jep lajmin e mirë për Jahjain, i cili do të vërtetojë Fjalën e All’llahut (Isain), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe profet, një prej të mirëve.”

(Zekerija) tha: “Zoti im! Qysh do të kem djalë, kur mua më ka zënë pleqëria, e gruaja ime është sterile?! (Engjëlli i) tha: “Kështu! All’llahu bën çfarë të dojë.”

Komentimi

Më parë thamë se bashkëshortja e Zekerijas dhe nëna e Merjemes ishin motra dhe të dyja nuk lindnin fëmijë. Kur nëna e Merjemes u mirësua me këtë gjenezë të pastër dhe Zekerija i pa me sytë e tij tiparet e larta, të veçanta e të habitshme, uroi që edhe ai të kishte një gjenezë të tillë të pastër, të devotshme si Merjemja dhe të ishte argument i fuqisë së All'llahut dhe e Njeshmërisë së Tij.

Zekerija dhe gruaja e tij ishin në moshë të pleqërisë, mirëpo dashuria ndaj All'llahut, prania e frutave jo të stinës në mihrabin e Merjemes, bënë që zemra e tij të mbushej akoma më shumë me shpresën e të bërit baba në pleqëri. Për këtë ai filloi t'i lutet e t'i përgjerohet All'llahut: **“Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: “Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!”¹**

Nuk kaloi shumë kohë dhe All'llahu iu përgjigj lutjes së Zekerijas (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, engjëjt e thirrën (Zekerijan): “All'llahu të jep lajmin e mirë për Jahjain.”**

Në kohën që po adhuronte All'llahun në mihrabin e tij, engjëjt e thirrën dhe i thanë se All'llahu të përgëzon për lindjen e djalit me emrin Jahja. Engjëjt nuk u mjaftuan vetëm me këtë përgëzim, por ata përmendën edhe pesë cilësi të atij djali:

E para: Ai do t'i besojë Mesijhut (Isait) dhe për hir të këtij besimi do ta përkrahë atë: **“i cili do të vërtetojë Fjalën e All'llahut (Isain)”** Fraza *kelimatulah*, si këtu edhe në vende të tjera në Kur'an,

¹ Fjala *dburijjetun*, siç e thamë edhe në shtojcën e komentimit të ajetit 24 të po kësaj sureje, ka kuptimin e fëmijëve të vegjël, por mund të përdoret edhe për të mëdhenjtë. Edhe pse në original ky term është cilësi për shumësin, përdoret edhe për njëjësin, siç thotë Ragibi në librin e tij “El Mufredate”. Në ajet, pas kësaj fjale vjen fjala *tajjibeten - të mirë*, në gjininë femërore, ku profeti Zekerija (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkoi t'i dhuronte djalë. Kjo për të ruajtur të dukshmen e të jashtmen e fjalës *dburijjetun*.

siç do ta shpjegojmë, ka kuptimin e Mesijhut (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*).

Në librat e historisë thuhet se hazreti Jahja ishte gjashtë muaj më i madh se hazreti Isa. Ai ka qenë i pari që i besoi atij. Ai njihej në mesin e njerëzve për pastërtinë dhe asketizmin. Ky besim i tij në Isain kishte ndikim të madh te njerëzit dhe i ftonte ata që të besonin në profecinë e tij.

E dyta: Ai do të jetë drejtues i njerëzve për nga dija dhe puna: **“...do të jetë një fisnik.”** Po ashtu, ai do të jetë mbrojtës i vetes së tij prej epsheve të pafrenuara dhe nga ndotja prej dashurisë së kësaj bote.

E treta: Fjala *el busur* (është ai që privon veten nga kënaqësitë), vjen nga fjala *el busr*, që do të thotë bllokim ose ndalim nga martesja, për të cilën thonë edhe disa komentues dhe e përmendin edhe disa hadithe.¹

E katërta dhe e pesta: Prej dallimeve të tij është se do të jetë i dërguar, (kjo fjalë përmendet në trajtën e pashquar si treguese e madhësisë) dhe do të jetë prej të mirëve: **“...i dëlirë dhe profet, një prej të mirëve.”**

Kur Zekerija e dëgjoi këtë përgëzim, u gëzua pa masë dhe nuk mundi ta fshehë habinë e tij për këtë dhe: “(Zekerija) tha: **“Zoti im! Qysh do të kem djalë, kur mua më ka zënë pleqëria, e gruaja ime është sterile?! Atëherë: (Engjëlli i) tha: “Kështu! All'llahu bën çfarë të dojë.”**

Kur Zekerija dëgjoi këtë përgjigje përmbledhëse, që tregon për ekzekutimin dhe zbatimin e dëshirës së All'llahut, u bind.

¹ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 14, f. 156. “Biharul Anuar”, vëll. 14, f. 169, 170 dhe 185.

Hulumtime

1- A është beqaria vepër e mirë?

Këtu mund të lindë pyetja: Nëse fjala *el hasr* ka kuptimin e *ndalimit nga martesja*, vallë a është kjo cilësi e mirë, me të cilën dallohet njeriu, siç u cilësua Jahjai?

Nuk ka argument që të tregojë se fjala *el hasr*, që përmendet në ajet, të ketë qëllimin e ndalimit nga martesja. Hadithi, që e përmend këtë kuptim, nuk është i besueshëm. Kuptimi mund të jetë për ndalim të epsheve dhe të dashurisë së kësaj jete. Tek asketët kjo është cilësia e parë.

Ka mundësi që Jahjai, të jetë si Isai dhe të ketë jetuar në rrethana të veçanta, që e detyruan të shkojë nga një vend në tjetrin për të predikuar mesazhin e tij. Për këtë u detyrua të jetojë beqar. Ky nuk mund të jetë ligj i përgjithshëm për të gjithë njerëzit. All'llahu e lavdëron këtë cilësi, sepse presioni i rrethanave të tij e larguan nga martesja. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ai arrin ta mbrojë veten e tij nga gjynahet dhe të ruajë pastërtinë e tij nga papastërtitë.

Ligji i martesës është ligj i natyrës krijuese. Asnjë fe nuk mund të nxjerrë ligj kundër tij. Për këtë, beqaria nuk është cilësi lavdëruese, as në Islam dhe as në fetë e tjera.

2- Jahjai dhe Isai

Fjala *jahja* vjen nga fjala *el bajat*, që do të thotë *qëndrim i gjallë*. Ky emër i zgjedhur për këtë profet të madh ka kuptimin e jetës materiale dhe të asaj shpirtërore në dritën e besimit, të pozitës së profecisë dhe të lidhjes me All'llahun. Këtë emër atij ia zgjodhi All'llahu para se të lindte, siç thuhet në ajetin 7 të sures "Merjem": **“O Zekerija, Ne po të japim lajmin e mirë për një djalë, që do të quhet Jahja. Askujt nuk ia kemi dhënë këtë emër më parë.”**

Nga ky ajet kuptohet se askush nuk quhej me këtë emër para lindjes së Jahjait.

Më parë thamë se, kur Zekerija pa pozitën e lartë shpirtërore të Merjemes, ai i kërkoi All'lahut që t'i dhurojë pasardhës të mirë. All'lahu iu përgjigj lutjes së tij dhe i dhuroi një djalë të ngjashëm me Isain, të birin e Merjemes në shumë cilësi: profecinë, kur të dy ishin të vegjël, kuptimi i përbashkët i emrave të tyre (emri Isa dhe Jahja kanë kuptimin e të qëndruarit të gjallë), në përrshëndetje dhe selamin e All'lahut për të dy në tri faza: lindje, vdekje dhe tubim, etj.

3- Zekerija

Në këtë ajet Zekerija e cilëson pleqërinë e tij me thënien: **"...kur mua më ka zënë pleqëria..."**, ndërsa në ajetin 8 të sures "Merjem" thotë: **"...dhe unë kam arritur pleqërinë e thellë...?!"** Kuptimi i thënies së parë është se më ka kapur pleqëria, kurse kuptimi i thënies së dytë është se unë kam arritur në pleqëri. Ka mundësi që ky ndryshim të shprehë se njeriu, sa më shumë të përparojë drejt pleqërisë, aq më shumë pleqëria dhe vdekja përparojnë drejt tij. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Nëse je në largim dhe vdekja është përpara, sa i shpejtë do të jetë takimi."¹

4- Kuptimi i fjalës *akirun*

Fjala *gulam* ka kuptimin e *djalit që sapo i kanë dalë mustaqet*. Fjala *akirun* vjen nga fjala *ukrun*, që do të thotë, *origjinë, bazë*, ose ka kuptimin e bllokimit. Cilësimi i gruas që nuk lind me këtë cilësi ka kuptimin se ajo ka arritur në moshë që nuk lind, ose ka kuptimin se ajo është e bllokuar për të lindur.

¹ "Nehxhul Belaga", Fjalët e urta, fjala e 28-të. "Uesailu Shiah", vëll. 2, f. 439.

Ajeti 41

قَالَ رَبِّ اجْعَلْ لِي آيَةً ۖ قَالَ آيَاتُكَ إِلَّا تُكَلِّمَ النَّاسَ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ إِلَّا
رَمَزًا ۗ وَادْكُرْ رَبَّكَ كَثِيرًا وَسَبِّحْ بِالْعَشِيِّ وَالْإِبْكَرِ ﴿٤١﴾

“Ai tha: “O Zot! Më jep një shenjë!” (Zoti) i tha: “Shenjë për ty është se tri ditë nuk do t’u flasësh njerëzve, veçse me gjeste. Përmende shumë Zotin tënd dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes.”

Komentimi

Këtu Zekerija i kërkon All’llahut një shenjë për lajmin e mirë të lindjes së Jahjait.

S’ka dyshim se dukja e habitë nga ana e tij dhe kërkimi i shenjës nga All’llahu i Madhëruar, nuk do të thotë se Zekerija nuk besonte në premtimin e All’llahut, e veçanërisht ky premtim dëshmohet dhe përforcohet me thënien e All’llahut: **“Kështu! All’llahu bën çfarë të dojë.”**, mirëpo Zekerija donte që besimi që mbarte të shndërrohej në besim të dukshëm dhe donte që zemra e tij të mbushej me qetësi dhe bindje, siç ndodhi me Ibrahimin, i cili kërkoi bindjen dhe qetësinë e zemrës, bazuar të skena e të parit.

“Ai tha: “O Zot! Më jep një shenjë!” (Zoti) i tha: “Shenjë për ty është se tri ditë nuk do t’u flasësh njerëzve, veçse me gjeste.”

Fjala *er remzu*, do të thotë *shenjë me buzë dhe zë i dobët*. Më pas në dialogët e zakonshme, kuptimi i saj është zgjeruar dhe përfshin çdo fjalë dhe shenjë jo e qartë për një çështje.

Këtë kërkesë, All'llahu ia plotësoi Zekerijas dhe i caktoi një gjest, që ishte të mos fliste me fjalë për tri ditë me radhë. Ai nuk fliste normalisht, por për përmendjen e All'llahut gjuha e tij ishte e lirë. Kjo gjendje e habitshme ishte shenjë e fuqisë së All'llahut për çdo gjë. All'llahu është i Plotfuqishëm ta çlirojë gjuhën kur fillohet përmendja e Tij. Në këtë mënyrë sqarohet lidhja mes kësaj shenje dhe asaj që donte Zekerija.

Ky kuptim, gjithashtu, përmendet edhe në ajetet e para të sures "Merjem".

Këtu shtrohet pyetja: A është memecëria në përputhje me pozitën e profetit dhe me detyrën e thirrjes e të predikimit?

Përgjigjja për këtë pyetje nuk është e vështirë, sepse kjo gjendje nuk është në përputhje me pozitën e profecisë kur vazhdon për një kohë të gjatë. Kurse, praktikimi i saj për një kohë të shkurtër, i cili mundëson të dërguarin që të mënjanohet nga njerëzit dhe të adhurojë All'llahun, nuk ka problem.

Në këtë kohë ai mund t'u flasë njerëzve me gjeste dhe të lexojë ajete të All'llahut, të cilat konsiderohen përmendje e Tij. Kjo ishte ajo që bëri Zekerija, i cili, me anë të shenjave, i ftonte njerëzit në përmendjen e All'llahut.

"Përmende shumë Zotin tënd dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes."

Fjala *el ashju* zakonisht përdoret për orët e para të natës. Fjala *el ebkaru* përdoret për orët e para të ditës. Thuhet se *el ashju* është *zevali i diellit deri në perëndim* dhe *el ebkaru* është koha prej lindjes së agimit e deri në drekë.

Ragibu Asfahani në librin e tij “El Mufredat” thotë: “*El ashiju* është koha prej zevalit të diellit e deri në mëngjes dhe *el ebkaru* është koha e parë e ditës.”

Nga ajetet e para të sures “Merjem” përfitohet se këtë program nuk e ka zbatuar vetëm Zekerija, por ai u kërkoi njerëzve me shenjë që ta lartësojnë All’llahun në mëngjes dhe në darkë si shenjë falënderimi për mirësitë dhe për udhëheqësin e drejtë, si Jahjai që All’llahu u dha atyre.



Ajetet 42 - 43

وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَأِكَةُ يَمْرِيْمُ إِنَّ اللّٰهَ اصْطَفٰكَ وَطَهَّرَكَ وَاصْطَفٰكَ عَلٰى
نِسَاءِ الْعٰلَمِيْنَ ﴿٤٢﴾ يَمْرِيْمُ اقْنِيْ لِرَبِّكِ وَاَسْجُدِيْ وَاَرْكَعِيْ مَعَ
الرَّاكِعِيْنَ ﴿٤٣﴾

“E kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All’llahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen!”

Komentimi

Zgjedhja e Merjemes nga ana e All’llahut

Ajetet e mëparshme flisnin kalimthi për Merjemen, e kjo ishte kur u fol për Imranin dhe bashkëshorten e tij Hannën. Ky ajet flet hollësisht për Merjemen.

Ajeti thotë se engjëjt flisnin me Merjemen: “E kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All’llahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës.”¹

Sa e madhe është kjo krenari, kur njeriu të flasë me njeriun dhe ata të flasin me të, veçanërisht kur biseda ka të bëjë me përgëzim nga ana e All’llahut të Madhëruar për zgjedhje dhe parapëlqim.

¹ Kuptimi i pastrimit të Merjemes është për pastrimin e saj prej periodave mujore, që të qëndronte në shërbim të Bejtul Makdisit; ose mund të ketë kuptimin e pastrimit moral dhe shpirtëror.

Kjo ndodhi me Merjemen, të bijën e Imranit kur engjëjt e përgëzuan se All'llahu e ka zgjedhur atë nga mesi i të gjitha grave të botës. E ka pastruar dhe ia ka ngritur pozitën për shkak të devotshmërisë, besimit dhe adhurimit të saj.

Është për t'u përmendur se fjala *istafaki* përsëritet dy herë në këtë ajet. Herën e parë është përdorur për zgjedhje absolute dhe e dyta tregon për përsosmërinë e saj mbi gratë e tjera të kohës së saj.

Kjo do të thotë se Merjemja ka qenë gruaja më e lartë e kohës së saj. Kjo thënie nuk bie ndesh me të qenit e zonjës Fatime Zahra, zonja e grave të botës. Në një hadith të profetit Muhammed dhe të imam Sadikut thuhet: "Përsa i përket Merjemes, ajo ka qenë zonja e grave të kohës së saj, kurse Fatimeja është zonja e të gjitha grave të botëve, nga të parët e deri te të fundmit."¹

Po ashtu, edhe fjala *el alemijne* nuk e kundërshton këtë thënie, sepse në Kur'an dhe në bisedat e përgjithshme kjo fjalë ka kuptimin e njerëzve që jetojnë në një kohë të përbashkët, siç thuhet për bijtë e Izraelit: "...ju kam ngritur mbi njerëzit e tjerë."² S'ka dyshim se lartësimi i bijve të Izraelit ka qenë mbi banorët e kohës së tyre.

"O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen!"

Ky ajet është plotësues i bisedës së engjëjve me Merjemen. Pasi e përgëzuan, se All'llahu e ka zgjedhur atë, i thanë: "Tani falënderoje All'llahun me përkulje (ruku), me sexhde dhe nënshtrim para Tij, si pohim për këtë mirësi të madhe."

Në ajet shohim se engjëjt i përmendin Merjemes tre urdhra:

I pari: Bindja dhe përrulja e vazhdueshme ndaj All'llahut;

I dyti: Suxhudi (sexhde), i cili gjithashtu tregon bindje të plotë ndaj All'llahut;

¹ Tefsijri "Nuru Thakalejn", vëll. 1, f. 337,338. "Biharul Anuar", vëll. 37. F, 85.

² Sure "El-Bekare", ajetet, 47 dhe 122.

I treti: Rukuja, që do të thotë përsëri përlulje dhe modesti.

Përsa i përket thënies: **“...dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen!”** ka mundësi të tregojë për namazin me xhemat, ose i kërkon asaj t'i bashkëngjitet grupit namazfalës, pra, bëj ruku me robtë e sinqertë që i bëjnë ruku All'lahut.

Në ajet tregohet se suxhud (sexhdeja) i është përmendur para rukusë. Kjo nuk do të thotë se suxhudi (sexhde) i tyre ka qenë para rukusë, por kuptimi është kryerja e adhurimit, por pa përmendur renditjen e tyre. Kjo është njësoj sikur t'i themi dikujt, falu, merr abdes, pastrohu. Qëllimi ynë është që ai t'i bëjë të gjitha këto. Dihet se rukuja dhe suxhudi (sexhde), në origjinal, kanë kuptimin e përluljes e të bindjes, kurse lëvizjet, që ne bëjmë, janë disa prej vërtetësisë së kësaj bindjeje e përluljeje.

Fladi

Ajeti 44

ذَلِكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ ۚ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يُلْقُونَ
أَقْلَمَهُمْ أَيُّهُمْ يَكْفُلُ مَرْيَمَ ۚ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يَخْتَصِمُونَ ﴿٤٤﴾

“Këto janë lajme të fshehta, që po t’i shpallim ty (o Muhammed). Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hodhën short se kush prej tyre do të merrte nën kujdes Merjemen dhe nuk ishe i pranishëm kur ata diskutonin.”

Komentimi

Kujdestaria ndaj Merjemes

Ky ajet flet për një anë tjetër të historisë së Merjemes (*Paqja qofitë mbi të!*). Ai thotë se ato, që u përmendën më parë rreth historisë së Merjemes dhe Zekerijas, janë prej lajmeve të fshehta (të gajbit): **“Këto janë lajme të fshehta, që po t’i shpallim ty (o Muhammed).** Kjo histori, në formën e saj të rregullt e të pastër nga legjendat, nuk gjendet në asnjë libër të mëparshëm. Në shtesë të kësaj, burimi i kësaj historie është shpallja nga qielli.

Pastaj ajeti shton duke thënë: **“Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hodhën short se kush prej tyre do të merrte nën kujdes Merjemen dhe nuk ishe i pranishëm kur ata diskutonin.”**, që do të thotë: Ti nuk ishe i pranishëm në atë kohë, por lajmi për atë të vjen nëpërmjet Shpalljes.

Më parë thamë se nëna e Merjemes, pasi e lindi dhe e mbështolli me copë, shkoi te vendadhurimi dhe u foli dijetarëve,

të bijve të Izraelit, parisë së tyre, duke u thënë: “Kjo foshnje e porsalindur është e përbetuar që të jetë në shërbim të Bejtul Makdisit, prandaj le të angazhohet dikush për edukimin e saj.”

Përderisa Merjemja ishte prej një familjeje të njohur, familja e Imranit, dijetarët e bijve të Izraelit filluan të garojnë se kush do ta fitonte angazhimin dhe kujdestarinë e edukimit të saj. Së fundi, ata ranë dakord të hedhin short mes tyre. Ata shkuan në bregun e lumit dhe morën me vete shkopinjtë e tyre, që i përdornin gjithmonë për shorte. Secili shkroi emrin e tij mbi kalem dhe i hodhën në ujë.

Çdo shkop, që zhytej në ujë, i zoti i atij shkopi humbiste. Fitues ishte kalemi që qëndronte mbi ujë. Shkopi, që kishte emrin e Zekerijas, u zhyt në ujë dhe pastaj doli përsëri mbi të. Në këtë mënyrë Merjemja u bë pjesë e kujdestarisë së Zekerijas. Në të vërtetë ai ishte më i merituari i tyre, sepse ishte profet dhe bashkëshorti i tezes së Merjemes.

Hulumtim

Shorti, zgjidhja e fundit

Nga ky ajet dhe nga ajete të tjera të veçanta për profetin Junus, që ndodhen në suren “Safat”, përfitohet se mund të përdoret shorti për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes palëve, sidomos kur rrugët e tjera janë të mbyllura dhe nuk gjendet zgjidhje e pranueshme ndër palët mosmarrëveshëse. Ky ajet dhe hadithet e ardhura nga imamët e Islamit¹ kanë qenë shkak që shorti të konsiderohet rregull i jurisprudencës. Shorti hidhet kur të gjitha rrugët e zgjidhjes mbyllen plotësisht. Nëse mendohet se gjendet një rrugë tjetër për zgjidhjen e problemit, atëherë nuk lejohet strehimi në hedhjen e shortit.

Në Islam nuk ka mënyrë të posaçme për shortin. Mund të përdoren kalema, shkopinj, gurë, letra e të tjera mjete, me kusht që të mos ketë marrëveshje të fshehtë apo komplot.

Është e qartë se Islami nuk e lejon fitimin apo humbjen me anë të shortit, sepse fitimi dhe humbja nuk janë prej problemeve të vështira që nuk zgjidhen dhe për këtë të hidhet short. Prandaj, fitimi i marrë nëpërmjet shortit nuk lejohet në Islam.

Duhet përmendur gjithashtu se shorti nuk kufizohet vetëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes njerëzve, por nëpërmjet tij mund të zgjidhen edhe probleme të tjera të vështira.

¹ Tehdhijb, vëll. 6, f. 233 (kreu 90... Rregullat e shortit). “Men la jehdherul fakih”, vëll. 3, f. 89 (kreu i Rregullit të shortit.)

Ajetet 45 – 46

إِذْ قَالَتِ الْمَلَأِكَةُ يَمْرِيْمُ إِنَّ اللّٰهَ يُبَشِّرُكَ بِكَلِمَةٍ مِّنْهُ اسْمُهُ الْمَسِيْحُ
عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ ﴿٤٥﴾ وَيُكَلِّمُ
النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهَلًا وَمِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٤٦﴾

(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All’llahu të jep lajmin e mirë për një Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesijh – Isai, i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e All’llahut. Ai do t’u flasë njerëzve qysh i vogël në djep edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.”

Komentimi

Ky ajet sqaron mënyrën e lindjes së Mesijhut (hazretit Isait) dhe fillon me përgëzimin e Merjemes nga ana e engjëjve me urdhër nga All’llahu. Ata i thanë asaj se All’llahu do të të japë ty një djalë me emrin Mesijhu, Isai, i biri i Merjemes. Ai do të ketë pozitë të lartë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër dhe do të jetë nga të afërmit e All’llahut.

(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All’llahu të jep lajmin e mirë për një Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesijh –

Isai, i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e All'llahut.”¹

Këtu duhen përmendur disa çështje:

1- Në këtë ajet dhe në dy ajete të tjera, Mesijhu, hazreti Isa, cilësohet se është *kelimeh* - fjalë. Kjo shprehje ndodhet edhe në librat e Dhiatës së Re.

Fjalët e komentuesve janë të shumta në sqarimin e shkakut të përdorimit të kësaj shprehjeje për Mesijhun. Por më e afërta ndër to me logjikën është se lindja e Mesijhut ka qenë e jashtëzakonshme dhe përfshihet tek thënia: **“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet;**² ose, sepse lajmi përgëzues për lindjen e tij erdhi në fjalë për nënën e tij.

2- Fjala *Mesijb* ka kuptimin e *el Masih* ose *el memsub-fshirës, pastrues*. Kjo është përdorur për hazretin Isa, sepse me dorën e tij u fshinte të sëmurëve sëmundje të rënda dhe shëroheshin me lejen e All'llahut. Kjo dhunti ka qenë e veçantë që në fillim. Për këtë All'llahu e quajti Mesijh para lindjes. Ka mundësi që emërtimi me këtë term të jetë bërë se All'llahu e ka pastruar atë prej të këqijave dhe gjynaheve.

3- Në këtë ajet Kur’ani flet qartë se Isai është i biri i Merjemes. Kjo qartësi hedh poshtë shpifjet rreth hyjnisë së Mesijhut. Cilido që lind nga një grua dhe kalon fazat e ndryshimit si të gjithë njerëzit e tjerë në barkun e nënës, nuk mund të jetë Zot, sepse Zoti është i pastër prej çdo lloj ndryshimi e shndërrimi. Ai është Një i vetëm i Pashoq.

Ajeti më pas tregon për një nga mirësitë dhe mrekullitë e hazretit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe kjo është të folurit e njerëzve kur është në djep: **“Ai do t’u flasë njerëzve qysh i vogël në djep edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.”** Për të

¹ Duhet theksuar se përemri pronor në fjalën *ismubu*, emri i tij është për termin *kelimetun* dhe është për hazretin Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

² Sure “Ja Sin”, ajeti 82.

mbrojtur nënën e tij nga akuzat e bijve të Izraelit, hazreti Isa, kur ishte i vogël, u foli atyre me fjalë retorike, duke shprehur adhurimin e All'llahut dhe të qenit profet. Me këtë mrekulli ai vërtetoi pastërtinë e nënës së tij, sepse është e pamundur që një profet të lindë nga një mitër e papastër.

Fjala *el mehd* është çdo vend që përgatitet për të fjetur fëmija e porsalindur, që ne i themi djep, qoftë i lëvizshëm apo i palëvizshëm.

Ajo që duket në ajetet e sures “Merjem”, është se hazreti Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) foli që në fillim të lindjes së tij, gjë që zakonisht është e pamundur për çdo fëmijë të kësaj moshe. Të folurit e tij në djep ishte mrekulli e madhe.

Po ashtu, ajeti tregon se Mesijhu, hazreti Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) gjithmonë thoshte të vërtetën, nga lindja e deri në moshën e mesme-kubuletit.¹ Ai i ftonte vazhdimisht njerëzit në rrugën e All'llahut.

Ka mundësi që kuptimi i kësaj shprehjeje të jetë argument i njoftimit për rikthimin e Mesijhut në këtë jetë. Ne e dimë prej librave të historisë që hazreti Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) është ngritur në qiell dhe ishte 33 veç. Kjo është në përputhje me shumë hadithe, që thonë se hazreti Isa do të kthehet në kohën e ardhjes së imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*), do të jetojë me të dhe do ta dëshmojë.

Pas përmendjes së virtyteve të ndryshme të hazretit Isai, ajeti në fund thotë: **“...dhe do të jetë nga më të mirët.”**

Nga kjo frazë kuptohet se *salabu-mirësia, drejtësia, ndershmëria, pastërtia morale, besimi dhe fetaria* janë shkaqet më të mëdha të krenarisë. Nën to përfshihen të gjitha vlerat e tjera të larta njerëzore.

¹ *Kubuleti* është moshë e mesme. Thuhet se është periudha nga 34 deri në 51. Moshë para kësaj periudhe është rinia dhe pas saj pleqëria.

Ajeti 47

قَالَتْ رَبِّ اِنَّىْ يَكُوْنُ لِىْ وُلْدٌ وَّلَمْ يَمَسَّسْنِىْ بِثَرٍّ ؕ قَالَ كَذٰلِكَ اَللّٰهُ يَخْلُقُ
 مَا يَشَآءُ ؕ اِذَا قَضٰى اَمْرًا فَاِنَّمَآ يَقُوْلُ لَهُ كُنْ فَيَكُوْنُ ﴿٤٧﴾

Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!” – “Kështu – tha (engjëlli) – All’llahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.”

Komentimi

Ne e dimë se kjo botë është bota e shkaqeve dhe e faktorëve. All’llahu e ka rregulluar çështjen e krijimit në atë mënyrë që çdo krijesë lind brenda një serie shkaqesh dhe faktorësh. Që të lindë një njeri, All’llahu ka caktuar që kjo të bëhet nëpërmjet kontaktit seksual dhe depërtimit të spermës në vezore. Ishte e drejta e Merjemes që të habitej dhe të pyeste se si do të ishte shtatzënë e të lindte fëmijë pa këtë kontakt seksual me asnjë njeri. Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!”

Engjëjt i erdhën asaj me lejen e All’llahut dhe e lajmëruan se All’llahu krijon çfarë të dojë dhe si të dojë. Sistemi i natyrës është prej krijimit të All’llahut dhe ecën sipas urdhrit të Tij. All’llahu është i Plotfuqishëm dhe e ndryshon këtë sistem kur të dojë dhe nëpërmjet shkaqeve dhe faktorëve të tjerë të jashtëzakonshëm, Ai krijon çfarë të dojë: “Kështu – tha (engjëlli) – All’llahu krijon ç’të dojë Vetë.”

Më pas, për ta përforcuar dhe për ta plotësuar këtë gjë, ajeti thotë: **“Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.”**

Shprehja **“kun fe jekun”** tregon për shpejtësinë e krijimit.

Fjala *kun* tregon për *dëshirën vendimtare të All'llabut*, të cilën nuk e kundërshton asgjë, që do të thotë se, kur All'llahu dëshiron të bëjë diçka, e bën në këtë ekzistencë.

Duhet përmendur se për krijimin e Isait (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) ka thënë *jekhluku-krijon*, dhe për krijimin e Jahjait (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) ka thënë *jef'alu-bën*. Ka mundësi që ky ndryshim në shprehje vjen nga ndryshimi i krijimit të këtyre dy profetëve. Njëri prej tyre lindi në mënyrë të zakonshme, ndërsa tjetri lindi në mënyrë të jashtëzakonshme.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajetet, që flasin për historinë e Merjemes dhe të djalit të saj, në fillim tregojnë për bisedën e engjëjve me Merjemen, kurse këtu bisedën e saj me All'llahun. Kështu duket se ndërmjetësitë mes saj dhe All'llahut nuk gjendeshin dhe filloi t'i flasë Atij dhe të dëgjojë thëniet e Tij.

Ajetet 48 – 49

وَيُعَلِّمُهُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ ﴿٤٨﴾ وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنِّي قَدْ جِئْتُكُمْ بِعَايَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ ^طأَنِّي أَخْلُقُ لَكُمْ مِنَ الطَّيْرِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ ^ط وَأُبرئُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ وَأُحْيِي الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ اللَّهِ وَأُنَبِّئُكُم بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ فِي بُيُوتِكُمْ ^ج إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً لَّكُمْ ^ط إِن كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿٤٩﴾

(All'lahu) do t'ia mësojë atij shkrimin, diturinë, Teuratin dhe Ungjillin dhe do ta caktojë atë të Dërguar te bijtë e Izraelit (të cilëve do t'u thotë): “Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj (që vërtetojnë Profecinë time): bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e All'lahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrsurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e All'lahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”

Komentimi

Dallimet e tjera të hazretit Isa (Paqja e All'llabut qoftë mbi të!)

Në ajetet e mëparshme lexuam katër cilësi të hazretit Isa (Paqja e All'llabut qoftë mbi të!): i nderuar në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër, nga të afërmit e All'llabut, u fliste njerëzve kur ishte në djep dhe nga më të mirët. Këto dy ajete fillojnë me dy cilësi të tjera të këtij profeti të madh. Në fillim të ajetit të parë thuhet: “(All'llahu) **do t'ia mësojë atij shkrimin, diturinë, Teuratin dhe Ungjillin...**”

Pra, në fillim ajeti flet për të mësuarit e tij të urtësisë dhe të njohjes. Pastaj sqaron vërtetësinë e dijes dhe të urtësisë, që janë Ungjilli dhe Teurati.

Vërtet, ata që All'llahu i zgjedh për udhëheqjen dhe udhëzimin e njerëzve duhet patjetër që të jenë në shkallët më të larta të dijes e të njohjes dhe të paraqesin mësim dhe ligje të larta dhe dobiprurëse. Pas këtyre, ata duhet të shfaqin argumente të qarta, që vërtetojnë lidhjen e tyre me All'llahun dhe të vërtetojnë misionin e tyre.

Me këto dy mjete plotësohet procesi i udhëzimit të njerëzve. Në ajetet e lartpërmendura tregohet për këto dy çështje. Në ajetin e parë flitet për Mesijhun dhe librat qiellorë, kurse në të dytin përmenden disa mrekulli. Më pas sqaron qëllimin, që është udhëzimi i bijve të Izraelit. “**...dhe të Dërguar te bijtë e Izraelit...**”¹

Ajo që vlen të përmendet është se mesazhi i hazretit Isa (Paqja e All'llabut qoftë mbi të!) ka qenë vetëm për bijtë e Izraelit. Kjo nuk e mohon të qenit e hazretit Isa prej profetëve të vendosmërisë së lartë (ulul azmi), sepse këta profetë janë ata që sollën fe të re, edhe pse feja e tyre nuk ka qenë mbarëbotërore.

¹ Kjo fjali është me aludimin e foljes *do ta caktojë atë*. Po ashtu, ka edhe alternativa të tjera për këtë.

Në tefsijrin “Nuru Thakalejn” përmendet një hadith, që e kufizon mesazhin e hazretit Isa vetëm te bijtë e Izraelit.¹

Mirëpo, disa komentues janë të mendimit se mesazhi i hazretit Isa është mbarëbotëror dhe nuk ka qenë i kufizuar vetëm për bijtë e Izraelit, edhe pse bijtë e Izraelit kanë qenë në krye të atyre që u dërguan për t’u udhëzuar.

Eruditi i ndjerë Mexhlisi, në librin “Biharul Anuar”, përmend hadithe se mesazhet e profetëve të qëndrueshmërisë së lartë janë mbarëbotërore.²

Më pas ajeti thotë: **“Ju kam sjellë shenja nga Zoti juaj.”**

Nuk është vetëm një shenjë, argument, por janë disa. Përderisa thirrja e profetëve ka qenë thirrje për jetë të vërtetë, ky ajet, që sqaron mrekullitë e hazretit Isa (*Paqja e All’llahut qoftë mbi tël*), fillon me përmendjen e dërgimit të jetës te të vdekurit me lejen e All’llahut. Me gjuhën e Mesijhut, ajeti thotë: **“...bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e All’llahut ajo bëhet shpend i gjallë;”**

Padyshim që ringjallja e të vdekurit me lejen e All’llahut nuk është e vështirë, sepse ne e dimë se të gjitha krijesat frymore janë krijuar prej ujit dhe tokës dhe All’llahun nuk e pengon asgjë që t’i bashkojë shkaqet që krijimi të bëhet në mënyrë të shpejtë dhe balta të kthehet në shpend të gjallë.

Është e natyrshme se realizimi i kësaj çështjeje në atë vend dhe në vende të tjera është argument i gjallë dhe tregues i qartë për lidhjen që ka zotëruesi i mrekullisë me metafizikën dhe me fuqinë absolute të All’llahut.

¹ Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 343.

² “Biharul Anuar”, vëll. 11, f. 28, 32 dhe 33. Usulul Kafij, vëll. 1, f. 175 dhe 224.

Më poshtë ajeti tregon për shërimin e sëmundjeve të rënda e të pashërueshme. Po me gjuhën e hazretit Isa thotë: **“...shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut;”**

S’ka dyshim se kryerja e të gjitha këtyre veprave, veçanërisht tek dijetarët e mjekësisë së asaj kohe, ka qenë prej mrekullive që nuk mund të mohohen.

Pas kësaj ajeti flet për lajmërimin e tij rreth sekreteve të njerëzve. Çdo njeri ka sekrete dhe të fshehta në jetën e tij, të cilat nuk i dinë të tjerët. Kushdo që u tregon atyre se çfarë hanë ose çfarë fshehin, kjo do të thotë se të dhënat atij i vijnë nga gajbi (e padukshmja). **“...ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja.”**

Së fundi thotë se të gjitha këto janë argumente të vërteta për ata që janë besimtarë: **“Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”**

Hulumtime

A ishin të habitshme mrekullitë e Mesijhut?

Disa komentues, si autori i komentimit “El Manar”, këmbëngulin në te’vilin e mrekullive të Mesijhut, për të cilat flet edhe Kur’ani, duke i dhënë forma të ndryshme. Prej thënieve të tyre është edhe ajo që Mesijhu është mjaftuar vetëm me thënie se bëj këtë apo atë me lejen e All’llahut dhe nuk i ka bërë me vepra.

Nëse ky mendim është i mundshëm për diskutim, atëherë ajeti 110 i sures “El-Maide” nuk lë vend për asnjë lloj diskutimi rreth kësaj çështjeje. Ajeti thotë: **“...se si me vullnetin Tim krijojë një figurë shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim;”** Ky ajet flet qartë se një prej mirësive të All’llahut ishte se hazreti Isa, me lejen e All’llahut, krijonte prej balte shpendin.

Këmbëngulja në të tilla te’vile nuk është e saktë, sepse, nëse prej kësaj këmbënguljeje qëllimi është mohimi i veprave të jashtëzakonshme të profetëve, Kur’ani i pohon qartë ato në shumë vende.

Nëse supozojmë se do t’i bëjmë te’vil këtyre mrekullive të Mesijhut, si do të bëjmë me mrekullitë e tjera që nuk u bëhet kurrë te’vil?

Pastaj, ne themi se All’llahu është sunduesi i ligjeve të natyrës dhe se ligjet nuk e sundojnë Atë. Atëherë çfarë i pengon ato ligje të natyrës të ndryshojnë me urdhrin e Tij në rrethana të veçanta dhe të sjellin ndodhi të jashtëzakonshme?

Nëse ata përfytyrojnë se kjo bie ndesh me njëshmërinë e veprave të All’llahut, duke qenë se është i Vetëm dhe i Pashoq, Kur’ani e ka dhënë përgjigjen.

Ndodhia e këtyre fenomeneve, kudo që të ndodhin, janë të kushtëzuara me lejen e All'llahut. Askush nuk është i aftë që, me fuqinë e Tij të posaçme, të kryejë kësioj fenomenesh, vetëm nëse do All'llahu, duke i dhënë fuqi prej fuqisë së Tij absolute, ku në vetvete është Teuhid dhe jo shirk.

Mbështetja në vullnetin e All'llahut

Duhet përmendur se përsëritja e frazës “**me lejen e All'llahut**” dhe mbështetja në vullnetin e Tij hedh poshtë çdo pretendim rreth hyjnisë së hazretit Isa, që njerëzit të mos e konsiderojnë Zot.



Shoqata

Islami

Ajetet 50 - 51

وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَلَا أُحِلَّ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي
حُرِّمَ عَلَيْكُمْ^ج وَجِئْتُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا^{٥٠} إِنَّ
اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَأَعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُّسْتَقِيمٌ^{٥١}

“Dhe për t’ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t’ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara, ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë All’llahun dhe bindmuni! Me të vërtetë, All’llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”

Komentimi

Në këtë ajet janë fjalët e Mesijhut (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) për t’i sqaruar qëllimet e profecisë, duke u thënë: “Erdha t’ua dëshmoj juve Teuratin dhe të përforcoj parimet dhe bazat e tij: **“Dhe për t’ju vërtetuar Teuratin, që është para meje.”**

Po ashtu kam ardhur që të heq ndalimin e imponuar në fenë e Musait (*Paqja e All’llabut qoftë mbi të!*) për ju për disa gjëra që ju ndaluan juve për shkak të mosbindjes suaj, si: mishi i devesë, dhjamërat e disa kafshëve, disa shpendë dhe peshq: **“...dhe që t’ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara.”**

Në ajetin 160 të sures “En-Nisa” lexojmë se për shkak të kokëfortësisë së disa jahudijve dhe të padrejtësisë së tyre, All’llahu ua ndaloi konsumimin e disa të mirave. Ajeti thotë: **“Ne ua ndalum atyre**

disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të padrejtësive që bënë...”

Këto mirësi, me mirësinë e Mesijhut, atyre iu lejuan përsëri. Më poshtë edhe njëherë përsëritet fjalia me gjuhën e Mesijhut, që ndodhej në ajetin 48: **“Ju kam sjellë një shenjë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë All'llahun dhe bindmuni!”**

Në ajetin e dytë, Mesijhu e përforcon me thënien e tij se është adhures i All'llahut. Kjo sqaron çdo dyshim dhe paqartësi që mund të lindë për shkak të mënyrës së lindjes së tij, ku disa mund ta përdorin si mjet për konstatimin e të qenit të tij Zot. Ajeti thotë: **“Me të vërtetë, All'llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”** Pra, ky ajet i hedh poshtë të gjitha pretendimet e atyre që thonë se, përderisa lindja e tij ka qenë e jashtëzakonshme, ai është Zot. Po ashtu, ajeti 30 në suren “Merjem”, i hedh poshtë të gjitha pretendimet dhe dyshimet rreth të qenit të Mesijhut Zot: **“Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i All'llahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet.”**

Të kundërtën shohim në Ungjillin e pranishëm e të devijuar, në të cilët thuhet se Mesijhu e përdorte fjalën *ebuna- At*, për All'llahun, ndërsa Kur'ani përdor fjalën *rabun-Zot, Sundues*, në vend të fjalës *ebuna- At*. **“Me të vërtetë, All'llahu është Zoti im dhe Zoti juaj.”**

Kjo ishte e shumta që mund të bënte Mesijhu për të luftuar pretenduesit e hyjnisë. Për ta përforcuar më shumë këtë thënie, ai u thotë njerëzve: **“...prandaj adhurojeni Atë.”** Pra, adhuroni All'llahun dhe mua.

Për këtë lexojmë se askush nga njerëzit në kohën e Mesijhut nuk guxonte të thoshte se Mesijhu është Zot apo është një prej zotave. Që pas dy shekujve nga ngritja e tij në qiell, mësimet e tij nuk kanë pasur asnjë papastërti e politeizëm.

Trinia, sipas udhëheqësve të kishës, u shfaq në shekullin e tretë të lindjes së Mesijhut. (Sqarimi i kësaj çështjeje do të jetë i detajuar në fundin e komentimit të ajetit 171 të sures “En-Nisa”).



Ajetet 52 – 54

فَلَمَّا أَحَسَّ عِيسَىٰ مِنْهُمُ الْكُفْرَ قَالَ مَنْ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ ^ط قَالَ
الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ اللَّهِ ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَأَشْهَدُ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٥٢﴾
رَبَّنَا ءَامَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ﴿٥٣﴾
وَمَكْرُوهًا وَمَكْرَ اللَّهُ ^ط وَاللَّهُ خَيْرُ الْمَكْرِينَ ﴿٥٤﴾

“Kur Isai e ndieu mosbesimin e tyre, tha: “Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e All’llahut?” Apostojt u përgjigjën: “Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) All’llahut. Ne e besojmë All’llahun e ti dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij). Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!” Dhe ata i përgatitën një kurth, por edhe All’llahu u përgatiti kurth, se All’llahu është strategu më i mirë.”

Komentimi

Palëkundshmëria e apostujve

Jahudijtët e prisnin ardhjen e Mesijhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) sipas lajmeve të hazretit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Por, kur erdhi dhe interesat e të padrejtëve e devijuesve u përballën me rrezik, atij nuk i besoi vetëm një pakicë e vogël njerëzish.

Hazreti Isa, pasi e shfaqti thirrjen e tij dhe e konstatoi me argumente të mjaftueshme, e kuptoi se një grup prej bijve të Izraelit këmbëngulnin në kundërshtimin e tij dhe nuk hiqnin dorë nga kokëfortësia e devijimi. Fillimi i ajetit të parë thotë: **“Kur Isai vuri re¹ mosbesimin e tyre...”**. Atëherë ai u tha shokëve të tij: **“Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e All'llahut?”**

Thirrjes së tij iu përgjigj një pakicë njerëzish. Ata ishin të pastër dhe Kur'ani i ka quajtur havarijun. Këta e pranuan ftesën e Mesijhut dhe bënë gjithçka për përhapjen e qëllimeve të shenjtja të Mesijhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Ata paraqitën gatishmërinë e tyre të plotë për ta ndihmuar Mesijhun: **“...apostujt u përgjigjën: “Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) All'llahut. Ne e besojmë All'llahun e ti dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij).”**

Shiko me vëmendje se havarijunët nuk thanë: “Ne jemi përkrahësit e tu!” Por, që të shprehin besimin e tyre të plotë në Njëshmërinë e All'llahut dhe që të konstatojnë sinqeritetin e tyre, ata thanë: “Ne jemi përkrahësit e All'llahut, ndihmues të fesë së Tij. Ne kërkojmë nga ty që të dëshmosh për këtë të vërtetë.”

Shihet qartë se në fjalën e tyre nuk ekziston asnjë lloj arome e politeizmit. Por, ka mundësi që ata të kenë ndier aromën e devijimit se në të ardhmen do të ketë prej njerëzve që do të thonë se Mesijhu është Zot.

¹ Përdorimi i fjalës *ehesse* mund të jetë për shkak se këmbëngulja e tyre në mohim arriti në shkallë të lartë, derisa dukej se ishte i prekshëm, edhe pse mohimi është çështje e brendshme dhe nuk shihet me shqisa. (Komentimi “El Mijzan”, fundi i ajetit në fjalë.)

Gjithashtu, havarijunët, me fjalët e tyre, thanë se janë myslimanë dhe kjo do të thotë se Islami është fe e të gjithë profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*).

Këtu, hazreti Mesijhu i dalloi ndjekësit e tij të çiltër prej kundërshtarëve dhe hipokritëve, që të vendosë një program të hollësishëm për përhapjen e mesazhit të tij, ashtu siç veproi edhe profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në betimin e Akabes.

Pasi havarijunët (apostojt) e pranuan ftesën e Mesijhut, që të bashkëpunojnë me të dhe se ai është dëshmitar për besimin e tyre, ata iu drejtuan All'llahut duke shprehur besimin ndaj Tij duke thënë: **“Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur...”**

Mirëpo, përderisa shfaqja e besimit nuk është e mjaftueshme, ata e pasuan atë me ndjekjen dhe zbatimin e urdhrave të All'llahut dhe me ndjekjen e të dërguarit të Tij, hazretit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“...dhe pasojmë të Dërguarin.”**

Kur besimi i njeriut gurgullon në shpirtin e tij, duhet që të reflektojë në punë e në vepra. Pa punë dhe vepra, thënia e tij, se është besimtar, është veçse hamendje dhe jo besim i vërtetë.

Pas kësaj, havarijunët i kërkuan All'llahut: **“Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!”** Dëshmitarët janë ata që kanë cilësinë e udhëheqjes së drejtë të popujve dhe në Ditën e Kiametit do të dëshmojnë për punët e tyre të mira.

Pas përfundimit të sqarimit të besimit të tyre, havarijunët treguan për kurthet djallëzore të jahudijve, për ekzekutimin e hazretit Mesijh dhe të mesazhit të tij.

Mirëpo, All'llahu ua prishi të gjitha planet dhe kurthet, sepse planet e All'llahut janë shumë superiore ndaj planeve dhe kurtheve të njerëzve: **“Dhe ata i përgatitën një kurth, por edhe All'llahu u përgatiti kurth, se All'llahu është strategu më i mirë.”**

Hulumtime

1- Kush janë apostojt?

Fjala *havarijun* është shumësi i fjalës *hurij* dhe vjen nga lënda *haure*, që do të thotë *larje* dhe *zbardhje*. Kjo fjalë përdoret edhe për diçka të bardhë. Ushqimit të bardhë arabët i thonë *el huriju*. Shumësi i fjalës *haurun* është *el haura*, që do të thotë *lëkurë e bardhë*.

Ka shumë mendime se pse u quajtën kështu nxënësit e Mesijhut. Më e afërta e tyre është thënia e ardhur nga imamët e fesë: “Ata u quajtën të tillë se, përveç pastërtisë së zemrave dhe kthjelltësisë së shpirtit të tyre, vazhdimisht përpiqeshin për pastrimin dhe larjen e njerëzve prej gjynaheve dhe ndriçimin e mendjeve të tyre.”¹

2- Apostujt në Kur’an dhe në Ungjill

Në suren “Saf”, Kur’ani flet për apostujt dhe tregon për besimin e tyre. Mirëpo, kur lexojmë Ungjillin, duket se të gjithë apostujt bënë të këqija. Emrat e tyre përmenden në Ungjillin e Mettës dhe të Lukës, në kapitullin e gjashtë si vijon: 1- Butrus, 2- Andrejas, 3- Ja’kub, 4- Juhanna, 5- Fijlups, 6- Portuluma, 7- Toma, 8- Metta, 9- Jua’kub ibn Halfa, 10- Shem’un, 11- Jehudha, vëllai i Ja’kubit, 12- Jehudha El Eksrijuti, i cili tradhtoi Mesijhun.

Komentuesi i njohur, i ndjeri Tabarsi, në komentimin “Mexhmaul Bejan”, thotë se apostujt e shoqëronin Mesijhun në udhëtimet e tij. Sa herë që i merrte etja dhe uria, ata gjenin ushqim dhe pije të gatshme, me lejen e All’llahut. Ata krenoheshin me këtë punë të tyre. Ata e pyetën Mesijhun: “A ka njerëz më të mirë se ne?”

Ai iu përgjigj: “Po.”

¹ Këtë e mbështet edhe hadithi i imam Rizait, i përmendur në librin “Ujun Akhbar Riza”, vëll. 2, f. 79. “Ilelu Sherajja”, vëll. 1, f. 80.

- “Më i mirë se ju është ai që punon me duart e veta dhe ushqehet me ato që fiton nga puna e tij.”

Pas kësaj ata filluan të punonin duke larë rrobat e njerëzve kundrejt një shpërblimi. Puna e tyre ishte mësim edhe për njerëzit e tjerë, se puna nuk është vepër e keqe dhe as turp.¹

3- Çfarë do të thotë fraza “kurthi i All'llahut”?

Në Kur'an ka ajete të ngjashme me këtë ajet, në të cilat kurthi i mvishet All'llahut.²

Fjala *mekrun*, në terminologjinë bashkëkohore ndryshon shumë nga kuptimi i saj gjuhësor. Në terminologjinë bashkëkohore fjala *mekrun* ka kuptimin e *vendosjes së planeve djallëzore e të dëmshme*, ndërsa në gjuhësinë arabe do të thotë *kërkim për zgjidhjen e një çështjeje*, e cila mund të jetë e mirë apo e keqe.

Në librin “El Mufredat” të Ragib Asfahanit thuhet: “*El mekr* do të thotë largimi i tjetrit nga ajo që synon, e mirë apo e keqe.”

Në Kur'an fjala *mekru* vjen e shoqëruar me fjalën *el khajr*: “...se All'llahu është strategu më i mirë.” Po ashtu përmendet e shoqëruar edhe me fjalën *es sejj'u- e keqe*: “**Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën.**”³ Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është se kundërshtarët e hazretit Isa (Paqja e All'llahut *qoftë mbi të!*) thurën plane dhe kurthe djallëzore për t'u përballur me thirrjen hyjnore, por, që të ruajë jetën e të dërguarit të Tij dhe mesazhin prej çdo kurthi dhe plani djallëzor, All'llahu i prishi ato.

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1, f. 448. “Mustedrekul Uesail”, vëll. 13, f. 23.

² Shiko ajetin 30 në suren “Enfal” dhe ajetin 50 në suren “En-Neml”.

³ Sure “Fatir”, ajeti 43.

Ajeti 55

إِذْ قَالَ اللَّهُ يَٰعِيسَىٰ إِنِّي مُتَوَفِّيكَ وَرَافِعُكَ إِلَيَّ وَمُطَهِّرُكَ مِنَ الَّذِينَ
كَفَرُوا وَجَاعِلُ الَّذِينَ اتَّبَعُوكَ فَوْقَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۗ ثُمَّ
إِلَىٰ مَرْجِعِكُمْ فَأَحْكُم بَيْنَكُمْ فِيمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٥٥﴾

(Kujtoje, o Muhammed) “kur All’llahu tha: “O Isa! Unë do të të marr, do të të ngre pranë Meje dhe do të të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit. Pastaj, të gjithë do të ktheheni tek Unë dhe do të gjykoj midis jush për çështjet që jeni grindur.”

Komentimi

Më parë thamë se disa jahudij dhe disa të krishterë tradhtarë vendosën ta vrasin hazretin Mesijh, por All’llahu ua prishi atyre planin dhe e shpëtoi profetin e Tij prej tyre. Në këtë ajet All’llahu përmend mirësinë e Tij ndaj Mesijhut, para se të ndodhte ndodhia, duke i thënë: “...kur All’llahu tha: “O Isa! Unë do të të marr, do të të ngre pranë Meje.”

Tek komentuesit është e njohur, bazuar edhe tek ajeti 157 i sures “En-Nisa”, se hazreti Isa nuk është vrarë, por All’llahu e ngriti atë në qiell. Të krishterët thonë se ai u vra, u varros, pastaj u ringjall

nga mesi i të vdekurve dhe qëndroi një periudhë të shkurtër në tokë, pastaj u ngrit në qiell.¹

Por ajo që duhet thënë këtu është se në këtë ajet nuk gjendet argument për vdekjen e hazretit Isa, edhe pse disa përfytyruan se fjala *mutefijke* vjen nga fjala *el nefat*, që do të thotë *vdekje*. Sipas këtij përfytyrimi, kjo bie në kundërshtim me mendimin e njohur në mesin e myslimanëve, të cilin e përforcojnë edhe hadithet, që thonë se hazreti Isa nuk ka vdekur dhe ai është i gjallë.

Fjala *el feut* ka kuptimin *e largimit të diçkaje nga njeriu, ku është e vështirë të arribet*. Fjala *el nafij* është *ai që arribet plotësisht*. *Uafaa bi abdh*, do të thotë *e zbatoi premtimin dhe nuk e ka shkelur*.

Fjala *teufaa* përsëritet disa herë në Kur'an, p.sh: **“Ai ju vë në gjumë natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën...”**² në këtë ajet gjumi është përmendur me frazën *jetenafakum*.

Po ky kuptim përmendet edhe në suren “Zumer”, ajeti 42. Po ashtu fjala *tenafaa* përmendet edhe në ajete të tjera të Kur'anit.

Kur All'llahu i thotë hazretit Isait se Unë do të të marr dhe do të të ngre pranë Meje, kjo ka kuptimin se Isai është i gjallë dhe jo i vdekur.

Më pas ajeti shton: **“...dhe do të të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë.”**

Pra, do të të shpëtoj prej atyre jobesimtarëve të këqij e të padrejtë, të largët nga e drejta dhe e vërteta që e refuzonin me akuza të kota. Prej atyre që përpiqen të thurin kurthe dhe të përlyejnë dinjitetin e tij.

¹ Ungjilli i Markusit, kapitulli 15 dhe 16, Ungjilli i Metas, kapitulli 27 dhe 28, Ungjilli i Lukës, kapitulli 24, Ungjilli i Juhanes, kapitulli 31.

² Sure “En'am”, ajeti 60.

Po ashtu ka mundësi që fjala tathijr, ka kuptimin e nxjerrjes së hazretit Isa (*Paqja e All'llabut qoftë mbi të!*) prej mjedisit të përlyer. Kjo i përshtatet ajetit të mëparshëm.

“...si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit.”

Ky është sihariq, me të cilin All’llahu e përgëzon profetin Isa dhe ndjekësit e tij, me qëllim që t’i inkurajojë ata në vazhdimin e rrugës që zgjodhën. Në të vërtetë, kjo është një prej ajeteve të mrekullive dhe prej lajmërimeve të fshehta të Kur’anit, që thotë se ndjekësit e Mesijhut, hazretit Isa, gjithmonë do të jenë sundues të jahudijve që e urrenin atë.

Këtë të vërtetë e shohim me sytë tanë këto ditë. Sionistët jahudij, pa mbështetjen e të krishterëve, nuk janë të aftë të vazhdojnë jetën e tyre shoqërore e politike. Natyrisht që fjala *kafirine* në këtë ajet është për jahudijtët, që nuk i besuan hazretit Mesijh.

Në mbyllje, All’llahu thotë: **“Pastaj, të gjithë do të ktheheni tek Unë dhe do të gjykoj midis jush për çështjet që jeni grindur.”**, që do të thotë se triumfet, përgëzimet kanë lidhje me këtë jetë, ndërsa gjykata e fundit dhe marrja e shpërblimit të plotë do të jetë në Jetën Tjetër.

Hulumtim

A ekzistojnë fetë jahudite dhe të krishtere?

Sipas këtij ajeti duket se feja jahudite dhe e krishterë do të qëndrojnë deri në Ditën e Kiametit. Po ashtu edhe pasuesit e këtyre dy feve. Megjithëse në transmetimet e posaçme rreth ardhjes së imam Mehdiut sqarojnë se ai do t'i bashkojë të gjitha fetë dhe do të udhëheqë të gjithë botën.

Në hadithe ne lexojmë se në kohën e ardhjes së imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) të gjithë njerëzit do të hyjnë në monoteizëm, që do të thotë se Islami do të jetë feja zyrtare e mbarë botës dhe udhëheqja do të jetë islame.

Mirëpo kjo nuk e pengon pakicën jahudite e të krishterë të jetojë nën hijen e udhëheqjes së imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) sipas kushteve të Ehli Dhimeh.

Ne e dimë se shteti i imam Mehdiut nuk i detyron njerëzit në përqaftimin e Islamit. Ndërsa ndërmjetësimi i fuqisë ushtarake është për përhapjen e drejtësisë dhe zhdukjen e udhëheqjeve të padrejta dhe jo për imponimin e njerëzve që të hyjnë nën flamurin e Islamit. Përndryshe nuk do të kishte kuptim liria, dëshira dhe zgjedhja.

Ajetet 56- 58

فَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَأُعَذِّبُهُمْ عَذَابًا شَدِيدًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمَا لَهُمْ
مِّنْ نَّصِيرِينَ ﴿٥٦﴾ وَأَمَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَيُوَفِّيهِمْ
أُجُورَهُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ ﴿٥٧﴾ ذَٰلِكَ نَتْلُوهُ عَلَيْكَ مِنَ الْآيَاتِ
وَالذِّكْرِ الْحَكِيمِ ﴿٥٨﴾

“Sa për ata që nuk besojnë, do t’i dënoj me dënim të ashpër në këtë botë dhe në Tjetrën. Dhe nuk do të kenë askënd që t’u vijë në ndihmë. Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t’u japë shpërblimin e merituar. All’llahu nuk i do të padrejtët. Këto që po t’i tregojmë ty janë vargje dhe këshilla të larta.”

Komentimi

Fundi i përkrahësve dhe i kundërshtarëve të Mesijhut

Ajeti i parë dhe i dytë vazhdojnë t’i flasin hazretit Isa për gjendjen e përkrahësve dhe të kundërshtarëve të tij. Ndërsa ajeti i tretë i flet profetit Muhammed (*Pajja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pasi u përmend në ajetin e mëparshëm kthimi i njerëzve tek All’llahu dhe gjykimi i tyre, ky ajet përmend rezultatin e asaj gjykate. Mohuesit e së vërtetës dhe të drejtësisë në Ahiret do të ndëshkohen me dënim të dhembshëm. Në atë Ditë, ata nuk do të kenë as mbrojtës

e as përkrahës. Ajeti thotë: **“Sa për ata që nuk besojnë, do t’i dënoj me dënim të ashpër në këtë botë dhe në Tjetrën. Dhe nuk do të kenë askënd që t’u vijë në ndihmë.”**

Nga dënimi në këtë jetë, që e tregon ajeti, kuptojmë se mohuesit, të cilët këtu janë jahudijtët, nuk i shpëtojnë dënimit. Këtë e përforcon historia e jahudijve.

Më pas Kur’ani flet për grupin e dytë dhe thotë: **“Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t’u japë shpërblimin e merituar.”** Më pas ajeti dëshmon se: **“All’llahu nuk i do të padrejtët.”**

Përmendja në fillim e fund i jobesimtarëve para besimtarëve është se mohuesit e profecisë së hazretit Isa përbënin shumicën dërrmuese.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajeti i parë përmend vetëm mohimin, kurse ajeti i dytë e shoqëron besimin me punën e mirë. Kjo tregon se vetëm mohimi është shkaktar i dënimit të All’llahut. Po ashtu, vetëm besimi nuk mjafton për të shpëtuar, por ai duhet patjetër të shoqërohet me punë të mira.

Fjalja **“All’llahu nuk i do të padrejtët.”** Ka mundësi që të përfshijë të gjitha llojet e mohimit dhe punët e këqija, me kuptim të gjerë. Është e qartë se All’llahu nuk i do të padrejtët dhe nuk i bën padrejtësi robve të Tij, por gjithkujt i jep atë që meriton.

Pas përmendjes së historisë së Mesijhut dhe çfarë i ndodhi atij, ajeti i tretë i flet profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë se të gjitha këto, që të parathamë ty, janë argumente të vërteta për thirrjen dhe shpalljen tënde. E gjitha kjo ishte përmendje e urtë që erdhi në formën e ajeteve të Kur’anit që t’u shpallën ty. Këto sqarojnë të vërtetën e pastër prej çdo kotësie dhe besëtytnie: **“Këto që po t’i tregojmë ty janë vargje dhe këshilla të larta.”**

Ajetet 59 – 60

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُن فَيَكُونُ ﴿٥٩﴾ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكَ فَلَا تَكُن مِّنَ الْمُمْتَرِينَ ﴿٦٠﴾

“Rasti i Isait për All’llahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë. E vërteta është nga Zoti yt, andaj mos u bëj nga ata që dyshojnë!”

Shkaku i zbritjes

Në fillim të kësaj sureje thamë se shumë prej ajeteve të saj janë përgjigje të dialogëve që zhvilluan të krishterët e Nexhranit, kur një delegacion i përbërë prej gjashtëdhjetë vetave, ndër ta disa të njohur, erdhën për të dialoguar me profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ndër temat e paraqitura në ato tubime ishte edhe çështja e hyjnisë së Mesijhut, që profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kundërshtoi. Ai solli si argumente se Mesijhu lindi dhe jetoi si njerëzit e tjerë dhe nuk mund të jetë Zot. Mirëpo, të krishterët e argumentonin të qenit e Mesijhut Zot me lindjen e tij pa baba. Atëherë zbriti ajeti si përgjigje për ta. Kur e refuzuan këtë, Profeti i thirri në ballafaqim (mubaheleh). Kjo do të përmendet më pas.¹

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë.

Komentimi

Mohimi i të qenit Zot i Mesijhut

Ajeti i parë i ajeteve në fjalë sjell argument të shkurtër dhe të qartë në përgjigje të të krishterëve të Nexhranit për thënien se Mesijhu është Zot. Vërtet, lindja e tij pa baba nuk mund të jetë argument se ai është i biri i Zotit apo vetë Zoti, sepse lindja e Ademit ishte më e habitshme. Ai u lind pa nënë e pa baba. Krijimi i Ademit prej dheut nuk është e habitshme, sepse All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Vepra dhe dëshira e Tij janë në përputhje me njëra-tjetrën. Nëse do diçka, Ai i thotë “Bëhu!” dhe bëhet. Po ashtu edhe lindja e Isait pa baba nuk është e vështirë: **“Rasti i Isait për All'llahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë.”**

Logjikisht, lehtësia dhe vështirësia janë për atë që ka fuqi të kufizuar, kurse fuqia e All'llahut është e pakufizuar. Tek Ai nuk ka kuptim vështirësia dhe lehtësia. Krijimi i një gjetheje është për Atë si krijimi i mijëra kilometrave të pyllit. Krijimi i një grimce është për Atë si krijimi i galaktikës.

“E vërteta është nga Zoti yt.”

Kjo fjali e ajetit dëshmon për temën se ajo që ta shpallëm ty për Mesijhun është e vërtetë, është prej All'llahut dhe nuk ka asnjë dyshim në të, prandaj mos dysho në pranimin e saj.

Për thënien: **“E vërteta është nga Zoti yt.”** Komentuesit kanë dy mendime:

Mendimi i parë: Fjalia (sipas sintaksës së gjuhës arabe) është kryefjalë dhe përcaktor. Për këtë kuptimi i saj është: E drejta gjithmonë është prej Zotit tënd, sepse e drejta është e vërteta. Dhe e vërteta është ekzistenca dhe ekzistenca e gjithçkaje është prej ekzistencës së Tij.

Mendimi i dytë: Fjalë kryen funksionin e përcaktorit të kryefjalës së papërmendur dhe aludimi i tij “ato lajme”, që do të thotë se ato lajme, që t’i shpallëm ty, janë të vërteta nga All’llahu. Këto mendime përshtaten me ajetin.



Ajeti 61

فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا
 وَأَبْنَاءَكُمْ وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنْفُسَنَا وَأَنْفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَل لَعْنَتَ
 اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ ﴿٦١﴾

“A tyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: “Ejani t’i thërrasin bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i All’llahut t’i godasë gënjeshtarët!”

Shkaku i zbritjes

Thuhet se ky ajet ka zbritur për delegacionin e Nexhranit, Akibin dhe Sejjidin dhe të tjerët që ishin me ta. Ata i thanë profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “A ke parë që fëmija të lindë pa baba?” Atëherë zbriti ajeti: **“Rasti i Isait për All’llahun është si rasti i Ademit...”**. Kur Profeti i ftoi për mubahel¹, i thanë që të presë mëngjesin e ditës më pas. Të krishterët u kthyen te grupi i tyre dhe Peshkopi u tha: “Nesër shikojeni

¹ Në origjinal fjala mubahel vjen nga lënda *bebun*, që do të thotë *zëbërthimi i të lidhurit prej diçkaje*. Për kafshën e lirë në sisat e së cilës nuk vendoset qese për të penguar të voglin që të pijë qumësht i thuhet *babele* ose *ibtibal*. Në lutje, kjo fjalë ka kuptimin e përgjërimit dhe të lënies së çështjes në dorën e All’llahut.

Nëse e komentojmë këtë fjalë me kuptimin e shkatërrimit, mallkimit e të largimit nga All’llahu (truga e All’llahut), shkaku është në të lënit e lirë të robit në çdo gjë dhe si pasojë e kësaj atë e kap shkatërrimi dhe mallkimi. Ky është kuptimi gjuhësor i fjalës *mubahel*.

Por ka edhe një kuptim të njohur zbritja e këtij ajeti, që është mallkimi mes dy njerëzve. Për këtë ata bashkohen për të dialoguar rreth një çështjeje fetare, në një vend të përbashkët dhe i luten All’llahut që ta demaskojë gënjeshtarin dhe ta ndëshkojë atë.

Muhammedin. Nëse ka marrë me vete fëmijët e tij dhe familjen e tij, kini kujdes te mubaheleti me të. Nëse vjen me shokët e tij, bëni mubahelet me të

Kur erdhi mëngjesi i ditës së nesërme, Profeti kishte marrë për dore Aliun, të birin e Ebu Talibit dhe në të djathtë e të majtë të Aliut ishin Hasani dhe Hysejni dhe pas tyre ecte Fatimeja. Të krishterët i kryesonin peshkopët e tyre. Kur panë Profetin dhe ata që ishin me të, pyetën se kush janë shoqëruesit e tij. Atyre u thanë: “Ky është djali i xhaxhait të tij dhe bashkëshorti i vajzës së tij. Ai e do shumë atë. Këta të dy janë djemtë e vajzës së tij, Fatimesë. Ajo femra është vajza e tij, më e dashura e tij ndër njerëzit dhe më e afërta në zemrën e tij.”

Profeti u afrua dhe u ul në gjunjë. Peshkopi Ebu Harithëh tha: “Betohem në All’llahun se ai u ul siç ulen profetët për të bërë mubaheleh.” Kur pa këtë, Ebu Harithi i sprapsi dhe nuk bëri mubaheleh. Sejjidi i tha: “O Ebu Harith, afrohu për mubaheleh!”

Ai i tha: “Jo. Unë e shoh këtë burrë guximtar për mubaheleh. Unë kam frikë se është i vërtetë. Nëse është i vërtetë, betohem në All’llah se për ne nuk do të gjendet asnjë i krishterë që të na ushqejë në këtë botë.”

Peshkopi tha: “O babai i Kasemit (profetit Muhammed)! Ne nuk bëjmë mubahele me ty. Por kërkojmë pajtım. Pajtona me atë që e sheh të arsyeshme...”

Transmetohet se Askafi u tha atyre: “Unë po shoh fytyra që, nëse i kërkojnë All’llahut që ta heqë malin nga vendi i tij, Ai e heq. Mos bëni mubahele se do të shkatërroheni dhe asnjë i krishterë nuk do të mbetet në sipërfaqen e tokës deri në Ditën e Kiametit.”¹

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë. Shkaku i zbritjes së këtij ajeti dhe i atyre para tij, është përmendur edhe në komentime të tjera me ndryshim të vogël shprehimor. Ndër to: Tefsijri “Ruhul Xhinan”, tefsdiyrul “Kebijr”, etj. Fahu Raziu ka thënë se këto transmetime janë mutefikun alejhi tek dijetarët e komentimit dhe të hadithit. (Biharul Anuar, vëll. 21, f. 321, 322, 342...)

Komentimi

“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria.”

Pas ajeteve që argumentuan pavlefshmërinë e thënies se hazreti Isai i biri i Merjemes, është Zot, All'llahu e urdhëron të dërguarin e Tij që të bëjë mubahele, nëse i vjen dikush që të debatojë me të, pasi i erdhi dija dhe njohja. Ai e urdhëron Profetin që t'u thotë atyre se unë do të ftoj fëmijët e mi edhe ju ftoni fëmijët tuaj. Unë do të ftoj gratë edhe ju ftoni gratë. Unë do të ftoj veten time edhe ju ftoni veten tuaj. Pastaj t'i lutemi All'llahut që të zbresë mallkimin e Tij mbi gënjeshtarin prej nesh. **“Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: “Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i All'llahut t'i godasë gënjeshtarët!”**

Nuk është nevoja të thuhet se qëllimi te mubaheleti nuk ka qenë prania e një grupi njerëzish për mallkim e pastaj secili të shkonte në rrugën e tij, sepse një veprim i tillë nuk ka asnjë ndikim. Mirëpo, pritej që lutja dhe mallkimi të kishin ndikim prekës e të dukshëm dhe gënjeshtari të ndëshkohej menjëherë.

Me fjalë të tjera: Mubaheleh ka qenë si “shigjeta e fundit”, pasi nuk solli dobi logjika dhe argumentimi. Padyshim se vetëm lutja nuk ka qenë qëllimi i këtij veprimi. Qëllimi ishte “ndikimi i jashtëm e i dukshëm”.

Hulumtime

1- Mubaheleh është argument i vërtetësisë së profecisë së Profetit islam

Kjo mënyrë e mubaheles ndoshta nuk njihet më parë nga arabët. Por ajo ka qenë një prej metodave të vërtetësisë së Profetit dhe i besimit të tij të palëkundur. Përndryshe, si do të ishte e mundur, që një njeri, që nuk besonte plotësisht në lidhjen e tij me All'llahun, të hynte në këtë mejdan? Si do t'i kërkonte kundërshtarëve të tij që të bashkoheshin me të dhe t'i luteshin All'llahut që t'u zbresë mallkimin e Tij mbi gënjeshtarin e më pas të shihnin menjëherë se çfarë do t'i ndodhte gënjeshtarit?

S'ka dyshim se hyrja në këtë mejdan është shumë e rrezikshme, sepse, nëse kërkuesi i mubaheles nuk sheh përgjigje të lutjes dhe as ndikimin e ndëshkimit të All'llahut ndaj kundërshtarëve, atëherë përfundimi i saj do të ishte skandal për kërkuesin. Vallë a mundet që një njeri logjik dhe arsyetues të merrte këtë nismë pa qenë i bindur se rezultati do të ishte në anë të tij? Për këtë thuhet se ftesa e profetit Muhammed për të bërë mubaheleh konsiderohet një prej argumenteve të vërtetësisë së profecisë dhe besimit të prerë të tij, pa llogaritur rezultatet që do të sillte mubaheleja.

Transmetimet islame thonë: Kur u propozua bërja e mubaheles, përfaqësuesit e të krishterëve të Nexhranit i kërkuan profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) afat kohor, që të konsultoheshin me të mëdhenjtë e tyre. Kërkesa e tyre u pranua. Rezultati i konsultimit të tyre, bazuar në anën psikike, ishte se ata i urdhëruan njerëzit e tyre që të bëjnë mubahele pa u frikësuar, nëse shohin se profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka sjellë shumë njerëz, sepse ky veprim ka

si qëllim futjen e frikës e të tmerrit në zemrat e njerëzve dhe do të çojë në çoroditje e zhurmë.

Kjo mënyrë nuk do të jetë e vërtetë. Ndërsa, po të shohin se Muhammedi ka sjellë disa persona nga familja e tij dhe të vegjël prej familjes së vet për të bërë mubahele, atëherë ta dinë se ai është me të vërtetë profet i All'llahut dhe të mos bëjnë mubahele.

Të krishterët erdhën në vendin e caktuar. Pastaj panë se Profeti po vinte. Në krah kishte Hysejnin dhe në dorën e djathtë mbante Hasanin. Pas tij ishin Aliu dhe Fatimeja. Kur të krishterët panë këtë skenë, i mbuloi frika dhe refuzuan që të bëjnë mubahele. Ata pranuan që të bashkëpunonin me Profetin, me kushtet e Ehlu Dhimehit¹.

2- Mubahele është një prej treguesve të madhështisë së Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!)

Komentuesit e Ehli Sunetit dhe ata të shiave thonë se ajeti i mubaheles ka zbritur për Ehli Bejtin e Profetit (Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!). Ata që mori Profeti për të bërë mubahele ishin: Hasani, Hysejni, Aliu dhe Fatimeja.

Kuptimi i frazës *ebnaena-fëmijët tanë*, e përmendur në ajet është i kufizuar me Hasanin dhe Hysejnin (Paqja qoftë mbi ata të dy!). Kuptimi i frazës *nisauna-gratë tona* është i kufizuar për Fatimenë dhe kuptimi i frazës *enfusena* është i kufizuar me Aliun. Ka shumë hadithe që flasin për këtë përkatësi.²

Disa dijetarë të Ehli Sunetit janë përpjekur të mohojnë praninë e haditheve për këtë çështje. Autori i komentimit “El Manar” rreth komentimit të këtij ajeti thotë: “Transmetimet e përbashkëta thonë se

¹ Pakica jomysliman që jeton në mesin e myslimanëve sipas kritereve dhe kushteve të caktuara

² “Biharul Anuar”, vëll. 10, f. 141 dhe 350.

Profeti zgjodhi për mubahele Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysejnin, duke i dhënë kuptimin fjalës *nisaena-për Fatimenë* dhe *enfusena-për Aliun*, janë burime të shiave dhe qëllimi i tyre është i qartë në këtë çështje. Ata u përpoqën që ta përhapin këtë derisa përfshiu shumë prej Ehli Sunetit.”

Që të sqarohet më shumë kjo e vërtetë, po përmendim disa hadithe nga burimet e Ehli Sunetit:

Kadiu Nurullah Esh Shushteri, në librin e tij me vlerë të madhe “Thkakul Hak”, vëllimi 3, faqe 46, botim i ri, flet për konsensusin e komentuesve se thënia *ebnaena* tregon për Hasanin dhe Hysejnin; thënia *nisaena* tregon për Fatimenë dhe thënia *enfusena* tregon për Aliun.

Në shënimet në fund të faqes përmend për gjashtëdhjetë dijetarë të mëdhenj të Ehli Sunetit, të cilët thonë se ajeti i mubaheles ka zbritur për Ehli Bejtin. Emrat e këtyre dijetarëve i përmend në faqet 46 – 76 të po këtij libri.

Prej dijetarëve të njohur, prej të cilëve është përcjellë kjo thënie e qartë, janë:

- 1- Ahmed ibn Hahbel në librin e tij “El Musned”: vëll. 1, f. 185, botim i Egjiptit.
- 2- Muslim ibn el Haxhxhaxh el Nijshaburij, autori i një prej gjashtë sahihave të njohura të Ehli Sunetit: vëll. 7, f. 120, botim i Muhamed Ali Sabijh- Egjipt.
- 3- Et Tabarij, në komentimin e tij të njohur “Xhamiul Bejan”; vëll. 3, f. 192, botim i shtypshkronjës “El Jemnijeh” - Egjipt.
- 4- El Hakim në librin e tij “El Mustedrek”, vëll. 3, f. 150, botimi i Hajdar Abad- ed Dekn.
- 5- El Hafidh ebu Naim el Asfahanij në librin e tij “Delailu Nubuveh”, f. 297, botimi i Hajdar Abad- ed Dekn.
- 6- El Uahidij en Nishaburij në librin e tij “Esbabu Nuzul”, f. 74, botim i shtypshkronjës “El Hindejeh” - Egjipt.

- 7- Fahu Raziu në komentimin e tij të njohur “Tefsirul Kebijr”, vëll. 8, f. 85, botim i shtypshkronjës “El Behijeh” - Egjipt.
- 8- Ibn el Ethijr në librin e tij “Xhamiul Usul”, vëll. 9, f. 470, botim i shtypshkronjës “Es Sunetul Muhamedijeh” – Egjipt.
- 9- Ibn el Xhevzi në librin e tij “Tedhkiretul Khavas”, f. 17, botim i Nexhefit.
- 10- El Kadij el Bejdauj në komentimin e tij, vëll. 2, f. 167, shtypshkronja “El Munijreh” - Egjipt.
- 11- El Alusij në komentimin e tij “Ruhul Meanij”, vëll. 3, f. 193, shtypshkronja “El munirijeh” - Egjipt.
- 12- Et Tantauj në komentimin e njohur “El Xheuhir”, vëll. 2, f. 120, shtypshkronja “Mustafa el Babij el halebij”- Egjipt.
- 13- Zamahsharij në tefsirin e tij “El Keshaf”, vëll. 1, f. 193, shtypshkronja “Mustafa Muhamed”.
- 14- El Hafidh Ahmed ibn Haxher el Askalanij në librin e tij “El isabetu”, vëll. 2, f. 503, shtypshkronja “Mustafa Muhamed”.
- 15- Ibn Sabag në librin e tij “El Fusulul Muhimeh” f. 108, shtypshkronja “Nexhef”.
- 16- Eruditi Kurtubij në librin e tij “El Xhamiul Ahkamul Kur’an”, vëll. 3, f. 104, shtypshkronja e Egjiptit, viti 1936.

Në librin “Gajetul Muram” është përcjellë nga Sahihu i Myslimit, në kreun “Virtytet e Ali ibn Ebu Talibit” se një ditë Muaviju i tha Sa’d ibn ebi Uekkasit: “Përse nuk e shan Ebu Turabin (imam Aliun)?!”

Sa’di iu përgjigj: “Unë e kam lënë sharjen e tij që në kohën kur kujtova tri gjëra, që Profeti i ka thënë për Aliun. Njëra prej tyre është kur ka zbritur ajeti i mubaheles. Profeti nuk mori tjetër në këtë ndodhi,

vetëm Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysejnin dhe tha: “O Zot, këta janë Familja ime!”¹

Autori i komentimit “El Keshaf”, i cili është prej dijetarëve të njohur të Ehli Sunetit ka mendimin se ky ajet është argumenti më i fortë për përparësinë e Ehli të Kisaut (mantelit).

Komentuesit, transmetuesit dhe historianët shi’it, gjithashtu, janë të një mendimi se ajeti i mubaheles ka zbritur për Ehli Bejtin. Autori i komentimit “Nuru Thakalejn” ka përmendur shumë hadithe për këtë çështje.²

Po ashtu edhe në librin “A’jun Akhbaru Rida” përmendet tubimi shkencor që organizoi Me’muni në pallatin e tij. Në atë tubim imam Rizai ka thënë: “All’llahu i ka dalluar të pastrit nga krijesat e Tij. Në ajetin e ballafaqimit e urdhëroi të Dërguarin e Tij që të bëjë mubahele me ta. All’llahu i Madhëruar thotë: “O Muhammed (“**Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait...**”). Atëherë Profeti doli me Aliun, Hasanin, Hysejnin dhe Fatimenë, (*Paqja e All’llabut qoftë mbi ta!*).

Pastaj imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Askush nuk e ka pasur këtë veçori para tyre. Ata janë më të përkryerit e njerëzve dhe më të ndershmit e tyre.”³

3- Kundërshtim dhe sqarim

Pyetje:

Këtu gjendet një kundërshtim që e ka përmendur Fahu Raziu dhe të tjerë për zbritjen e këtij ajeti rreth Ehli Bejtit. Aty thuhet: “Si mund ta konsiderojmë kuptimin e thënies *ebnaena* se është për Hasanin dhe Hysejnin (*Paqja qoftë mbi të dy!*), ku fjala *ebnaun* është në

¹ Sahihu i Muslimit, vëll. 7, f. 120. El Gadijr, vëll. 3, f. 200.

² Tefsijri “Nuru Thakalejn”, vëll. 1, f. 348, 349 dhe 350.

³ Tefsijri “Nuru thakalejn”, vëll. 1, f. 349. Tefsijri “El Burhan”, vëll. 1, f. 289. Tefsijru “Ajjashij”, vëll. 1, f. 177. “Biharul Anuar”, vëll. 25, f. 223. “Ujun Akhbar Rida”, vëll. 1, f. 229- 231.

shumës dhe nuk përdoret për dy njerëz? Po ashtu, edhe fjala *nisaena* është shumës dhe si mund të thuhet që është për zonjën e Islamit, Fatimenë? Nëse kuptimi i thënies *enfusena* është vetëm për Aliun, përse gjendet në shumës?”

Përgjigje:

Së pari: Më parë thamë që ka hadithe të shumta në literaturat islame që dëshmojnë se ky ajet ka zbritur për Ehli Bejtin. Të gjitha ato transmetime thonë se Profeti nuk ka marrë asnjë tjetër për mubahele veçse Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysejnin (*Paqja e All'llabut qoftë mbital*). Këto transmetime, në vetvete, janë argument i qartë i komentimit të ajetit, sepse prej argumenteve, që ndihmojnë në komentimin e ajeteve të Kur'anit, janë edhe Suneti i Profetit dhe ajo që konstatohet prej shkaqeve të zbritjes.

Për këtë, ky kundërshtim nuk i është drejtuar vetëm shiitëve. Duhet që të gjithë dijetarët e Islamit t'i përgjigjen këtij kundërshtimi, bazuar në ato që thamë më parë.

Së dyti: Përdorimi i shumësit me qëllim njëjës dhe dytësorin nuk është diçka e re, sepse ai përmendet shumë në Kur'anin Fisnik, si dhe në letërsinë arabe dhe joarabe.

Për shembull, kur vendoset një ligj apo nënshkruhet një marrëveshje, përdoret shumësi në përpilim. Në aktmarrëveshje mund të thuhet: Përgjegjësit e zbatimit të kësaj aktmarrëveshjeje janë ata që firmosin dhe fëmijët e tyre. Në të njëjtën kohë, një palë mund të jetë një person apo dy. Në këtë nuk ka asnjë kundërshtim me përpilimin e aktmarrëveshjes në shumës. Kjo, sepse gjenden dy faza: faza e marrëveshjes dhe ajo e zbatimit. Në fazën e parë mund të përdoren fjalët në numrin shumës, me qëllim që të jetë në përputhje me të gjitha situatat. Mirëpo në fazën e zbatimit, situata mund të kufizohet vetëm me një person. Kjo nuk bie ndesh me përgjithësinë e çështjes.

Në Kur'anin Fisnik ka vende të shumta, në të cilët është përdorur shumësi dhe qëllimi i vërtetë është për një person, p.sh: në ajetin 173 të sures “Al Imran” thuhet: **“...të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: “Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!”**. Qëllimi i fjalës *nas*, sipas një grupi komentuesish, është për Naim ibn Mes’ud, sepse ky kishte marrë para nga Ebu Sufjani, për t’i frikësuar myslimanët prej forcës së politeistëve.¹

Po në suren “Al Imran”, ajeti 181 lexojmë: **“Sigurisht që All’llahu i ka dëgjuar fjalët e atyre (çifutëve) që thanë: “All’llahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur”**. Qëllimi i fjalës *el ledbijne-atyre*, në këtë ajet është për Haj ibn Akhtab ose për Fanhas.²

Ka raste që shumësi përdoret për njëjësin, për nderim siç thuhet për hazretin Ibrahim (*Paqja e All’llabut goftë mbi të!*): **“Me të vërtetë, Ibrahim ka qenë bashkësi, i përlurur para All’llahut...”**³ Fjala *ummet-bashkësi*, është përdorur për njëjësin.

4- A janë fëmijët e vajzës fëmijët e babait?

Nga ky ajet përfitohet që fëmijët e vajzës konsiderohen fëmijë të babait të saj. Ndryshe ishte në kohën para Islamit, në të cilën vetëm fëmijët e djalit ishin fëmijë të gjyshit. Ata thoshin: “Fëmijët tanë, fëmijët e djemve dhe vajzat tona. Fëmijët e tyre (vajzave) janë të burrave të largët.”⁴

Kjo mënyrë e gabuar e të menduarit në atë kohë nuk e konsideronte gruan pjesë të shoqërisë, por “enë” për lindjen e

¹ Tefsijri “El Kebir”, tefsijri “Ruhul Meanij” dhe tefsijri i Kurtubiut, fundi i ajetit në fjalë.

² Tefsijri “Xhamiul Bejan”, tefsijri i Kurtubiut, fundi i ajetit në fjalë.

³ Sure “Nahl”, ajeti 120.

⁴ Tefsijrul “Mijzan”, vëll. 4, f. 312. “Sherhu Nehxhul belaga”, i Ibn ebil Hadijdit, vëll 11, f. 28.

fëmijëve. Sipas këtij mendimi të gabuar, fëmijët i takonin vetëm babait.

Një poet ka thënë: “Sigurisht, nënat e njerëzve janë enë të vendosura dhe gjeneza është për baballarët.”¹

Mirëpo Islami e zhduku këtë mënyrë mendimi dhe vuri shenjën e barazimit mes fëmijëve të djalit dhe të vajzës. Në suren “En’am”, ajetet 84 dhe 85 lexojmë: **“Ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët. Ne udhëzuam edhe Zekerijan, Jahjain, Isain, Iljazin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë.”**

Hazreti Isa, i biri i Merjemes, këtu është numëruar prej fëmijëve të Ibrahimit, edhe pse ishte nga ana e vajzës.

Transmetimet e shumta në literaturat e myslimanëve, në përgjithësi, që flasin për Hasanin dhe Hysejnin, i përmendin me Ibn Resulilah.

Në ajetin që ndalon martesën me disa gra lexojmë: **“Ju ndalohet martesa me gratë e bijve tuaj...”**² Të gjithë dijetarët islamë janë të një mendimi se është e ndaluar martesa me gruan e djalit dhe të nipit, qoftë nga ana e babait apo e nënës, bazuar në përgjithësinë e këtij ajeti.

5- A është mubaheleja rregull i përgjithshëm?

S’ka dyshim se ky ajet nuk është ftesë e përgjithshme për myslimanët, që të bëjnë mubahele, sepse ai i drejtohet vetëm të dërguarit të All’llahut, profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut*

¹ Tefsijrul “Mijzan”, vëll. 18, f. 44.

² Sure “En-Nisa”, ajeti 23.

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Mirëpo nuk gjendet pengesë që mubaheleti me kundërshtarët të jetë rregull i përgjithshëm, ku besimtarët e devotshëm, që i frikësohen All'llahut, t'i kërkojnë atyre që nuk u bëri dobi arsyetimi dhe argumentimi që të bëjnë mubahele.

Përgjithësimi i këtij rregulli duket edhe në disa transmetime islame. Në tefsirin “Nuru Thakalejn”, vëllimi 1, faqe 351 përmendet një thënie e përcjellë nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse është kështu (pra, kur kokëforti nuk e pranon të vërtetën), thirri për mubahele. Dil ti dhe ai në shkretëtirë. Lidhi gishtat e dorës së djathtë me gishtat e tij. Më pas thuaj: “O Zot, Sunduesi i shtatë qiejve dhe i shtatë tokave, i Gjithëdituri për të fshehtën dhe të dukshmen, i Gjithmëshirshmi, Mëshirëploti! Nëse (filani) e mohon të vërtetën dhe ideja pranon të pavërtetën, atëherë zbriti atij fatkeqësi dhe ndëshkim të rëndë prej qielli!” Përsërite këtë lutje ndaj tij, e ti do ta shohësh menjëherë se çfarë do t'i ndodhë atij.”¹

Nga ky ajet, gjithashtu, sqarohet se femra myslimane e ka ndihmuar mashkullin në situata të vështira e delikate për realizimin e qëllimeve të larta të Islamit. Ai u përgjigjet akuzave të disave që thonë se Islami është fe vetëm për meshkuj dhe femra nuk llogaritet në të. Vërtet, faqet e ndritura të jetëshkrimit të zonjës së Islamit, Fatime Zahrasë, vajzës së saj, Zejbul Kubra dhe e grave të tjera myslimane janë argument i qartë për këtë çështje.

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 513 dhe 514.

Ajetet 62 - 63

إِنَّ هَذَا لَهُوَ الْقَصَصُ الْحَقُّ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا اللَّهُ وَإِنَّ اللَّهَ لَهُوَ الْعَزِيزُ
الْحَكِيمُ ﴿٦٢﴾ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِالْمُفْسِدِينَ ﴿٦٣﴾

“Pa dyshim, të gjitha këto janë rrëfime të vërteta. S’ka zot tjetër përveç All’llahut. Vërtet, All’llahu është i Plotfuqishmi, i Urti. Në qoftë se ata ia kthejnë shpinën të drejtës, All’llahu i njeh mirë ngatërrestarët.”

Komentimi

Pas sqarimit të jetës së Mesijhut, ky ajet thotë se ajo që të treguam ty për historinë e Isait është e vërtetë dhe e zbritur nga All’llahu i Madhëruar.

Të gjitha pretendimet se hazreti Isa është zot apo të konsideruarit e tij bir i All’llahut apo është kopil, janë besëtytni të kota. **“Pa dyshim, të gjitha këto janë histori të vërteta.”**

Më pas, për përforsim, ajeti thotë se Ai, që e meriton adhurimin, është vetëm All’llahu: **“S’ka Zot tjetër përveç All’llahut.”**, i Vetëm i Pashoq. Adhurimi i diçkaje tjetër përveç Tij është punë larg së vërtetës dhe drejtësisë. **“Vërtet, All’llahu është i Plotfuqishmi, i Urti.”** Ai është i Plotfuqishëm që ta lindi fëmijën pa baba. Kjo është e lehtë për Atë.

Njëjesi i fjalës *el kasas* është *el kisatu*, që vjen nga fjala *elkas* dhe ka kuptimin *e ndjekjes së gjurmëve*. Në suren “Kasas”, ajeti 11, nëna e

Musait i thotë vajzës së saj *kasiibi-ndiqe dhe kërkoje*: **“Ajo i tha motrës së Musait: “Shko pas tij!”**

Thënia për gjakmarrjen është *el kisas*, sepse ai pason të drejtat e të afërmve të të vrarit.

Fjala *el kisasatu* do të thotë *historia e të shkuarve dhe bulumtim në jetëshkrimin e tyre*. Nga këtu kuptohet se ajeti tregon për historinë e hazretit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe jo për Kur'anin dhe as për historitë e të dërguarve.

Ajeti i dytë kërcënon atë që nuk i bindet së vërtetës, pas argumenteve logjike që ndodhen në Kur'an rreth çështjes së hazretit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Kërcënon nëse nuk i nënshtrohen mubahes dhe vazhdojnë në kokëfortësinë dhe fanatizmin e tyre, sepse ajo është argument se ata nuk janë kërkues të së vërtetës, por janë të prangosur me prangat e fanatizmit, të egos dhe të zakoneve të tyre të ngurta. Për këtë ata janë prej ngatërrestarëve në shoqëri. **“Në qoftë se ata ia kthejnë shpinën të drejtës, All'llahu i njeh mirë ngatërrestarët.”**

Qëllimi i tyre është mpiksja e njerëzve dhe prishja e besimit të shëndoshë te individët e shoqërisë. Dihet se All'llahu i Madhëruar është i njohur për ata dhe i di qëllimet e tyre dhe do t'i ndëshkojë në kohën e duhur.

Ajeti 64

قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا ٱللَّهَ
 وَلَا نُشْرِكَ بِهِۦ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ ٱللَّهِ ۚ فَاِن
 تَوَلَّوْا۟ فَقُولُوْا۟ اَشْهَدُوْا۟ بِأَنَّا مُسْلِمُوْنَ ﴿٦٤﴾

“Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm All’llahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të All’llahut! Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar All’llahut!”

Komentimi

Thirrja për bashkim

Në ajetet e mëparshme Kur’ani fillon me thirrjen e të krishterëve në argumentet logjike dhe i ftoi për mubahele. Kjo ndikoi në shpirtërat e tyre dhe e refuzuan, duke iu nënshtruar kushteve që konsideronin “ehli dhimeh”. Duke parë përgatitjen e tyre shpirtërore, Kur’ani iu kthye përsëri metodës së argumentimit.

Mirëpo, argumentimi këtë herë ndryshon shumë nga ai i pari. Në ajetet e mëparshme ishte thirrja për në Islam (me të gjitha detajet), kurse këtë herë ftesa iu drejtua për pikat e përbashkëta mes Islamit dhe ithtarëve të Librit.

Me këtë, Kur'ani na mëson: Nëse nuk jeni dakord që të bashkëpunoni me të tjerët në të gjitha synimet tuaja, nuk duhet t'ju gjunjëzojë plogështia në vepra, por përpiquuni që t'i bindni ata që të bashkëpunojnë me ju në realizimin e qëllimeve të përbashkëta mes jush. E kjo të jetë si pikënisje e realizimit të qëllimeve tuaja të tjera të shenjta. “Thuaj: **“O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm All'llahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të All'llahut!”**”

Ky ajet konsiderohet thirrje për unitet dhe bashkim për ithtarët e Librit. Ajeti u thotë atyre: Ju thoni, por besoni, se trinitetit nuk e mohon Teuhidin, kështu që ju thoni për unitet në trini. Po kështu edhe jahudijtët. Ata ftojnë në Teuhid dhe flasin me thënie që përmbajnë politeizëm dhe e konsiderojnë Yzejrin bir të All'llahut.

Kur'ani u thotë atyre se të gjithë ju mendoni se Teuhidi është i përbashkët, atëherë ejani të vendosim dorën mbi dorë dhe ta pranojmë këtë parim, pa i ardhur rreth e rrotull. T'i largohemi çdo komenti që çon në politeizëm dhe të largon nga monoteizmi.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajeti i bekuar e dëshmon monoteizmin me tri thënie të ndryshme. **Së pari**, përmend: “...se do të adhurojmë vetëm All'llahun.” **Së dyti**: “...se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë...” dhe **së treti**: “...dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të All'llahut!”

Ka mundësi që fjalë e fundit të tregojë për dy çështje:

E para: Nuk lejohet hyjnia e Mesijhut, sepse ai është njeri si ne dhe prej nesh.

E dyta: Nuk lejohet pohimi dhe pasimi i dijetarëve të devijuar, të cilët e shfrytëzojnë pozitën e tyre duke ndryshuar të lejuarën dhe të ndaluarën e All'llahut si t'i dojë qejfi atyre.

Nga ajetet e mëparshme të Kur'anit duket qartë se në mesin e dijetarëve të Ehli Kitabit (jahuditë dhe të krishterët) ka pasur prej tyre që i ndryshonin rregullat e All'llahut sipas "interesit" apo "fanatizmit" të tyre. Mendimi i Islamit është se kush i pason këta dijetarë dhe është i ditur për ta, kjo do të thotë se i adhuron ata me kuptimin e gjerë të fjalës adhurim.

Shkaku i këtij rregulli është i qartë, sepse vendosja e ligjeve dhe e rregullave i takon All'llahut. Ai, që thotë se unë e bëj këtë e jo All'llahu, ka rënë në politeizëm.

Në fund të komentimit të këtij ajeti komentuesit thonë se Udej ibn Hatim, i cili ka qenë i krishterë, pastaj përqafoi Islamin, kur dëgjoi këtë ajet, e kuptoi se me fjalën *erbab* Kur'ani u thotë Ehli Kitabit se ata adhurojnë disa dijetarë të tyre. Ai i tha profetit Muhammed (*Pajja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "O i Dërguari i All'llahut. Ne nuk i adhuronim ata."

Profeti i tha: "A nuk ishin ata që lejonin dhe ndalonin dhe ju zbatonit thëniet e tyre?"

Ai iu përgjigj: "Po."

Profeti i tha: "Ai është adhurimi."¹

Islami e konsideron robërimin dhe kolonizimin mendor si lloj adhurimi dhe jo adhurim të All'llahut. Ashtu siç e lufton politeizmin dhe adhurimin e idhujve, po ashtu e lufton kolonizimin mendor, i cili është i ngjashëm me adhurimin e idhujve.

Duhet përmendur se fjala *erbab* është në numrin shumës, prandaj nuk mund të themi se qëllimi është vetëm adhurimi i Isait, por ndalimi përfshin Isain dhe dijetarët e devijuar.

"Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar All'llahut!"

¹ Tefsijri "Mexhmaul Bejan", fundi i komentimit të ajetit në fjalë. Tefsijri "Nuru Thakalejn", vëll. 1, f. 352.

Nëse ata, pas thirrjes logjike në pikën e përbashkët në monoteizëm, këmbëngulin në kundërshtim, patjetër u duhet thënë: “Dëshmoni që ne i jemi dorëzuar të vërtetës dhe ju jo.”

Me fjalë të tjera: “Kuptojeni kush kërkon të vërtetën dhe kush është fanatik dhe kokëfortë.” Pastaj thoni: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar All’llahut! Kokëfortësia dhe kundërshtimi juaj nuk ndikon në shpirtërat tanë, sepse ne vazhdojmë të jemi në rrugën tonë, në rrugën e Islamit. Nuk adhurojmë tjetër përveç All’llahut, zbatojmë vetëm sheriatin islam dhe nuk adhurojmë njerëz.”



Hulumtim

Letrat e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) **drejtuar udhëheqësve të botës**

Historia thotë se kur Islami u përqendrua në Hixhaz, profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u dërgoi disa letra udhëheqësve të botës së asaj kohe. Në disa letra u mbështet te ajeti i thirrjes në monoteizëm, që është parimi i përbashkët mes feve qiellore. Duke qenë se tema është e rëndësishme, do të përmendim disa nga ato letra:

1- Letra drejtuar Mukaukas¹

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirmit, Mëshirëplotit!

Nga Muhammedi, i biri i Abdullahut, drejtuar Mukaukasit të madh të Kabtit.

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Sa më poshtë: Unë të ftoj në Islam. Pranoje që të jesh i sigurt. All'llahu do të të japë dy shpërblime. Nëse kundërshton, do të kesh gjynahun e "El Kabit".²

O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush, se do të adhurojmë vetëm All'llahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të All'llahut! Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaj: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar All'llahut."³

Letrën e profetit për tek Mukaukasi i Egjiptit e dërgoi Hatib ibn Ebi Belte'ah. Kur mbërriti në pallatin e tij, Mukaukasi kishte udhëtuar në Aleksandri. Shkoi tek ai dhe ia dorëzoi letrën. Pastaj i tha

¹ Mukaukas, udhëheqës i Egjiptit, i vendosur nga mbreti i romës Herkul dhe ka qenë i krishterë.

² El Ekabat është populli që banonte në Egjipt.

³ Letrat e të Dërguarit të All'llahut, vëll. 1, f. 97. "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 383.

Hatibit: “Çfarë e pengon atë nëse është i dërguar që të ftojë kundërshtarët e tij e pastaj t’i nxjerrë nga vendi i tyre ose të bëhet sundues i tyre?”

Hatibi i tha: “A nuk dëshmon se Isai, i biri i Merjemes, është i Dërguari i All’llahut? Çfarë bëri ai kur populli i vet donte ta vriste? A nuk iu lut All’llahut që t’i shkatërrojë ata derisa e ngriti All’llahu tek Ai?”

Ai tha: “Bukur fole. Ti je i urtë, i ardhur nga një i urtë.”

Pastaj Hatibi i tha atij: “Para teje ka pasur të tjerë që pretendonin se janë zot, siç ishte Faraoni. All’llahu e shkatërroi në këtë jetë duke e ndëshkuar rëndë. Merr mësim nga të tjerët dhe jo të tjerët të bëjnë si ti. Ky Profet i ftoi njerëzit dhe kundërshtarët më të ashpër, kurejshët dhe armiqtë më të rreptë, jahudijtët dhe më të afërtit e tij, të krishterët. Pasha jetën timel! Sihariqi i Musait për Isain është njësoj si sihariqi i Isait për Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*). Ftesa jonë për ty, që të ndjekësh Kur’anin, është njësoj si ftesa që ti i bën ithtarëve të Teuratit për të ndjekur Ungjillin...”

Hatibi qëndroi disa ditë në pritje të përgjigjes së Mukaukasit për letrën e Profetit. Më vonë Mukaukasi e ftoi në pallatin e tij për t’u njohur më shumë me Islamin. Ai i tha Hatibit: “Për çfarë fton Muhammedi?”

Hatibi iu përgjigj: “Që të adhurojmë vetëm All’llahun. Na urdhëron të falim namazin pesë herë në ditë e natë. Na urdhëron të agjërojmë Ramazanin, të bëjmë Haxhin te Shtëpia e All’llahut, të zbatojmë premtimet. Na ndalon nga ngrënia e ngordhësirës, e gjakut.... Pastaj i sqaroi atij disa anë të jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*).”

Mukaukasi tha: “Këto janë cilësitë e tij. Unë e dija që është edhe një i dërguar për të ardhur. Unë mendoja se do të vijë nga Shami (Damasku i sotëm), sepse nga atje erdhën profetët para tij. Tani po dëgjoj se ka ardhur nga toka e Arabisë.”

Pastaj ftoi shkruetin e tij që të shkruante në gjuhën arabe dhe i shkroi Profetit:

“Me emrin e All'lahut, të Gjithëmëshirmit, Mëshirëplotit!

Për Muhammedin, i biri i Allahut, nga Mukaukasi i madh i Egjiptit.

Paqja qoftë mbi ty!

Unë e lexova letrën tënde dhe e kuptova atë që kishe shkruar dhe atë në të cilën ti fton. Unë e dija se do të vijë një i dërguar dhe mendoja se do të vinte nga Shami. Unë e kam nderuar dërguesin tënd...”

Pastaj i numëroi dhuratat që i dërgoi dhe e mbylli letrën me thënie:

“Es selamu aleje.”¹

Librat e historisë thonë se Mukaukasi i dërgoi Profetit njëmbëdhjetë lloje dhuratash, ndër to edhe një doktor që të shëronte të sëmurët myslimanë. Profeti i pranoi dhuratat dhe e ktheu doktorin duke thënë: “Ne jemi popull që hamë derisa të na marrë uria dhe kur hamë, nuk ngopemi.” Duke treguar se ky rregull në ngrënie mjafton për të mbrojtur shëndetin e myslimanëve.²

Pa dyshim se nderimi i Mukaukasit, që i bëri dërguesit të Profetit, dhurata që i dërgoi atij dhe përmendja e emrit të Profetit para emrit të tij, tregojnë se ai e pranoi ftesën e Profetit në brendi të vetes së tij, ose më e pakta, anoi kah Islami. Mirëpo, që të mos lëkundej pushteti i tij, nuk e shfaqti atë.

¹ Letrat e Profetit, vëll. 1, f. 100. “Meusuatu Tarihul islam”, vëll. 2, f. 663.

² Letrat e Profetit, vëll. 1, f. 100. “Meusuatu Tarihul islam”, vëll. 2, f. 663.

2- Letra drejtuar Kajsarit të Romës

Me emrin e All'llabut, të Gjithëmëshirmit, Mëshirëplotit!

Nga Muhammedi, i biri i Abdullabut, drejtuar Herkulit të madh të Romës.

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Sa më poshtë: “Unë të ftoj në Islam. Pranoje që të jesh i sigurt. All'llahu do të të japë dy shpërblime. Nëse kundërshton, do të kesh gynabun e El Erisijinnëve.¹ O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush, se do të adhurojmë vetëm All'llabun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të All'llabut! Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thujju: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar All'llabut.”²

Mbartësi i letrës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për Kajsarin ka qenë Duhejeh el Kelbij. Dërguesi u përgatit dhe u nis për në tokën e Romës. Para se të mbërrinte në Kostandinije, kryeqytet e Kajsarit, dëgjoji se Kajsari kishte shkuar të vizitonte Bejtul Makdesin. Ai shkoi te mëkëmbësi i Bisras, Harith ibn ebi Shimr dhe i tregoi misionin e tij.

Pasi Mëkëmbësi u informua për çështjen, ftoi Udejj ibn Hatim dhe e ngarkoi që të udhëtonte me Duhejeh për në Bejtul Makdes, për t'ia dhënë letrën Kajsarit. Dërguesi e takoi Kajsarin në Hummus. Shoqëruesit e Kajsarit i thanë se duhet të bëjë sexhde para Kajsarit dhe të mos e ngrinte kokën derisa ta lejonte Kajsari. Duhejeh u tha: “Këtë nuk e bëj kurrë. Unë i bëj sexhde vetëm All'llahut.”

Ata u habitën prej logjikës së fortë të tij. Njëri prej burrave të pallatit mbretëror i tha: “Atëherë, vendose letrën në anë të minberit të Kajsarit dhe largohu, sepse askush tjetër përveç Kajsarit nuk e prek letrën.”

Duhejeh e falënderoi për mendimin dhe e la letrën aty dhe u largua.

¹ El Erisijin kanë qenë elementë romak dhe punonjës.

² “Musnedi i Ahmedit”, vëll. 1, f. 263. “Biharul Anuar”, vëll. 20, f. 386.

Kajsari e hapi letrën. Atij i bëri përshtypje fillimi i letrës: “Bismilahi Rrahmani Rrahim.” Ai tha: “Unë nuk kam parë si kjo letër, me përjashtim atë të Sulejmanit.” Pastaj i kërkoi përkthyesit të tij, që t’ia përkthente dhe t’ia lexonte. Kajsari kujtoi që shkruesi i letrës është Profeti i premtuar në Teurat dhe në Ungjill. Për këtë ai vendosi të njihej më shumë me jetën e këtij Profeti. Ai urdhëroi që të kërkohet në Sham se mos gjejnë dikë që e njeh Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Qëlloi që Ebu Sufjani dhe një grup burrash prej kurejshëve kishin shkuar në Sham, i cili ka qenë krahu lindor i Romës, për tregti. Njerëzit e Kajsarit u takuan me ta dhe i dërguan te Bejtul Makdesi. Kajsari i pyeti: “Kush prej jush është më i afërm nga gjeneza me këtë burrë, që thotë se është profet?” Ebu Sufjani u përgjigj: “Unë!”

Pastaj, përmes përkthyesit të tij, Kajsari u tha kurejshëve: “Unë do të pyes Ebu Sufjanin për këtë burrë, që thotë se është profet. Nëse më gënjen, gënjejeni atë.”

Ebu Sufjani tha: “Ueejjumulla. Sikur të mos ishte frika e ndikimit të gënjeshtres mbi mua, do të gënjeja.”

Kajsari i tha përkthyesit të tij: “Pyete atë (Ebu Sufjanin) çfarë prejardhje ka ai tek ju?”

Ebu Sufjani tha: “Në mesin tonë është prej gjenezës së mirë.”

Kajsari e pyeti: “A ka qenë dikush prej familjes së tij mbret?”

Ebu Sufjani u përgjigj: “Jo.”

Kajsari tha: “A e akuzonit me gënjeshtër para se të thoshte atë që thotë?”

Ebu Sufjani u përgjigj: “Jo.”

Kajsari: “Kush e ndjek atë, të pasurit dhe të njohurit e njerëzve apo të dobët e tyre?”

Ebu Sufjani: “Të dobët.”

Kajsari: “Pakësohen apo shumohen?”

Ebu Sufjani: “Ata shtohen.”

Kajsari: “A e lë kush fenë e tij, pasi ka hyrë në të?”

Ebu Sufjani: “Jo”

Dialogu mes tyre vazhdoi rreth qëndrimit të kurejshëve ndaj Profetit dhe me përmendjen e virtyteve të tij. Pastaj Kajsari tha: “Nëse ato që the janë të vërteta, ai është Profet. Unë e dija që do të vijë, por nuk e mendoja se do të jetë prej jush. Të jem i çiltër ndaj tij, do të dëshiroja ta takoja. Sikur të isha pranë tij, do t’ia laja këmbët.” (Sipas zakonis të respektit të asaj kohe.)

Ai e respektoi Duhëjhen dhe iu përgjigj Profetit, duke i dërguar dhurata. Letra përmbante dashuri dhe mbështetje për profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*).¹

¹ “Letrat e Profetit”, vëll. 1, f. 109. “Biharul Anuar”, vëll. 20, f. 378 dhe 379.

Ajetet 65 – 68

يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَآبِ لِمَ تُحَآجُّونَ فِىٓ إِبْرَٰهِيمَ وَمَا أُنزِلَتِ ٱلتَّوْرَةُ
 وَٱلْإِنجِيلُ إِلَّا مِنْ بَعْدِهِۦٓ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٦٥﴾ هَتَآئِنَّمْ هَتُّوْا ۖ حَسْبَ جُنُودِكُمْ
 فِيمَا لَكُمْ بِهِۦ عِلْمٌ فَلِمَ تُحَآجُّونَ فِيمَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِۦ عِلْمٌ ۗ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ
 وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٦٦﴾ مَا كَانَ إِبْرَٰهِيمُ يَهُودِيًّا وَلَا نَصْرَانِيًّا وَلَكِنْ كَانَ
 حَنِيفًا مُّسْلِمًا وَمَا كَانَ مِنَ ٱلْمُشْرِكِينَ ﴿٦٧﴾ إِنَّ أَوْلَى ٱلنَّاسِ بِإِبْرَٰهِيمَ
 لَٱلَّذِينَ ٱتَّبَعُوْهُ وَهَذَا ٱلنَّبِيُّ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوْا ۗ وَٱللَّهُ وِلِيُّ ٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿٦٨﴾

“O ithtarët e Librit! Pse polemizoni për Ibrahimin, kur Teurati dhe Ungjilli janë zbritur vetëm pas tij? A nuk kuptoni? Ju jeni ata që polemizuat për gjëra që keni një farë dije, por, pse polemizoni për atë, për të cilën s’dini asgjë? All’llahu e di hollësisht, ndërsa ju nuk dini asgjë për këtë. Ibrahimin nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë, i përlur ndaj All’llahut dhe nuk ka qenë nga politeistët. Pa dyshim, njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë dhe ky Profet me besimtarët. All’llahu është mbrojtës i besimtarëve.”

Shkaku i zbritjes

Në transmetimet e bekuara thuhet se dijetarët jahudij dhe dijetarët e krishterë të Nexhranit shkuan te profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe filluan të polemizojnë rreth hazretit Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Jahudijtët thanë se Ibrahim ka qenë jahudi. Të krishterët thanë se ka qenë i krishterë. Secili pretendonte se Ibrahim u takon atyre, me qëllim që njëra palë të jetë triumfuese dhe më krenare se pala tjetër, sepse Ibrahim ka qenë profet i lartë tek të gjithë fetë dhe fraksionet. Atëherë zbriti ajeti i lartpërmendur për të shpjeguar pretendimet e gënjeshttrat.

Komentimi

“O ithtarët e Librit! Pse polemizoni për Ibrahimin...”

Ky ajet hedh poshtë pretendimet e jahudijve dhe të krishterëve dhe u thotë se polemizimi juaj rreth profetit sakrifikues në rrugën e All'llahut, hazretit Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është i pavlerë, sepse ai ka jetuar shumë vite para hazretit Musa dhe hazretit Isa. Po ashtu, Teurati dhe Ungjilli kanë zbritur shumë kohë pas hazretit Ibrahim. “...kur Teurati dhe Ungjilli janë zbritur vetëm pas tij?...” A është e mundur që profeti i mëparshëm të ndjekë fenë e profetit pasardhës? “...A nuk kuptoni?”

“Ju jeni ata që polemizuat për gjëra që keni një farë dijenie, por, pse polemizoni për atë, për të cilën s’dini asgjë?”

Këtu All'llahu i qorton ata duke u thënë se ju vërtet hulumtuat rreth fesë suaj, që e njihni. E patë vetë se edhe në hulumtimet tuaja gabuat shumë dhe u larguat nga e vërteta. Në realitet, dija juaj ishte

padituri e dyfishtë. Atëherë, si doni të polemizoni për gjëra që nuk i dini e pastaj thoni gjëra që nuk përputhen me asnjë histori?

Në fund ajeti thotë: **“All’llahu e di hollësisht, ndërsa ju nuk dini asgjë për këtë.”** Ky është përforcim i çështjes së mëparshme dhe parashtrim për hulumtimin pasardhës.

Vërtet, Ai e di se kur u dërgua profet Ibrahim i dhe me mesazh dhe jo ju që keni ardhur pas shumë e shumë vitesh pas tij dhe gjykoni mbi të pa asnjë argument.

“Ibrahimi nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë i përlulur ndaj All’llahut...”

Kjo është përgjigje e qartë për pretendimet dhe thotë se Ibrahim i nuk ka qenë as jahudij e as i krishterë, por ai ka qenë monoteist i pastër, i çiltër, i nënshtruar ndaj All’llahut dhe nuk i ka vënë shok Atij.

Fjala *el hanijf* ka kuptimin *e animit nga një gjë kah një gjëje tjetër*. Në gjuhën e Kur’anit do të thotë animi nga humbja kah rruga e drejtë.

Kur’ani e cilëson Ibrahim i të drejtë, sepse ai hoqi perdet e nervozizmit verbues në kohën që ishte e mbushur me adhurimin e idhujve. Ai kurrë nuk e ka pranuar adhurimin e idhujve dhe nuk është përlulur kurrë para tyre.

Mirëpo, arabët, që në kohën para Islamit, adhuronin idhujt. Ata e konsideronin veten e tyre në rrugë të drejtë dhe se ishin në fenë e Ibrahim i. Kjo u përhap aq shumë te ithtarët e Librit, sa që i quanin *“hunefa” – të drejtë*. Në këtë mënyrë fjala *el hanijf* mori kuptim të kundërt nga kuptimi origjinal dhe u bë sinonim i adhurimit të statujave.

Kur’ani, pasi e cilëson Ibrahim i se ka qenë “I drejtë”, thotë se ka qenë “mysliman” dhe më pas tha: **“...dhe nuk ka qenë nga politeistët.”** Për të larguar çdo supozim.

Si ka qenë Ibrahim mysliiman?

Ndoshta dikush mund të pyesë: Nëse nuk e konsiderojmë Ibrahimin prej ndjekësve të Musait dhe as të Isait, atëherë ne nuk mund ta konsiderojmë mysliiman, sepse Ibrahim ka qenë para këtyre feve. Atëherë, pse Kur'ani thotë që ai ka qenë mysliiman?

Përgjigje: Fjala Islam, që përmendet në Kur'an, nuk ka vetëm kuptimin e ndjekjes së profetit Muhammed. Kuptimi i saj është më i gjerë dhe do të thotë dorëzim i plotë ndaj urdhrave të All'lahut dhe të monoteizmit të plotë e të çiltër, të pastër nga çdo ngjyrë e politeizmit dhe idhujtarisë. Hazreti Ibrahim ka qenë mbartësi i flamurit të atij Islami.

Nga ato që u përmendën, sqarohet se Ibrahim nuk ka qenë ndjekës i këtyre feve (Jahudizmit, Kristianizmit dhe Islamit). Këtu lind një pyetje tjetër: Cilët janë ata që e meritojnë të thonë se kanë lidhje me fenë e Ibrahimit?

Me fjalë të tjera: Si mund ta pasojmë këtë profet të madh, me të cilin krenohen të gjitha fetë qiellore?

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë e sqaron këtë çështje dhe thotë: **“Pa dyshim, njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë...”** Sikur ithtarët e Librit t'i vendosnin kufi debatit të tyre rreth Ibrahimit, profetit të madh, ku secila anë pretendonte se është prej tij dhe gjithmonë thoshin se janë të afërt me të, atëherë Kur'ani do ta quante parim themelor lidhjen dhe dashurinë me profetët vetëm nëpërmjet rrugës së besimit.


Bazuar në këtë, njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që ndjekin shkollën e tij dhe u qëndrojnë besnikë qëllimeve të tij, njësoj si Profeti i Islamit dhe ndjekësit e tij.

“...dhe ky Profet me besimtarët...”

Shkaku është i qartë se respektimi i profetëve është me respektimin e shkollës së tyre dhe jo nëpërmjet fanatizmit, fisit dhe

gjenezës së tyre. Edhe pse ithtarët e Librit, me besimin e tyre politeist, i janë larguar parimit më të rëndësishëm të parimeve të thirrjes së Ibrahimit, i Dërguari i Islamit dhe myslimanët i kanë qëndruar besnikë të gjitha parimeve dhe porosive të Ibrahimit. Për këtë duhet patjetër të pranojmë se ata janë më të afërm të Ibrahimit dhe jo jahudijtët apo të krishterët.

Në fund të ajetit All'llahu i përgëzon ata që ndoqën mesazhet e vërteta të profetëve, duke thënë: **“All'llahu është mbrojtës i besimtarëve.”**



Lidhja fetare është lidhja më e fortë

Ky ajet thotë se lidhja e vetme që i lidh njerëzit me profetët është ndjekja e shkollës dhe e qëllimeve të tyre.

Edhe tekstet e ardhura nga imamët e Islamit e përforcojnë këtë temë. Në komentimin “Mexhmaul Bejan” dhe në komentimin “Nuru Thakalejn” përmendet thënia e përcjellë nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “Më i afërmi me profetët është ai që zbaton më shumë ato që sollën ata.” Dhe lexoi ajetin e lartpërmendur. Pastaj tha: “I dashuri i Muhammedit është ai që i bindet All'llahut, edhe pse është i largët në gjenezë. Armik i Muhammedit është ai që nuk i bindet All'llahut, edhe nëse është i afërt me të në gjenezë.”¹

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1 dhe 2, f. 458. Sherhu “Nehxhul Belaga”, i Ibn Ebi el Hadijid, vëll. 18, f. 252.

Ajeti 69

وَدَّتْ طَائِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَوْ يُضِلُّوكُمْ وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّا أَنفُسَهُمْ
وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿٦٩﴾

“Një grup ithtarësh të Librit dëshirojnë që t’ju shpien në rrugë të gabuar. Në të vërtetë ata çojnë në humbje vetëm vetveten, por këtë nuk e ndiejnë.”

Shkaku i zbritjes

Disa komentues thonë se një grup jahudijsh, duke u mbështetur në vesvese djallëzore, u përpoqën që t’i fusin në jahudizëm disa personalitete islame, si: Meadhin, Ammarin e të tjerë. Atëherë zbriti ky ajet, që i paralajmëron myslimanët për ato që fshehin jahudijtë ndaj tyre.¹

Komentimi

“Një grup ithtarësh të Librit dëshirojnë që t’ju shpien në rrugë të gabuar...”

Armiqtë e Islamit, veçanërisht jahudijtët, siç u përmend në shkakun e zbritjes, u përpoqën shumë që t’i largonin myslimanët nga Islami. Ata lakmuan deri në mashtrimin e shokëve të afërm të Profetit. Është e vërtetë se, nëse ata do t’ia arrinin qëllimit të tyre,

¹ Ky shkak i zbritjes, me ndryshim të vogël, përmendet edhe në Tefsijret: “Ruhul Xhinan”, “Ruhul Meanij”, “El Kebijr”, “Kurtubiu”, “El Bahrul Muhijj”, në fund të ajetit në fjalë.

qoftë edhe te një person, kjo do të ishte goditje e ashpër për Islamin dhe do të hapte rrugën për të çuar të tjerë në humbje.

Ky ajet zbulon planet e armiqve dhe i paralajmëron ata që të heqin dorë prej përpjekjeve të sëmura, sepse, bazuar te shkolla e edukimit të myslimanëve, që është ajo e profetit Muhammed, nuk do të gjejnë mundësinë më të vogël që t'i kthejnë myslimanët nga feja e tyre. Ata e përqaftuan Islamin me gjithë qenien e tyre. Për këtë ata e duan këtë shkollë njerëzore me gjithë zemër dhe e pasojnë atë. Bazuar në këto, armiqtë nuk gjejnë rrugë për t'i çuar myslimanët në humbje, por ata humbasin veten e tyre.

“...Në të vërtetë ata çojnë në humbje vetëm vetveten, por këtë nuk e ndiejnë.” Kjo sepse, ata, duke hedhur dyshime mbi Islamin dhe mbi Profetin dhe duke hedhur akuza të shumta mbi ta, edukohen me shpirtin e paragjyqimit dhe të mendimit të keq.

Me fjalë më të qarta: Fanatizmi dhe kokëfortësia e tij, pikat pozitive e ndriçuese, i mendon të errëta dhe negative. Sa më shumë të këmbëngulë në të, aq më shumë largohet nga e vërteta.

Ka mundësi që shprehja: *ue ma jesh'urune-por nuk e ndiejnë*, tregon për këtë gjendje shpirtërore, që njeriu, me pavetëdije, ndikohet edhe nga thëniet e veta. Në kohën që ai përpiqet të shpjerë të tjerët në rrugë të gabuar me anë të gënjeshtërisë, shpifjes dhe mashtrimit, nuk është vetja e tij, që flet nga ndikimi i gënjeshtreve të tij. Këto kundërshtime dalëngadalë ndikojnë në shpirtin e tij dhe bëhen besim i ngulitur, të cilin e quan të vërtetë dhe me anë të tij humbet vetveten.

Ajetet 70 – 71

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَكُمْ وَرَفَعْنَا فَوْقَكُمُ الطُّورَ خُذُوا مَا آتَيْنَاكُمْ بِقُوَّةٍ
وَأَذْكُرُوا مَا فِيهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٧٠﴾ ثُمَّ تَوَلَّيْتُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ فَلَوْلَا
فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَكُنْتُمْ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٧١﴾

“O ithtarë të Librit! Përse i mohoni shpalljet e All’llahut, edhe pse jeni dëshmitarë se ato janë të vërteta? O ithtarët e Librit! Përse e pështjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?”

Komentimi

Përse fshihet e vërteta?

Pas bisedës rreth punëve shkatërruese të ithtarëve të Librit, që u përmendën në ajetet e mëparshme, këto dy ajete u drejtohen ithtarëve të Librit dhe i fajëson ata për fshehjen e të vërtetave dhe për zbatimin e tyre. Ajeti thotë: **“O ithtarë të Librit! Përse i mohoni shpalljet e All’llahut, edhe pse jeni dëshmitarë se ato janë të vërteta?”**¹

¹ Frazja *teshbedune* ka kuptimin e *dijes e të njohjes*, sipas komentimit të lartpërmendur dhe sipas asaj që thuhet në komentimin “Mexhmaul Bejan” e në komentime të tjera. Kjo dije e ka zanafillën tek njohja e tyre për cilësitë e profetit, që përmenden në Teurat dhe në Ungjill. Mirëpo disa kanë mendimin se kuptimi i dijes këtu është mrekulli e mjaftueshme për konstatimin e profetësisë së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Disa të tjerë kanë thënë se kuptimi është që i mohoni ato në dukje, mirëpo në tubimet tuaja të posaçme dëshmoni për vërtetësinë e thirrjes së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pyetja në ajet u drejtohet ithtarëve të Librit, se çfarë i bën ata që të jenë kokëfortë e të pabindur, pasi i lexuan shenjat e profetit Muhammed në Teurat dhe në Ungjill dhe e dinë mirë se çfarë gjendet në këta dy Libra. Atëherë, pse i mohojnë?

“O ithtarët e Librit! Përse e pëshjtjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?”

Përsëri Kur'ani e dënon veprën e tyre, që bëjnë duke e përzier të vërtetën me të pavërtetën, dhe për fshehjen që i bëjnë të vërtetës. Megjithëse janë në dijeni për shenjat e profetit Muhammed në Teurat dhe në Ungjill, ata i mohojnë ato.

Në ajetin e parë Kur'ani i qorton ata për devijimin e tyre nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Në ajetin e dytë i qorton ata se duan të çojnë të tjerët në rrugë të gabuar.¹

¹Kemi folur për këtë çështje në komentimin e ajetit 42 të sures “El-Bekare”, që është i ngjashëm me këtë ajet.

Ajetet 72 – 74

وَقَالَتْ طَآئِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ ءَامِنُوا بِالَّذِي أُنزِلَ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا
 وَجَهَ النَّهَارِ وَآكْفُرُوا ءَاخِرَهُ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٧٢﴾ وَلَا تَتُومِنُوا إِلَّا لِمَن تَبِعَ
 دِينَكُمْ قُلْ إِنَّ الْهُدَىٰ هُدَىٰ اللَّهِ أَن يُؤْتَىٰ أَحَدٌ مِّثْلَ مَا أُوتِيْتُمْ أَوْ
 يُحَاجُّوكُمْ عِنْدَ رَبِّكُمْ قُلْ إِنَّا الْفَضْلَ بِيَدِ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ
 عَلِيمٌ ﴿٧٣﴾ يَخْتَصُّ بِرَحْمَتِهِ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿٧٤﴾

“Një grup ithtarësh të Librit thanë: “Besojeni në mëngjes atë që u është zbritur besimtarëve, por në mbrëmje mohojeni atë, se ndoshta edhe ata do ta braktisin dhe besojeni vetëm atyre që ndjekin fenë tuaj!” Thuaj (o Muhammed): “Udhëzimi i All’llahut është udhëzimi i vërtetë.” (Hebrenjtë i thanë njëri-tjetrit:) “Mos besoni se mund t’i jepet ndokujt ajo që ju është dhënë juve (vetëm nëse ndjekin fenë tuaj), përndryshe ata do të polemizojnë kundër jush te Zoti juaj.” Thuaj (o Muhammed): “Mirësia është në Dorë të All’llahut, Ai ia jep atë kujt të dojë. All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm. Mëshirën e Vet, Ai ia dhuron kujt të dojë. All’llahu është zotërues i mirësisë së pakufishme.”

Shkaku i zbritjes

Disa komentues të shkuar kanë thënë se dymbëdhjetë jahudij të Khajberit planifikuan plane për t'ia lëkundur besimin disa besimtarëve myslimanë. Ata vendosën me njëri-tjetrin që në mëngjesin e ditës pasardhëse të jenë të profeti dhe të hiqen sikur kanë përqaftuar Islamin. Nëse do të pyeten përse e pranuat Islamin, do të përgjigjen: “Në e mbikëqyrëm nga afër moralin e Muhammedit dhe, kur u kthyem te librat dhe rabinët tanë, pamë se, ato që diktuan në sjelljen dhe moralin e tij, nuk përputhen me ato që ndodhen në librat tanë, prandaj u larguam.”

Kjo thënie e tyre do t'i detyronte disa që të thoshin se ata vërtet i lexuan librat e tyre qiellorë, për të cilët janë më të ditur se ne, prandaj ajo që thonë është e saktë. Kështu që besimi i tyre do të lëkundet.¹

Gjendet shkak tjetër për zbritjen, por ajo që përmendëm është më afër me kuptimin.²

Komentimi

Intrigë e rrezikshme

Ky ajet zbulon një plan shkatërrues prej planeve të jahudijve. Ajeti thotë se, që të lëkundet baza e besimit Islam, jahudijtët përdorën çdo mjet të mundshëm. Ata u bashkuan në një mendim që të besojnë në atë që iu zbrit myslimanëve në fillim të ditës dhe ta braktisin në fund të ditës. Ajeti thotë: **“Një grup ithtarësh të Librit thanë: “Besojeni në mëngjes atë që u është zbritur besimtarëve, por në mbrëmje mohojeni atë.”**

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i komentimit të ajetit në fjalë. “Esbabu Nuzul” i Uahid Nijshaburij, f. 71.

² I njëjti burim.

Ka mundësi që fillimi i ditës dhe fundi i saj të ketë kuptimin e kohës së shkurtër të besimit dhe të mohimit të tyre. Kufizimi i kësaj periudhe frymëzon të tjerët që të mendojnë se ata jahudij, para se të hynin në Islam, e konsideronin atë diçka madhështore, mirëpo, pas përçafimit të tij, gjetën diçka tjetër, e cila ia zbehu shpresat, prandaj e lanë.

S'ka dyshim se kjo lloj intrige do të ndikonte te ata njerëz, ku besimi ishte ende i dobët, veçanërisht se ata jahudij ishin prej rabinëve të ditur dhe të gjithë e dinin se ata janë të njohur për librat qiellorë dhe për shenjat e vulës së profetëve. Besimi dhe mohimi i tyre ishin të mundshëm që ta lëkundnin besimin e myslimanëve të rinj. Për këtë, ata jahudij mbështeteshin shumë në këto lloj planesh të zgjuara. Thënia e ajetit: **“...se ndoshta edhe ata do ta braktisin...”** është argument i shpresës së jahudijve se ndoshta myslimanët do ta braktisin Islamin.

Plani i tyre bazohej në shfaqjen me gojë të Islamit, ndërsa me zemër të qëndronte lidhja me fenë e tyre.

“...dhe besojuni vetëm atyre që ndjekin fenë tuaj!”

Nga disa komentime përfitohet se jahudijtë e Khajberit i porositën jahudijtët e Medines që të mos i afrohen të dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e të ndikohen prej tij, duke i besuar me të vërtetë, sepse ata besonin se profecia duhet të jetë prej jahudijve. Nëse do të vijë profet, ai duhet të jetë jahudij.

Disa komentues kanë mendimin se fraza *dhe besojuni vetëm* e ka prejardhjen nga fjala *iman*, që në gjuhësi do të thotë *besim dhe bindje*. Bazuar në këtë, kuptimi është: Kjo intrigë duhet të mbetet e fshehtë dhe sekrete dhe askush të mos e dijë, përveç jahudijve, madje as politeistët. Kjo me qëllim që të mos dështonte. Mirëpo, në këto ajete, All'llahu i skandalizon ata, që të jetë mësim për besimtarët dhe mësim

për udhëzimin e kokëfortëve. **“Thuaj (o Muhammed): “Udhëzimi i All’llahut është udhëzimi i vërtetë.”**

Në këtë fjali, që ndodhet në mesin e fjalëve të jahudijve, All’llahu u përgjigjet me përgjigje të shkurtra, por me kuptim të thellë.

Së pari: Burimi i udhëzimit është All’llahu dhe nuk është e posaçme dhe e pavarur për një individ apo popull dhe nuk është e domosdoshme që profeti të vijë vetëm nga jahudijtët.

Së dyti: Vërtet, ata që All’llahu i ka përfshirë në udhëzimin e tij të gjerë, kjo intrigë nuk ua lëkund besimin dhe as nuk ndikohen nga këto plane.

“...se mund t’i jepet ndokujt ajo që ju është dhënë juve, përndryshe ata do të polemizojnë kundër jush te Zoti juaj.”

Ky ajet është vazhdimësi e thënieve të jahudijve, për faktin se ka aludim para saj që është (mos e besoni).

Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është: Mos besoni se ndokujt do t’i jepet ajo që iu dha juve prej krenarisë dhe çfarë ju zbrit juve nga qielli prej librave. Po ashtu, mos besoni se dikush mund të polemizojë me ju në Ditën e Kiametit për fenë tuaj para All’llahut, sepse ju jeni kombi më i mirë në botë. Ju jeni poseduesit e profecië, logjikës, dijes dhe argumentit.

Me këtë ide, jahudijtët përpiqeshin që të fitonin veçori për t’u dalluar nga popujt e tjerë, nëpërmjet lidhjes së tyre me All’llahun, dijen, logjikën dhe argumentin. Për këtë All’llahu u thotë atyre në ajetin vijues: **“Thuaj: “Mirësia është në Dorë të All’llahut, Ai ia jep atë kujt të dojë. All’llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.”**, që do të thotë: O i Dërguari Im. Thuaju atyre se dhuntitë dhe mirësitë, qoftë profeci, apo argumente logjike, apo krenari të ndryshme, të gjitha këto janë prej All’llahut. Ai ua jep atyre që do. Askush nuk ka marrë premtim e as besë së është më i miri.

Prania e Tij dhe falja e Tij janë të pakufishme. Ai është i Gjithëditur për gjithçka.

“Mëshirën e Vet, Ai ia dhuron kujt të dojë. All’llahu është zotërues i mirësisë së pakufishme.”

Ky është një përforsim për ato që u thanë më lart se All’llahu e veçon një rob të Tij, atë që e sheh të merituar dhe të volitshëm për mëshirën e Tij, përfshirë këtu edhe profecinë. Askush nuk e përcakton se është zotërues i përsosmërisë apo i mirësive të mëdha.

Nga përmbajtja e këtij ajeti përfitohet se, nëse mirësia e All’llahut përfshin disa njerëz dhe disa jo, kjo nuk ka kuptimin e kufizimit të mirësisë së All’llahut, por ndodh për shkak të aftësisë dhe dallimeve të njerëzve.

Hulumtim

Planet e hershme

Në realitet ky ajet konsiderohet prej ajeteve të mrekullisë së Kur’anit, sepse ai zbulon sekretet e jahudijve dhe të armiqve të Islamit dhe i skandalizon planet e tyre, që kishin për qëllim lëkundjen e besimit në zemrat e myslimanëve të parë. Me mirësitë e tij, ky ajet i zgjoi myslimanët dhe i bëri të kuptojnë pëshpëritjet mashtruese të armikut.

Mirëpo, nëse e përqendrojmë vëmendjen, do të shohim se ato plane janë edhe sot, po me rrugë të ndryshme. Mjetet e fuqishme të informacionit të armikut përdoren sot, po për të njëjtin qëllim. Nëpërmjet tyre ata përpiqen të shembin bazat e besimit islam në mendjet e myslimanëve, veçanërisht të brezi i ri. Në këtë rrugë ata përdorin çdo shpifje dhe strehohen të metodat e ndryshme, duke u

veshur me petkun e dijetarit, orientalistit, historianit, gazetarit, biologut, deri edhe aktorit të kinemasë.

Ata e thonë qartë se nuk kanë qëllim që t'i kthejnë myslimanët në të krishterë e as në jahudij. Qëllimi i tyre është shkatërrimi i bazave të ideve islame në mendjet e të rinjve dhe t'i largojnë ata nga feja dhe trashëgimia e tyre. Edhe sot, Kur'ani i paralajmëron myslimanët prej atyre planeve, njësoj siç i paralajmëroi në të shkuarën.



Ajetet 75 – 76

وَمِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ إِنْ تَأْمَنَهُ بِقِنطَارٍ يُؤَدِّهِ إِلَيْكَ وَمِنْهُمْ مَنْ إِنْ تَأْمَنَهُ بِدِينَارٍ لَّا يُؤَدِّهِ إِلَيْكَ إِلَّا مَا دُمْتَ عَلَيْهِ قَائِمًا ۗ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا لَيْسَ عَلَيْنَا فِي الْأُمِّيَّنَ سَبِيلٌ وَيَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٥﴾ بَلَىٰ مَنْ أَوْفَىٰ بِعَهْدِهِ وَاتَّقَىٰ فَإِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَّقِينَ ﴿٧٦﴾

“Ka nga ata ithtarë të Librit, që sikur t’u besosh një barrë të tërë ari, do t’jua kthejnë, por ka edhe të atillë që, nëse u jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthejnë, veçse nëse nuk u ndahesh. Kjo është kështu, ngase ata thonë: “Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabetëve.” Ata flasin gënjeshtër për All’llahun me vetëdije. Jo! Por kushdo që plotëson premtimin e tij dhe është i devotshëm, All’llahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm.

Shkaku i zbritjes

Ajeti i parë ka zbritur për dy jahudij, njëri ishte besnik dhe i vërtetë, kurse tjetri ishte i pabesë. Te i pari, Abdullah ibn Selam, la amanet 1200 ukijetun¹ flori. Kur ia kërkoi burri floririn, ai ia dha. All'lahu e lavdëron atë në këtë ajet. Jahudijut të dytë, Fenhas ibn Azura, një kurejsh, i la amanet një dinar, e ai e tradhtoi. All'lahu e qorton atë në këtë ajet për shkak të tradhtisë së amanetit.²

Thuhet se pjesa e parë e ajetit ka për qëllim një grup prej kristianëve, ndërsa ata që e tradhtuan amanetin janë një grup jahudijsh.³ Ka mundësi që ajeti të tregojë për të dy.

Komentimi

Ajeti vizaton peisazh tjetër për ithtarët e Librit. Disa jahudij besonin se ata nuk janë përgjegjës për ruajtjen e amanetit të njerëzve, por ata kishin të drejtë t'i zotëronin ato amanete. Ata thoshin: “Ne jemi ithtarë të Librit, sepse profeti dhe Libri qiellor kanë zbritur mes nesh. Për këtë, pasuritë e të tjerëve nuk respektohen tek ne.” Kjo ide e tyre u bë aq e zjarrtë, sa që u bë besim fetar i ngulitur tek ta. Kjo është ajo për të cilën Kur'ani thotë: **“Ata flasin gënjeshtër për All'lahun...”**.

Jahudijtët thoshin: “Ne kemi të drejtë të bëjmë si të duam me pasuritë e arabëve, edhe t'i pushtojmë ato, sepse ata janë mushrika dhe nuk ndjekin fenë e Musait.” Gjithashtu thuhet se jahudijtët kanë pasur marrëveshje ekonomike dhe tregtare me arabët. Kur arabët e pranuan Islamit, jahudijtët refuzuan t'ia kthejnë atyre të drejtat dhe thoshin: “Në kohën e marrëveshjes ju nuk keni qenë prej

¹ Një okë (ukijeh) flori është baraz me 7 mithkale.

² Tefsijri “Mexhmaul Bejan”; fundi i ajeteve në fjalë. “Biharul Anuar”; vëll. 9, f. 71.

³ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”; fundi i ajeteve në fjalë. “Biharul Anuar”; vëll. 9, f. 71.

kundërshtarëve tanë. Në kohën që ju pranuat fenë e re, e drejta juaj nuk qëndron.”

Këtu vlen të përmendet se ky ajet tregon se jo të gjithë ithtarët e Librit kanë pasur këtë mendim jonjerëzor, sepse në mesin e tyre ka pasur njerëz që mendonin se e kanë për detyrë që t’ua japin të drejtat që u takojnë të tjerëve. Për këtë, Kur’ani nuk i qorton të gjithë ata dhe nuk i quan të gjithë gabimtarë për hir të gabimeve të një grupi. Ai thotë: **“Ka nga ata ithtarë të Librit, që sikur t’u besosh një barrë të tërë ari, do t’jua kthejnë, por ka edhe të atillë që, nëse u jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthejnë, veçse nëse nuk u ndahesh...”**

Fraza *nëse nuk u ndahesh...* tregon për një parim burimor të jahudijve. Shumica e tyre mendojnë se e drejta kthehet vetëm me forcë. Prandaj edhe për myslimanët nuk gjendet rrugë tjetër për të rimarrë të drejtën e tyre prej jahudijve veçse me këtë rrugë.

Ngjarjet, që kanë ndodhur kohët e fundit në Lindjen e Mesme, kanë konstatuar se vendimet ndërkombëtare dhe mendimi mbarëbotëror nuk kanë as vlerë e as kuptim në pikëpamjen sioniste. Kjo është kështu, ngaqë ata thonë: **“Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabetëve.”**

Kjo fjali e ajetit sqaron logjikën e jahudijve në ngrënien e pasurisë së njerëzve, sepse ithtarët e Librit janë më të mirë se analfabetët. Analfabetë quanin politeistët (mushrikët) dhe arabët, sepse shumica e tyre ishin analfabetë, ose ata që nuk e lexonin Ungjillin dhe Teuratin. Për këtë ata kanë të drejtë të pushtojnë pasuritë e të tjerëve dhe askush nuk ka të drejtë t’i fajësojë e t’i qortojë për këtë veprim. Ata kanë arritur deri në atë gradë sa të thonë gënjeshtër ndaj All’llahut. Prej atyre gënjeshtërve është se gjoja All’llahu i ka bërë ata më superior se të tjerët.

S’ka dyshim se kjo logjikë është më e rrezikshme se sa ajo e tradhtisë së amanetit, sepse ata e mendonin superioritetin një prej të

drejtave të tyre. Për këtë gënjeshtër Kur'ani thotë: **“Ata flasin gënjeshtër për All'llahun me vetëdije.”**

Ata e dinë shumë mirë se në librat e tyre qiellorë nuk gjendet asgjë prej këtyre thënieve që t'ua lejojë atyre tradhtinë në pasurinë e njerëzve. Mirëpo, për të mbuluar punët e tyre të shëmtuara, filluan të shpifin trillime e gënjeshtër dhe t'ia veshin All'llahut të Madhëruar.

Ajeti vijues e mohon thënien e jahudijve: **“Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabetëve.”** Ata u mbështetën në këtë pretendim të rremë për të sunduar mbi pasuritë e të tjerëve. Ata i konsiderojnë ligjet veçse lojëra në duart e tyre për të plotësuar qëllimet e veta. Ajeti thotë: **“Jo! Por kushdo që plotëson premtimin e tij dhe është i devotshëm, All'llahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm.”**

Ky ajet konstaton se etaloni i personalitetit, vlerat njerëzore e humane dhe dashuria e All'llahut janë simbolizuar veçanërisht në plotësimin e premtimeve, në mos tradhtinë e amaneteve dhe në devotshmëri. Është e vërtetë se All'llahu i do të devotshmit dhe jo të pabesët e gënjeshtarët, të cilët ia lejojnë vetes së tyre pushtimin e të drejtave të të tjerëve dhe me plot guxim thonë që këtë të drejtë jua ka dhënë All'llahu.

Dy hulumtime

1- Kundërshtim: Dikush mund të thotë se Islami ka nxjerrë këtë ligj për pasuritë e jomyslimanëve dhe se ai e lejon marrjen, sundimin e pasurive të tyre.

Përgjigje: S'ka dyshim se kjo akuzë për Islamin është shpifje, sepse ligjet e Islamit, që janë të prera dhe të padiskutueshme, të ardhura në shumë transmetime, thonë: “Nuk lejohet tradhtia

e amanetit, qoftë për myslimanin apo jomyslimanin, deri edhe për politeistin dhe adhuruesin e idhujve.”

2- Në një hadith të njohur, i ardhur nga imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Çojini në vendin e tyre amanetet. Beto hem në Atë që dërgoi Muhammedin Profet, me të drejtë se, sikur vrasësi i babait tim Husejn ibn Ali ibn Ebu Talib (*Paqja qoftë mbi ta!*) do ta linte tek unë shpatën me të cilën e vrau atë, unë do t’ia ktheja atij.”¹

Në një transmetim tjetër, i ardhur nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Vërtet, All’llahu i ka dërguar profetët që të thonë të vërtetën dhe të çojnë në vend amanetin, qoftë për të mirin, qoftë për të keqin.”²

Bazuar në ato që përmendën transmetimet, themi se Islami nuk e pranon në asnjë formë tradhtinë e amanetit. Myslimanët janë të detyruar që të mos tradhtojnë amanetet, të kujtdo qofshin.

Fjala *bela* përdoret si përgjigje për mohimin ose për përgjigje, e shoqëruar me mohim. Siç është thënia e All’llahut: “A nuk jam Unë Zoti Juaj?”

Ata thanë: Po!”³

Fjala *neam*, që do të thotë *po*, përdoret si përgjigje e pyetjes konstatuese. Siç është në thënien e All’llahut: **“...a gjetët të vërtetë atë që ju premtoi Zoti juaj?”**

Ata do të thonë: “Po!”⁴

¹ “Amalij Suduk”; f. 149. “Uesailu shia”; vëll. 19, f. 76.

² “Sefijnetul Bihar”; lënda *emene*, “Usulul Kafij”; vëll. 2, f. 104.

³ Sure “A’raf”, ajeti 172.

⁴ Sure “A’raf”, ajeti 44.

Ajeti 77

إِنَّ الَّذِينَ يَشْتَرُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَأَيْمَانِهِمْ ثَمَنًا قَلِيلًا أُولَٰئِكَ لَا خَلْقَ لَهُمْ فِي
 الْأَخْرَةِ وَلَا يُكَلِّمُهُمُ اللَّهُ وَلَا يَنْظُرُ إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَا يُزَكِّيهِمْ
 وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٧﴾

“Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj All’llahut me një vlerë të paktë, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. All’llahu nuk do t’u flasë atyre, as nuk do t’i shikojë në Ditën e Kiametit dhe as nuk do t’i pastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm.”

Shkaku i zbritjes

Një grup jahudijsh dhe dijetarët e tyre, si: Ebi Rrafju, Haj ibn Ekhtab dhe Ka’b ibn Eshref, kur vunë re se pozita e tyre shoqërore në mesin e jahudijve po përballej me rrezikun, ndryshuan shenjat e ardhjes së vulës së profetëve që ndodheshin në Teurat, të cilat ata vetë i kishin shkruar me duart e tyre në kopjet e Teuratit. Ata u betuan se ato shkrime ishin të devijuara nga All’llahu. Për këtë zbriti ky ajet, i cili përmban qortim të rreptë për ata.¹

Ka komentues që thonë se ky ajet ka zbritur për Esh’ath ibn Kajs, i cili donte të sundonte tokën e një tjetri nëpërmjet rrugës së gënjeshtres dhe falsifikimit. Kur u bë gati të betohej për të forcuar pretendimin e tij, atë e mbuloi frika dhe e pohoi të vërtetën dhe ia ktheu tokën të zotit të saj.²

¹ Komentimi “Mexhmaul Bejan”, komentimi “Xhamiul Bejan”, komentimi “Ruhul Meanij”, fundi i ajetit në fjalë.

² I njëjti burim i mëparshëm.

Komentimi

Ajeti tregon për një anë tjetër të mëkateve të jahudijve dhe të ithtarëve të Librit. Përderisa ajeti flet në mënyrë të përgjithshme, ai përfshin çdokënd që i përputhen këto cilësi.

Ajeti thotë: **“Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj All’llahut me një vlerë të paktë...,”** që do të thotë se ata, të cilët e përdorin premtimin dhe betimin në All’llahun për shitblerje, në këmbim të një shume materiale, do të ndalohen prej pesë gjërave:

1- Atyre do t’u ndalohen mirësitë e pafundme të All’llahut në Jetën Tjetër: **“...nuk do të kenë asnjë të mirë në Jetën e ardhshme.”**

2- Në Ditën e Kiametit All’llahu u flet besimtarëve, ndërsa këtyre lloj njerëzve nuk u flet. **“...All’llahu nuk do t’u flasë atyre...”**

3- Në Ditën e Kiametit All’llahu nuk do t’i shohë ata me shikimin e mëshirës e të butësisë. **“...as nuk do t’i shikojë në Ditën e Kiametit...”**. Në atë Ditë ata do ta kuptojnë se All’llahu u flet robëve të Tij besimtarë (qoftë drejtpërsëdrejti apo me ndërmjetësimin e melekëve) gjë që i gëzon më shumë zemrat e besimtarëve në atë Ditë. Kjo është argument se All’llahu është gjithmonë me ata që kanë besuar, qoftë në këtë jetë, qoftë në Jetën Tjetër.

Duhet të dihet se shikimi i përmendur në ajet nuk është material e trupor, siç e përfytyrojnë disa të paditur. Kurse ata njerëz, që i përdorin argumentet e All’llahut për interesa materiale, nuk do t’i përfshijë as kujdesi i All’llahut në atë Ditë dhe as nuk do të kenë nderin që Ai t’u flasë atyre.

As nuk i pastron ata prej gjynaheve të tyre. **“...dhe as nuk do t’i pastrojë prej gjynaheve...”**

Së fundi, ata do t'i dënojnë me dënim të rëndë. **“...e për ta do të ketë dënim të dhembshëm.”**

Qëllimi i frazës *themenun kaliljün - vlerë të paktë*, nuk do të thotë se, nëse njeriu e këmben premtimin e All'lahut me këmbim të madh, atij i lejohet ta bëjë këtë. Por qëllimi është për çdo lloj vlere që këmbehet premtimi dhe betimi përballë kryerjes së këtyre gjynaheve të mëdha.

Është e natyrshme se fjalët e All'lahut nuk janë fjalë të thëna me gjuhë, sepse All'lahu është i pastër nga trupëzimi. Por të folurit do të jetë nëpërmjet frymëzimit të zemrës ose nëpërmjet krijimit të valëve të zërit në hapësirë, siç ishin fjalët që dëgjoji hazreti Musa (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) nga pema e Turit.

Hulumtim

Këtu vlen të përmendet se këto pesë ndëshkime, që vijnë për shkak të “thyerjes së premtimit” dhe të “betimit të rremë”, të cilat i përmend ajeti më lart, ka mundësi të tregojnë për “fazat e afrimit e të largimit” nga All'lahu i Madhëruar.

Ai që afrohet tek All'lahu, atë e përfshijnë mirësitë e Tij shpirtërore. Nëse afrohet më tepër, All'lahu i flet atij. Nëse afrohet edhe më shumë, All'lahu e sheh me shikimin e butësisë e të mëshirës. Nëse afrohet edhe më shumë, All'lahu e pastron atë prej gjynaheve. Dhe së fundi, e shpëton atë prej dënimit të rëndë dhe e mbulon me mirësitë e tij të pafundme. Kurse ata, të cilët ecin në rrugën e thyerjes së premtimeve dhe e përdorin emrin e All'lahut në formë të parregullt, do të ndalohen prej të gjitha mirësive.

Në komentimin e ajetit 174 të sures “El-Bekare” që ngjason me këtë ajet, ka sqarim më të detajuar.

Ajeti 78

وَإِنَّ مِنْهُمْ لَفَرِيقًا يَلُورْنَ أَلْسِنَتَهُم بِالْكِتَابِ لِتَحْسَبُوهُ مِنَ الْكِتَابِ وَمَا هُوَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَقُولُونَ هُوَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَمَا هُوَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ وَيَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٨﴾

“Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre, që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit (që ka zbritur All’llahu), kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit. Ata thonë: “Kjo që lexojmë është nga All’llahu”, por ajo nuk është nga All’llahu. Ata flasin gënjeshtër për All’llahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë.”

Komentimi

Ky ajet, i cili përforcon ato që përmendën ajetet e mëparshme rreth tradhtisë (pabesisë) së disa dijetarëve të ithtarëve të Librit, thotë se një grup prej tyre i shtrembërojnë gjuhët kur lexojnë Librin. Kjo është homofoni për shmangien e Fjalëve të All’llahut nga ana e tyre.

Fjala *jel’une* vjen nga lënda *lej’jun*, njësoj si fjala *haj’jun* dhe ka kuptimin e *el emaletu-shtrembërim*. Kjo është shprehje retorike për devijimin e fjalës së All’llahut. Të jep të kuptosh se, kur ata lexojnë Teuratin dhe në kohën që arrijnë tek argumentet në të cilat përmenden cilësitë e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe përgëzimi i ardhjes së tij, ata e ndryshojnë leximin e fjalëve të tyre.

Ajeti shton se ata janë mjeshtër të shmangieve, derisa ju të mendoni se, ajo që lexojnë, janë ajetet që i ka zbritur All'llahu. Në të vërtetë, ato nuk janë të tilla: **“Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre, që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit, kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit...”**

Ata jo vetëm që nuk binden me këto fjalë, por dëshmojnë hapur se ato janë prej Librit të All'llahut. Mirëpo ato nuk janë prej Librit të All'llahut: **Ata thonë: “Kjo që lexojmë është nga All'llahu”, por ajo nuk është nga All'llahu...”**

Përsëri Kur'ani thotë se, me këtë vepër të tyre, ata nuk janë viktima të gabimit e të gjynahut, por ata thonë gënjeshtër me plot dije e qëllim për All'llahun. Ata ia veshin Atij këtë akuzë të madhe, duke qenë të ditur për atë që veprojnë. **“...Ata flasin gënjeshtër për All'llahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë.”**

Ajetet 79 – 80

مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُؤْتِيَهُ اللَّهُ الْكِتَابَ وَالْحُكْمَ وَالنُّبُوَّةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ
كُونُوا عِبَادًا لِي مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّيْنَ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ
الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ ﴿٧٩﴾ وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَّخِذُوا الْمَلَائِكَةَ
وَالنَّبِيِّينَ أَرْبَابًا أَيَأْمُرُكُمْ بِالْكُفْرِ بَعْدَ إِذْ أَنْتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿٨٠﴾

“Asnjë njeriu të cilit All’llahu i ka dhënë Librin, dijeninë e gjerë dhe Profecinë, t’u thotë njerëzve: “Bëhuni robtë e mi dhe jo të All’llahut.” Përkundrazi, ai thotë: “Bëhuni rob të ditur të Zotit, sepse ua keni mësuar Librin të tjerëve dhe e mësoni edhe vetë! Ai nuk ju urdhëron që engjëjt dhe profetët t’i merrni për zota. Vallë, a ju urdhëron të bëheni mohues, pasi i jeni nënshtruar All’llahut?!”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së ajeteve ka dy transmetime:

I pari: Një burrë ka thënë: “O i Dërguari i All’llahut, ne të përshëndesim ty ashtu siç përshëndesim njëri-tjetrin. A nuk duhet të të bëjmë ty sexhde?”

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: **“Askujt nuk i bëhet sexhde, veçse All’llahut. Por ju nderojeni të Dërguarin tuaj dhe njiheni të drejtën e familjes së tij.”** Atëherë, All’llahu zbriti ajetet e lartpërmendura.¹

I dyti: Ebu Rafiu, i cili ishte prej jahudinjve dhe bashkë me të kryetari i delegacionit të Nexhranit i thanë Profetit: “A do që të të adhurojmë ty dhe të të marrim për zot? Ata mendonin se, nëse ia ngenë atij pozitën deri në hyjni, siç bënë me hazretin Isa, Profeti do të hiqte dorë nga kundërshtimi i hyjnisë së Isait. Ka mundësi që ky propozim të mbante ne vetvete një intrigë të përgatitur nga ata, për të njollosur personalitetin e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të mos ndjekjes së tij.

Mirëpo profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj: **“I kërkoj mbrojtje All’llahut që të mos adhuroj tjetërkënd përveç Tij. Ai nuk më ka dërguar për këtë dhe as më ka urdhëruar ta bëj këtë.”** Atëherë All’llahu zbriti ajetin dhe ajetet e lartpërmendura.²

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë. Biharul Anuar, vëll. 9, f. 71. Tefsijri “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 47.

² I njëjti burim.

Komentimi

Thirrja për adhurimin e tjetërkënd përveç All'llahut është e pamundur

Më parë thamë se një prej zakoneve të shëmtuara të ithtarëve të Librit ishte shtrembërimi i të vërtetave. E shtrembëruar ishte edhe thënia e tyre për hyjninë e hazretit Isa, duke thënë se ai i ka urdhëruar ata për këtë gjë. Të njëjtën gjë donin të realizonin edhe për Profetin e Islamit, sipas shkaqeve që përmendëm në shkakun e zbritjes së ajeteve.

Ajeti u përgjigjet qartë dhe prerazi të gjithë atyre që propozonin adhurimin e profetëve, duke thënë se ju nuk keni të drejtë të adhuroni Profetin e Islamit dhe asnjë tjetër prej profetëve e prej melekëve. Gabon rëndë ai që thotë se Isai i ka thirrur ata që ta adhurojnë.

“Asnjë njeriu të cilit All'llahu i ka dhënë Librin, dijeninë e gjerë dhe Profecinë, t'u thotë njerëzve: “Bëhuni robtë e mi dhe jo të All'llahut.”

Ajeti e mohon rreptësisht këtë gjë. Ata, të cilët All'llahu i dërgoi dhe u dha dije e urtësi, nuk mund të adhurohen, sado e lartë të jetë pozita e tyre. Të dërguarit e All'llahut janë njerëzit më adhurues të All'llahut se sa të tjerët. Ata kurrë nuk mund të dalin nga rruga e monoteizmit dhe e adhurimit dhe t'i çojnë njerëzit në humnerat e politeizmit.

Përkundrazi: “Bëhuni rob të ditur të Zotit, sepse ua keni mësuar Librin të tjerëve dhe e mësoni edhe vetë!”

Er Rabbani është ai njeri që i ka të forta lidhjet me All'llahun. Përderisa kjo fjalë e ka prejardhjen nga fjala *rabbun*, përdoret edhe për atë që kryen edukimin e të tjerëve, drejtimin dhe organizimin e çështjeve, si dhe bën ndreqjen dhe pajtimin e tyre.

Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është: Thirrja e të dërguarve, që njerëzit t'i adhurojnë ata nuk u ka hije atyre. Ajo që u ka hije të dërguarve është që t'i bëjnë të ditur njerëzit nga ana e fesë, duke u mësuar atyre shenjat e All'llahut dhe të vërtetat e fesë. Po ashtu, t'u mësojnë atyre që ta adhurojnë All'llahun me dije dhe njohje.

Nga kjo kuptohet se qëllimi i të dërguarve nuk ka qenë vetëm edukimi, por qëllimi i tyre ishte më i madh. Ata edukonin dijetarë edukues dhe udhëheqës për shoqërinë. Me fjalë të tjera, të edukonin njerëz, të cilët, me dijen dhe njohjen e tyre, të ndriçonin një ambient të gjerë ku jetonin.

Ajeti fillon me përmendjen e të mësuarit, pastaj përmend mësimdhënien. Fjalët ndryshojnë për nga kuptimi i gjerë. Studimi është më i gjerë dhe përfshin të gjitha llojet e studimeve, me fjalë, me vepra, për studiuesit dhe analfabetët. Kurse fjala mësimdhënie është nëpërmjet shkrimeve dhe shikimit në libër. Ajo është më e veçantë se studimi.

“Ai nuk ju urdhëron që engjëjt dhe profetët t'i merrni për zota...”

Kjo fjali është plotësim i ajetit të mëparshëm. Profetët, ashtu siç nuk i ftojnë njerëzit në adhurimin e tyre, po ashtu nuk i ftojnë ata në adhurimin e melekëve e të profetëve të tjerë. Këtu gjendet përgjigje për politeistët arabë, të cilët besonin se melekët janë vajzat e All'llahut. Në këtë mënyrë i ngjyrosnin engjëjt me ngjyrën e hyjnisë. Edhe pse kishin këtë besim, prapëseprapë ata e konsideronin veten e tyre prej pasuesve të fesë së Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

Gjithashtu, kjo thënie e ajetit është përgjigje edhe për sabi'inët, të cilët thoshin se janë prej pasuesve të Jahjait dhe e ngrinin pozitën e melekëve deri në adhurimin e tyre.

Po ashtu, kjo thënie është përgjigje edhe për jahuditët, të cilët thoshin se Uzejri është i biri i All'lahut, si dhe përgjigje edhe për të krishterët, që thonë se Mesijhu është i biri i All'lahut.

Pra, ajeti u përgjigjet të gjithëve dhe u thotë se profetëve nuk u ka hije që të ftojnë njerëzit në adhurimin e tjetër kënd përveç All'lahut.

Në fund ajeti thotë: **“Vallë, a ju urdhëron të bëheni mohues, pasi i jeni nënshtruar All'lahut?!”**

A është e mundur që Profeti t'ju ftojë juve në mohim, pasi keni zgjedhur për fe Islamin?

Është e qartë se fjala *Islam*, që përmendet këtu, ka kuptim të gjerë, ashtu siç gjendet në shumë vende të tjera në Kur'an. Kuptimi i saj është nënshtrim ndaj urdhrave të All'lahut, besim dhe monoteizëm. Si ka mundësi që Profeti në fillim të ftojë njerëzit në besim e në monoteizëm, pastaj t'i fusë ata në rrugën e politeizmit? Si ka mundësi që Profeti të shembë atë që ndërtuan profetët e tjerë në thirrjen e njerëzve në besim, monoteizëm dhe nënshtrim ndaj urdhrave të All'lahut e t'i ftojë ata në shirk?

Në përmbajtjen e ajetit gjendet edhe mbrojtja e profetëve nga gjynahet dhe mosdevijimi i tyre nga rruga e All'lahut të Madhëruar.

Hulumtim

Ndalimi i adhurimit të njerëzve

Ky ajet lufton qartë çdo lloj adhurimi, përveç adhurimit të All'lahut. Ajeti e edukon njeriun me shpirtin e lirisë dhe të personalitetit të pavarur. Pa këtë liri e pavarësi ai shpirt nuk mund të mbajë emrin njeri.

Nëpërmjet historisë, e dimë se ka pasur njerëz, që, para se të arrinin në pushtet, dalloheshin për inteligjencën e tyre dhe i ftonin njerëzit tek e vërteta, drejtësia, liria dhe besimi. Mirëpo, sapo hipin në karrigen e pushtetit e ndërronin vijën e tyre dalëngadalë, duke menduar vetëm për veten e tyre dhe i ftojnë të tjerët që t'i adhurojnë.

Në realitet, prej mënyrave dalluese të “thirrësve të vërtetë” dhe “të pavërtetë” është se ftuesit e vërtetë, në krye të të cilëve janë të dërguarit dhe imamët, të cilët kanë qenë në majat më të larta të pushtetit, para se të kishin këtë pozitë të lartë udhëheqjeje, ftonin në rrugën e fesë së shenjtë, në rrugën e humanizmit, monoteizmit dhe të lirisë. Ndërsa ftuesit e së pavërtetës, e para punë që bëjnë kur arrijnë në pushtet, ftojnë për veten e tyre dhe i nxisin njerëzit në një lloj adhurimi për ta. Kjo si rezultat i servilizmit të njerëzve të dobët që i rrethojnë, ngushtimi i horizontit të mendjes dhe i mendjemadhësisë së tyre.

Gjendet thënie nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) nëpërmjet së cilës nxjerr në pah personalitetin e lartë të tij. Dhe kjo thënie konsiderohet edhe dëshmi i këtij hulumtimi.

Në kohën që imami mbërriti në tokën e Enbarit, një prej qyteteve kufitare të Irakut, të gjithë ranë në sexhde para tij, sipas

traditës që kishin. Imami u inatos prej këtij veprimi që bënë dhe u bërtiti me zë të lartë: “Ç’është kjo që vepruat?”

Ata thanë: “Është prej moralit tonë që të madhështojmë udhëheqësit tanë.”

Ai u tha: “Betohem në All’llah, ky veprim i juaji nuk i sjell dobi udhëheqësve tuaj. Ju i bëni keq vetes suaj, si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër. Sa e humbur është fatkeqësia pas së cilës gjendet ndëshkimi! Dhe, sa e fituar është thirrja për tek e vërteta kur me të është siguria prej zjarrit.”¹



¹ “Nehxhul Belaga”, fjalët e urta, fjala 37. “Uesailu Shiah”, vëll. 12, f. 228.

Ajetet 81-82

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ النَّبِيِّينَ لَمَا آتَيْتُكُمْ مِنْ كِتَابٍ وَحِكْمَةٍ ثُمَّ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مُصَدِّقٌ لِمَا مَعَكُمْ لَتُؤْمِنُنَّ بِهِ ۖ وَلَتَنْصُرُنَّهُ ۚ قَالَ أَأَقْرَرْتُمْ وَأَخَذْتُمْ عَلَىٰ ذَٰلِكُمْ إِصْرِي ۗ قَالُوا أَقْرَرْنَا ۚ قَالَ فَاشْهَدُوا ۚ وَأَنَا مَعَكُمْ مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿٨١﴾ فَمَنْ تَوَلَّىٰ بَعْدَ ذَٰلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ

الْفَاسِقُونَ ﴿٨٢﴾

“Kujto kur All’llahu mori besëlidhjen nga profetët (dhe u tha): “Çfarëdo që t’ju jap prej Librit dhe urtësisë, kur t’ju vijë një i Dërguar, vërtetues i asaj që ju është dhënë, pa dyshim që duhet ta besoni dhe ta ndihmoni atë! A e pranoni këtë dhe barrën që po ju ngarkoj?” Ata u përgjigjën: “E pranojmë.” (All’llahu) u tha: “Bëhuni dëshmitarë, se edhe Unë bashkë me ju jam dëshmitar. Kurse ata që i shmangen detyrës pas kësaj, me të vërtetë janë të këqij.”

Komentimi

Besëlidhja e shenjtë

Ajetet e mëparshme treguan për shenjat e Profetit të Islamit, të pranishme në librat e profetëve paraardhës. Ajetet në fjalë flasin për një parim të përgjithshëm, që është: “Profetët paraardhës dhe ndjekësit e tyre i dhanë besën All’llahut se do t’i binden profetëve që do të vijë më pas. Në shtesë të besimit të tyre në këta profetë, ata nuk do të ngurrojnë për asgjë për t’i ndihmuar ata të dërguar që të realizojnë qëllimet e tyre. Ajeti thotë: **“Kujto kur All’llahu mori besëlidhjen nga profetët** (dhe u tha): **“Çfarëdo që t’ju jap prej Librit dhe urtësisë, kur t’ju vijë një i Dërguar, vërtetues i asaj që ju është dhënë, pa dyshim që duhet ta besoni dhe ta ndihmoni atë!...”**”

Në realitet, ashtu siç i respektojnë të dërguarit dhe popujt pasardhës të dërguarit paraardhës dhe fetë e tyre, po ashtu edhe ata që ishin më parë i respektojnë të dërguarit që vijnë pas tyre. Në Kur’an ka shumë tregues për qëllimin e përbashkët të profetëve. Ky ajet është një shembull prej tyre.

Fjala *el mijthak*, vjen nga *el thuk*, që do të thotë *diçka që fton në bindje, qetësi dhe në mbështetje në të*. El mijthaku është konsensus i fortë. Marrja e besës nga profetët është e shoqëruar me marrjen e besës prej pasuesve të tyre. Tematika e kësaj besëlidhjeje ishte se, kur të vijë një i dërguar, thirrja e të cilit është në përputhje me thirrjen e të dërguarve para tij, atëherë ai duhet besuar dhe duhet ndihmuar. Për ta përforcuar më shumë këtë çështje, ajeti thotë: **“A e pranoni këtë dhe barrën që po ju ngarkoj?” “Ata u përgjigjën: “E pranojmë.”**

Pastaj, për ta forcuar më shumë këtë çështje të rëndësishme, All’llahu, thotë: “Jini dëshmitarë për këtë dhe Unë jam dëshmitar mbi

ju dhe pasuesit tuaj: (All'llahu) **u tha: “Bëhuni dëshmitarë, se edhe Unë bashkë me ju jam dëshmitar.”**

Në ajetin tjetër Kur'anit i qorton dhe i kërcënon thyerësit e besës. Ajeti thotë: **“E kush shmanget pas kësaj, me të vërtetë janë të këqij.”**

Pas gjithë këtij konstatimi në marrjen e besës e kundërshton besimin ndaj profetëve, ndër ta edhe profeti Muhammed, për të cilin përgëzuan për ardhjen e tij librat e mëparshëm, ai është i keq dhe kundërshtues i urdhrit të All'llahut të Madhëruar. Ne e dimë se All'llahu nuk i udhëzon të këqijtë kokëfortë e të pabindur, siç thuhet edhe në ajetin 80 të sures “Teube”: **“...All'llahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.”**¹ Ai që nuk ka pjesë në udhëzimin e All'llahut, fundi i tij do të jetë zjarr i Xhehennemit.

Hulumtime

1- Vallë, ky ajet është i veçantë për përgëzimin e profetëve të mëparshëm për ardhjen e profetit Muhammed apo përfshin çdo profet që dërgohet pas profetit paraardhës?

Nga ajeti duket se kjo është çështje e përgjithshme, edhe pse vula e profetëve është vërtetësia e tij më e dukshme. Ky kuptim i gjerë është në përputhje edhe me shpirtin e njohjeve të Kur'anit. Sipas disa transmetimeve kuptojmë se qëllimi i ajetit është Profeti i Islamit, kjo për shkak të komentimit të ajetit dhe të përputhshmërisë së tij me më të vërtetën e dukshme dhe nuk ka kuptimin e kufizimit.

Fahru Raziu përmend në tefsirin e tij thënien nga imam Aliu (*Paqja qofitë mbi të!*) ku thotë: “

¹ Shiko edhe suren “Maide”, ajeti 108, suren “Teube”, ajeti 24 dhe suren “SaP”, ajeti 5.

2- Nervozizmi verbues

Historia na flet se pasuesit e një feje nuk e kanë të lehtë të heqin dorë nga feja e tyre dhe të pasojnë profetë të rinj, të dërguar nga ana e All'lahut të Madhëruar. Përkundrazi, ata janë të kapur fort me fenë e tyre të vjetër, e mbrojnë atë sikur të jetë pjesë e ekzistencës së tyre dhe besojnë se lënia e saj është zhdukje e kombësisë së tyre. Për këtë, ata e kanë të vështirë pranimin e fesë së re. Vërtet, burimi i shumë luftërave fetare, të ndodhura gjatë historisë, është pikërisht ky nervozizëm verbues e i ngurtë ndaj fesë së mëparshme.

Mirëpo ligji i përsosmërisë dhe i ngritjes thotë se këto fe duhet të vijnë njëra pas tjetrës dhe t'u paraqesin njerëzve njohjen e All'lahut, të vërtetën, drejtësinë, besimin, moralin, humanizmin dhe virtytet e larta. Njësoj si fëmija që kalon fazat e mësimave derisa arrin në marrjen e diplomës në fakultet apo universitet.

Përmendja e besëlidhjes së profetëve dhe e popujve për profetët që do të vijnë, që përmendet në këtë ajet, mund të ketë si qëllim edhe shmangien prej këtij nervozizmi verbues e ngurtësues. Mirëpo, është për të ardhur keq se edhe sot e gjejmë këtë lloj nervozizmi te pasuesit e feve të vjetra dhe nuk binden para të vërtetave të reja.

Ajetet 83 – 85

أَفْغَيْرِ دِينَ اللَّهِ يَبْغُونَ وَلَهُ أَسْلَمَ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا
 وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴿٨٣﴾ قُلْ ءَامَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ عَلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ
 عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ
 وَعِيسَىٰ وَالنَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ
 مُسْلِمُونَ ﴿٨٤﴾ وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ
 مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٨٥﴾

“A mos kërkoni ata diçka tjetër përveç fesë së All’llahut, ndërkohë që Atij i përuken të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?! Thuaj: “Ne besojmë All’llahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij i përulemi. Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur.”

Komentimi

Islami, feja më e përkryer e All'lahut

Deri tani u fol për fetë e shkuara. Duke filluar nga këto ajete, fjala është për Islamin. Në këto ajete u tërhiqet vëmendja ithtarëve të Librit dhe ndjekësve të feve të mëparshme që të pasojnë Islamin.

Ajeti fillon me pyetje: **“A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së All'lahut...?”** Vallë, ata duan fe tjetër përveç fesë së All'lahut? Feja e All'lahut nuk është gjë tjetër veçse bindje ndaj ligjeve të Tij. Dhe, të gjitha këto ligje janë të përmbledhura në formë të plotë në fenë e Profetit të Islamit. Nëse ata kërkojnë fenë e vërtetë, ata duhet të ndjekin Islamin.

“...ndërkohë që Atij i përuken të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!”

Kur'ani fillon me sqarimin e Islamit, me kuptimin e tij të gjerë. Ai thotë se çdo gjë, që gjendet në qiej e në tokë, ose e thënë ndryshe, të gjitha krijesat, që gjenden në qiej e në tokë, i përuken dhe i nënshtrohen urdhrave të All'lahut: “me hir a me pahir”. Nganjëherë kjo përukenje është “me hir” ose zgjedhëse. Dhe herë tjetër është “me pahir” sipas “ligjeve të krijimit”.

Për sqarim më të shumtë themi: Tek All'lahu ka dy lloj urdhrash për ekzistencën. Disa urdhra të Tij janë në atë formë që sundojnë krijesat e ndryshme të ekzistencës, siç janë ligjet e natyrës dhe të metafizikës. Këto krijesa i përuken Atij me pahir dhe nuk e kundërshtojnë përukenjen. Kjo është një lloj përukenjeje dhe nënshttrimi ndaj ligjeve të All'lahut, p.sh: rrezet e diellit që bien mbi dete, avullimi i ujit të tyre, pikat e ujit të shiut që zbresin nga qielli, bimët që mbijnë dhe rriten, lulet që çelin, etj, të gjitha këto janë të përukurura ndaj ligjeve të krijimit.

Lloji tjetër i urdhrave të All'llahut janë “urdhrat teshriijeh”. Ato janë ligje që gjenden në legjislacionet qiellore dhe te mësimet e të dërguarve. Përulja para këtyre urdhrave është *tanij-zgjedhës*. Besimtarët, që u nënshtrohen këtyre urdhrave, janë myslimanët e vërtetë.

Meqenëse fjala *esleme-përulen*, *nënshtrohen*, që gjendet në këtë ajet është përdorur me kuptim më të gjerë se fjala Islam, pra me kuptimin që përfshin të dy llojet e urdhrave të All'llahut, për këtë ajeti thotë se një grup përulen me hir, siç janë besimtarët dhe një grup tjetër përulen me pahir, siç janë jobesimtarët. Prandaj, i shohim jobesimtarët të mos u nënshtrohen disa urdhrave të All'llahut. Përse nuk u nënshtrohen të gjitha urdhrave të All'llahut dhe fesë së vërtetë?

Për komentimin e këtij ajeti gjendet edhe një alternativë tjetër, që e përmendin shumë komentues, edhe pse nuk bie në kundërshtim me ato që thamë. Ajo është se besimtarët, të cilët ndodhen në një gjendje qetësie, ecin drejt All'llahut me plot bindje dhe zgjedhje. Kurse, jobesimtarët ecin drejt All'llahut vetëm kur i godasin fatkeqësitë dhe problemet e vështira. Ata i luten Atij dhe i kërkojnë rrugëzgjdhje. Në situata të zakonshme ata nuk i binden All'llahut, mirëpo në vështirësi ata i drejtohen vetëm Atij.

Nga ato që u thanë sqarohet se fjala *men*, që gjendet në ajet, sipas sintaksës së gjuhës arabe, përfshin krijesat arsyetuese dhe joarsyetuese, edhe pse në të shumtën e rasteve përdoret për arsyetueset, mirëpo këtu është përdorur për arsye shumice.

Fjala *teuan-me hir*, tregon për krijesat arsyetuese dhe besimtare, ndërsa fjala *kerhan-pahir*, tregon për jobesimtarët dhe për krijesat joarsyetuese.

“Thuaj: “Ne besojmë All'llahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait

dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij i përulemi.”

Në këtë ajet, All'llahu i Madhëruar e urdhëron Profetin dhe myslimanët, se, përveç besimit në atë që iu shpall profetit Muhammed, ata duhet të shfaqin besimin për të gjitha shpalljet dhe të dërguarit e mëparshëm dhe të thonë se nuk bëjmë dallim mes tyre. Të gjithë janë të vërtetë dhe të ardhur nga All'llahu. Ne i pohojmë të gjithë, sepse të gjithë kanë qenë udhëheqës të dërguar nga All'llahu. Ata u dërguan për udhëzimin e njerëzimit. Ne i përulemi plotësisht urdhrave të All'llahut dhe nuk bëjmë dallime.

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur.”

Fjala *jebtëgi* vjen nga fjala *el ibtiga*, që do të thotë *kërkim dhe përpyetje*. Përdoret për çështje të mira dhe jo të mira. Këtu mbyllet hulumtimi me konkluzionin e përgjithshëm se feja e vërtetë është Islami. Kjo do të thotë përulje ndaj urdhrave të All'llahut, me kuptim të përgjithshëm. Ndërsa me kuptim të veçantë do të thotë kalim në fenë islame, e cila është feja më e plotë ndër fetë e tjera.

Ajeti thotë se, përveç Islamit, asgjë tjetër nuk pranohet, me gjithë respektin për fetë e tjera. Shembulli është i ngjashëm me studentët në universitete, të cilët në të njëjtën kohë i respektojnë librat mësimorë të fazave të mëparshme, fillore e të mesme, mirëpo ata duhet të studiojnë librat dhe mësimet e caktuara për fazën finale. Po kështu edhe Islami. Ata, të cilët nuk pasojnë këtë të vërtetë, nuk do t'u pranohet asgjë dhe do të jenë të humbur.

“...dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”, sepse ai pasurinë e ekzistencës së tij e shpenzoi në rrugën e legjendave, të zakoneve të pavlera dhe në rrugën e fanatizmit, të padijes dhe të racizmit. S'ka dyshim se ai është humbës në këtë tregti. Kur njeriu humbet pasurinë e ekzistencës së tij, ai do të përballet me dënim e ndëshkim në Ditën e Kiametit.

Disa komentues kanë përmendur se ky ajet ka zbritur për dymbëdhjetë hipokritët, të cilët shfaqën besimin, pastaj e mohuan. Ata dolën nga Medina dhe shkuan në Mekë. Atëherë zbriti ajeti, që i qorton se, kush përqafton fe tjetër përveç Islamit, ai do të jetë prej të humburve.¹

Në librin “Ed Durul Menthur”, për thënien e All’llahut të Madhëruar, përmendet një transmetim që e përcjellin Ahmedi dhe Tabarani nga Ebu Hurejra, i cili ka thënë se profeti Muhammed ka thënë: “Në Ditën e Kiametit do të paraqiten punët para All’llahut.

Kur vjen namazi ai thotë: “O Zot, unë jam namazi.”

All’llahu i thotë se ti je mirë.

Pastaj vjen sadakaja dhe thotë: “O Zot unë jam sadakaja.”

All’llahu i thotë: “Ti je mirë.”

Pastaj vjen agjërimi dhe thotë: “O Zot, unë jam agjërimi.”

All’llahu i thotë: “Ti je mirë.”

E më pas do të vijnë të gjitha punët dhe All’llahu do t’u thotë: “Ti je mirë.”

Pastaj do të vijë Islami dhe do të thotë: “O Zot, Ti je Paqe dhe unë jam Islami!” All’llahu i thotë: “Ti je mirë. Sot, nëpërmjet teje do të dënoj dhe do të shpërblej.” All’llahu në Librin e Tij, Kur’anin Fisnik thotë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur.”**²

¹ Tefsijri “Ruhul Xhinan”, vëll. 3, f. 100.

² Tefsijri “Ed Durul Menthur”, vëll. 2, f. 48. “Mexhmau Zeuaid”, vëll. 10, f. 345.

Ajetet 86 – 89

كَيْفَ يَهْدِي اللَّهُ قَوْمًا كَفَرُوا بَعْدَ إِيمَانِهِمْ وَشَهِدُوا أَنَّ الرَّسُولَ حَقٌّ
 وَجَاءَهُمُ الْبَيِّنَاتُ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٨٦﴾ أُولَئِكَ جَزَاءُهُمْ
 أَنْ عَلَيْهِمْ لَعْنَةُ اللَّهِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ ﴿٨٧﴾ خَالِدِينَ فِيهَا لَا
 تُخَفَّفُ عَنْهُمْ الْعَذَابُ وَلَا هُمْ يُنظَرُونَ ﴿٨٨﴾ إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ
 وَأَصْلَحُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٨٩﴾

“E si t’i udhëzojë All’llahu në rrugë të drejtë njerëzit që u bënë mohues, pasi më parë patën besuar e dëshmuar se i Dërguari është i vërtetë dhe u kishin ardhur provat e qarta?! All’llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë ata që janë keqbërës. Mallkimi i All’llahut, i engjëjve dhe i mbarë njerëzve është shpërblimi i tyre. Ata do të jenë përherë në të e, vuajtjet nuk do t’u lehtësohen dhe nuk do t’u jepet afat; përveç atyre që pas kësaj pendohen e përmirësohen, se All’llahu është Falës i madh, Mëshirëplotë.”

Shkaku i zbritjes

Harith ibn Suejdi, i cili ka qenë prej përkrahësve (ensarëve) vrau një njeri të pafajshëm, që quhej Mexhdher ibn Zijad. Nga ky veprim ai e braktisi Islamin prej frikës dhe dënimit. Ai e la Medinen dhe shkoi në Mekë. Atje u pendua për krimin që bëri dhe filloi të mendojë se përse e bëri. Së fundi, vendosi që të dërgojë një prej të afërmeve të tij në Medine për të pyetur profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se a mund të kthehej përsëri në Islam. Atëherë zbritën këto ajete që informojnë pranimin e pendimit të tij me kushte të posaçme. Pastaj Harithi shkoi te profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe u rikthye në Islam. Ai qëndroi besnik dhe zbatues i Islamit deri në fund të jetës së tij, kurse njëmbëdhjetë të tjerë, që e braktisën Islamin, nuk u rikthyen në Islam.¹

Në komentimin “Durul Menthur” dhe në komentime të tjera, shkaku i zbritjes, që u përmend më lart, nuk ndryshon shumë me ato që u thanë më lart.²

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1,2. f. 471. “Kenzu Dekaik”, vëll. 2, f. 152.

² “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 49.

Komentimi

Në ajetet e mëparshme flitej për fenë e vetme, të pranueshme tek All'llahu, që është Islami. Në këto ajete flitet për ata që e pranuan Islamin e më pas e braktisën dhe e lanë. Këtij njeriu i thuhet *murted-renegat*. Ajeti thotë: **“E si t’i udhëzojë All’llahu në rrugë të drejtë njerëzit që u bënë mohues, pasi më parë patën besuar e dëshmuar se i Dërguari është i vërtetë dhe u kishin ardhur provat e qarta?!...”**

Ajeti thotë se All’llahu nuk i ndihmon këta lloj njerëzish për t’i udhëzuar. Përse vallë? Arsyeja është e thjeshtë, sepse ata e njohën Profetin me argumente dhe fakte të qarta dhe e pranuan mesazhin e tij. Pasi e lanë Islamin, u bënë të padrejtë dhe keqbërës. Ai njeri, që bëhet keqbërës me dije të mëparshme, nuk e meriton udhëzimin e All’llahut. **“...All’llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë ata që janë keqbërës.”**

Kuptimi i fjalës *el belinat-prova dhe argumente të qarta*, që përmendet në ajet është për Kur’anin Fisnik dhe për mrekullitë e tjera të profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*). Kuptimi i fjalës *edh dhalimu*, është për atë që i bën padrejtësi vetes së vet, së pari, duke braktisur Islamin, dhe, së dyti, është shkak për humbjen e të tjerëve. Ajeti vijues thotë: **“Mallkimi i All’llahut, i engjëjve dhe i mbarë njerëzve është shpërblimi i tyre.”**

Ndëshkimi i atyre që braktisin të vërtetën pasi e njohën atë siç thuhet në ajetin paraardhës, është se ata i mallkon All’llahu, engjëjt dhe të gjithë njerëzit.

Në origjinal fjala *el la’nu-mallkimi*, ka kuptimin e largimit e të të përçënit nga rruga e saktë. Për këtë, mallkimi i All’llahut do të thotë largimi i njeriut prej mëshirës së Tij.

Kurse mallkimi i melekëve dhe i njerëzve mund të jetë zemërim dhe përçenie shpirtërore, ose ata i kërkojnë All’llahut që t’i

largojë këta lloj njerëzish nga mëshira e Tij. Në realitet, këta persona janë të zhytur në gjynahe e në shturje deri në atë shkallë, sa që mohohen prej çdo logjikuesi në botë, prej njerëzve apo prej melekëve. **“Ata do të jenë përherë në të e, vuajtjet nuk do t’u lehtësohen dhe nuk do t’u jepet afat”**

Ky ajet na thotë se ata njerëz, përveç të qenit në pozitën e mallkimit të përgjithshëm, do të qëndrojnë të tillë përgjithmonë. Ata janë si shejtani, i cili është gjithmonë i mallkuar. S’ka dyshim se rezultati i veprës së tyre do t’i bëjë që të qëndrojnë gjithmonë në dënim, i cili as nuk do t’u lehtësohet e as nuk do të ketë afat.

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë u hap rrugën e rikthimit atyre njerëzve që braktisin Islamin dhe i fton ata në pendim. Kjo, sepse qëllimi i Kur’anit është edukimi dhe ndreqja e njeriut. Prej rrugëve më të rëndësishme është hapja e derës së rikthimit për gjynahqarët dhe keqbërësit, me qëllim që të shlyejnë ato të këqija që bënë. Ajeti thotë: **“...përveç atyre që pas kësaj pendohen e përmirësohen, se All’lahu është Falës i madh, Mëshirëplotë.”**

Ky ajet, si shumë ajete të tjera në Kur’an, pasi flet për pendimin, flet edhe për të menduarit rreth gjynaheve të mëparshme. Kjo kuptohet nga fraza *ne eslehu- përmirësohen, ndreqen*. Ajeti sqaron se pendim nuk do të thotë thjesht të pendohesh për ato që veprove më parë dhe të vendosësh se nuk do t’i bësh në të ardhmen. Por, kusht i pranimit të pendimit është që penduesi, nëpërmjet punëve të tij të mira në të ardhmen, t’i fshijë të gjitha ato punë të këqija që veproi në të shkuarën.

Prandaj, në shumë ajete të Kur’anit shohim se pendimin e shoqëron puna e mirë, si p.sh: **“...përveç atyre që pendohen, që**

besojnë dhe bëjnë punë të mirë.”¹ Përndryshe, pendimi nuk është i plotë. Nëse veprojnë siç thotë ajeti, ata do të fitojnë faljen e All’llahut dhe mëshirën e Tij. **“...All’llahu është Falës i madh, Mëshirëplotë.”**

Nga ky ajet përfitohet se mëkati konsiderohet prej mangësisë së besimit. Pas pendimit, njeriu i penduar bën ripërtëritjen e besimit, me qëllim që të pastrohet nga kjo mangësi.

Hulumtim

A pranohet pendimi i renegatit (murtedit)?

Nga ajeti i lartpërmendur dhe nga shkaku i zbritjes duket se pranimi i pendimit të renegatit (atij që përfaqon Islamin e pastaj e braktis atë) është i lidhur me llojin e renegatit.

Kemi dy lloj renegatësh:

I pari: Renegat nga natyra krijuese. Quhet kështu ai njeri që ka lindur prej prindërve myslimanë e pranon Islamin e më pas heq dorë prej tij.

I dyti: Renegat mil’lij. Quhet kështu ai njeri që ka lindur prej prindërve jomyslimanë.²

¹ Sure “Merjem”, ajeti 60.

² Sqarimet më të detajuara rreth kësaj çështjeje gjenden në librat e jurisprudencës islame.

Ajetet 90 – 91

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بَعَدَ إِيْمَانِهِمْ ثُمَّ أَزْدَادُوا كُفْرًا لَنْ تُقْبَلَ تَوْبَتُهُمْ وَأُولَئِكَ هُمُ الضَّالُّونَ ﴿٩٠﴾ إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَمَاتُوا وَهُمْ كُفَّارٌ فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْ أَحَدِهِمْ مِلءُ الْأَرْضِ ذَهَبًا وَلَوْ افْتَدَى بِهِ ۗ أُولَئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ وَمَا لَهُمْ مِنْ نَاصِرِينَ ﴿٩١﴾

“Vërtet, atyre që mohojnë pasi patën besuar dhe pastaj e shtojnë mohimin e tyre, nuk do t’u pranohet pendimi. Pikërisht këta janë ata që kanë humbur. Nuk ka dyshim se atyre që e mohojnë besimin dhe vdesin mosbesimtarë, nuk do t’u pranohet asnjë shpërblesë, edhe sikur ajo të ishte sa e tërë toka e mbuluar me ar. Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe askush nuk do t’i ndihmojë.

Shkaku i zbritjes

Disa komentues kanë thënë se ajeti i parë ka zbritur për ithtarët e Librit që i besuan profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para dërgimit të tij.¹

Disa të tjerë kanë thënë se ka zbritur për Harith ibn Suejdin dhe njëmbëdhjetë të tjerët, të cilët, për shkaqe të ndryshme, hoqën dorë nga Islami. Pastaj Harithi u pendua dhe u rikthye në Islam, kurse të tjerët e refuzuan ftesën e tij dhe thanë: “Ne do të qëndrojmë në Mekë dhe do të vazhdojmë vëzhgimin e Muhammedit dhe do të presim mposhtjen e tij. Nëse kjo realizohet, do të jetë e mirë. Nëse jo, porta e pendimit është e hapur dhe do të pendohemi në kohën që duam dhe atëherë do të kthehemi tek Muhammedi dhe ai do ta pranojë pendimin tonë!” Kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llabut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*) e çliroi Mekën dhe disa hynë në Islam dhe iu pranua pendimi, ata që këmbëngulnin në mohim, u zbriti ajeti i dytë.²

¹ Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, tefsijri “Ruhul Meanij”, fundi i ajetit në fjalë. “Biharul Anuar”, vëll. 22, f. 17.

² I njëjti burim.

Komentimi

Pendimi i kotë

“Vërtet, atyre që mohojnë pasi patën besuar dhe pastaj e shtojnë mohimin e tyre, nuk do t’u pranohet pendimi. Pikërisht këta janë ata që kanë humbur.”

Në ajetet e mëparshme bëhej fjalë për ata që pendohen sinqerisht prej devijimit të tyre nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Në këtë ajet bëhet fjalë për ata që nuk u pranohet pendimi. Ata janë prej atyre që në fillim besuan, pastaj hoqën dorë, u bënë jobesimtarë dhe këmbëngulnin në mohimin e tyre. Ata refuzuan bindjen ndaj urdhrave të All’llahut deri sa iu vështirësuan çështjet e më pas vetë ata u detyruan të rikthehen në Islam.

All’llahu nuk e pranon pendimin e tyre, sepse ata nuk e bënë pendimin për hir të All’llahut, por ishin të detyruar në shfaqjen e pendimit, pasi panë triumfin e myslimanëve. Prandaj, pendimi i tyre ishte sa për sy e faqe dhe për këtë nuk u pranohet. Gjendet alternativë tjetër për komentimin e këtij ajeti: Të tillë njerëz, kur arrijnë në prag të vdekjes, pendohen me të vërtetë. Mirëpo pendimi i tyre nuk pranohet, sepse koha e pendimit ka ikur, siç do të sqarohet në komentimin e ajetit 18 të sures “En-Nisa”, që thotë: **“Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë po pendohem...”**

Ajeti i dytë thotë: **“Nuk ka dyshim se atyre që e mohojnë besimin dhe vdesin jobesimtarë, nuk do t’u pranohet asnjë shpërblesë, edhe sikur ajo të ishte sa e tërë toka e mbuluar me ar...”**

Ajeti është i përveçëm për ata që e kalojnë jetën e tyre me mosbesim, pastaj vdesin po në këtë gjendje. Kur’ani thotë se, pasi atyre u është sqaruar rruga e drejtë dhe ata ecin në rrugën e shtrembër të mëkatit, në të vërtetë ata nuk janë myslimanë dhe nuk u pranohet

pendimi, çfarëdo që të bëjnë. Për ata nuk ka asnjë rrugë shpëtimi, edhe sikur të shpenzojnë gjithë tokën e mbushur me flori.

Është e qartë se qëllimi i thënies për shpenzimin e kësaj sasive të madhe floriri tregon për pavlefshmërinë e shpenzimit të tyre, sepse ky shpenzim është i shoqëruar me urrejtjen që kanë zemrat dhe shpirtërat e tyre për All'lahun.

Përsa i përket vendit të këtij shpenzimi, a është në këtë jetë apo në Ahiret, disa komentues kanë përmendur dy alternativa. Mirëpo pamja e jashtme e ajetit tregon për Botën Tjetër. **“...dhe vdesin mosbesimtarë...”** Nëse zotëronin gjithë tokën të mbushur me flori dhe mendonin se do të përfitojnë prej kësaj pasurie për të hequr dënimin prej vetes së tyre, kanë gabuar, sepse kjo taksë dhe pagesë nuk është e mundur t'ua largojë atyre dënimin me të cilin do të përballen.

Në të vërtetë, përmbajtja e këtij ajeti është e ngjashme me përmbajtjen e ajetit 15 të sures “Hadijd”: **“Sot nuk pranohet prej jush kurrfarë shpërblese e as prej atyre që nuk kanë besuar: zjarri është vendbanimi juaj, ai është për ju; eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai!”**

Në fund ajeti thotë: **“...Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe askush nuk do t'i ndihmojë.”**

S'ka dyshim se ata do të marrin dënimin e rëndë e të dhembshëm. Askush nuk ka mundësi t'i ndihmojë ata apo të bëjë ndërmjetësim për ta, sepse ndërmjetësimi ka kushte dhe kritere dhe më i rëndësishmi është besimi te All'llahu. Për këtë arsye, sikur të mblidhen të gjithë ndërmjetësuesit për shpëtimin e një mohuesi prej zjarrit të Xhehennemit, nuk do t'u pranohet ndërmjetësimi.

Përderisa ndërmjetësimi është me lejen e All'llahut të Madhëruar, atëherë ndërmjetësuesit nuk bëjnë kurrë ndërmjetësim për njerëz të ngjashëm që nuk e meritojnë ndërmjetësimin, sepse ndërmjetësimi ka nevojë për leje dhe leja e All'llahut nuk i përfshin njerëzit e pamërituar.